This is a reproduction of a library book that was digitized by Google as part of an ongoing effort to preserve the information in books and make it universally accessible.

Google books

https://books.google.com

Digitized by Google

THE
UNIVERSITY OF
CHICAGO
LIBRARY

Digitized by Google

Digitized by Google

THE
UNIVERSITY OF
CHICAGO
LIBRARY

Digitized by Google

Digitized by Google

Digitized by Google

BOTIME TE FEDERATES
PAN-SHQIPTARE "VATRA"

HISTORIA
E
SKENDERBEUT

(*Gjerq Kastriotit*)

MBRETIT TE SHQIPERISE
1412-1468

Prej Peshkopit Theofan

(Fan S. Noli)

DR960
.N6
C.1
Gen

E Botuar prej Shoqërisë Korchare
"Arësimi"

BOSTON
Shtypeshkronja e "Diellit"
1921

Digitized by Google





Digitized by Google

Maria Stilián Noli

Memes se shtrenjte

Per kujtim dhe mirenjohje

Digitized by Google

Digitized by Google

PARCTHCNIE

Qcllimi im, kur shkrova kcté vepre, ishte t' i jap pópullit tonc nje historí te Skenderbeut dhe kjó libre duhet gjykuar kryesísht nga kjó pikepamje. Po nuke harrova te marr ne sy qe, midís kendónjesve tane, ka disá qe do mos kenáqeshin me nje historí fjesht popullore dhe u-perpoqa, me sa ishte e mundur, te kendonj te gjitha dokumentat rellative dhe te shkruanj nje historí pak a shume kritike, te bazuar mi fakte te vertetúara dhe jo mi legjenda romantike te pashoshítura. Atjé ku s' ishte e mundur t' a shqipnja legjenden nga historia, e lashe ashtú si e gjeta ne historianet e vjeter me shpresen t' a çkoklavit mé vone kur te kem perpara dokumenta, te cilat te me japin perin e Arianes. Si kryebaze te historise sime mora mé pare historín' e Tivárasit dhe pastáj até te Barletit. Nga historianet moderne mora si udheheqes kryesór, gjer me nje pike, Fallmerayer-in, historia e te cilit eshte nje kryevepre, si pas kohes kur eshte shkruar, dhe ka vetem nje mungim, qe auktorí i saj s' kishte perpara historín' e Tivárasit. Fallmerayer-i e perménd Tivárasin, po per çudí s' e kishte shtudiuar dhe merr per kryebaze historín' e Barletit. Perfitova shume nga Paganel-i, Hahn-i, Hopf-i dhe savantet e tjere qe kane shkruar mi Skenderebene pas Fallmerayer-it.

Digitized by Google

Dyke mbaruar këtó radhë të paka, e quanj për detyrë të shtonj që këté veprë Shqiptaret nukë m' a detyrojnë aqë mua ëa pleqve të Shoqërisë Korçare "Arësimi"—dhe veçanërísht kryetarit të saj, Z-it Kostandín Tashko—që më ngarkuan të shkruanj dhe kështú më shtrenguan t' a shtudiónj thellërísht historín' e Skënderbeut.

Auktori

Boston, Mass., 20 Maj, 1920

Digitized by Google

HYRJE

Kryeburimet pɛr historín' e Skɛnderbeut janɛ Tivárasi dhe Barleti:

I. *Historia Scanderbegi, edita per quendam Albanensem,* domethɛnɛ *Historia e Skɛnderbeut, e botuar prej njɛ Shqiptari,* e cila u-shtyp latinisht nɛ Venetík mɛ 2 tɛ Prillit, 1480, pothua dymbɛdhjetɛ vjet e tre muaj pas vdekjes sɛ Skɛnderbeut. Pɛr fat tɛ keq, teksti latinísht duket qɛ humbi dhe, nga sa dimɛ nukɛ gjɛndet nɛ asnjé biblioteke. Kemi vetɛm njɛ kthim italísht tɛ kesáj historie prej njɛ prifti italián, *Giammaria Biemmi,* tɛ botuar nɛ Brescia mɛ 1742 dhe pastáj mɛ 1756 gjithɛ n' até qytét me títullin *Istoria di Giorgio Castrioto, detto: Scander-Begh,* domethɛnɛ *Historia e Gjergj Kastriotit, tɛ qúajtur Skɛnderbé.* Nga historianɛt e vjetɛr tɛ Skɛnderbeut, Biemmi ɛshtɛ i vétɛmi qɛ e pati pɛrpara dhe e pɛrdori ketɛ libre si kryebazɛ tɛ historisɛ sɛ tij. Nga Biemmi mɛsojmɛ qɛ ky *Shqiptár* ishte nga *Tivari* dhe e shkroj historín' e Skɛnderbeut pas rapórteve qɛ i jipte i vellàj, i cili ishte oficér nɛ garden mbretɛrore. Biemmi prapɛ na thotɛ qɛ libra e *Tivárasit* ishte e vjeturuar dhe e çjerur; nɛ krye dhe nɛ funt mungonin disá fletɛ; nɛ mest ca faqe ishin prishur nga dy mapa, niste nga faqja 10 dhe mbaronte nɛ faqen 92, qɛ kur hyri Skɛnderbeu nɛ Krujɛ gjer nɛ rrethimin ɛ

Digitized by Google

dytε tε Krujεs prej Sulltán Mehmedit II dhe Ballabán Pashεs. Fallmerayer-i (1) εshtε i mendjes qε *Anonimi Tivarás* s' qé tjatεr veç kardinali Pal Engjelli, kryepeshkóp i Dúresit, legát i Pashεs nε Shqipεrí, dhe kεshilltár i besuar i Skεnderbeut. Pal Engjelli (2) ishte nε kuptimin e plottε tε fjalεs ministri i púnεve tε jashtme i Skεnderbeut, se aý shkrúante letrεkembimet latinisht me fuqit' e húaja dhe aý udhεhiqte politikεn e jashtme tε Skεnderbeut. Barleti e pεrshkruan si "shokun e veprave tε rezíkeve dhe tε kεshíllave, dhe bashkεpunεtorin e pandarε tε Skεnderbeut" (3). Lεvdon kryemendjen, zotesín' e fjalεs dhe dijen e tij tε gjerε. Theoria e Fallmerayer-it forcohet nga dy fakte: Pal Engjelli ishte nga dera e prínceve tε Tivarit dhe kishte njε vellá oficer pranε Skεnderbeut (4). Sidó

1).—Dr Jakob Philipp Fallmerayer, Das *Albanesische Element in Griechenland,* botuar nε *Abhandlungen der Historischen Classe der Koeniglich Bayerischen Akademie der Wissenschaften,* Vellím 8 dhe 9, Munchen, 1866, shih Vεll. 9, f. 11.

2).—I biri i Kontit Andrea Engjelli tε Drishtit, shtepia e tε cilit kishte mbrεtεruar nε Tivár. "Discendea dalla casa Angeli che una volta godea la Signoria di Antivari: cosi riferisce l' Antivarino." Biemmi, Libre II, f. 126, shenim 1.

3).—Omnium laborum, periculorum, atque consiliorum socius atque particeps velut Aeneae alius Achates.—Barleti, Vita Scanderbegi, Libre X, f. 288, Zagabria 1743.

4).—Barleti, L. XI, f. 331.

Digitized by Google

qe te jete, historia e Tivárasit qendrón ne radhen e pare jo vetem se duket qe eshte shkruar prej nje njeriu qe e shkoj jeten e tij prane herójt qe pershkruan, po dhe nga shkaku qe i rrefén ngjarjet, te mira a te liga, me ftohtesí dhe si historián prej race, pa shtuar e pa hequr, dyke dhene motin, múajin dhe diten per çdo beteje, dhe veçanerísht dyke treguar disá intriga dhe komplote te shemtúara te princeve shqiptare, te cilat Barleti e quan per detyre patriotike te mos i permende. Qýsh libra e tij e vyer u-harrua dhe humbi na e shpjegón Biemmi: latinishtja dhe shtylla e Tivárasit ishin te thata, te pakréhura dhe te pakéndeshme (1). Qe t' a thomi shqip: Tivárasi kendonte bukur, po zeri s' i punonte fare. Per çudí, fati e ndoqi libren e Biemmit gjithashtú si dhe libren e Tivárisit. Vertét nuke humbi, po u-harrua dhe i pari nga historianet moderne qe e perdori ishte konsulli austriák Pisko (2) ne funt te shékullit te nentembedhjette.

II.—*Historia de Vita et Gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis,* domethene *Historia e Jetes dhe te Trimerive te Skenderbeut, Princit te Shqiptereve,* prej priftit shkodrán Marín Barletit, e botuar latinísht ne Venetí me 1504, afró 36 vjet pas vdekjes se Skenderbeut. Kjó eshte historia m' e

1).—Biemmi, Prefazione.

2).—Julius Ernest Pisko, Scanderbeg, Historische Studie, Wien, 1894.

Digitized by Google

vjetєr e Skєnderbeut qє ndodhet nє latinishten ashtú si u-shkrua prej auktorit tє saj. Barleti ishte disá vjet m' i ri se Tivárasi. Ishte djalє kur vdiq Skєnderbeu, njihte personalisht shokєleftónjєsit e tij, kishte pєrpara syve dokumenta tє kohєs, kishte vizituar fushat e bєtéjave qє pєrshkruan, u-ndoth nє rethimin e Shkodrєs dhe pastáj u-vendós nє Venetí, ku shkroj vepрєn e tij me famє pєr trimin e math tє shékullit tє tij. Libra e tij єshtє themelia e historive tє panúmurta qє janє shkruar mi Skєnderbenє qє mє shekullin e gjashtєmbєdhjettє gjer pothua nє funt tє shékullit tє nєntєmbєdhjettє. Me latinishten e tij elegante dhe shtyllєn e tij tє kujdesur fitój kєndonjєs an' e mb' anє botєs dhe e bєri tє pavdekur kujtimin e Skєnderbeut nє Evropє. Libra e tij pati disá edicje tє ndryshme latinísht dhe u-pєrkthye nє tє gjitha gjuhet evropjane. Si historián, Barleti qєndrón aqє shkallє nєnє Tivárasin sa e kapєrxén si shkrimtár. Kєndón liksht, po ka zє tє bukur. Rallє jep mot, muaj e ditє, si Tivárasi, dhe veç ca dátave tє paka, tє cilat vertetohen dhe nga burime tє tjera, gabohet nє mé tє shumat. Vijtoret i madhón, ngjarjet i zbukurón, gjєrat e papєlqýera i heth nє kosh, a i tregón si me pahír kur s' ka se qysh t' i fshehє, shtrin nє fushє tє bєtejєs me míjєra Turq tє vrarє, dhe si pa gjє tє keqe shton qє Shqiptaret e vrarє ishin ca dyzina tє paka, sikúr refén romancє dhe jo historí. Nga ky shkák historianet kritikє, tє rahur me uthull, e shi-

Digitized by Google

kojnɛ historin' e tij me dyshím dhe s' besojnɛ as ató tɛ vertetat qɛ tregón. Dhe s' qendrón vetem kɛtú: Si Shkodrán, subjékt i Venetisɛ, nukɛ nxjer nga goja kurrɛ nonjé fjalɛ tɛ keqe pɛr Mbretɛreshen e Déteve; sjelljen e saj tɛ papɛlqyer kundrejt Skɛnderbeut e paspallós me aqɛ sheqér sa ka nɛ torbɛ; vervit nɛ shportɛ çdo gjɛ tɛ shemtuar pɛr Republikɛn qɛ munt tɛ mbulohet pa rezík mos dalɛ sheshit; dhe kɛndón me brohorí miqɛsin' e ngushtɛ dhe besimin e plottɛ qɛ mbretɛronte nɛ mes tɛ Skɛnderbeut dhe tɛ Republikɛs Veneciane. Nɛ funt tɛ historisɛ tij e tepɛrón zullumin dhe, pa dashur a pa ditur, ia rɛmben shpatɛn kryetrimit sa pa vdekur, dhe ia dɛrgón Republikɛs: Pas dɛshmimit tɛ tij, Skɛnderbeu vuri njɛ kumandár venecián nɛ Krujɛ, nɛ rrethmin e dytɛ mɛ 1466, dhe mɛ tɛ vdekur e siper, i lá Venetisɛ me traktét kujdesin' e mprojtjes sɛ kryeqytetit, mbretɛrisɛ dhe trashɛgimtarit tɛ tij, gjɛ e cila i bɛri disá historianɛ kritikɛ (I) tɛ besojnɛ qɛ Skɛnderbeu, nɛ ditɛt e tij tɛ funtme, u-dɛrmua krejt prej Sulltán Mehmedit, ia lɛshój mbretɛrín' e tij Republikɛs dhe vdiq nɛ tokɛ tɛ saj si refugjiát. E vɛrteta e thatɛ ɛshtɛ krejt e ndryshme: Republika Venetike ishte kundrejt Skɛnderbeut e

1).—Simondi nga tɛ vjetrit dhe Gibbon-i nga tɛ rinjtɛ; Fallmerayer-i, Hahn-i dhe Hopf-i, tɛ gɛnjyer nga dɛshmimi i Barletit, besojnɛ qɛ Skɛnderbeu ia lɛshój Krujɛn, tɛ paken ush-ɛrísht, posá vuri njɛ kumandár venecián.

Digitized by Google

ftohtє nє krye, armike e hapur a e fshehur mé tє shumєn e kohєs, dhe vakur nє funt nga nevoja dhe interesi; pas dєshmimit tє Tivєrasit, i cili єshtє dhe ay venetofil (1), kumandari i Krujєs, nє rethimin e dytє, ishte Shqiptár; e dimє pa nonjé pikє dyshimi qє Skєnderbeu e dergój tє shoqen dhe trashєgimtarin e vogєl jo nє Venetí, po nє Nápoli; nga

---

1).—Nє besdfshim Fallmerayer-in qє Tivárasi ishte Pal Engjєlli, s' dó shumє mundím qє t' a provojmє venetofil. Barleti e pєrshkruan: "Venetorum observantissimus erat." (Barleti, L. XI, f. 270). Aqє Barleti sa dhe Biemmi na thonє qє kryepeshkopi Pal Engjєlli, i vєnє prej ambasadorit venecián, e bindi kєshillen e Skєnderbeut t' i dekllaronjє luftє Turqisє mє 1463. Romanini (Storia Documentata di Venezia, vєll. VI, f. 333, Venetí 1855) na thotє qє, pas vdekjes sє Skєnderbeut, Senati i Venetisє e dergój Pal Engjєllin qє t' a vinte Krujєn nєnє mprojtjen e Republikєs, *nє qoftє se ndodhej nє rezík.* Po dhe sikúr tє mos tє jetє e vertetє theoria e Fallmerayer-it, shohim nga Biemmi qє Tivárasi, nє mos aqє sa Barleti, prapє ishte venetofil. Kur na thotє qє Shkodranєt ftuan Sulltán Muradin II t' i bjerє Skєnderbeut nga kurrizi, nє kohєn qє ky lєftonte kundєr Venetisє, Tivárasi bєn njє pєrpjekje tє dєshpєruar qє t' a lehtєsonjє poshtєrsin' e Republikєs sє krishtєrє dhe i bie samarit, nє vєnt tє gomarit (Shih Biemmin, L. II, f. 131 dhe pєrqás-e mє Romanini-n, vєll. IV, f. 243-4). Pєr tє shpjeguar venetofilín' e Tivárasit e tє Barletit duhet marrє nє sy qє, kur shkruanin historít' e tyre, rronin si refugjiatє nє Venetí, a nє tokє veneciane.

Digitized by Google

arshivat zyrtare tє Republikєs Veneciane provohet katєrçipєrísht qє Skєnderbeu s' ia la Krujєn dhe mbretєrin' e tij Venetisє as pєrpara as pas vdekjes sє tij, as me traktét as me testamént; jo Skєnderbeu Venetisє, po Venetia ia dorєzój shpatєn e saj Skєnderbeut qє t' a mpronte kundєr rrebeshit turk. Vdiq, vertét, nє tokє veneciane, nє Lesh, po me shpatєn nє dorє, dhe jo si refugjiát, po si kryekumandár i ushtєrive aliate veneto-shqiptare, i cili thirri n' até qytét njє kuvént tє dytє tє príncєrve shqiptarє dhe tє kumandáreve venecianє qє tє merrte masa pєr mprojtjen e tókave tє Shqipєrisє dhe tє Republikєs kundєr Sulltán Mehmedit. Me gjithє ketó, s' jam aspák i mendjes qє Barleti duhet marrє nєpєr kembє, si bejnє disá historianє kritikє. Pєrkundєr, єshtє njє thesár i çmuar pєr jetєn e Skєnderbeut dhe duhet studiuar me kujdés, pranє Tivárasit, tє pakєn si plotesím i tij. Gabohet nє datat a i ngatєrón, shtón e zbukurón, mbulón a hesht, paspallós me oratorira tє pambarúara, po rallє genjehet kur thotє qє aksh gjє ngjau. Dhe—gjє e papritur—disá herє e ndreq Tivarasin. Pєr shembell vajtja e Skєnderbeut nє Raguzє, tє cilєn s' e pєrmént Tivárasi, konfirmohet prej kronikanit tє kєsáj Republike (1); dєrgimi i Gjon Stres

1).—Pietro Luccari, Annali di Rausa, 1605, f. 106: "Fece scala in Rausa et mentre vi dimoró fu spesate dal publico secondo l' antico costume della cittá."

Digitized by Google

Balshes per tє ndihmuar Ferdinandin e Napolit, para se tє hidhet vetє Skenderbeu nє Italí, provohet me dokumenta tє arshívave tє Nápolit (2); ndodhja e Skenderbeut nє bєtejat e Ursares vertetohet prej historianit spanjóll Mariana t' asáj kohe; (3) bєteja e Skenderbeut kundєr Sheremét Beut, tє cilєn s' e pєrmént asfare Tivárasi dhe tє cilєn e pershkruan gjer' e gjatє Barleti єshtє njє ngjarje historike e padyshimtє (4); rrethimi i tretє i Krujєs mє 1467, tє cilin shumє historianє tє vjetєr e tє rinj e kanє qúajtur si njє єndєr tє Barletit dhe pєr tє cilєn hesht Tivєrasi nga shkaku qє kanє humbur fletєt e funtme tє historisє tij, provohet katєrçipterísht nga kronikani bizantín Franza (5) dhe nga kronikanєt Turq t' asáj kohe (6). Pastáj duhet

---

2).—Shih Pisko, Skanderbeg, Appendix.

3).—Mariana, Storia della Spagna, Libєr 23, kaptinє 2. Shih Biemmi, L. XI, f. 407 dhe Duponcet, Histoire de Scanderbeg, Roy d' Albanie, préface, Paris, 1709. Gjith' ashtú Anonimi i Sansovino's, Anonimi Venecián, Dimitєr Frєngu, dhe Lavardin-i.

4).—Anonymus Venetus, Commentario de le Cose di Scanderbeg, f. 33, Venetík, 1539. Gjith' ashtú Anonimi i Sansovino's, Dimitєr Frєngu dhe Lavardin-i.

5).—Georgius Phrantza, Corpus Scriptorum Historiae Byzantinae, L. IV, kap. XXII, f. 425, Bonn 1838.

6).—Kronikanєt turq heshtin pєr Skenderbenє, se s' kanє tє tregojnє veç dishfata dhe turpєrime pєr ushtєrít' e Sulltáneve. E hapin gojєn vetєm nє njє rasje,

Digitized by Google

mbajtur ment qe Skenderbeu kishte vdekur tridhjét' e gjashte vjet para se te merrte penden Barleti qe t' i shkrúante historine. Ne kete mes, ishte rritur legjenda e herójt te pavdekur, fytyra e tij ishte rethuar me shkelqimin e nje gjyrme-perendie te vjeterise, e kurorezuar me arollen e nje perluftari gjysme-shénjt te Krishterimit, dhe veprat e tij te çudiçme po shtoheshin nga atá qe e kishin pare vete me sy dhe kishin leftuar nene kumanden e tij. Mé ne funt, kritikáneve teper te ashper te Barletit munt t' u tregojme historiane te vjeter e moderne te Skenderbeut, te cilet pa qene as Shqiptare, as fetare, as gjakndezur, na nxjerin mallin e priftit shkodrán, dhe ne disá pika e kaperxejne. Fajin, na duket, s' e ka aqe Barleti sa Skenderbeu, i cili ua rembén mendjen edhe atyre historiáneve mé gjakftohet.

Veç te dy historive, te perméndura siper, kemi dhe disá burime te tjera, te cilat hedhin drite mi ca pika te jetes se Skenderbeut:

III.—Pas Tivarasit dhe Barletit, lajmat mé te mira per veprat e Skenderbeut duhej te na i kishin dhene te dy historianet e funtme bizantine, Laoniku (Nikoll Halkokondili) nga Athina dhe krye-

---

kur na tregojne qe Sulltán Mehmedi II hyri ne Shqipení me 872 te Hixhretit (1467 pas Krishtit) dhe zaptój Elbasanin, gje e cila ngjau, pas Barletit, até mot qe u-rethua Kruja per se treti. (Shih Hammer-Purgstall, Geschichete des Osmanischen Reiches, Vell. I, L. XIV, f. 492, note 9, Pesth, 1840).

Digitized by Google

ministri Franza nga Stambolli. Qe te dy ishin te mesuar, shtetare, ambasadore, minister, dhe koheshoke te Tiverasit dhe te Barletit. Qe te dy kane lene kronika mi nisjen dhe ritjen e fuqise turke gjer ne ngadhenimin e plotte te perandorise bizantine prej Turqve. Skenderbeu ish aý qe beri perpjekjen e funtme per te prapsur valat e tyre te terbúara. Me trimerine dhe vijtoret e tij fati i Sinisise Ballkanike u-vú perseri ne pyetje. Shqiperia u-bé kryeqendra dhe fusha e veperímeve ushteriake te krishterimit evropián kunder kryefuqise turke. Dhe Evropa e Perendimit kishte shprese te mbaronte me shpaten e Skenderbeut até qe s' mundi te benje me armet e saj ne Marice me 1362, ne Kosove me 1389, ne Nikopoli me 1396, dhe ne Varne me 1444. Skenderbeu ishte kryegjenerali i krishterimit katholík kunder Turqerise. Po vijtorja e krishterimit keté here, si dhe me 1204, do t' ia kishte dhene zoterimin e Bosforit Katholikizmes, armikes shekullore te Orthodoksise. Kjo vetem arrín per te shpjeguar ploterísht shkurtesine, ftohtesine dhe armiqesine, me te cilen shkrúajne per Skenderbene kronikanet bizantine orthodokse Laoník dhe Franza. Si Luka Notaráj, edhe ketá deshnin mé mire te shikonin ne Stambóll sarekun e Myftiut se sa mitren e Papes. Njezét e kater vjet me radhe Skenderbeu e mbajti ne ballance fatin e Sinisise Ballkanike, dhe per keté periude te shkelqyer te Shqiptáreve dhe kryekumandarit te tyre

Digitized by Google

Franza na jep vetem dy shenime tε shkúrtera, njε pεr rrethimin e tretε tε Krujεs prej Sulltán Mehmedit II mε 1467, dhe njε pεr vdekjen e Skenderbeut nε Jenár, 1468 (1). Me shenimin e parε e nxjer faqebardhε Barletin, dyke vertetuar kεtέ ngjarje tε kontestuar prej dísave, dhe me shenimin e dytε na jep, i vétemi nga tε gjithε historianεt e vjetεr, motin e vertetε tε vdekjes sε Skenderbeut. Laoniku (2) shkruan pak mé gjerε, ndonesé i ngaterón shpesh ngjarjet, emrat dhe kronollogjitε; si orthodóks dhe turkofil, me-zi nxjer nga goja me pahír njε levdatε pεr Skenderbenε dhe pεr Krujanεt me rasjen e rethimit tε parε tε Krujεs prej Sulltán Mehmedit II, po εshtε i vétemi qε na pεrshkruan kryengritjen e Arianitit (1435-38), tε cilin e ngré nε qiell nga shkaku qε ky kishte gjak prej Komnéneve

---

1).—Phrantza, L. IV, kap. XXII, f. 425 dhe 430, Bonn 1838. Franza ka dhe njε shením tε shkurtεr pεr Gjon Kastriotin, t' atin e Skenderbeut, pεr tε cilin na thotε qε e roberój krejt Sulltán Muradi II: "Et Iohannem Castriotam plane sibi subjecit." —L. I. kap. XXXII, f. 92.

2).—Laonicus Chalcocondylas, Corpus Scriptorum Historiae Byzantial, Bonn 1843. *Laonicus* εshtε anagrami i emrit *Nicolaus*. Me qenε qε shtypεshkronja, ku u-shtyp *Historia e Skenderbeut* prej Imzot Nolit, s' kish letra gεrqishte, qitesat nga Laoniku dhe Franza janε hequr nga pεrkthimet latinishte, qε u-botuan bashkε me tekstet gεrqishte nε Bonn.

Digitized by Google

tє Stambollit nga njє stєrgjyshe e tij (L. V, f 249-251).

IV.—*Commentario de le Cose di Scanderbeg,* domethenє *Shєnime pєr vєprat e Skєnderbeut* prej njє anonimi Venecián, botuar italísht nє Venetí mє 1539. Ky na jep tєrthori motin 1410 tє lindjes sє Skєnderbeut, qє i afrohet mé tєpєr sє vєrtetєs, kur na thotє qє ishte 33 vjetsh, kur u-kthye nє Shqipєrí mє 1443: *"Nel anno del nostre Singore 1443 e nel anno di Scander-Beg della nativitá sua* XXXIII" (f. 5 v.)

Gli Illustri e Gloriosi Gesti e Vittoriose Imprese, fatte contra Turchi, dal Signor Don Giorgio Castriotto, detto Scanderbeg, Prencipe d' Epirro, domethenє *Trimєrít' e Shkєlqýera e tє Lavdєrúara, dhe Fushatat Vitorioze, qє bєri kundєr Turqvє Zoti Gjєrgj Kastrioti, i qúajtur Skєnderbé, Princi i Shqipєrisє, e* kthyer italísht prej njє doreshkrimi latinísht tє priftit shqiptár At Dimitєr Frєngut (Demetrio Franco), arkєtarit tє Skєnderbeut, dhe e botuar nє Venetí mє 1545 prej njє Anonimi, dhe pastáj e ndrequr dhe e botuar pєrsєrí italísht prej Kontit Giovan Maria Monardo nє Venetí mє 1591, 1610, 1646 dhe 1679. Konti Monardo ia dedikón libren Lartєsisє Tij Serenisime, Zotit Girolamo Angelo Flario, Princit tє Thesalisє dhe Kontit tє Drishtit, njє stєrnipi tє Skєnderbeut nga vija femєrore. Nga parєthénia e tij mesojmє qє Konti Monardo shkroj kєté historí pas njє doreshkrimi lati-

Digitized by Google

nísht tє At Dimitєr Frєngut, passí e ndreqi dhe hoqi tє gjitha shtimet e pa nevójshime tє kthénjєsit tє mєpáreshme qє e botój mє 1545, (Shih Bibliografie Albanaise, par Emile Legrand, Paris 1912, dhe Henry Wadsworth Longfelow, Skєnderbeu, kthyer prej Fan S. Nolit, Boston 1916, shєnime f. 20-30).

I Fattti Illustri del Signor Giorgio Scanderbegh, domethєnє *Veprat e Shkєlqýera tє Princit Gjerq Skєnderbé,* prej njє auktori pa emєr. Historia e ketí Anonimi u-botua italísht prej *Francesco Sansovino's* nє vepren e tij *Historia Universale dell' Origine et Imperio de Turci,* nє Venetí mє 1564 dhe pastáj mє 1577. S' dimє asgjé pєr autorin anoním tє kєsáj historie.

Historit' e Anonimit Venecián, Anonimit tє Sansovino's dhe Dimitєr Frєngut janє tє shkúrtєra dhe s' japin hollєsira; shembellejnє njєra mє tjatrєn si tri motra binjake dhe kanє patur njє kryeburím qє tє tria; janє influencuar shumє prej Barletit, po ndryshojnє nє shumє pika, gjє e cila provón qє s' janє shkurtime tє historisє tij. Dimitєr Frєngu mє tє dy Anonimєt na japin tєrthori motin e vєrtetє tє vdekjes sє Gjon Kastriotit mє 1442, njє mot pєrpara bєtejes sє Nishit midís Hungarézєve dhe Turqve, pas sє ciles u-kthye Skєnderbeu nє Shqipєrí (1), dy fjalє shqipe tє Lek Duka-

1).—"Dopo queste cose (morte di Giovani Castri-

Digitized by Google

gjinit dhe disá informata tє tjera, tє dorєs sє parє.

V.—*Histoire de Georges Castriot, surnommé Scanderbeg, Roy d' Albanie,* domethenє *Historia e Gjerq Kastriotit, tє qúajtur Skєnderbé, Mbretit tє Shqiperisє, prej Jaques De Lavardin-it,* e botuar nє Paris mє 1576, afró 108 vjet pas vdekjes sє Skєnderbeut. Lavardin-i ka marrє pєr themelí historitє mé tє vjetra dhe veçanerísht até tє Barletit, po me qenє qє ka patur pєrpara sysh dhe ka pєrdorur njє vepрє (Vie de Scanderbeg, Jeta e Skєnderbeut) prej njє auktori anonim, e cila ka humbur, historia e tij munt tє quhet e tє pєrdoret si njє burím i dorєs sє dytє pєr Skєnderbenє.

VI.—*Historia e Genealogia della Casa Musachia scritta da Giovani Musachio despoto d' Epiro, a suoi figli nel 1510,* domethenє *Historia dhe Gjeneallogjia e Derєs sє Myzeqesє, e shkruar prej Gjon Muzakєs, princit tє Shqiperisє,*

---

ota et occupatione di Croya da Sebalia) sendo di giá passato l' anno, li Ungari per esortatione di Papa Eugenio, un' altra volta si mossero contra il Signor Turco." .—Francesco Sonsovino, f. 371, Venetí 1564.— "Essendo poi in questi accidenti passado piú d' un' anno successi che gli Ungari...."—Demetrio Franco, kap. II, f. 13, Venetí 1679.—Hopf-i e shtyn vdekjen e Gjon Kastriotit peraferísht mє 1443, pa qenє dhe ay vetє shigúr pєr ketє mot, po sidomós pak kohe pєrpara kthimit tє Skєnderbeut. Shih Charlts Hopf, Chroniques Gréco-Romane, f. 533, Berlin 1873.

Digitized by Google

per tє bijtє mє 1510. Ky doreshkrím u-botua per heren e parє prej Charles Hopf-it nє vepren e tij *Chroniques Gréco-Romanes,* nє Berlin, mє 1873, dhe permbán ca shenime rendesore per Skenderbenє dhe Princєt e tjerє Shqiptarє tє kohes sє tij. Gjon Muzaka ishte nga atá Princєt e pakє, tє cilet qendruan nє Shqiperí pas vdekjes sє Skenderbeut dhe me ndihmen e venetisє vazhduan luften kunder Sulltán Mehmedit II gjer sa ra Shkodra. Mє 1479 shkoj nє Napoli ku u-vendós dhe mє 1510, kur gatitej njє kryqesatє kunder Turqve dhe ishte shpresє tє çlirohej Shqiperia, shkroj ketє memorandє qє t' u tregonte tє bijve ç' vise ishin tє principates sє Myzeqesє dhe keshtú t' i kerkonin e t' i merrnin. Krahinat e Beratit, Kaninєs, Myzeqesє, Tomonishtєs (Myzeqesє Vogєl), Selenicєs Serrєs, Tomorricєs, Skraparit, Oparit, Devollit tє Math, Korçєs (1), Devollit tє Vogєl, dhe Kosturit gjer nє Nestrám perbenin

---

1).—Korça, e cila kujtohet si njє qytét i ri, permendet prej Gjon Muzakєs si njє keshtjellє qє mє 1280. "E piú possedí (il Signor Andrea Mosachi *Sebastocrator)* e signoreggió la cittá di Corizza per insino alla villa Savoiana (kendó *Sovján),* et anco lo casale de Viola (?), dove se pigliano gran' pesci e capituni" (Hopf 280). Aqє tє vjetra sa Korça, pas deshmimit tє Gjon Muzakєs, janє fshatrat Lavdari, Dushari, Mariani, Voskopi, Sovjani, Selenica e Serrєs, dhe Mazereka e Oparit.

Digitized by Google

shtetin e Andreut I, themeltarit tє dinastisє Myzeqare mє 1280, (Shih Hopf, f. 280-81). Viosa, Shkumbimi dhe Devolli ishin kufiret e principates sє ti. Mé vonє me anє trashєgimi a zaptimi, principata e Myzeqesє u-shtua me krahinat e Vlorєs, Kaninєs, Prespєs dhe Ohrisє (Hopf 290-91). Kєté principatє Gjon Myzaka ua ndan tє bijve me testamént kєshtú: Princ Theodorit, i lє krahinat e Beratit, Kaninєs, Myzeqesє dhe Skraparit; Princ Adrianit i lє Tomoricєn, Oparin, dhe Devollin e Math me Korçєn dhe Sovjanin; Princ Kostandinit i lє Devollin e vogєl me Kosturin gjer nє Nestrám (Hopf 293-94). Kjó vepрє pra duhet gjykuar pas qєllimit tє cilin u-shkrua. Dhe me tє kєnduar kuptohet me njє herє qє nuk єshtє aspák e paáneshme. Çdo krahinє a qytét qє e kanє pasur princєt e ndryshmє tє Myzeqesє nє kohє tє shkuar, Gjon Muzaka e kєrkón si tє tijnє. Nє qoftє se nonjé tjatєr princ e ka patur nonjé nga kєtó krahina a mé parє a mé pas, Gjon Myzaka a s' na e thotє fare, a e quan uzurpatór até princ. Kunder Skєnderbeut ka dy qarje: e para se ky paska ndarє Karóll Muzakє Thopinє nga princesha Zanfina (Suina, a Serafina, e motra e Gjon Muzakєs) qє t' i japє tє motrєn Mamica Kastrioti; e dyta qє i paske rєmbyer t' ett krahinєn e Tomonishtєs, qє e quan Myzeqé e Vogєl. Nє syt' e Gjon Muzakєs, Skєnderbeu єshtє nga njє der' e vogєl, e cila nga dy fshatra qє kish nє krye u-rrít pastáj

Digitized by Google

dhe u-perpóq te zoteronje tere Shqiperine. Ja si ua pershkruan Gjon Muzaka te bijve ritjen e Gjon Kastrióteve: "Dijeni qe i gjyshi i Skenderbeut s' kishte veç dy fshatra, Sinjen dhe Gardhin e Poshtme (Hopf 301); i bir' i tij Gjon Kastrioti u-bé Zot i Matit (Hopf 298, 301); i bir' i tij Skenderbeu, passi mori Matin, shtetin aterór, u-bé Zot i Krujes, te cilen s' e kish i ati (Hopf, 299); dhe pastáj u-bé Zot i Dibres, i Brinjes, domethene Rondecit, Tomonishtés, Misise dhe Krahines Guonimi gjer ne det" (Hopf 298-9). Dhe ja me ç' menyre: "Dhe pak kohe passí u-bé kryegjenerel i príncerve te Shqiperise, pati ner ment te behet zot i tere vendit; u rembeu Bálsheve shtetin, qe ish midís Krujes dhe Leshit, domethene Misine; i rembeu Moisi Komnén Thopise Dibren; na rembeu dhe neve Tomonishten, domethene Myzeqén' e Vogel, kur vdiq im-ate; e gjithashtú u rembeu krahinat e Kommit e te Rondecit disá príncerve te tjere, te cilet s' kishin ç' te benin, se aý kishte ne dore ushterine, dhe Turku na rrinte mi koke me çdo ore; dhe shpresa iu shtua ca mé teper, kur Papa Pius II deshi te bente kryqesaten; po passí vdiq Papa i siperthene, nisi t' a humbase até shprese, dhe mé ne funt Turku na i mori edhe neve edhe atí te gjitha, se keshtú i pelqeu Perendise per mekatet tona, (Hopf 299-300). Gjetke Gjon Muzaka na thote: "Dhe e-ema e Skenderbeut quhej Zonja Voisava Tripalda dhe ishte nga der' e mire"

Digitized by Google

(Hopf 301), me fjalë të tjera e-ëma ishte nga një oxhák m' i mirë se i atí. Divorcin e Karoll Muzakë Thopisë e përshkruan kështú: "Edhe ju thoni që Skënderbeu e ndau Princin Karóll Muzakë Thopinë nga Zanifina Muzakën, pa marrë në sy as Perëndí, as gjë tjatër, as bijtë që kishin dhe ia dha së motrës Zonjës Mamicë e cila me té bëri kater bij meshkuj dhe dy vajza; méshkujtë u-bënë që të gjithë Turq" (Hopf 298), domethënë edhe këtú Skënderbeu e gjeti nga Perëndia dhe nga Turku. Po ka dhe mé: Zanfina e divorcuar marrtohet me Moisinë, i cili hidhet nga ana e Turqve dhe i bie Skënderbeut, që t' i marrë gjakun e së shoqes dhe të fitonjë Dibrën e rëmbyer! (Hopf 300, 302). Sikúr e degjojmë këtú Gjon Muzakën të thotë, si Shqiptár i kulluar: "Amá sa bukur ja bëri Zanfina me Moisinë!" Sidó që të jetë, këtó arrijnë për të provuar që Gjon Muzaka, jo i paáneshmë, po ësht të dhe armík i Skënderbeut, dhe deshmimi i tij është pak a shumë i dyshimtë. Nga ana tjatër, doreshkrimi i Muzakës është me të vërtét i çmuar nga dy pikëpamje të tjera, e para se jep informata për princët e Shqipërisë me gjeneallogjitë dhe principatat e tyre, dhe e dyta se heth një drite sinistre mi rethimin e Skënderbeut: Kúsh e di ç' intriga dhe komplote bënte Zanfina që e ndau Skënderbeu nga i shoqi i parë; kúsh e di ç' pabesira dhe tradhësira bënin "*princët e tjerë*" që ushtrëngua Skënderbeu t' u aneksonte principatat!

Digitized by Google

Nga Barleti dimε qε i dúall tradhεtorε dhe rebelε gjenerali m' i mirε Moisiu dhe i nipi i dashur Hamza; Biemmi e shton listεn me njε nip tjatεr, Gjerq Stres Balshεn, dhe me njε komplót tε shemtuar tε ca príncεrve qε s' u-muar vesh cilεt ishin; Muzaka i vε kapakun kur na thotε se qε tε katεr bijt' e Mamicεs dhe me duzina princεr tε tjerε, Gegε e Toskε, u-kthyenε Muhamedanε dhe natyrísht lεftuan kundεr atdheut tε tyre. Dhe kεtú s' duhet harruar qε Gjon Muzaka ishte lule pεrpara tε tjéreve, se ky tε pakεn qendrój nga ana e Skenderbeut gjer nε funt, dhe lεftoj kundεr Turqve, edhe pas vdekjes sε tij. Si Muzaka, qenε pothua tε gjithε tε *mirεt dhe besnikεt.* Aý vetε na thotε: "Edhe disá bij tε kεtyre príncεrve lεftonin nenε kumandεn e Skenderbeut *aqε pεr tε mεsuar mjeshtεrin' e luftεs sa dhe pεr tε mprojtur shtetet e tyre" (1).*

1.—Poi fecero consiglio detti Signori d' Albania (il Signor Arainiti Comnino, il Signor Coico Bassa, il Signor Nicoló e Paulo Ducaguino, il Signor Ginno Mosachi mio padre, il Signor Andrea Thopia, il Signor Pietro Spani) in Alessio; chi ce andó personalmente e chi ce mandó suoi sustituti, talché il detto Scanderbegh fú creato e fatto lor Capitano in Albania, e ciascuni contribuiva de gente e de denari pro rata, et anco alcuni figlioli de quelli signori militavano sotto de lui si per imprender la guerra, come anco per difendere loro stati; per ossere detto Signor pratico alla guerra e valente, fú fatto Capitano et ogn' uno l' obsdeva.— Hopf, Giovanni Musachi, f. 274-75.

Digitized by Google

Natyrísht posá e mesonin mjeshterinë, a híqeshin më nj' anë dhe shikonin punën e tyre, a i kthenin armet kundër ustájt! Me të këtijë shokë lëftój Skënderbeu njëzét e katër vjet kundër mizerive turke, një mjerím, i cili i rrit në syt' e historianit mé tepër se çdo gjë tjatër. Nga kjo pikëpamje doreshkrimi i Muzakës është më të vërtetë një "margaritár", ashtú si e quan Dr. Hahn-i, i cili e komentón, e shpjegón dhe e bisedón gjer' e gjatë në libren e tij *"Udhëtime nëpër krahinat e Drinit dhe Vardarit" (1).* Nga të tjerat, s' ka nonjé vlerë të pazakóneshme dhe nukë marr dot vesh persé Dr. Hahn-i e kap si drasë shpëtimi për të shpëtuar nga pellku i kronollogjive të koklavítura dhe i vërsës së paçkoqur të Skënderbeut. Sa për këtó, Gjon Muzaka s' ben tjatër veç kopión gabimet e Barletit: "Skënderbeu vdiq më 1466—*gabím i Barletit*—, më 4 të Dhjetorit—*gabím i Muzakës, i kopiuar liksht nga Barleti (2)*—, rrojti 23 vjet passí u-bé

---

1).—*Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar, von Johann Georg von Hahn,* e botuar në *Denschriften der Kaizerlichen Akademie der Wissenschaften,* Vëll. 16, f. 84-130, Vienë 1869.

Hopf-i, i cili e zbulój doreshkrimin e Muzakës, e bisedón në një artikull, të botuar në *Monatsberichte der Berliner Akademie der Wissenschaften,* 1864, f. 193-197, dhe në *Chroniques Gréco-Romanes, Introduction* XXXIII—XXXV, Berlin 1873.

2).—Muzaka merr datën e kurorëzimit të Skënderbeut për të vdekjes së tij: *"quarto kalend. Decemb."*

Digitized by Google

i Krishtere —*hequr nga Barleti*—, dhe kur ardhi ishte afró 40 vjetsh—*hequr nga Barleti*—, *keshtú* qe rrojti afró 63 vjet—*marre nga Barleti*—; lufta e paprere e Turkut me Skenderbene mbajti afró 24 vjet"—*marre nga Barleti (1).* Dhe kopión Barletin aqe verberísht sa s' qendrón nje minute te mejtohet qysh ish e mundur per Skenderbene te kete rrojtur 23 vjet, passí u-kthye i Krishtere, e te kete leftuar kunder Turqve afró 24 vjet pa prere! Po Gjon Muzaka eshte aqe i forte ne kronollogjite sa gabohet edhe ne motin kur iku aý vete nga Shqiperia. Na thóte qe u-hoth ne Itali, *passí ra Shkodra, afró me 1476,* kur ky qytét ra ne duar te Turqve me 1479 (2).

(Barleti, L. XIII, f. 372, Zagabria 1743), te cilen nga padija e kujtón per 4 Dhjetór, kur ajó eshte 28 Nentór.

1).—"Il Signor Scanderbeg morse nell' anno 1466 alli quattro de decembre, visse anní 23, dopo ché ritornó a farse christiano, e quando venne, era de circa anni 40, si ché visse circa anni sissanta tre; duró la guerra continua del Turco col Signor Scanderbeg circa anni 24."—Hopf, f. 299.—Perqás-i ketó me Barletin L. XIII, f. 372. "Animumque suum Deo maximo tradens 16 kalend. Februarias, Anno Domini, MCCCCLXVI —*(domethene me 17 te Jenarit, 1466 pas Krishtit)* extermum diem suum obiit. Fertur igitur Scanderbegum 63 annos natus, 24 sui imperii anno e vita migrasse. Auguratus est autem Scanderbegus prima auspicia imperii sui quarto kalend. Decemb. anno ejusdem Domini M C C C C X L III" *(28 Nentór, 1443).*

2).—"Ma il detto Turco fando poi pace con Ve-

Digitized by Google

VII.—Mé nє funt kemi arshivat e Vatikanit, tє Republíkave tє Venetisє e tє Raguzєs, tє mbretєrive tє Nápolit e tє Hungarisє, dhe tє dukáteve tє Millanit e tє Burgonjєs, me tє cilat kishte marrєdhénie dipllomatike Shqipєria nє kohєn e Kastrióteve. Nє ketó munt tє shtojmє manastirin e Hilandarit nє Mal tє Shєnjtє ku njє Rus (1) gjeti dy dokumente pєr Gjon Kastriotin dhe tє bijtє. Nga ketó arshiva kanє hєqur lajma lartєsísht rєndєsore pєr historin' e Skєnderbeut historianє dhe savantє si Rinaldi (2), Farlati (3), Hopf (4), Hahn (5), Romanini (6), Thalloczy dhe Jireçek (7), Pisko (8) e tє tjєrє, po vepra e tyre duhet vazhduar. Historia kritike e Skєnderbeut s' munt tє shkruhet gjer sa tє shoshiten ploterísht ketó arshiva. Pєr shembєll, dokumenta tє gjétura nє arshivat e Millanit e tє Venetisє provojnє pa lenє as pikє dyshimi qє Skєnderbeu nukє vdiq as mє 1466, si na thotє Barleti, as mє 1467, si na thonє pothua gjithє historianєt e tjєrє, po mє 1468, si na thotє historiani bizantín Franza.

---

netiani, *quando li donaro Scutari,* non me volsero comprendere in quella, com' ho detto, anzi promisero, in lor mano venisse; talché de questo da alcuni gentilhuomini de Durazzo fui avvisato, che subito fugisse. Fui costretto allora travestirme de notte; diconsciuto andai in una barca, qual per sorte era per partire non sapendo ch' io fosse, me passó in queste parti, *e fú nelli 1476 in circa,* e cosí anco quell' altri Signori d' Albania

Digitized by Google

chí fuggí e chí se fé Turco; il tutto andó in roina."—Hopf, f. 276.

1).—Grigorovich, Oçerk Puteshestvia po Evropeiskoj Turcii, p. 2, f. 47, Moskɛ 1877.

2).—Rinaldi, Annales Ecclesiastici, Vɛll. IX dhe X, Lucae 1752.

3).—Daniel Farlati, Illyricum Sacrum, Venetí 1817.

4).—Charles Hopf, Chroniques Gréco-Romanes, dhe Ersch-Gruber's Encyclopadie, Vɛll. 86, Leipzig 1842.

5).—Hahn, Reise, Denkschriften, Vɛll. 15, 16.

6).—S. Romanin, Storia Documentata di Venezia, Vɛll. IV, 1855.

7).—Thalloczy und Jireçek, Zwei Urkunden aus Nordalbanien, botuar nɛ Archiv fur Slavische Philologie, Vɛll. 21, f. 78-99, Berlin 1899.

8).—Pisko, Scanderbeg, veçanɛrísht nɛ Appendix.

Digitized by Google

Digitized by Google

KAPTINC I

LUFTA KUNDCR TURQVE GJER NC KUVCNT TC LESHIT 1362-1444

Balsha I dhe çlirimi i Shqipcrisc Veriore nga zgjedha scrbe, 1356.—Gjerq I Balsha dhe perandoria e tij, 1362-79.—Kthimi i Shqipcrisc nc Katholikizmc, 1250-1368.—Lúfterat e Bálshcve kundcr Turqisc dhe Venetisc, 1383-1422.—Despotati i Nartcs, Pjetcr Losha, 1358-74, Gjin Bua Shpata, 1374-1400.—Bcteja e Savrcs, 1385.—Bcteja e Kosovcs, 1389.—Çkatcrimi i perandorisc balshiane dhe i despotatit tc Nartcs, 1400-1422.—Stefán Çernoviçi, princ i Malit Zi, 1423.—Origjina e Kastrióteve.—Gjon Kastrioti, 1407-1442.—Kryengritja e Arianitit, 1436.—Zenevizet dhe kryenkritja e Gjirokastrcs, 1436.—Rrethimi i Beratit, 1438.—Kryengritja e dytc e Arianitit dhe e Zenevízcve, 1443.—Gjerq Kastrioti, rritja e tij nc Turqi, hyrja e tij nc Krujc dhe çlirimi i Shqipcrisc nga zgjedha turke, 1410-1443.—Kurorzimi i Skcnderbeut, 28 Ncntór, 1443.—Kuvendi i Leshit, 1 Mars, 1444.

Pcr tc kuptuar mirc historín' e Skcnderbeut duhet tc hídhemi pakc mé prapa dhe tc çkoqim

Digitized by Google

shkúrtazi shituaten e Shqiperisë që kur e shkelë token e saj Turqit për heren e parë gjer në Kuvént të Leshit.

Turqit nisnë të zgjerohen në Shqipëri, passí zaptuan Maqedoninë dhe dërmuan Serbët në betejen e Maricës më 1362. Ahere mbretëronte në Shqipërí Balsha I. Shqiptarët posá kishin nisur luften e tyre të madhe për të shkundur zgjedhen e rendë të Sérbëve. Pas vdekjes së Stefán Dushanit, Carit të Serbisë, më 1355, perandoria e tij e gjerë u-ndá si thotë një kronikán bizantín, në disá míjera copra që u-dękllaruan më vete prej príncerve feodalë vendës, të cilët qenë shtrenguar mé parë t' a njihnin Carin serp si kryezót. Një nga ketó copë ishte dhe Shkodra me krahinën e saj mi të cilen zoteronte Princ Balsha, një Gegë i kulluar nga fshati Balsh afër Shkodrës, të cilin disá historianë janë munduar t' a nxierin nga racë frenge. Balsha, me të vdekur Car Dushani, u-dekllarua më vete dhe mori títullin Balsha I. Me këtë menyrë e çlirój Shqiperinë Veríore përtéj Drinit, e cila kishte qenë nenë Serbët që më 640. Po nukë ukenáq me kaqe. U-zgjat në Mal të Zi nga veriu dhe, i ndihmuar prej të bijve Strasimirit, Gjergjit dhe Balshës e çlirój pothua tërë Gegërinë nga Serbët. Për të këputur çdo lidhje me Serbinë Balsha I dhe të bijtë, që ishin Orthodoksë, ukthyen katolikë dykë hequr pas edhe një shumicë të madhe prej subjékteve të tyre. Idea prapa kë-

Digitized by Google

sáj levízjeje ishte tє bashkohej Shqipєria aqє politikєrísht, sa dhe fetarísht, dhe t' i kthente sytє prej Anadollit nє Perєndím. Katholikizma ishte pothua shuar nє Shqipєrí nєnє Serbєt dhe nisi tє ngjallej e tє perhapej perserí mє 1250 (1) si njє protést kunder zoterimit tє tyre. Gjerq I Balsha, i ndihmuar prej tє vellézerve dhe prej disá prínцerve shqiptarє, e mbarój vepren e nisur prej plakut Balshє. Zaptójj Krujєn, Dúrєsin, Beratin, Vlorєn, Kaninєn, Gjirokastren dhe Kosturin; e zgjerój mbreterin' e tij nga ana e lindjes gjer brenda nє Maqedoní, u-zgjat nga veriu nє Dalmatí gjer nє Seleník e Trau dhe ish i pari dhe i funtmi mbret shqiptár, qє mbreterój mi njє perandorí, e cila kishte brenda jo vetem tєrє Gegerinє dhe Toskerinє veç Çamerisє, po edhe tєrє Malin e Zi, njє pjesє tє Bosnjes e tє Herzegovinєs, pothua gjysmen e Dalmatisє, dhe njє pjesє tє madhe tє

1).—Kєté mot u-kthyen krahinat e Pulatit, Arbenisє dhe Kandavisє. Me tє dy emrat e funtme qúheshin viset midís lumit tє Matit dhe Shkumbinit. Shtepia princore e Thopíave tє Krujes e tє Kaninєs permendet si katholike qє mє 1208; e Muzákeve tє Myzeqesє mє 1318; e Mazarákeve tє Çamerisє, e Shpáteve tє Nartєs dhe e Zenevízeve tє Gjirokastrєs mє 1354; mє 1368 Balshet e Shkodrєs i derguan Papєs Urban V peshkopin Pjeter tє Shvacit dhe u-pritnє nє peqí tє kishєs katholike mє 29 Jenár, 1369; Altisferet e Danjєs mє 1414; Dukagjinet dhe Kastriotet ishin katholikє mє 1400 po nukє dimє sa vjet mé parє ishin kthyer.

Digitized by Google

Maqedonisë, me fjalë të tjera një Shqipërí, e cila ishte të paken pesë herë m' e madhe se ajó e Konferences së Londres më 1913. Sa kohë rroj Gjerq I Balsha (1), i cili ngjalli perandorinë iliriane, e mprojti Shqipërinë nga shkeljet e húaja dhe prapsi me radhë Serbët, Bosnjakët, Napolitanët, Bullgarët dhe Turqit. Passí dermój për heren e funtme mbretin e Bosnjes Stefán Tvarko në Berát, ukthye në kryeqytetin e tij Shkodër, ku vdiq në mes të triumfit më 1379.

Ishte koha e imperializmes shqiptare jo vetem në verí po edhé në jugë. Përtéj Gjirokastres, ku mbaronte perandoria e Bálsheve, niste depotati shqiptár i Nartes, i cili përmblithte tërë Çamerinë dhe zgjatej përmés Etolisë dhe Akarnanisë gjer në zemër të Greqisë. Luften e independences kunder Sérbeve, dhe veçanerísht kunder Princit serp Thoma të Janines, e dekllaruar në jugë pas

---

1).—Gjon Muzaka u jep Bálsheve títullin e *mbretit:* "Ré Balsha". Shih Hopf, f. 281. Nga monedhat e tyre duket që kishin títullin e *dukes.* Degrand-i përshkruan në libren e tij mi Shqipërinë Veriore një monedhë të Bálsheve, e cila kishte nga njera anë Shën-Laurentin me temjanicë në dorë të djathtë dhe Ungjíllë në të méngjer; nga tjatra anë një helmé me kuroren dukale dhe permí té një kokë ujku gojehapur, me fjalët "D. GORGI. BALSA." Shih *A. Degrand, Souvenirs de la Haute-Albanie,* f. 182 Paris 1901, dhe *Derniers de Balscha III par Francois Lenormant,* në *Revue Numismatique, Nouvelle Série VI, Paris 1861.*

Digitized by Google

vdekjes sɛ Car Dushanit Princi i Nartɛs Pjetɛr Losha Mazaraka dhe Princi i Angjellokastrɛs etoliane Pjetɛr Bua Shpata. Pas vdekjes sɛ Pjetɛr Loshɛs mɛ 1374, Gjin Bua Shpata, njɛ burrɛ i híjeshmɛ, dorembarɛ dhe energjík zaptój despotatin e Nartɛs. Pesɛ vjet mé vonɛ, pikerísht nɛ kohɛn kur kryezoti gegɛ Gjerq I Balsha i dermonte Bosnjakɛt nɛ Banát, kryezoti çam Gjin Bua Shpata çkaterój perpara Nartɛs ushterít' e bashkúara tɛ Sérbɛve, tɛ Grékɛve dhe tɛ Napolitáneve dhe e shigurój despotatin e tij, mi tɛ cilin mbreterój gjersá vdiq mɛ 1400. Mɛnyra mɛ tɛ cilɛn u-fitua beteja e Nartɛs ɛshtɛ pɛr tɛ vɛnɛ re, se do t' a shohim tɛ pɛrsɛritet disá herɛ prej Skɛnderbeut nɛ rrethimet e Krujɛs. Gjin Bua Shpata i la ushteritɛ armike t' a rrethojnɛ kryeqytetin e tij dhe aý vetɛ qendrój jashtɛ; passí u-lodhɛ kundershtarɛt nga rrethimi i gjatɛ, nga goditjet e paprítura sɛ jashtmi dhe nga sulmat e tɛ rrethúarve sɛ brɛndeshmi, u ra pɛrsipɛr si rrufé dhe e shojti farɛ ushterin' e tyre, nga e cila mɛ-zi shpetój njɛ pakicɛ e vogɛl, dhe, zuri rop kumandarin e saj Kryemjeshterin Heredia.

Po fati nukɛ u nɛnɛqeshi shumɛ kohɛ kɛtyrɛ mbreterive shqiptare. Pas vdekjes sɛ Gjerq Balshɛs nɛ verí dhe tɛ Gjin Bua Shpatɛs nɛ jugɛ, punɛt ndryshuan dhe Shqipɛria nga ofenciva qɛ kish marrɛ, u-shtrɛngua tɛ nistɛ njɛ lufte defensive pɛr jetɛ dhe pɛr vdekje nga tɛ gjitha anɛt,

Digitized by Google

kunder Turqve nga lindja, kunder Sérbeve dhe Bosnjákeve nga veriu kunder Veneciáneve nga Perendimi, kunder Franko-Napolitáneve nga juga. Shqiperia, po t' ishte e bashkuar, s' eshte çudi aspák qe do te kishte qene e zonja t' u bente balle ketyre armiqve. Per fat te keq, kreret feodale shqiptare ne veri e ne juge, posá u-çliruan nga zgjedha e huaj, nisne te hahen e te leftojne midís tyre dhe keshtú armiqt' e jashtme gjetne rasjen te hyjne e t' a çkaterojne Shqiperin' e çliruar.

Shqiptari e urrén zotin e huaj, po kjo nuke dó te thote qe e dó zotin vendes. S' i pelqén asnjé fare zgjedhe, qofte e rende dhe me ngjyre armike, qofte e lehte dhe me ngjyre kombetare. Posá shkunt te paren, e quan per detyre te vervite dhe te dyten pa ditur qe me keté menyre e denón veten per nje roberí tjater. Per çudí, edhe bashkimin e quan si nje fare freri te padurúarshme, ne te cilen e fut koken ne oren e zeze te rezikut, dhe te cilen e merr neper kembe posá kthjellohet koha pakez. Keshú bashkimi i Shqiptáreve nene Balshen dhe Shpaten shkoj mi qiellin e Shqiperise si nje meteór i ndriçim pas furtunes dhe u-çduk, dyke lene nje erresire mé te thelle dhe nje çkaterím mé te plotte.

Me 1399, pese vjet pas vdekjes se princit serp Thoma, Gjin Zenevizi i Gjirokastres zaptój Janinen, passí e mundi dhe e zuri rop princin e saj te ri Esau de Buondelmonte. Gjin Zenevizi e mbajti Janinen vetem nje mot. Pas tij, i bir' i Gjin Bua

Digitized by Google

Shpatës Maurík e zaptój më 1403 dhe e mbajti gjer më 1418, kur u-munt dhe u-vra prej princit Napolitán të Kefallonisë Carlo Tocco, i cili me ndihmën e Grékëve zaptój tërë despotatin e Nartës e të Janinës.

Katër vjet mé pastáj, perandoria balshiane, e shtypur në mes të Turqve, të Veneciáneve, të Sérbëve dhe të Bosnjákëve u-përmbýs pothua e tërë dhe u-copëtua në mes të shkélësve. Më1385,në kohë të Sulltán Muradit I një ushtërí turke prej 40,000 nënë Vezirin Hajredín hyri nga Maqedonia në Shqipërí dhe zaptój Kòsturin dhe Beratin. Në fushën e Savrës, afër Elbasanit u-bé një betejë e madhe, në të cilën u-munt dhe u-vra Balsha II, i velláj i Gjerq Balshës dhe i bir' i Balshës I. Me të shkuar Hajredín Pasha, Princët e Myzeqesë i dbuan Turqit nga Berati dhe nga Kosturi (1). Më 1389 Gjerq II Balsha, Theeodór II Muzaka, Gjerq Kastrioti, stërgjýsh i Skënderbeut, dhe disá princër Shqiptarë të tjerë u-bashkuan me kralin Lazar të Serbisë, i cili organizój një kryqësatë kundër Sulltán Muradit I. Ushtëria kryqësore, e përbërë prej Serbësh, Bullgarësh, Bosnjakësh, Shqiptarësh, Vllehësh, Pollakësh dhe Hungarezësh u-përpóq me ushtërinë turke në fushën e Kosovës. Në kështi-

1).—Më 1389 Theodór II Muzaka përmendet si Princ i Beratit dhe Stoja Muzaka si Princ i Kosturit. Shih Hopf, f. 532.

Digitized by Google

llεn e luftεs qε u-mbajt nεnε kryesin' e kralit Lazár, Gjerq Kastrioti kishte proponuar qε t' u bien Turqve naten, po ky proponím nukε u-pεlqye nga shkaku qε armiqtε munt tε shpεtonin nga njε dishfatε e plottε e tε iknin mε t' errεt (1). U ranε pra diten dhe u-dermuan ploterísht prej Turqve. Midís tε vráreve ishin Sulltán Muradi I vetε dhe Theodor II Muzaka (2). Qε ketéj e tutje nisnε lúfterat e paprera midís Turqve dhe Shqiptáreve. Sulltán Bajazíd Jillderemi, qε tε çgjakεsohej, i ra Shqiperisε an' e mb' anε dhe mε 1394-1396 e zaptój pothua tε tεrε qε nε Gjinokastrε gjer nε Shkodrε

---

1).—"Im feindlichen Kriegsrath war der Vorschlag, den Feind waerend der Nacht anzugreifen, von Georg Castriota aus dem uebermuethigen Grunde verworfen worden, dass die Nacht die Flucht der Feinde beguenstigend, sie ihrer gaenzlichen Niederlage entziehen koenne."—*Hammer-Purgstall, Geschichete des Osmanischen Reisches,* Vεll. I, L. V. f. 177, ed. Pesth, 1840. Kjo ngjarje historike arrín pεr tε provuar sa mik i sε vεrtetεs εshtε Gjon Muzaka kur na thotε qε Pal Kastrioti kishte vetεm dy fshatra dhe lε tε nεnεkuptohet qε Skenderbeu ishte nga njε der' e vogel. Sikur t' ish e vεrtetε kjo, qysh εshtε e mundur qε njε Gjerq Kastriót historík tε mεrrte pjesε nε kεshillεn e luftεs sε kryqεsóreve nε fushe tε Kosovεs pranε Gjerq II Balshεs dhe Theodór II Muzakεs e tε bεnte proponime pεr mεnyrεn mε tε cilεn munt tε fitohej bεteja? Pεr çudí, kεté Gjerq Kastriót tε Kosovεs s' e pεrment as Fallmerayer-i, as Hahn-i, as Hopf-i as Pisko-ja.

2).—"Ma Lazaro Dispoto de Servia e Marco Re de

Digitized by Google

e qɛ nɛ Kostur gjer nɛ Durɛs (1). Pas motit 1402, kur Sulltán Bajazidi u-munt dhe u-zu rop prej Timurlengut, Shqiptarɛt u-ngritnɛ pɛrsɛrí. Gjin Zɛnɛvizi e mori prapɛ Gjinokastrɛn; Andrea Muzaka Devollin dhe Myzeqènɛ; Nitika Thopia Krujɛn; Balshɛt dhe princɛt e tjerɛ i qɛruan Turqit nga viset e tyre. Balsha III, i funtmi i kɛsáj dinastie tɛ shkɛlqyer, passí e mundi Evrenós Pashɛn mɛ 1410, u-ngatɛrua me Venetinɛ, e cila i dekllarój luftɛ, u-vu nɛ mes dy zjarrɛsh, u-munt dhe vdiq mɛ 1422, passí humbi pothua tɛrɛ mbretɛrin' e tij. Venetia zaptój Dúrɛsin, Leshin, Ulqinin, Tivarin, Drishtin, dhe Shkodrɛn. Turqit, nɛnɛ Sulltán Mehmedin I, zaptuan mɛ 1415 Krujɛn, Vlorɛn mɛ 1417,

---

Bulgaria e Theodoro Mosachi secondo genito de nostra cosa et altri signori d' Albania uniti insieme vennero alla battaglia (de cossovo), e fur rotti i christiani, e ce morse il predicto Theodoro che portava seco grossa bonda d' Albanesi.—Hopf, Muzaka, f. 273.

1).—"Per il che incomminciaro le continue guerre de' Turchi in Albania, nelle qualli ce morsero de' molti Signori e gentilhuomini; e mancando il valor delli sopradetti, mancorno anco li stati, e se perse la cittá de Croya in tempo de Baicete primo (Bajazid I) de queste nome, e dapoi la Velona, benche sempre ce defendeamo; ma la forza del Turco sempre cresceva, e le nostre diminuivano. Il Signor Andrea mio avo fu sposseduto in quel impeto de Baycete da una parte del Devoli e della Musachia, le quali pure le ricuperó. Il resto del stato non lo perse mai".—Hopf, Muzaka, f. 273.

Digitized by Google

dhe Kaninen me 1420, te cilat i humpne prape me nonjé tjater kryengritje nuke dihet kur. Si vdiq Balsha III, nje kusherí i tij i larkme, Princi Stefán Çernoviç, i cili e trashegój, s' kishte ne dore veç Malin e Zi, pa Ulqinin e Tivarin, dhe u-vendós ne Xhabják afer lumit Moraça; nje tjater kusherí i tij, Pal Stres Balsha mori krahinen midís Krujes dhe Leshit. Keshtú, nje mot passí hipi ne fron te Turqise Sulltán Muradi II, u-shua kryevija e dinastise balshiane me perandorine qe krijoj po jo pa lene gjyrme. Perkunder, se jo vetem i dha Shqiperise dy çlironjes, te shkelqyer, si Balshen I dhe Gjergjin' e I, qe zgjuan ne zemer te kombit spiriten e independences, ndjenjen e forces se bashkimit dhe shijen e lirise kombetare, po i lane si trashegím dhe Kishen Katholike, e cila i solli mprojtjen e Papes dhe perkrahjen e fuqive Katholike te Perendimit, mi te cilat u-pshtet mé vone Skendebeu per te nisur fushaten e tij te paharúarshme.

Me katastrofen e Bálsheve u-dúk sikúr Shqiperia u-coptua perfunderísht midís Turqise dhe Venetise. Keté pershtypje e forconte trakteti i bere ne mes te ketyre fuqive me 1408, pas te cilit Venetia pengohej t' i paguante Turqise haráç per viset shqiptare qe mbante anes detit. Te tradhetuar me keté menyre, Shqiptaret s' kishin veç t' i únjeshin fatit dhe te mérreshin vesh me Turqit me konditat mé te mira qe muntnin te çkeputnin. S' kishin veç te njihnin siperanine turke, te pagu-

Digitized by Google

anin haráç dhe tє líheshin tє qetє me njє farє autonomie tє bréndєshme. Kєté çap u-kєshillontє forca e rásjeve; po natyra e tyre kryelartє i ndalontє t' i jipnin armєt pa u-matur dhe pa lєftuar nє fushє tє nderit gjer sa t' u thyhej shpata dhe t' u mpihej forca e kundєrshtimit.

Fuqia turke shtohej sa vente po arrintє kulmin e saj; perandoria bizantine me-zi merrtє frymє; Sєrbia ishtє e çaluar; Bullgaria ishtє e shtypur; Maqedonia dhe Greqia veriore ishin shkelur, po Shqipєria e vogєl, e copєtuar, e paorganizuar si gjithenjé dhe posá e dalє nga njє rrebésh, po qendronte e armatisur qє tє priste njє rrebésh tjatєr mé tє tmerruar dhe tє kontestontє çap pєr çap shkeljen e tokєs qє i kishtє mbetur. Gjer nє kєté kohє Turqit, me dúartє tє zєna gjetkє, s' patnє kohє t' a pasonin seriozísht ngadhєnimin e Shqipєrisє, nofta dyke pandehur qє e kishin nє dorє, posá ua falte tєrthori trakteti me Venetinє. Po nga falja e traktetit me nyja gjer te marrja e vendit me armє kishtє njє gropє qє u-deshnє shtatєdhjetє vjet e ca qє tє kapєrxehej, dhe gropa mbeti prapє e hapur dhe s' u-mbyll kurrє ploterísht. Kєté fakt e çprovuan Turqit nє kєté shekull dhe patnє rasjen t' a shtudiojnє me ngé shekuj me radhє pastáj.

Parєthénia e luftєs sє Shqipєrisє kundєr Turqisє pєr jetє a pєr vdekje po arrintє nє mest mє 1421, kur Sulltán Muradi II, 18 vjetsh trim, ngje-

Digitized by Google

shi shpatєn e Osmanit. Ishte njє luftє inegale nє mes tє njє Goliathi tє tmeruar, tє ushqyer mirє, dhe t' armatisur rendє nga njєra anє, dhe tє njє Davidi tє vogєl, tє pa ngrenє, tє reçkosur me njє hobé nє dorє nga tjatra. Lufta pa shpresє, tє cilen cilidó tjatєr do t' a kishte lenє si tє humbur. Po Shqiptari jo. Kur kombe tє tjerє mé tє fortє, mé tє medhénj, mé tє organizuar u-perfshinє prej Turqve me njє lehtesí çnderónjєse, Shqiptarєt leftuan pa prerє qє mє 1385 gjer mє 1479, pothua njє shekull tє tєrє, mprojtin independencєn e atdheut dhe nderin e ármєve tє tyre kunder Sulltáneve mé tє tmerruar, qє ka nxjerrє Turqia, me njє trimeri dhe me njє perseverancє tє pathyer, qє s' kanє shoqe nє historí tє botes dhe qє gjenden vetem nє legjendat trimєrore tє vigándeve prehistorikє.

Kur u-permbysnє Balshet dhe Shpatєt, tє tjerє princєr shqiptarє zunє vendin e tyre, kapnє flámurin e lirisє qє u ra nga dora, dhe u-radhitnє qє t' u bejnє ballє súlmave turke. Mé tє shenúarit prej ketyre ishin Gjon Kastrioti, princ i Krujes, i Matit dhe i Vumenishtit nє verí, dhe Arianit Komnén Thopia Golemi, princ i Kaninєs, i Himarєs, i Çermenikes dhe i Shpatit nє Jugє (1). Kufiret

1).—Principatєn e Arianitit e pєrshkruan Barleti kєshtú: "Nam a fliumine Aoo, sive Aeante, licet eiincolae aliud superindiderint nomen, Vavissam appellantes, ad finum usque Ambratium fere per omnen imperium ejus extendebatur" (L. II, f. 34). Gjetkє

Digitized by Google

e principátave tє tyre Laoniku i pershkruan kështú: Nisnin qє nga principata e Stefanit, tє birit tє Sandalit, nє verí dhe arrinin gjer nє Gjirokastrє nє jugє (1). Nga juga kufiret janє tє çkóqura, po nga veriu dhe nga lindja? Cili ishte ky Stefán, i bir' i Sandalit? Per fat tє mirє, kronikani i Raguzes Luccari na ndriçón mi pikєn e funtme, se prej tij mesojmє qє ky Stefán, i bir' i Sandál Hraniçit, ishte Voivodє i Chelm-it, Novipazarit tє sotmє. Influenca e Gjon Kastriotit, pra kaperxente Drinin e Zi dhe arrinte gjer nє burimet e Drinit

(L. XIII,f. 364) shton qє kishte dhe disá krahina afer Elbasanit. Biemmi e quan "Signore della Canina provincia dell' Albania inferiore" (L. I, f, 30). Laoniku e pershkruan: "pleraque maritima erat" (L. V. f. 248). Muzaka, nofta nga shkaku qє e dó Kaninєn dhe Vloren per veten e tij, hesht per viset qє kish Arianiti anes detit perketéj Viosєs dhe e heth pertéj Devollit: "Il Signor Arianiti Comnino fú Signore de una parte de Macedonia, cioé del paese de Cerminicha, e del de Mochina e di Spatennia stendendo per fin al fiume de Devoli, che divide il paese nostro del suo ch' é confine" (Hopf, f. 299), Hahn-i dhe Hopf-i, tє cilєt s' e kishin kenduar Biemmin, hedhin mє nj' anє deshmimin e Barletit e tє Laonikut dhe venє pas Muzakes sa per principaten e Arianitit (Shih Hahn, Reis, vell. 16, f. 109-114 dhe Hopf, f. 535). Qє Barleti dhe Laoniku nukє gabohen provohet nga Biemmi, i cili pas Tivárasit e vє Arianitin nє Kaninє, njє qytét qє s' e perménte si kryeqytét té tij as Barleti, as Laoniku, dhe qє s' munt t' a ketє parє nє enderr Biemmi.

1).—Laonicus, L. V, f. 248.

Digitized by Google

tє Bardhє dhe Moraçєs, nє verí tє Kosovєs. Taní, dyké hequr njє vijє peraferishte qє prej Parges, tє cilєn e múarє Venecianєt mє 1401, gjer nє Kostúr. tє cilin e múarє Turqit pas motit 1389, s' andejmi nє liqén tє Prespєs dhe tє Ohrisє(1), dhe nga liqeni i Ohrisє pak pertej Drinit nga ana e lindjes e drejt permés Kosovєs nє Novipazár, s' andejmi dyke marrє brenda Malin e Zi tє sotmє dhe dyke mbajtur mєnt qє Shkodra, Tivari, Ulqini, Leshi, dhe Dúresi ishin nєnє zoterím tє Venetisє, munt tє kemi njє idé tє pergjítheshme tє Shqiperisє, mi tє cilєn zgjatej influenca e Gjon Kastriotit dhe e Ariantit. Nga ana tjatєr, nukє duhet harruar qє perbrenda kєtyre kufíreve tє Shqiperisє kishte disá princєr tє mєdhénj e tє vegjєl, mє vete krejt a per gjysmє, tє cilєt e njihnin Gjon Kastriotin nє verí dhe Arianitin nє jugє, tє paken, si tє parin midís shókєve, dhe tє shumєn, si kryekumandár tє ushterive aliate.

Dinastia e Thopíave, e ndarє mє dy dega kryesore, kishte influencє qє nga Dúresi gjer nє Nartє, e qє nga Kruja gjer nє liqén tє Ohrisє nє verí tє Devollit. Renjєn e kishte nga Laberia. Dega e Krujєs dhe e Dúresit mbante vetєm llagapin *Thopia;* dega e Kaninєs, e Çermenikєs dhe Shpatit

1).—Ohria, mi tє cilєn mbreteronin princєt shqiptár nga shtepia Gropa ra nє duar tє Turqve pas bетejєs sє Kosovєs, 1389, nє kohє tє Sulltán Bajazidit I.

Digitized by Google

shtonte llagapet *Komnén Golem*. Stergjysher tє kєtyre dy dégєve permenden qє nє krye tє shekullit tє trembєdhjettє. Dega e parє ishte e lidhur me anє marrtese me shtepinє mbreterore frenge Bourbon-Anjou tє Nápolit; dega e dytє me shtepinє perandorake tє Komnénєve tє Stambollit. M' i dєgjúari nga dega e parє ishte Karóll Thopia, i bir' i Andrea Thopisє dhe i njє princeshe angjevine tє Nápolit, Princ i Shqiperisє, Zot i Krujєs dhe i Dúrєsit nє kohє tє Balshєs I dhe Gjergjit I; i cili mє 1358 e mundi dhe e vrau Nikefór II Orsinin, kryezotin e Epirit dhe Thesalisє, nє bєtejen e lumit, Akelloos (Aspropótamos); rindertój fortesat e Krujєs e tє Petrellєs; u-zu me Gjergjin I Balshen dhe Balshen II, tє cilєt i rembyen Krujen dhe Dúrєsin; pastáj u-pajtua me tá, u-martua me Voisavєn, tє bijen e Balshєs I, dhe ishte aliati i tyre; vdiq nє Jenár 1388 (1). M' i dєgjúari nga de-

1).—Nє Manastirin e Shєn Yoán Vladimírit, afєr Elbasanit, ka njє pєrshkєrím latinísht, gєrqisht dhe sllavísht, me anєn e tє cilit bєhet e njohur qє Karoll Thopia e rindertój qє nga themelia mє 1381. Nga pєrmí shkrimi gєrqísht merret vesh qє llagapi i tyre ishte *Thopía* (me *th* e me aksentin nє *i*). Kєtú Karoll Thopía quhet "primus de domo Franciae" dhe armєt e tij janє njє luán i kurorєzuar (Shih Hahn, Albanesische Studien, I, f. 120, Jena 1854). Gjon Muzaka e pєrshkruan kєshtú lidhjen e Thopíave me Angjevinєt e Nápolit: "Et anco sappiate ch' il Ré Roberto quale fú

Digitized by Google

ga e Kanines eshtε koheshoku dhe vjehri i Skenderbeut, Arianít Thopia Komnén Golemi, i cili fitój famε me lúfterat qε beri kunder Sulltán Mehmedit I dhe Sulltán Muradit II. Nε kohet e vjetra principata e Arianíteve zgjatej gjer brenda nε Maqedoní, se nε shékullin e trembedhjetε permendet njε Komnén shqiptár si Princ' i Prespes.

Emri i Kastrióteve del nε shesh per heren e parε mε 1368, kur njε Kastriót permendet si kapeden i Kanines (1). Mε 1389, si pamε mé siper, princet e kesáj shtepie ishin nε njε radhε me prin-

---

Ré de Napoli, mandó ad marito una sua bastarda al Principe della Morea, et essendo per la fortuna menata in detta cittá de Durazzo, lá stette alcuni giorni di modo ch' il Signor Andrea se n' innamoró de detta cittá de Durazzo, lá stetta alcuni giorni di modo ch' il Signor Andrea se n' innamoró de detta Signora e lei de lui, li quali furno d' accordo d' accasarse insieme, e cossí fecero e fero due figlioli; il primo hebbe nome il Signor Carlo, e l' altro Signor Giorgio. E per spatio de tempo il Ré Roberto convitó sua figliola e suo genero in Napoli, e poi, che foro in suo potero, li fece ambidue morire per l' atto fatto, e li detti' suoi figlioli' fuggirno indietro al lor paese (Hopf 297-298). Disá e shkrúajnε llagapin e tyre *Theopia* dhe *Theopea*. Barleti gabohet kur e quan Karóll Thopinε *themeltár* tε Krujes, se kjó fortesε permendet prej Akropolitit mε 1250 (Acropolita, f. 98, Bonn).

1).—Nε Vlorε mbreteronte mε 1350-1363 i kunati i Car Dushanit, Princ Iván Komnén Aseni, i vellάj i

Digitized by Google

cet e pare te Shqiperise, se nje Gjerq Kastriót merr pjese dhe ben proponime ne keshillen e luftes perpara betejes se Kosoves. Me 1407 permendet Gjon Kastrioti ne arshivat e Venetise, dhe me 1421 Gjerq Kastrioti ne nje dokumént te manastirit te Hilandarit, ne Mal te Shenjte.

Barleti na thote qe Gjon Kastrioti ishte nga nje shtepi e vjeter e Matit, te cilen e quan latinísht *Aemathia* (1), dhe s' vete mé tutje; Gjon Muzaka na shpie gjer tek i ati, qe e quan Pal dhe shton qe ky s' kish veç dy fshatra, Sinjen dhe Gardhin e

---

Carines Helena te Serbise dhe i Carit te Bullgarise, dhe me 1366-1368 i biri Aleksander, te cilin e dboj nga Vlora dhe nga Kanina Gjerq I Balsha. Me 1368 Princ Aleksandri ben nje aplikate ne Republiken e Raguzes qe te qaset si qytetár i saj i nderit. Aplikaten dhe bene qe ben e vertetojne ketá deshmore: "*Prodán Voevoda, dhe Mikleúsh kapedani i Vlores, Branillo dhe kapedani i Kanines Kastriót.*" Mi keté dokumént, qe eshte shkruar sllavísht dhe ndodhet ne arshivat e Raguzes, bazohet Hopf-i, kur i jep Skenderbeut nje stergjýsh me emrin Branillo Kastriót (f. 533), ne te cilin gabohet, se Branillo-ja dhe Kastrioti jane dy njeres te veçante. Shih Thalloczy und Jireçek, Zwei Urkunden aus Nordalbanien.

1).—"Neque omnem avorum ejus seriem prescribere in animo est, illud unum attigisse contentus ero auctores gentis Castriotae ex *Aemathia* nobili ortu fluxisse, imperitasseque pari gloria, fortunaque in Epiro." Barleti, L. I. f. 1.

Digitized by Google

Poshtme, midís Matit e Dibres (1); Hopf-i dhe Hahn-i e shtyjnε gjeneallogjín' e tij gjer tek i gjyshi. me emrin sllav *Branillo* dhe atjé gabohen, sikunder provohet nga dokumenti mi tε cilin bazohen (2); nga ky *"Branillo Kastriót"*, i çpikur gabimísht, dhe nga njε frazε e kronikanit bizantín Spandugino (3), Hopf-i dhe Hahn-i besojnε qε

---

1).—"Sappiate com' l' avo del Signor Scanderbeg se chiamo Signor Paulo Castrioto, e non hebbe piú de due casali nominati Signa e Gardi-ipostesi; e de questo Signor Paulo nacque il Signor Giovanni Castrioto, lo quale se fece Signor della Matia, e de questo nacque il Signor Scanderbeg." Hopf, 301.

2).—Shih shenimin mé siper per Kastriotin e Kanines; Hopf, f. 533; Hahn, Reise, vell. 16, f. 115-121; perqás-i me Thalloczy und Jireçek, Zwei Urkunden aus Nordalbanien.

3).—"Scanderbeg, huomo valoroso della persona, il qual essendo per natione Serviano." Francesco Sansovino, Spandugino, f. 201; dhe Hopf, Spandugino, f. 334: "Scanderbeg huomo valente e per natura Serviano." Ky kronikán bizantín Spandugino (Spandolitio, osé Spandoni) shkroj njε libre mi Turqit, e cila u-botua prej Sansovino' s nε njε vellím me historín' e Skenderbeut prej Anonimit mε 1564. Doreshkrimi i Spandonit qε botón Hopf-i eshtε shkruar mε 1535. Tani, para se tε besojmε njε historián per ató qε thotε, duhet tε shikojmε nga ç' burím i hoqi lajmat qε na jep. Spandoni shkruán vetem disá radhε per Skenderbenε dhe nga ketó merret vesh lehtε qε burimi prej tε cilit i hoqi ishte Barleti me Anonimin. Per shembell,

Digitized by Google

Kastriotet qenε sllavε tε shqiptarizuar dhe me njε lehtesi tε çudíçime i vεnε vulεn e tyre prej savantesh njε legjente tε pa themeltε. Hahn-i, pεr tε mbytur ca dyshime qε ka mi ketέ hipotheze dhe pεr tε shpjeguar qysh Kastriotet kishin tε drejta mi Krujεn, dhe qysh ketá "sllavε" tε shqiptarizuar nga njε der' e vogεl vihen nε krye tε príncεrve shqiptarε tε kulluar nga dyer tε vjetra, na thotε qε i ati i Gjon Kastriotit, tε cilin Gjon Muzaka e quan Pal, ishte Kostandini, i cili u-marrtua me Helenεn, tε bijεn e Karóll Thopisε, dhe i cili mbreterój nε Krujε mε 1395-1401; keshtú, nga kjó lidhje me shtepin' e vjeter tε Thopíave, Kastriotet forcuan pozitat e tyre nε Shqipεrí, dhe Skenderbeu del sternip' i Karóll Thopisε nga vija femrore (1) Hopf-i ketέ Kostandín tε Krujεs na e tregón jo si t' atín, po si tε vellan' e Gjon Kastriotit (2). Mé

Spandoni na thotε qε Sulltán Muradi II vdiq pεrpara Krujεs dhe na tregón legjenden e shpatεs qε i dergój Skenderbeu Sulltán Mehmedit II. Qε tε dyja ketó i ka marrε ngà Barleti dhe anonimi. Edhe sllavesín' e Skenderbeut e ka hequr nga e-ema Viosava Polloga dhe nga Aemathia e Barletit dhe Anonimit, tε cilεn e kujtón pεr Maqedoninε sllave, dhe s' eshtε as i pari as i funtmi qε genjehet me ketέ emεr, sikundεr do tε shohim mé tutje. Ndryshe e levdón Skenderbenε, pεr tε cilin shkruan: "Era tonta la virtú militare ch' in lui regnava, che non se patria narrare, il qual fece mirabil cose contro Turchi."

1).—Shih Hahn Reise, vεll. 16, f. 115-121.

2).—Shih Hopf, 533.

Digitized by Google

nє funt, provohet qє ky Kostandín s' qé nga shtepia e Kastrióteve, po nga e Bálsheve (1), dhe ahere tєrє argumenti i Hahn-it bie prej vetiu, dhe mbetet pєr tє shpjeguar qysh Kastriotєt, *"ketá princєr tє vegjєl tє Sinjєs dhe nga rєnjє e huaj"*, fituan kryesin' e feodáleve Shqiptarє. Pisko-ja (f.7) dhe Fallmerayer-i (vєll. 9, f. 4) janє tє mendjes qє legjenda e sllavєsisє sє Kastrióteve e ka rєnjєn tek Princesha Viosava e Pollogut (afєr Shkupit) me tє cilєn u-marrtua Gjon Kastrioti. Po Fallmerayer-i (vєll. 9, f. 21) vє gjishtin nє plagє kur na thotє qє *Aemathia* e Barletit ka qєnє qє nga koha e tij gjer sot njє burím lajthimesh, se me ketє emєr quhej nє kohєt e vjetra Maqedonia jugore dhe shpesh tєrє Maqedonia. Spandoni, Lavadin-i (2), Paganel-i (3), e me dyzina tє tjerє janє gєnjyer

---

1).—Ky Kostandín ish i bir' i Gjerq I Balshєs dhe Theodorєs, ish-murgeshєs Xenia; u-vra nє Durєs prej Veneciáneve mє 1402 nukє dihet qysh e pєrsé. Shih Zwei Urkunden.

2).—"Les autheurs de la lignée des Castriots tirent leur noble source d' Aemathie, et (comme aucuns adioustent) de Vumenestie, qui fait portion de Macedoine, ayans jadis regné en Epire avec non moindre gloire que prospérité." Lavardin, L. I, k. I, f. 2.

Pєrqás me ketє Dimitєr Frєngun, kap. I, f. 1: "Il Signor D. Giovanni Castrioto fu quello che signoreggió quella parte dell' Albania, *la quella si chiama ancora oggi* Emathia & Vumenestia."

3).—"Jean Castriota d' une antique e vaillante

Digitized by Google

nga ky emer, dhe kanë kujtuar që Kastriotët e kanë patur renjen nga Maqedonia sllavë. Që Barleti flet për Matin dhe jo për Maqedoninë s' duhet as biseduar. Për shembëll, Krujën e vë "in campis Aemathiae", gjith ashtú dhe Petralbën, dhe lumin e Matit e quan *Aemathus* (1). Mé në funt, nuke duhet harruar që, sikúr të kish një pikë vertétësie për sllavësin' e Kastriótëve, Gjon Muzaka, i cili s' le gjë pa thënë, nuke do të kishte heshtur mi këté pikë. Përkundër, do t' a kishte krisur më të katër anët.

Thalloczy dhe Jireçek-u e qúajnë *pralle* sllavësín' e Kastriótëve (2) dhe shtojnë që llagapi i tyre është bizantín, dhe tregón që e kishin rënjen nga një fshat, i qúajtur *Kastrí* (me aksentin në i). Llagapet gërqishte të príncërve shqiptarë t' asáj kohe nuke janë një gjë e pazakónëshme, nga shkaku i zotërimit të gjatë bizantín. Emërat Arianit,

---

race originaire d' Emathie, en basse Macédoine.—Note: Actuellement district de Moghlena.....Edesse, aujourd' hui Vodena, était sa principale ville."—Camille Paganel, Historie de Scanderbeg, Paris 1855.

1).—"Diximus enin jam Croiam Epiri urbem esse in campis Aemathiae positam." Barleti, L. XII, f. 360. "Oppidum hoc (Petralba) in Aemathia est in sublimi montis cacumine situm parvum alitu tamen, praeter famem nullam vim hostium timens. Preaterea ad ipsas montis radices praeterfluens *Aemathus* fluvius, non minus pulchritude, quam munimenti, et commoditatis loco illi addere videtur."—Barleti, L. I, f. 22.

2).—Zwei Urkunden aus Nordalbanien.

Digitized by Google

Span (spanos), Skura (Sguros), Theopia e tjera duken me nje hete qe jane greko-bizantine. Nga ana tjater, prapashtimi *iót* a *jot* per te treguar vendesin e nje fshati a qyteti u-bé pjese e shqipes dhe perdoret nga kohet mé te vjetra pothua ne tere Toskerine perendore, nga kanina gjer ne Narte (1). Qe ky prapashtím kishte hyre ne gjuhen qe nga periuda e zoterimit bizantín dhe qe llagapi *Kastriót* nuk eshte e vétema shembell, provohet prej Barletit, i cili Himariotet e sotme i quan "Cimerotae" (2). Fshatra me emrin *Kastrí (Kastria-a)*, ka sot ne Shqiperí, nje ne Çamerí dhe nje ne verí te Míredites afer Drinit. Ne kohen bizantine, dyke marre ne sy qe kjo fjale llatinishte me forme greqishte ka kuptimin e nje kulle, a keshtjelle te vogel, munt te thomi sigurísht qe kishte me dyzina *Kastrira* ne Gegerí e ne Toskerí.

Veç asáj se Gjon Muzakes, Hopf-it e Hahn-it, kemi nje tjater gjeneallogjí, te cilen na e jep historiani Frenk Du Cange (3) i cili e ka marre nga An-

---

1).—Keshtú themi *Kaninjót, Suliót, Himariót, Delvinjót, Borshiót, Fteriót, Sheperiót, Frasheriót,* etj.

2).—"Montanus is est locus (Cimera), Corcyrae oppositus. Indomita gens habitat, feroxque, ne bellicosa dicam, *Cimerotas, vulgo dicimus*, mullius rei, artisve auxilio, praeterquam naturae, et locorum munimento tuti."—Barleti, L. II, f. 34.

3).—Charles Du Fresne Du Cange, Historia Byz-

Digitized by Google

drea Angeo Flavio Comneno (1), një princ shqiptár nga dera Engjelli e Drishtit dhe e Tivarit. Pas kesáj, stergjyshi i Skenderbeut quhej "Kostandín Kastrioti, me llagapin *Mazaraka* a (Mazereku), Princ, a Zot; i Matit dhe i *Kastorise*, i cili vdiq me 1390 (2)." Ky ia la principaten e tij te birit, "Gjerq Kastriotit, Princit te Matit, Vumenishtit

---

antina, Familiae Augustae Byzantinae, Venetí 1729. Gjeneallogjia e Kastrióteve eshte ne faqen 270.

1).—Aqe Hopf-i sa dhe Hahn-i e qúajne "çpikes te degjuar prej gjeneallogjirash te rrema" dhe deshmirain e tij s' e marrin fare ne sy. Per çudí, Andrea Flav Komnén Engjelli nuke duket qe genjén shume ne gjeneallogjín' e tij, sikunder do te shohim mé tutje. Nga ana tjater, Hopf-i gabohet trasherísht kur e cilesón si "te veteqúajtur Princ." Pas deshmimit te Tivárasit, te anonímeve dhe te Dimiter Frengut, shtepia *Engjelli*, te cilen s' e perménd fare Hopf-i, ishte princore dhe nga ató mé te vjetrat e Shqiperise.

2).—Constantinus Castriotus, cognomento *Meserechus, Aemathiae* et Castriae Princeps, vel Dominus, memoratur a Flavio Comneno, qui eum obiisse ait anno MCCCXC." Du Cagne, f. 270. Nofta ató qe e bene Hopf-in t' a hedhe ne shporte keté gjeneallogjí jane fjalet *Mazaraka* dhe *Kastoria*, nga te cilat nenekuptohet qe ky stergjýsh i Skenderbeut ishte i lidhur me shtepín' e vjeter princore te Mazarákeve te Nartes dhe mbreteronte qe ne Mat e gjer ne Kostúr. Po kjo ndreqet lehte: *Castoria* dhe *Meserechus* munt te jene fshatrat *Kastria* afer Drinit dhe *Mazreku* afer Shkodres; pas kesáj, Kostandín Kastrioti del Princ i Kastrise dhe i Matit; llagapin *Mazrék* e shton per te treguar

Digitized by Google

(1), dhe *Kastorisë*", i cili ishte gjysh i Skenderbeut dhe i cili, sikunder pamë mé siper, mori pjesë në betejen e Kosovës. *Kastoria* e permendur siper s' eshtë Kosturi, po *Kastria* e Malësive, vendi lindór i Kastrióteve, që ndodhej nofta në krahinën a bajrakun e Mazarakut, midís Shkodrës dhe Drinit. Shembella Shqiptaresh që marrin llagapet nga fshati lindór dhe krahina e tyre ka me míjera dhe munt të thomi që të ketíja janë mé të shumat e llagápeve të tyre. Geneallogjia e Du Cange-it, pra, ka avantat që shpjegón llagapin *Kastriót* nga *Kastria* dhe që perménd Gjerq Kastriotin e betejës së Kosovës. Veç kesáj, forcohet nga fakti që Skenderbeu u-emërua *Gjerq* pas gjyshit dhe një i velláj *Kostandín* pas stërgjyshit.

---

krahinën ku ndodhej *Kastria*, fshati i tij lindór, ose bajrakun, pjesëtár i të cilit ishte. Kështú, me pak të kréhura, Flav Komneni na shpie afër së vertetës dhe na jep shpjegimin e llagapit *Kastriót* fare korekterísht pas etimollogjisë. Veç Mazrekut të Shkodrës, ka dhe dy fshatra të tjera me këtë emër, një Mazereke pranë Oparit dhe një Mazarake në Çamerí. Është për të vënë re që ndénjësit e *Kastrisë* në Çamerí quhen sot e kesáj dite Kastriotë.

1).—Gjon Kastrioti quhet "Princ i Matit dhe i Vumenishtit" prej Anonímeve dhe prej Dimitër Frengut. Këtë titull e vertetón Hopf-i me arshivat e Venetisë. Ç' farë krahinë e Shqipërisë ishte Vumenishti dhe ku ndodhej nukë dimë. Nofta është Guonimi, që perménd Muzaka, po s' dimë ku ndodhej as kjo.

Digitized by Google

Kronikani i Raguzes Luccari na thotε qε dera e Kastrióteve, "buronte nga *fshati Kastrati* nε malesí tε Hasit, afer lumit Drin (1). Etimollogjísht, εshtε shumε rendε qε tε dalε llagapi *Kastriót* nga *Kastrati*, dhe duket qε Luccari ngaterrón Kastrin' e Drinit me malesin' e Kastratit nε verí tε Shkodres. Po Barbarich-u na shigurón qε nε Kastrát ka sot njε bajrák tε vogel, pranε Shtjéfanit, pjesεtaret e tε cilit quhen pikerísht *Kastriotε*, dhe levdohen qε janε nga gjaku i Skenderbeut." (2)

---

1).—"Giovanni Castrioto, Signor di Crui, laqual famiglia uscí da Castrati villa nella giurisditione in As in Albania, poco discosto dal fiume Drillon." Luccari, Annali di Rausa, f. 86.—Deshmimi i Luccarit ka rendesí tε madhe, se Gjon Kastrioti dhe tε bijtε ishin qytetarε tε nderit tε Republikes sε Raguzes, dhe Skenderbeu e vizitój Raguzen mε 1461. Veç kesáj, kronikani i Raguzes εshtε i lajmeruar mirε pεr shtepitε princore t' asáj kohe. Fallmerayer-i e cilεsón keshtú: "Die Chronik von Ragusa, die ueber alle mittelaterischen Begebenheiten jener Laender die verlaessigsten Nachrichten enthaelt." Vell. 8, f. 713, Muenchen, 1860.

2).—"I Castrioti sembrano originari di Maserek, villaggio posto sui colli alle falde del monte zuccali. Sembra infatti che Maserek sia stato il nome piú antico di questa nobilissima famiglia albanese, come attestano Ducange e Flavio Comneno. E anche probabile che essa sia originaria dalle attigue terre dei Castrati, tra le cui genti si trova anche oggi giorno una piccola tribú (presso Shtiefani) denominata dei *Cas-*

Digitized by Google

Tɛ gjitha dɛshmimet, e ndryshme, qɛ nɛmɛruam siper, munt t' i pɛrmbledhin e t' i pajtojmɛ kɛshtú: Kastriotet riedhin nga njɛ fshat i qúajtur *Kastria*, qɛ ndodhej a nɛ Mat, a nɛ Mirditɛ, a nɛ Has (1), a pranɛ Mazarakut, a nɛ Kastrát, sidomós nɛ Malɛsitɛ afɛr Drinit; Kostandín Kastrioti, Princ i Matit dhe i Kastrisɛ, stɛrɛgjýsh i Skɛnderbeut, u-dbua nga principata e tij bashkɛ me Dukagjinɛt prej Bálshɛve tɛ parɛ, dhe shkon nɛ Vlorɛ, ku princi bullgár Aleksandɛr Komnén Aseni e emrɛrón Kapedán tɛ Kaninɛs (2); Aseni, Dukagjinɛt dhe Kastriotet pɛrpiqen tɛ lidhin njɛ aliancɛ me Republikɛn e Raguzɛs kundɛr Bálshɛve mɛ 1368; po Gjɛrq I Balsha, i lidhur me princɛt e Myzɛqɛsɛ, u bie mɛ 1372 dhe zaptón Vlorɛn, Kaninɛn dhe Gjirokastrɛn, pas kɛsáj, Kostandín Kastrioti dhe Prodán Dukagjini a u-pajtuan me

---

trioti appunto. Questa famiglia, per non interrotta tradizione, e reputata della stripe di Giorgio lo Scanderbeg."—Eugenio Barbarich, Albania, f. 177, shenim 2, Romɛ 1905.

1).—Mirɛditɛn dhe Hasin i kishte Gjon Kastrioti, po Barleti s' ua pɛrmént emrat fare dhe i pɛrmbléth nɛ emrin e pɛrgjítheshmɛ *Aemathia.*

2).—Pas Hopf-it, "Prodan Voevoda" i dokumentit tɛ Raguzɛs, ku ɛshtɛ nɛnɛshkruar dhe njɛ Kastriót mɛ 1368, s' ɛshtɛ tjatɛr vɛç Princi i Dukagjinit Prodán I, i dbuar prej Bálshɛve, i ikur nɛ Vlorɛ dhe i emɛruar Vojvodɛ i Kaninɛs prej Aleksandɛr Komnén Asenit. Shih Hopf, f. 533.

Digitized by Google

Balshet, a u-kthyen dhe zaptuan principatat e tyre, passí u-munt dhe u-vra Balsha II nє fushє tє Savrєs mє 1385; sidó qє tє jetє, mє 1389 Kastriotєt mbreterojnє prapє nє Mat, se Gjerq Kastrioti; i bir' i Kostandín Kastriotit, me njє ushterí shqiptare merr pjesє nє bєtejєn e Kosovєs dhe, si princ aliát i kryqєsatєs, bєn proponime nє keshillєn e luftєs; nє kohєn e Sulltán Bajazidit I, mє 1394-1396, Turqit ua rєmbejnє principatat Kastrióteve, tє cílєve s' u mbetnє nє dorє veç fshatrat Sinja dhe Gardhi i Poshtmє, mi tє cilat mbreteronte gjyshi i Skєnderbeut Gerq-Pal Kastroti (I); passí u-munt dhe u-zu rop Sulltán Bajazidi I prej Timurlengut mє 1402, Gjon Kastrioti, i bir' i Gjerq-Pal Kastriotit dhe i at' i Skєnderbeut rizaptój Matin, Vumenishtin dhe viset e tjera tє principatєs sє Kastrióteve.

Gjon Kastrioti ish i marrtuar me princeshєn Voisava, tє bijєn e princit tє Pollogut, njє krahinє midís Gostivarit dhe Shkupit (2). Kjo krahinє dukej qє ishte pjesє e perandorisє balshiane dhe

---

1).—E quajmє Gjerq-Pal pєr tє mos zєmєruar as Gjon Muzakєn, as Andrea Flav Komnєn Engjєllin e Du Cange-it, dhe s' єshtє çudí t' i kish tє dy emrat.

2).—"Uxori Viosave nomen erat, non indignam eo viro, tum pater nobilissimus *Tribalorum Princeps*, tum forma moresque, ac insignis super muliebre ingenium animus faciebat." Barleti, L. I, f. 1.—"Et la matre di esso Scanderbeg, chiamata Viosava, fu figliola del

Digitized by Google

hynte nenc influencen e Kastrióteve. Ndénjesit e saj Barleti i quan Bullgarc, po princerit e saj munt tc ishin Shqiptarc qc nga koha e Bálsheve. Si do tc shohim mé vonc, Skenderbeu i theu Türqit dy herc nc fushen e Pollogut. Nga kjo marrtesc, Gjon Kastrioti pati pesc vajza, Maren, Vlajken, Angjelinen. Jellen dhe Mamicen; dhe kater djema, Stanishin, Reposhin, Kostandinin, dhe Gjergjin. Tc kater vajzat e para i martój Gjon Kastrioti me princer aliatc: Maren me Stefán

---

signore di Pollogo, che é una parte della Macedonia et Bulgaria."—Anoním, K. I, f. 1, Venetí 1545.—"E piú sappiate ch' il Signor Giovanni Castrioto, padre del Signor Scanderbego, hebbe per moglie la Signora Visava Tribalda".— Hopf, Muzaka, 295, dhe f. 301: "hebbe nome Signora Voisava Tripalda e venne da bona parte."—"Viosava sua moglie figliuola d' un Signore de' Triballi, oggi i Bulgari."—Biemmi, L. I, f. 4.—I vétemi qc na jep llagapin e Voisaves eshtc Muzaka, i cili e quan *Tribalda* nc njc faqe, dhe *Tripalda* nc njc tjatcr. Ky llagáp ujdís aqc shumc me fjalen *Triballc* (Bullgarc), sa s' eshtc çudí t' ía kenc ngjitur Shqiptaret dhe tc ketc kuptimin *Bullgarka.* Po nc qoftc se ishte llagapi i vjetcr i shtepisc saj, ahere s' tingellin aspák sllavísht. Andrea Flav Komnén Engjelli e nxier nga familia e Muzákeve dhe ahere ishte Shqiptarkc e kulluar (Hopf, 308), po pcr ketć nukc ben fjalc fare Gjon Muzaka vetc; nga ana tjatcr ky i funtmi na thotc qc njc princ shqiptár me títullin *Marchese di Tripalda,* i cili rronte nc Italí pas vdekjes sc Skenderbeut, kishte gják prej tc Muzákeve (Hopf, 301).

Digitized by Google

Çernoviçin, princin e Malit tє Zi; Vlajkєn me Gjin Muzakєn (1); Angjelinє dhe Vlladán Arianít Komnén Golemin, princin e Çermenikєs dhe tє vellán' e Arianitit tє Kaninєs; Jellєn me Pal Stres Balshєn, princin e krahinєs midís Krujєs dhe Leshit. Mamica u-marrtua me Muzak Thopinє, passí u-kthye Skєnderbeu nє Shqipërí. Fortesat e Gjon Kastriotit qenє: Kruja, e cila ish kryqyteti i principatєs sє tij, Petrella (2) afєr Tiranєs, Petralba (3) dhe Stelluzi (4) nє Mat dhe Sfetigradi (5) nє Dibrє tє Síperme (6).

---

1).—Gjin Muzaka i Vllajkєs nukє duhet pєrzier as me Gjon Muzakєn, i cili ish marrtuar me njє princeshє nga dera e Dukagjinit, as me t' atin, i cili quhej edhé aý Gjin Muzaka dhe ish marrtuar me njє princeshє tє Gorєs; ka dy princєr Myzeqarє tє tjerє me kєtє emєr, qє i pєrmént Gjon Muzaka po s' na thotє me kє ishin marrtuar: Gjin Mataranga Muzaka, princ i Gorєs, dhe Gjin Bogdán Muzaka, princ i Merlonєs sє Tomoricєs. Nofta ish njє nga ketá tє dy.

2) Gúresi i sotmє.

3) Guri i Bardhє i sotmє.

4) Nukє dihet ku ndodhej.

5) Pranє fshatit Koxhasík, pas Barbarich-ut. Dibranєt rrefejnє gjєr mє sot njє gєrmadhє pranє fshatit Kєrçishtє, tє cilєn e qúajnє *Kalá e Skєnderbeut*, osє Qytét i Shenjtє pєrkthimi shqip i fjalєs Sfetigrad, nє verí-pєrendím tє Dibrєs.

6).—Duhet mbajtur mєnt qє Dibra e Síperme ndodhet afєr liqenit tє Ohrisє dhe Dibra e Poshtme nє verí

Digitized by Google

Nukɛ dihet qýsh e kúr Kruja shkoj nga duart e Thopíave a tɛ Turqve nɛ duar tɛ Gjon Kastriotit. Pervéç Gjon Muzakes (2), tɛ gjithe historianet e vjeter, si Barleti, Biemmi, Anonimet, Lavardin-i dhe Dimiter Frengu na thonɛ qɛ e kishte. Kronikani i Raguzes Luccari di vetem njɛ titull tɛ Gjon Kastriotit mɛ 1423, *Prínc' i Krujes* (3), dhe deshmimi i tij munt tɛ merret si aqɛ i paáneshmɛ sa dhe i shigurtɛ, se kishte perpara syve arshivat e Republikes sɛ Raguzes, i sɛ ciles ishte qytetár i nderit Gjon Kastrioti qɛ mɛ 1413 (4).

Lufta midís Gjon Kastriotit dhe Turqve mbajti qɛ mɛ 1407 gjer mɛ 1430, dhe nga sa dimɛ, Gjon Kastrioti u-thye tɛ paken tri herɛ prej Turq-

---

tɛ Dibres sɛ Síperme. Quhen keshtú, se njera eshtɛ nɛ mal dhe tjatra nɛ fushɛ.

2).—"E il predetto Signor Scanderbeg..... s' insignori della cittá de Croia, *ch' il padre l' hebbe.*" Shih Hopf, Muzaka, f. 299. Nofta Muzaka do tɛ thotɛ qɛ i at' i Skenderbeut s' mundi t' i benjɛ príncerit e Thopíave t' ia njohin Krujen zyrtarísht si tɛ tijnɛ.

3).—"Giovanni Castrioto, Signor di Crui." Luccari, f. 86.

4).—Thalloczy und Jireçek, Zwei Urkunden aus Nordalbanien, Archiv fuer Slavische Philologie, Vɛll. 21, f. 78-99, Berlin 1899.—Nɛ keté artikull gjenden tɛ gjitha hollesitɛ per Gjon Kastriotin qɛ japim mé tutje, tɛ vertetúara nga arshivat e Venetisɛ, Raguzes dhe manastirit tɛ Hilandarit.

Digitized by Google

ve dhe tri herë u-shtrëngua të bënjë paqe me kondita të rënda. Si duket, ngrinte krye posá merrte veten. Nukë dimë hollësísht cilat qenë konditat e këtyre tri·páqeve veç e veç, po përgjithërísht qenë këtó: 1) T' i jipte Sulltanit të katër bijtë si penk të besnikërisë tij me zotimin nga ana e Sulltanit që do të rríteshin në fen' e krishtere dhe që një prej këtyre do të lëshohej, pas vdekjes së Gjon Kastriotit, për të zënë fronin e zbrazët të principatës së Matit; 2) t' i lëshonte ploterísht fortesën e Sfetigradit; 3) t' i jipte Dibrën e Poshtme dhe Dibrën e Síperme me ca priviligje veteqeverimi për véndesit; 4) një aliancë ofensive dhe defensive, pas së cilës Gjon Kastrioti duhej t' i dërgonte një ushtërí Sulltanit në çdo luftë që të kishte me fqinjët; 5) t' a njihte Sulltanin si kryezót dhe t'·i pagúante haráç. Të tri konditat e para i dimë nga Barleti; të káterten na e thotë Laoniku, dhe kjo ka shumë rëndësí, se kështú shpjegohet qýsh Skënderbeu i gjeti të tre qint Shqiptarët, me nga arshivat e Venetisë. Mé poshtë do të japim të gjitha ngjarjet që dimë për Gjon Kastriotin:

Më 1407 përmendet si "një princ mjaft i fortë në viset e Shqipërisë," i cili njeh siperanin' e të cilët iku nga bëteja e Nishit; të pesten e heqim Republikës Venetike, pa fjalë nga shkaku i rezikut turk që i turej mi kokë (1).

---

1).—"Dominus satis potens in partibus Albaniae; se subjecit fidelitati nostri dominii."

Digitized by Google

Mε tre tε Prillit, 1407, Senati i Venetisε vendosi tε bεnjε ca pεrçape pranε Papεs pas njε letre tε Gjon Kastriotit. Peshkopi i Leshit deshte tε zaptonte dymbεdhjetε kishε tε peshkopatεs sε Arbenisε (1). Gjon Kastrioti protestón kunder kesáj gjεje, nga shkaku qε ketó kishε ishin tε Peshkopit tε Arbenisε qε prej 800 vjetsh dhe shton qε rembimi i kεtyre kísheve prej Peshkopit tε Leshit do tε sillte ngaterime tε mεdha (2).

Mε 1410, bajlozi i tij nε Venetí e lajmerón Senatin qε Gjon Kastrioti u-shtrengua prej Turqve t' u japε *tε birin* si penk dhe qε Turqit i bien mε qafε ditε pεr ditε qε t' i lerε tε zbresin pεrmés principatεs sε tij nε tokat veneciane anεs detit (3). Si duket, alianca me Venetinε nuk i solli

---

1),—"Occupare duodecim de ecclesiis episcopatus Albaniae et illas nititur semovere ab ipsu epicopatu Albaniae et unire atque reducere sub episcopatu suo." —Peshkopata e Arbenisε pεrmblithte krahinat e Matit, Miredites (Nεrfandinε dhe Orosh), dhe Tiranεs. Nga kjo merret vesh qε Miredita dhe Tirana ishin pjesa tε principatεs sε Gjon Kastriotit, osé tε paken, qε ishin nenε influencεn e tij qε mε 1407.

2).—"Maximus tumultus et dissensio inter ecclesias interque nobiles et omnes alios de contracta illa."— Pεr ketó shenime dhe pεr ató qε pasojnε shih *Zwei Urkunden.*

3).—"Ipsum esse astrictum a Turchis et habere proprium natum in obsidem apud eos et quotidie infestari, ut ipsos Turchos permittat per passus et loca sua des-

Digitized by Google

nonjé fitím ne keté rasje, dhe Gjon Kastrioti u-munt prej Evrenos Pashes, i cili keté mot shkeli Shqiperine dhe goditi Balshen III, prej te cilit u-dermua ne nje beteje te gjákeshme. *"I biri"*, qe qe u-shtrengua t' i jape Sulltanit si penk, nuk eshte Gjerq Kastrioti, sikunder besón Hahn-i, po Stanisha, sikunder merret vesh nga dokumenti i manastirit te Hilandarit (1).

Me 1411, merret vesh me Venetine kunder Balshes III dhe i blatón Republikes 2000 kalores, a mé teper ne qofte nevoje, per 1,000 dukate ne mot.

Me 21 te Marsit, 1413, Senati i Republikes se Raguzes vendosi t' a benje Gjon Kastriotin qytetár te saj te nderit. Kjo ka kuptimin qe Gjon Kastrioti, dyke pare qe Republika e Venetise e neveriti ne fat te tij, u-kthye nga Republika e Raguzes.

Po as kjo nuk i solli nonjé fitim, se me 1416 permendet ne arshivat veneciane si vasáll i Turqise. Duket qe, ne keté mes, u-shtrengua te njohe Sulltanin si kryezot dhe t' i pagúanje haráç.

Me 25 te Shkurtit, 1420, Gjon Kastrioti *dhe te bijte* bene nje traktét me Republiken e Raguzes per detyrat e doganes qe duhej te pagúanin

---

cendere ad territoria et loca nostra dominationi subjecta."

2) Shih mé tutje ne faqet qe pasojne.

Digitized by Google

tregetaret Raguzane që shkonin permés principates së Kastrióteve, që nga Shufadaja, në jugë të Leshit, gjer në Prizren. Leja (1) per tregetaret eshtë nëneshkruar prej kancellarit Pjeter në emer të Gjon Kastriotit, i cili permendet si Princ, dhe të bijve si bashkembretëronjës, të cilet nukë permenden me emrat e tyre.

Perpara motit 1421, Gjon Kastrioti *dhe të tre të bijtë, Reposhi, Kostandini dhe Gjergji,* blenë nga manastiri i Hilandarit në Mal të Shenjtë kullen e Shen Gjergjit. Më 1421, Gjon Kastrioti *dhe të kater bijtë,* Stanisha, Reposhi Kostandini dhe Gjergji, i falë manastirit të Hilandarit fshatrat Radostina dhe Trebishta (2). Nga blerja e

---

1).—Dokumenti i cili ndodhet në arshivat e Raguzës, ka títullin "Salvo-conduto ali merchadanti di Ragusa."—Shih Zwei Urkunden.

2).—Dokumentin e Hilandarit e ka gjetur një Rus, Grigorovich (Shih Zwei Uruknden). Në një pergamén, ku shkrúheshin veperimet e manastirit, ndodhet blertrioti ble kullen dhe fal të dy fshatrat *me të bijtë bashkë.* Pas këtí dokumenti, Stanisha duket si djali m' i në lejen per tregetaret e Raguzës, edhe këtú Gjon Kasmath, pas Barletit, Gjon Muzakës e të gjithë të tjéreve, në 1 Shtatór, 1421, gjer më 31 Gusht, 1422). Nga númerat merret vesh që blerja ngjau perpara faljes. Si Reposhi vihet perpara Stanishës. Disá veta që kanë vizituar Malin e Shenjtë me thonë që ka atje një kulle fshátrave me número 40, mot bizantín 6930 (domethënja e kullës me número 39 pa mot, dhe falja e të dy

Digitized by Google

kulles, ku mungón emri i Stanishes, duket qe ky, dhe jo Gjergji, u-dha si penk ne Turqit me 1410. Nga falja e te dy fshátrave merret vesh qe Stanisha, me nje menyre a me tjater, u-kthye ne Mat midís víteve 1410-1421, dhe qe Gjergji gjer me 1 Shtatór, 1421, s' ishte dhene penk ne Turqit. Ky dokuménт eshte i çudiçim nga nje pike: Qysh Gjon Kastrioti katholík i fal dy fshatra manastirit orthodóks te Hilandarit? Kjo gje munt te shpjegohet nga fakti qe Gjon Kastrioti kishte si subjekte, sikunder na thote dhe Barleti, shume Bullgare orthodokse ne Dibre dhe pertéj, dhe me keté falje qe i beri manastirit deshte t' u bente qefin dhe t' u fitonte simpathine. Ka dhe nje tjater shpjegím, i cili eshte fare i papritur per te húajte dhe i cili u duket Shqiptáreve fare i natýreshme: Gjon Kastrioti, ne lufte prape me Turqit dhe i shtrenguar keq prej ushterive te Sulltán Muradit, i cili hipi ne fron me 1421, dergón dhurata neper manastire e kísha, katholike dhe orthodokse, qe t' i luten Perendise llatinísht, gerqísht, sllavísht, ne perendím e ne lindje, t' a shpetonte nga reziku ne te cilin ndodhej, me shpresen pak a shume t' aresyshme qe, po te mos sillnin nonjé dobí faljet e

te prishur te Shen Gjergjit. Keté, si duket, e bleu Gjon Kastrioti per kallogjeret orthodokse te principates se tij. Nofta kulla ndodhej gjekúnt ne Dibre dhe ahere e bleu me qene qe ishte me nonjé brek me vlere strategjike.

Digitized by Google

fréterve katholikε tε qethur e tε rruar, munt t' a mbaronin punεn litanít' e pafuntme tε kallogjéreve orthodoksε kokεluanε, si Samsoni, qε i kanε dekllaruar urrejtje shékullore gersheres, briskut, kréherit dhe paqesisε. Tamám kater qint vjet pastáj, si Gjon Kastrioti, Ali Pashε Tepelena, nε lufte per jetε dhe per vdekje me Turqit, i porosít rabinet çifutε, hoxhet muhamedanε, baballaret bektashínj, dhe prifterínjte orthdoksε tε luten per shpetím tε tij nε havre e nε xhamí, nε teqé e nε kishε, dhe t' a sqojnε tε Lartin, qε e harrój Shqiperinε, me thirrjet e minareve dhe me gjemimet e kembánave. Sot e kesáj dite, fshataret shqiptarε nε shtrengím, pa ndryshím feje, trokasin me radhε deren e priftit, tε hoxhes e tε babajt. Pralla e bariut, i cili, i deshperuar nga shenjtoret, i ndezi njε qerí dhe i kerkój ndihmen Djallit, εshtε tipikerísht shqiptare. Kur reziku εshtε i math dhe shpresa e humbur, shpetimi εshtε i mirε ngadó qε tε vinjε, dhe nε oren e zezε tε mjerimit, Shqiptari εshtε pagán i fjeshtε dhe heth nga njε grusht temjám nε çdo alltár tε çdo Perendie qε i ka degjuar emrin.

Nε Vjeshten e motit 1421 Gjon Kastrioti e pati pisk dhe duket qε kεtε herε, passí leftój dhe u-munt, u-shtrengua prej Sulltán Muradit t' i japε tε kater bijte si penk, ndonesé historianet e vjeter nukε thonε çkoqur nε cilin mot i ngjau ky mjerím. Po Franza dhe Laoniku e lidhin dish-

Digitized by Google

faten e Gjon Kastriotit me rethimin e Belgradit mε 1421 me njε mεnyrε tε tillε sa duket qε njera ngjau pas tjatrεs. Laoniku, passí na tregón qysh Sulltán Muradi e ngriti rrethimin e Belgradit dhe e goditi Mbretin e Bosnjεs, passón (L. V, f. 248): Ngjitur me mbretεrín' e Bosnjεs εshtε principata e Stefanit, tε birit tε Sandal Hraniçit (Novipazár i sotmε); midís kεsáj dhe Epirit janε disá qytete tε Venetisε dhe principata e Gjon Kastriotit, pas sε ciles zgjatet principatat e Arianít Komnenit, *m' e shuma e sε ciles εshtε anεs detit* dhe arrín gjer nε Gjirokastrε, ku rrinte njε guvernór i Sulltanit; Muradi plaçkiti prncipatat e Kastriotit e tε Komnénεve; prej kεtyre u-thye (i pari) Gjoni dhe *u-shtrεngua tε vente me ushtεrin' e tij pas Sulltanit kudó qε tε kishte luftε (1).* Qε Sulltán Muradi e shkeli Shqiperinε mε 1421 provohet edhe nga njε tjater burím: Mε 21 Korrík, 1421, e εma e Balshes III vajti nε Venetí (2) pεr tε kerku-

)"Interea Ivanes victus ibat in januas regis, eumaque sequebatur quocumque cum copiis militatum abiisse." Laonicus, L. V, f. 249.—Pεrqás Frantza, L. I, k. 32, f. 92.

2)Chronik Johann Bembo: "Balscha's Mutter, welche die Herrin vieler orte in Albanien gewesen war, kam am 21 Juli, 1421, nach Venedig und emfahl die Staaten und Voelker ihres Sohnes dem Dogen und Senate, welshe sie mit Ehren weberhaeuften."—Shih Hahn, Reise, Denkschriften, vell. 16, f. 130, dhe shenime 7 dhe 8 tε kεsáj fáqeje.

Digitized by Google

ar ndihmen e Republikes kunder Sulltán Muradit, i cili keté mot nisi ngadhenimin e Shqiperisé; Senati i Venetisé e priti me nderime té medhá, po s' i dergój nonjé ndihmé Balshes III, me té cilin Venetia kishte qené né luftè qé mé 1410; Balsha III, me ató forca té paka qé kishte, e dermój ushterine turke qé u-dergua kunder tij dhe vdiq pak kohé pastáj. Gjon Kastrioti dhe Arianiti s' qené aqé té lumur sa Balsha III, u-muntné dhe njohné Sulltán Muradin II si kryezót. Sikunder pamé nga dokumenti i Hilandarit, e dhena penk e Gjerq Kastriotit s' munt té keté ngjaré perpara Shtatorit, 1421, edhe sikunder do té shohim mé tutje s' munt té keté ngjaré shumé kohé pas ketí moti. Lidhja e ngjárjeve qé na tregojné Laoniku dhe Franza me kronikanin venecián Bembo, dokumenti i Hilandarit i perqasur me njé lajme né arshivat e Venetisé mé 1428, dhe deshmimi i njezeshmé i té gjithé historiáneve té vjeter qé Gjerq Kastriotin nentevjeçár e mori si penk Sulltán Muradi II, dhe jo Sulltán Mehmedit I (1413-1421), na shtrengojné t' a vendosim keté ngjarje né Vjeshtè a né dimer té motit 1421.

Qé Gjon Kastrioti u-munt dhe beri njé aliancé ofensive dhe defensive me Sulltán Muradin mé 1421, ashtú si na e tregón Laoniku provohet nga iky fakt: Republika e Venetisé, e cila ndodhej né luftè me Serbiné pas vdekjes sé Balshes III, dyke mesuar qé Gjon Kastrioti beri njé aliancé me Sull-

Digitized by Google

tán Muradin II edhe qe ketá te dy gatíteshin t' a ndihmonin Serbine kunder Venetise, dergój me 1422 nje ambasadór te veçante prane Gjon Kastriotit qe t' a prapste nga kjo aliance me çfaredó menyre; Senati i Venetise i heq vrejtjen ambasadorit te saj qe Gjon Kastrioti ka ne sy te Republikes até nder, qe kish patur mé pare konti Nikita Thopía i Krujes (1), domethene si i pari i príncerve te Shqiperise. Me nje menyre a me tjater, Gjon Kastrioti e ujdisi prape me Venetine.

Me 1423, Gjon Kastrioti hyn si meses dhe arbitrón paqen midís Venetise dhe Serbise (2). Me keté ngjarje historike shkalla e principates se Matit ngrihet nenje lartesí me Republiken e Venetise dhe mbreterin' e Serbise.

---

1)"illum honorem habuit comes Nicheta."—Konti Nikita Thopia, princ i Vlores me 1392 dhe i Krujes me 1402, pas vdekjes se Kostandín Balshes; u-marrtua me te bijen e Maurík Shpates, kryezotit te Nartes dhe te Janines, dhe nemerohej prej Republikes se Venetise si i pari princ i Shqiperise; ishte i nipi i Karóll Thopise; disá vjet me radhe qé i lidhur me Venetine, po ne vitet e funtme u-zu me tá; vdiq me 1415, kur Turqit e zaptuan Krujen per heren e dyte. Nofta Gjon Kastrioti midís víteve 1415-1420 ua rrembeu Krujen Turqve dhe perandáj Sulltán Muradi II i dekllarój lufte me 1421.

2) Hopf, Ersch-Gruber's Encyclopaedie, vell. 86, f. 101.

Digitized by Google

Nε Maj, 1426, Gjon Kastrioti kerkón njε mjek nga Raguza.

Nε Korrík, 1428, Gjon Kastrioti i ben tε njohur Senatit tε Venetisε me anen e bajlozit tε tij, At Dimitεr, qε nuk εshtε i pergjígjεshmε, nε qoftε se i bir' i tij Gjerq, qε u-kthye muhamedán, shkel toka venetike. Senati i pergjigjet qε do t' a marrε nε sy ketέ gjε, po i lutet Gjon Kastriottit tε perdorε influencen e tij aterore pranε tε birit qε tε mos i ngasε viset e Republikεs. Nga kjo lajme merret vesh qε Skenderbeu ketέ mot ishte berε oficér i larte i ushterisε turke dhe dergohej prej Sulltanit si kumandár i pergjítheshmε nε shpedita tε ndryshme. Ky fakt, i bashkuar me ató qε thamε mé siper, na shtrengón tε besojmε qε Sulltán Muradi II e mori Gjerq Kastriotin si penk jo mé von se nε funt tε motit 1421. Skenderbeu ishte nentε vjetsh pas Barletit (I) kur u-dha si penk; nε qoftε

---

1).—"Vix dum enim nonum attigerat annum." Barleti, L. I. f. 3.

"Ancora fanciullo d' otto anni."—Dimitεr Frengu, k. I, f. 2.

Gjith' ashtú tetε vjetsh e nxierin edhé tε dy Anonimεt. Laoniku nukε na jep versεn e tij, po thotε vetεm qε ish djal' i vogεl; "qui puer venit in januas regis."—Laonicus, L. VII, f. 350.

Pas ketí hesapi, Skenderbeu lindi afró mε 1412; u-dha si penk nentε vjetsh mε 1421; u-kthye nε Shqipεrí tridhjet' e njε vjetsh mε 1443; u-marrtua tridhjet' e nentε vjetsh mε 1451; vdiq pesεdhjet' e gjashtε vjetsh

Digitized by Google

se u-dha, me 1421, del gjashtembedhjete vjetsh me 1428, dhe eshte shume rende te besojme qe arriu nje shkalle te larte ushteriake ne verse me te vogel se aqe. Duhet mbajtur ment qe edhe versa e gjashtembedhjete vjéteve eshte e vogel per shkallen e nje oficeri te larte, po kjo s' qé gje e pazakóneshme per até kohe, dhe veçanerísht per nje princ te nje shtepie mbreterónjese dhe nje trím te lindur kryekumandár si Skenderbeu. Gjon Kastrioti nuk i bén fjale Senatit per te bijt' e tjere se ketá, si duket nuk ishin bere oficere dhe s' kishin pozita te larta me pergjigjesí ne ushterí turke.

Me 18 Jenár, 1430, Senati i Raguzes vendosi t' u japé Gjon Kastriotit dhe bajlozit te tij Nikóll Suma nga nje dhurate.

Ne keté mes Gjon Kastrioti i prishi prapé marredhéniet me Turqit, se e shohim prapé ne lufte me Sulltán Muradin II. Me 18 Mars, 1430, ra Seleniku dhe pak kohe pastáj Isák Pasha valiu i Shkupit e goditi Gjon Kastriotin. Lufta mbajti qe ne Prill gjer ne krye te Qershorit. Pas dokuménteve ne arshivat e Raguzes, ushteria turke zaptój tere principaten e Gjon Kastriotit, sheshój krejt kater fortesa te tij dhe ne dy te tjera vuri

---

me 1468. Barleti na thote qe vdiq gjashtedhjet' e tre vjetsh, po per keté s' eshte shigúr as aý vete dhe veç kesáj kjo verse nuke pajtohet me deshmimin e tij qe ish nente vjetsh, kur e mori Sulltán Muradi, i cili hipi ne fron te Turqise me 1421.

Digitized by Google

garnizone turke. Pas kesáj lajme Gjon Kastrioti kishte gjashtε fortesa. Cilat qenε ketó? Nga Barleti dimε Krujεn, Petrellεn, Petralbεn, Stelluzin dhe Sfetigradin; nga Biemmi mesojmε emrin e sε gjashtes, e cila quhej Tornáç. Ushteria turke, si duket, vuri garnizonε nε Krujε e nε Sfetigrád dhe tε tjerat i prishi fare. Pas kesáj lufte Gjon Kastrioti u-muar prapε vesh me Sulltán Muradin, i cili ia dha prapε terε principatεn e tij veç dy fortésave dhe njε pjesε tε vogel tε principates, tε cilεn e aneksój Isak Pasha me vilajetin e Kosoves (1). Ketέ mot u-zaptua prej Turqve Danja dhe Dukagjini, po u-çliruan mé von me ma-

1).—Mε 18 tε Majit, 1430, Senati i Raguzes i shkruan bajlozit saj nε Novipazár: "De novello abiamo questo. Come avanti fo scritto, lo Turco obtení Salonicco et obtegnudo che l' have, parte delle sue gente mandó nella Morea e parte contra le tenute e paexe de Iuan Castrioth, le qual ad esso levarno *quatro forteze*, zoe castelle, *che gitorno per terra*, e segondo se diceva, esso Iuan cerchava sego achordo."

Mε 3 tε Qershorit, 1430, Senati i Raguzes lajmerón bajlozin e saj nε Bosnjε: "Di nove qua si dice, el Turco aver tolto tutte le forteze a Iuan Castrioti e quelle aver ruinate, *excetto due*, e qual a posto in man e guardia di Turchi, e la contrata aver renduta a Iuan, salvo alcuna particella, data a Isach, e la hoste mazor parte a licentiado, excetto una particula, chi é rimasta a guerizar el despoto de la Janina, e lo imperador e andato in Adrianopoli con la sua corte."

Digitized by Google

rreveshje a me kryengritje, nuke dihet qýsh.

Me 1438, Senati i Venetise i jep ca privilegje tregetare Gjon Kastriotit ne limán te Venetikut. Nga kjo lajme dhe nga ajó qe japim mé poshte nenekuptohet qe Gjon Kastrioti mori veten ne keté mes, e prishi prape marreveshjen me Turqit dhe ulith me Republiken e Venetise dhe te Raguzes.

Me 10 Korrík, 1439, Senati, i Raguzes vendosi t' i benje qytetare te nderit edhe te bijt' e Gjon Kastriotit. Ne vendimin emri i Gjerq Kastriotit eshte shkruar dhe pastáj prishur (1). Nga ky dokuménт duket qe Gjon Kastrioti, para se te vdiste, deshte t' i lihte te bijte me Republiken e Raguzes, qe keshtú te kishin ku te pshtéteshin, kur te iknin nga Turqia e te kthéheshin kunder saj. Pyetja qe na vjen ne goje me nje here eshte qysh Gjon Kastrioti kerkón nga Republika e krishtere e Raguzes t' i njohe per qytetare te saj te bijt' e tij qe ishin kthyer muhamedane. Pergjígjia eshte qe Gjon Kastrioti me anen e bajlozit te tij do t' a kete shiguruar Senatin e Raguzes qe te bijt' e tij, muhamedane nga nevoja dhe nga emri, ishin te krishtere nga zemra dhe qe do te iknin nga Eder-

1) Shih Zwei Urkunden.—Per fat te keq, Thalloczy dhe Jireçek-u, qe e kane patur perpara keté dokuménт, nuke na thone emri i kujt prej te bijve te Gjon Kastriotit vjen i pari ne vendín, qe keshtú te dinim shigurísht cili ishte m' i madhi, Reposhi apo Stanisha.

Digitized by Google

neja posá tε gjenin rasjen. Senati i Raguzεs pεlqén t' i bεnjε qytetarε tre tε parεt, po pas shumε bisedimesh e shuan emrin e Gjerq Kastriotit, i cili nε kεté kohε kishte marrε famε si kumandár i ushtərisε turke dhe u kishte kallur tmerrin shtéteve tε krishtera tε Ballkanit, kundεr tε cílave dergohej prej Sulltán Muradit. Ironia εshtε qε u-kthye nε Shqipεrí aý qε u-refuzua prej Senatit si qytetár i nderit; nga tε tre tε tjerεt, dy vdiqnε tε helmuar nε Ederné, dhe njε vdiq si murk nε manastír tε Malit Siná (1).

1).—Gjon Muzaka na thotε qε Gjon Kastrioti i dha vetem tre tε bijt' e vegjεl Sulltán Muradit, se aý m' i madhi ishte bεrε murk dhe falej nε manastír tε Malit Siná. "Questo (Scanderbegh) l' havea donato il padre al detto Amuratt con *due* altri fratelli *tutti piccoli;* li due morsero." Hopf, Muzaka, f. 274; dhe nε f. 295: "Repossio predetto fú huomo de santa vita e se n' ando al monte Sinai e si fé frate e li morse." Veç Muzakεs, edhe njε kronikán frenk mε 1542 na thotε: "Il (Murad II) contraignit Jehan Castrioth, despote de la Cymera, de lui bailler la forte ville de Croya et *ses trois fils* en ótage, lesquels il fit Turcs."—F. Antoine Geuffroy, Conquêtes des Turcs, ch. LXXII, f. 294, ed. Charles Schefer, Paris 1896.

Nga ana tjatεr Barleti na thotε qε "i Pεrndérçimi hieromonák" Repósh Kastrioti vajti nε Ederné me tre tε vellézεrit, u-bé muhamedán, u-marrtua me njε zonjε turke dhe bεri njε djalε, Hamza Kastriotin, tε cilin do t' a shohim mé vonε nε kεté historí. Kεtó deshmime

Digitized by Google

Gjon Kastrioti vdiq afró me 1442, se emri i tij permendet gjer ahere ne arshivat e Venetise dhe te Raguzes, dhe jo me 1431, si besohej pothua prej te gjithe historiáneve pas mezit te shékullit te nentembedhjette. Anonimet dhe Dimiter Frengu, si pame mé siper, e vene vdekjen e tij afró nje mot perpara betejes se Nishit, e cila ngjau me 1442 dhe ne keté nuke gabohen. Pas vdekjes se Gjon Kastriotit, Sulltán Muradi II ia zaptój tere principaten, te cilen ia dha Hasán Beut, nje renegati shqiptár, i cili ishte princ i Verzhesdes dhe guvernór i Krujes. Ky Hasán Bé, te cilin Barleti e quan *Sabelia*, ish bir' i Aidín Beut, Princit te Verzhesdes, dhe i Princeshes Elena Muzaka (1).

Aferó me 1428, mjerimi qe e goditi dinas-

---

te ndryshme munt te pajtohen nofta keshtú: Gjon Kastrioti ia dha Sulltán Muradit qe te kater bijte, po Reposhi, i rrahur prej vetedijes, iku nga Stambolli, passí ia la Hamzen e vogel Skenderbeut, dhe shkoj ne manastír ku u-bé murk e ku falej nat' e dite per te lare mekatin qe u-bé muhamedán e u-martua me nje zonje turke. I mjeri Repósh duket qe s' ish fare njerí i shpates, po i metanive dhe i tropáreve.

1) Shih Hopf, f. 432.—Aidín Bé Verzhesda e pati Krujen me 1415; vdiq me 1416 dhe duket qe u-vra prej Gjon Kastriotit, i cili rrembeu Krujen. I bir' i tij Hasán Bé Verzhesda u-vrá me 1443, kur e mori Krujen Skenderbeu; ishte kusherí i pare i Gjon Muzakes, t' et te Gjon Muzakes, dhe pa dyshím ketó vrasje ishin nje nga shkaket e armiqesise midís Muzákeve dhe Kastri-

Digitized by Google

tín' e Kastrióteve me 1421, u-persedýt ne juge per dinastín' e Komnén Thopíave. Princi i Kanines u-munt prej Sulltán Muradit II dhe u-shtrengua te bente paqe gjithe me ató kondita, a nofta mé te renda, dhe keshtú Arianiti shkoj ne Ederné qe te piqej me djemt' e Gjon Kastriotit. Laoniku (1) na thote: Edhe Arianít Komneni, passí i rembeu Sulltani principaten aterore, ardhi ne Porte te Larte dhe hante nje cope buke prane Sulltanit. Barleti nuke di gje per vajtjen e tij ne Ederné, po shton vetem qe u-munt prej Muradit II dhe u-shtrengua t' i pagúante haráç (2). Nje gje vetem munt te thomi me shigurí: qe Arianitit s' munt t' i kete ardhur per te zene udhen e Edernese perpara motit 1427. Keté e heqim nga faki qe me 1428 i lindi Ariantit e bija Marina Andronika, e cila u-marrtua me Skenderbene me 1451, kur ish njezét e tre vjetsh; dhe kjo vajze s' munt te kete lindur ne

óteve. Gjon Muzaka ishte katholík dhe shume fetár; po gjaku uje s' behet; ne gjeneallogjí te deres princore te Myzeqese i kujtón dhe atá qe u-kthyen muhamedane pa nonjé urrejtje; perkunder, dikú u thote te bijve: "Díjeni qe kini ne Turqí nje krushk, te qúajtur Hajdár Bé, i cili ishte Princ i Svirínes prane Sovjanit dhe i cili u-marrtua me nje kusheriren time, te qúajtur Princesha Qyrana, te bijen e Princit Andrea Muzakes, prej te cíleve lindi nje djale, i qúajtur Hasán Bé."— Shih Hopf, Muzaka, f. 287.

1) Laonicus, L. V, f. 249.

2) Barleti, L. II, f. 33.

Digitized by Google

Ederné, as mé von se njε mot passí i ati vajti nε keté qytet.

Mε 1430, si pamε mé siper, Isák Pasha zaptój tεrε principatat e Matit, Dukagjinit dhe Danjes; nε Tetór, 1431 Janina u-dha nε duar tε Turqve me privilegje veteqeverimi, tε cilat u-shkelε pak kohε pastáj; mε 1431-1433 Ali Pashε Evrenozi, dyke perdorur Krujen si bazε e shkretój Shqiperinε qε nga Vlora gjer nε Shkodrε; mε 1434 Turqit u-rembyen Gjirokastren Zenevízeve. Nga dukjet e jashtme fati i Shqiperisε dukej i shiluar qε keté mot. Pothua e tεra kishte rεnε nε duar tε Turqve dhe dukej si e shtruar nεnε zoterimin e ri. Vetem Shkodren me qytetet e anedetit i kish Venetia dhe njε copε tε vogel tε Shqiperisε Veriore afer lumit tε Moraçes e mbante Princi shqiptár i Malit tε Zi Stefán Çernoviç. Po kjo pershtypje ish e gabuar. Shqiperia, nεnε qetesin' e jashtme po zíente dhe s' priste veç njε kapedán qε tε ngrihej e tε kapte armet per tε fituarlirin' e humbur e per tε dbuar shkélesit e huaj. Si Anteu i Mithollogjisε, Shqiptari sa herε permbyset i dermuar dhe i mundur, merr forcε tε re nga Dheu e ngrihet per tε nisur luften prapε, sikúr s' ish aý qε u-thye pak kohε mé parε. Kjo ish e vertetε dhe keté herε, si kurdoherε, dhe u-provua mé von qε Shqiptari s' munt tε hiqej i mundur nga fusha para se tε zgjithte ca hesape tε gjata me mundesin.

Digitized by Google

Per çudí, Tosket e zbutur e buzeqeshur, dhe jo Geget e ashper e te mvrojtur, qene te paret qe rrembyen armet dhe u-ngritne per te shkundur zgjedhen turke. Keté kryengritje, fare pak te njohur, na e pershkruan Laoniku (L. V, f. 249): Arianít Komneni qe nga Ederneja, ku kish ardhur per te marre nonjé thele nga Sulltani, passí dergój fjale ne njerezit e tij dhe mori pergjigjen qe ishin gatí per kryengritje, posá te vinte aý vete dhe te vihej ne krye, iken nga Porta e Larte; kthehet ne principaten aterore, ku bashkohet me kreret e vendit, te cilet e pritne me gezím; dhe u-ngritne kunder Sulltanit; spastruan garnizonet turke; invaduan vendin e Mbretit; dhe kornin e shinin, dyke patur si kryeqender nje vent malesór, te ashper, e te paaferúarshme. Alí Pashe Evrenozi mori urdher prej Sulltanit te shkonje me ne ushterí te madhe, te mbledhur nga Maqedonia, Janina dhe Gjirokastra, qe t' a shtype kryengritjen, t' i shese véndesit si skleve, dhe Arianitin t' a sjelle te gjalle ne Ederné. Kudó qe vajti kjo ushterí, arat u-shkretuan, shtepite u-doqne dhe asnjerí i gjalle qe u ra ne dore s' u kursye. Po ne grykat, nga te cilat duhej te shkonte Evrenozi per te hyre ne kryeqendren e kryengritesve, qendronte Arianiti dhe e priste armikun me Láberit, Himariotet, Shpataraket dhe Çermenikasit e tij. Ketú u-bé nje beteje e gjákeshme, ne te cilen Arianiti fitój nje vijtore qe beri buje ne tere Evropen. Turqit bene

Digitized by Google

sulma tє deshpєrúara pєr tє kapєrxyer grykat pa u-dєrmuan me humbje tє tmérrshime. Ishte njє kasapanє e vєrtetє. Mé nє funt, Turqit u-thyen ploterísht dhe múarє aratinє. Atá qє s' ranє nє grykat a u-zunє robєr, a u-çkatєruan dhe u-therrє pa meshirє prej ndénjєsve tє egєrsuar, tє cilєt u kishin zenє pusinє ngadó qє shkonin. Nga ushtєria e madhe turke me-zí shpetój, dyke ikur anєs detit Ionián, Ali Pashє Evrenozi pothua i vetєm me njє pakicє ushtaresh.

Qє kur shkelє Evropєn, Turqit, nє tє gjitha bєtejat e mєdhá, kundєr bizantíneve, Sérbєve, Vllehve dhe Shqiptáreve, nє Maricє, nє Savrє, nє Kosovє, edhe kundєr Hungarézve dhe Perandorit tє Perєndimit nє Nikopoli, kishin dalє mundєs dhe nuk ua nxinte koka qє kish ushterí tє krishtєre nє botє, e cila tє ish e zonja t' u bєnte ballє. Nє grykat e Laberisє njohnє, pєr turpin e tyre, njє armík tє ri qє ish i zoti t' u jipte grushte pєr sysh dhe shkelme kurizit.

Çkatєrimi i njє ushterie aqє tє madhe e tє fortє ishte njє ngjarje me rendesí tє pazakónєshme dhe e rrethój fytyrєn e Arianitit me njє lavdí e me njє shkelqím qє shtrєngohet t' a njohє edhe Laoniku bizantín, turkofil dhe anti-shqiptár, i cilí thotє: "Kєtú Arianiti i Komnenit fitój njє lavdí tє shkelqyer, dyke bєrє vepra tє pєrkujtúarshme, dhe qє ahere u-bé njeri i dєgjuar (1). Fama e tij

1).—"Ea in expeditione magnam gloriam invenit

Digitized by Google

si mprojtes i Krishterimit kunder Turqve u-perháp ne te gjithe hoborret e Evropes, hoqi verejtjen e botes se krishtere mi Shqiperine per heren e pare, dhe lartesój emrin shqiptár ne syt' e Perendimit. Po Laoniku s' na thote çkoqur as motin as vendin e kesáj dishfate te madhe. Nga konteksti merret vesh qe ngjau ne kohen e shpedites turke se dyte kunder princit te Karamanise domethen me 1435-1438. Pas kronikanit te Raguzes Luccari ngjau me 1435, se ky na thote (1) qe ne keté kohe Kaizeri Sigmund i Hungarise "deshte te dergonte Princ Dautin, te nipin e Muradit I, me luftanie ne

---

Arianites Comneni filius operesque memorabilibus gestis admodum celebratus est."—Laonicus, L. V, f. 251.

1).—"Lo imperadore Gismondo ricercó i Rausei che lo (Daut nepote di Murad) traghetassero con le loro galee in Albania et in Grecia, per seminare guerra ai Turchi, che di quelli giorni erano stati cacciati da l'Epiro da Andrea Topia Signor della provincia posta al fiume Aloo, che oggi si chiama Vaiusa." Luccari, f. 91, mot 1435.—

Andrea Thopia nga dega e Krujes permendet ketú ne vent te Arianitit, se aý beri marreveshje me Republiken e Raguzes e me Perandorin Sigmund, per keté kryengritje i gatiti udhen Arianitit ne Laberí, dhe ishte krahu i tij i djathte. Sa per títullin "princ i krahines se Vioses" qe i jep, Luccari nuke gabohet se edhe Barleti na thote se qe te dyja deget e deres se Thopíave kishin te drejte nene Viosen. Shih Barleti, L. II, f. 34.

Digitized by Google

Shqipërí dhe nε Greqí per tε nisur atjé njε lufte civile kunder Turqve, tε cilet i kishte dbuar nga Epiri Andrea Thopía, Princi i krahinεs sε Viosεs." Sa per vendin e betejes dimε pergjitherísht qε ngjau nε Laberí perketéj Viosεs, afer detit Ionián, po ku pikerísht nukε dihet. Laoniku thotε: Keshtú u-dermua ushteria e Alí Pashe Evrenozit, kur shkeli vendin afer detit Ionián (1). Luccari e vertetón, dyke thenε qε Andrea Thopía i Laberisε i dboj Turqit nga Epiri. I pshtetur mi ketó deshmime, Hahn-i e vε nε njε libre tε tij keté beteje nε grykat e Kurveleshit (2), pastáj i genjyer prej Gjon Muzakes, i cili s' u jep Thopíave asnjé pellembe vent nε juge tε Viosεs, e heth nε njε libre tε dytε betejen e Arianitit nε grykat e fámeshme tε Kandavisε, nε Via Egnatia, midís Elbasanit dhe liqenit tε Ohrisε (3). Po Muzaka εshtε udheheqes i dyshimtε sa per kufiret e principátave tε cilat ndryshonin dita me diten, dhe fund' i fundit ky as e perménte fare betejen e Arianitit, dhe nofta ka aresye per keté heshtje, se nukε deshte tε theshte qε Arianiti e kaperxeu Viosen. Nga ana tjater, aresyja e Hahn-it qε kjo beteje s' munt tε ketε

1)"In hunc modum Aliis exercitus, cum in regionem quae Ionium spectat irruisset, afflictus est." Laonicus, L. V, f. 251.

2)Hahn, Albanesische Studien, I, f. 326.

3)Hahn, Reise, Denkschriften, vell. 16, f. 109-112.

Digitized by Google

ngjarε nε Jugε tε Viosεs nga shkaku qε tεrε kjo krahinε ishte e shtruar nenε Turqit, qε Vlora kishtε renε mε 1417 dhe Kanina mε 1420 (1), s' qendrón mε kembε perpara deshmimit tε njεzεshmε tε Laonikut e tε Luccarit qε Turqit u-thyen dhe u-dbuan nga krahina e Viosεs afró mε1435, dhe perpara vertetimit tε njεzεshmε tε Barletit e tε Tivárasi (2) qε Arianiti mbretεronte nε Laberí

1).—Vlora dhe Kanina ishin nε duar tε príncerve bullgarε nga dera mbretεrore e Asenit qε mε 1350 gjer mε 1372. Mε 72 ua rrembyen Balshet dhe i mbajtin gjer mε 1385. Si u-vrá Balsha II nε bεtejen e Savrεs, e shoqja e tij Princesha Komita Muzaka, njε Amazonε e fjeshtε, mbretεrój mi Vloren, Sazanin, Kaninen, Himaren dhe Pargen; pastáj u-zgját gjer nε krahinen e Devollit, qε ia rrembeu tε kusheririt Nikoll Muzakε, tε cilin e mundi dhe e zuri rop; mε 1392 Nikita Thopia ia mori Vloren nukε dimε qýsh; mé vonε Sulltán Bajazidi I ia rrembeu pothua tεrε principaten, tε cilen Komita e mori prapε dhe vdiq mε 1396. E bija e saj, Regjina Balsha, princesha e Vlorεs dhe e Kaninεs, humbi Vloren mε 1417 dhe Kaninen mε 1420, tε cilat ia rrembeu Hasán Bé Verzhesda i Krujεs.

2).—Shih Barleti, L. II, f. 34; Biemmi, L. I. f. 30. —Barleti, kur εshtε fjala per qytetin ku duhej mbledhur Kuvendi i Príncerve, na thotε qε Skenderbeu s' e qúajti gjε tε urtε t' i therresε as nε Krujε, kryeqytet tε tij; as nε xhabják, kryeqytét tε Stefán Çernoviçit; as nε *Apolloní*, kryeqytét tε Arianitit (L. II, f. 32): "vel Crojam,.....vel Apolloniam, Daynum, Xabiacum, aut aliquod Epirotici nominis oppidum." Me emrin arkaík *Apollonia* Barleti quan Kaninen. Kur shkoj

Digitized by Google

mε 1443, kur u-kthye Skenderbeu nε Krujε. Perpara kεtyre deshmímeve dermónjεse, dhe veçanerísht tε Luccarit, i cili kishte perpara syve dokumentat zyrtare tε marrεveshjes sε kryengrítesve me Republikεn e Raguzes dhe me Perandorin Sigmund, si dhe lajmat zyrtare tε bajlózεve Raguzanε mi ngjarjet dhe vendin e ngjárjeve, argumentet e Hahn-it, tε bazúara mi kufiret e principátave shqiptare pas Muzakes, i cili s' εshε i paáneshmε, dhe mi zaptimin e perkóheshmε tε Vlorεs dhe Kaninεs prej Turqve mε 1417-1420, bien vetε-vetiu si njε keshtjellε prej karte. Hahn-i pra kish tε drejtε, jo heren e dytε kur e ktheu mendjen dhe u-hóth nε Çermenikε, po heren e parε, kur e kerkonte dhe e vendosi fushen e betejes sε Arianitit nε grykat e Kurveleshit.

Kryengritja u-perháp nε tεrε Toskerinε. Gjirokastritet u-ngritnε, thirrε nga Korfuzi Depε

Skenderbeu nε Italí, disá anie ngarkuan ushtarεt nε Vlorε, pas Barletit (L. X, f. 290): "Multae classes e Rizicho sinu, Durrachino portu, Aulonae, ac toto Epiri Illyricique tractu profectae erant." Pas Lavardin-it, L. X. k. III, f. 302: "Beaucoup de voiles estoient en mer hors du Golfe Rizic, du port de Duraz, de la Valona, d' Epire, et coste de Sclauonie." Merret vesh lehtε qε as munt tε bεhej fjalε per tε mbajtur Kuvendin e Ligεs nε Kaninε, as ushtarε shqiptarε munt tε ngarkóheshin nga Vlora, po t' i kishin Turqit kετó qytete.

Digitized by Google

(1) Zenevisin, te birin e princit te tyre, qe u-munt e u-vra prej Turqve me 1434, e prokllamuan *mbret*, si na thote Laoniku, mblodhe nje ushteri, rrethuan Gjirokastren dhe e ftuan ganizonin turk te jipet. Turqit refuzuan dhe ahere Depa e rrethój qytetin dhe nisi t' a rrahe me artileri medievale. Rrethimi u-zgjat dhe kur gjysma e ushterise goditte Gjirokastren, gjysma tjater plaçkiti dhe zoterój krahinen e zaptuar prej Turqve. Garnizoni i Jeniçéreve u-forcua me Turqit dhe renegatet e ikur nga fusha. Sulltán Muradi II ndodhej ahere ne Karamani dhe dergój Turhán Pashen, valín' e Thesalise, kunder *mbretit* te Gjirokastres. Ne mes dimrit, neper male e neper fusha te mbulúara me debore, arriu i papritur Turhani nga Terhalla dhe i goditi Shqiptaret nga krahet kur atá po i binin qytetit. Te vene midís dy zjarresh, Shqiptaret u-muntne, dyke lene permí nje mije te

---

1).—Emri "*Depas*" i Laonikut i ka vene ne mendime te medhá historianet. Disá kane kujtuar qe eshte nje korrupte e llagapit *Thopía*. Etimollogjísht eshte shume rende te dale Dépa nga Thopía. Nofta ky emer eshte nje korrupte e fjales gerqishte "*déspota*" (me aksentin ne é), dhe ahere ka kuptimin *kryezót*. Ne Qyteze, a Ibrik-Tepé, nje fshat shqiptár te Thrakes lindore, emri Déspina i grave eshte shqiperuar me *Dhespa* dhe *Depa*. Per kryengritjen e Gjirokastres dhe rrethimin e saj prej Depes shih Laonicus, L. V, f. 251-253.

Digitized by Google

vrarɛ nɛ fushɛ. Depa u-zu rop dhe u-varr. Tɛ gjithɛ krerɛt shqiptarɛ dhe t' áfɛrmit e tyre u-shuan, dhe aý qɛ s' iku máleve u-thér me barbarí asiatike.

Pastáj Turhán Pasha u-sul kundɛr Beratit, tɛ cilin e rrethój mɛ 1438. Passí e rrahu fortesɛn mɛ kot shtatɛ muaj me radhɛ, u-shtrɛngua tɛ hiqet i turpɛruar pa bɛrɛ gjɛ, dyke humbur afró 10,000 tɛ vrarɛ (1). Pɛr tɛ nxjerɛ inatin, vrau e preu nɛ Myzeqé dhe pɛr kujtím tɛ fushatɛs sɛ tij tɛ lavderuar ngriti njɛ piramidɛ me kokɛ shqiptarɛsh tɛ masakruar. Mɛnyra çnjerɛzore, me tɛ cilɛn shtýpeshin kryengritjet e Shqiptárɛve m' até kohɛ, illustrohet me kɛté piramidɛ dhe me vrasjen e pashpirtme tɛ pesɛ príncɛrve tɛ Myzeqesɛ qɛ u-zunɛ robɛr. Turqit, si na thotɛ Muzaka, i vranɛ dyke ua thyer koskat me çekán (2).

Nga kɛtó kryengritje tɛ Tóskɛve, ajó e Arianitit, e Beratit dhe e Myzeqesɛ vajtnɛ mbarɛ, ajó e Depɛs, kryezoti jetɛshkurtɛr tɛ Gjirokastrɛs si

---

1).—Pɛr kɛté rrethim shih Biemmi, L. IV, f. 236. Mprójtesi i Beratit nɛ kɛté rasje ishte nofta Theodór Korona Muzaka, tɛ cilin do t' a shohim mé tutje nɛ kɛté historí.

2).—"Il Signor Blasio (Muzaka)fece cinque figlioli (Bogdán, Gjin, Kostandín, Theodór, e Gjon); e tutti cinque suoi figlioli li prese il Turco e li fe morire rompendole le ossa col martello." Hopfé f. 286.

Digitized by Google

mos mé keq. Si duket, cilidó kapedán toskɛ lɛftonte pɛr hesáp tɛ tij, dyke e kujtuar veten mjáft tɛ zotin pɛr tɛ nisur e pɛr tɛ mbaruar çlirimín' e atdheut pa ndihmen e shókɛve. Pɛr bashkɛpuním dhe organizatɛ kunder armikut tɛ pɛrbashkmɛ s' u mejtua asnjé nga kryengrítesit, nofta nga shkaku qɛ cilidó pɛrpiqej vetem pɛr krahinen e tij, nofta nga qɛ ish e pamundur tɛ lidheshin midís tyre príncɛrit dhe farat e ndryshme nɛnɛ njɛ kumandár. Bashkimi pɛr lirin' e pɛrbashkme, pa nonjé interés tɛ veçantɛ, ishte çudí qɛ s' ia nxinte koka asnjé Shqiptari, dhe keté çudí, nɛ tɛrɛ historin' e kombit, e bɛri vetem njɛ njeri: *Skɛnderbeu.* Qɛ jo vetem e bɛri keté bashkím, po edhe mundi t' mbanjɛ pothua njɛzét e pesɛ vjet me radhɛ, nɛ mes tɛ furtunɛs sɛ jashtme e sɛ bréndeshme, ɛshtɛ njɛ nga lavdit' e tij mé tɛ medhá.

Kúr lindi Skɛnderbeu? Asnjé nga historianet e vjetɛr nukɛ na e thotɛ. Historianet e pastajmɛ e kanɛ hequr motin e lindjes sɛ tij nga vɛrsa prej 63 vjetsh qɛ i jep Barleti, kur na thotɛ qɛ vdiq mɛ 1466. Sikundɛr pamɛ mé siper e do tɛ shohim mé tutje, nukɛ vdiq as mɛ 1466, si besón Barleti, as mɛ 1467, si kanɛ besuar pothua tɛ gjithɛ tɛ tjerɛt, po mɛ 1468, sikundɛr provohet nga arshivat e Millanit e tɛ Venetisɛ. Po á ishte 63 vjetsh kur vdiq? Pɛr keté as vetɛ Barleti, nga i cili e kanɛ marrɛ historianet e tjerɛ, nuk ɛsht i shigurtɛ, posá e vɛ nɛ keté formɛ: *Thuhet qɛ ish*

Digitized by Google

63 vjetsh (1). Duhet shtuar qe versen e Skenderbeut dhe motin e vdekjes se tij e shkruan Barleti me çifra dhe ne keto eshte fare lehte te behen gabime shtypi (2). Per fat te mire, Barleti na shigurón qe, kur e mori Sulltán Muradi si penk, Skenderbeu ishte nente vjetsh, dhe e shkruan me letra, jo me çifra (3). Historianet e tjere jane pothua me nje mendje mi keté pike. Anonimet, dhe Dimiter Frengu na thone qe ish tete vjetsh, dhe keté e shkrúajne edhe ketá me letra, jo me çifra

---

1).—"Aninumque suum Deo maximo tradens 16 Kalend. Februarias, Anno Domini, *MCCCCLXI* extremum diem suum obiit. Fertur igitur Scanderbegus *63* annos natus, 24 sui imperii anno e vita migrasse. " Barleti, *XIII*, f. 372.

2).—Qe ka nje lajthim shtypi ne motin e vdekjes se Skenderbeut, ashtú si na e jep Barleti duket me nje here: Posá Skenderbeu vdiq ne motin e 24-te te mbreterimit te tij dhe posá Barleti vete na thote qe Skenderbeu u-kurorezua me 28 Nentór, 1443, ahere s' munt te kete vdekur me 1466, se 1443 dhe 24 bejne 1467, ose s' munt te kete mbreteruar afró 24 vjet, po afró 23. Si pame mé siper, Gjon Muzaka, te cilin Hahn-i e merr si baze per versen e Skenderbeut, e kopión verberísht nga Barleti keté gabím shtypi.

3).—"Vix dum enim *nonum* attigerat annum."—Barleti, L. I. f. 3. "Car á peine avoit-il atteint *neuf* ans."—Lavardin, L. I, k. I. f. 4.

Digitized by Google

(1). Laoniku (2) dhe Muzaka (3) vertetojnë që ish djal' i vogël, po nukë na japin versën e tij. Taní, kush e mori si penk dhe kúr? Sa për kúsh, që të gjithë historianët e vjetër na thonë: Sulltán Muradi II. Tivárasi hesht mi këté pikë, se kanë humbur fletët e para të historisë tij. Sa për kúr, s' na thotë as kúsh dhe duhet t' a gjejmë vetë. Si thamë mé siper, Sulltán Muradi II s' munt t' a këtë marrë as mé parë as mé vonë se 1421. Ahere, pra, Skenderbeu lindi në Mat (4) afró më

---

1).—"Ancora fanciullo d' *otto* anni." Dimiter Frengu, k. I, f. I, gjithë me këtó fjalë edhé Anonimët.

2).—"*Puer* venit in januas regis." Laonicus, L. VII, f. 350.

3).—"Questo (Scanderbegh) l' havea donato il donato il padre al detto Amurath con due altri fratelli *tutti piccoli*."— Hopf, Muzaka, f. 274.

4).—Barbarch-u thotë që lindi në kështjellën e Petrellës, po e quan të tepër të na tregonjë ku e ka marrë këté lajme. "Egli contava allora appena nove anni, essendo nato a Gursi (Petrella), nel 1404. Shih Eugenio Barbarich, Albania, f. 178, Roma 1905.

Ka mé tepër të ngjarë të këtë lindur në kështjellën Petralbës (Gur' i Bardhë), se atjé shkonte gjithënjé Skenderbeu të prehej nga mundimet e luftës, dhe si u-marrtua, atjé rrinte edhé mbreteresha mé të shumën e kohës. "Dimisso milite omnes domum redire permisit, ipse cum Amesa et paucis equitibus Petralbam perrexit. Ibi namque principio aestatis uxorem reliquerat, id quod et omni deinceps imperii tempore fecit, ut per aestatem autumnumque illic solatii causa

Digitized by Google

1412 (1).

Ishte m' i vogli djalë i Princ Gjon Kastriotit dhe Princeshës Viosavë. Rreth lindjes së tij imagjinata popullore endi një qerthull legjendash të çudíteshme. Voisava pá n' enderr që lindi një dragua, që mbulój tërë Shqipërinë, që e kish kokën në kufiret turke dhe bishtin në Adriatik, dhe me gurmazin e tij të gjákeshmë përpinte Turq me míjera. Gjergji, kur lindi, kish në krahun e djathtë një shpatë të shkruar. Posá dolli nga djepi, princi i vogël zvarnisej në armët e t' et, dhe përpiqej të kapte arkun, shigjetat, dhe shpatën.

---

reliquo tempore Croiae maneret." Barleti, L. VII, f. 201.

1).—Pas Barletit, lindi më 1403, u-dha si penk më 1412; pas Lavardin-it, Biemmit dhe Pisko's, lindi më 1404, u-dha si penk më 1413 pas Anonimit Venecián, ed. 1539 llndi më 1410, u-dha si penk më 1418; pas Anonimit të Sausovino's dhe Dimitër Frëngut lindi më 1407, u-dha si penk më 1415; pas Hahn-it dhe Hopf-it, lindi më 1403, u-dha si penk më 1410; pas Hammer-it, Paganel-it dhe Fallmerayer-it lindi më 1414, u-dha si penk më 1423. Pas Biemmit, Pisko's, Hahn-it e Hopf-it e mori Sulltán Mehmedi I; pas të gjithë të tjérëve e mori Sulltán Muradi II. Me fjalë të tjera, lindja e Skënderbeut kolovitet midís víteve 1403-1414 dhe përgësimi i tij midís víteve 1410-1423. Auktori i kësáj historie e shton këtë listë me dy kronollogjira të ra dhe origjinale: Lindi afró më 1412, u-dha si penk më 1421 prapë Sulltán Muradit II.

Digitized by Google

Kur u-rrit, ató qe i pelqenin ishin lodrat luftetare me te vellézerit a me djemat e tjere. Qe ne vogelí tregonte ç' do te behej kur te madhohej.

Kur i mori Sulltán Muradi II te bijt' e Gjon Kastriotit si penk ne Ederné, prínderit, hoborí princór, dhe pópulli i Matit qane mé teper per Gjergjin e vogel, i cili posá kish arrire motin e nentte. E para gje qe beri Sulltán Muradi ishte shkelja e zotimit te dhene qe femija do te líheshin te lire ne fene aterore. I beri synét qe te kater princet e vegjel, ua ndroj emrat dhe u vuri mesonjes qe t' i rritin ne fene muhamedane. Gjergji mori emrin Skender-Bé, domethene Princ Aleksander (1). Keté emer e meritój pastáj ne betejat e Turqise dhe te Shqiperise.

Ne hoborin e Sulltanit, Skenderbeu mori

---

1).—"Deducti ad Ottomanum adolescentuli, primam perfidiam ejus in eo sensere, quod abjecta, quae eorum parentibus praestita erat, fide, circumcidi Macometano ritu illico jussi sunt.....Epirensibus varia nomina, prioribus mutatis, indita sunt, ex consuetudine gentis. Georgius, seu casu, seu quod nobilior inter caeteros indoles, egregium nescio quid prae se ferre videbatur, Scanderbeg appellatus: idem quod apud nos Alexander Dominus." Barleti, L. I. f. 3.

"Lo fece ciconcidere in quella pueritia et porgli nome Scanderbeg." Dimiter Frengu, k. I, f. 2.

"Lui se chiamave Giorgio Castrioto, ma quando si fé Turco, lo chiamarno Scanderbegh." Hopf, Muzaka, f. 274.

Digitized by Google

aresimin e príncerve tє shtepisє mbretєrore. Mєsój, seç Turqishtes, Arabishten, Greqishten, Sllavishten dhe Italishten (1). Studiój mjeshtєrín' e luftes nє libra mé parє, nє fushє pastáj. Sa pa rritur mirє, i lutej Sulltanit qє t' i jipte lejє tє merrte pjesє nє bєtejє, po ky s' e linte, dyké e gjykuar tєpєr tє vogєl. Nє pєrdorjen e shpates, tє arkut, tє ushtes, dhe nє ngarjen e kúajve s' kishte shok nє pallát. I gjatє, i híjєshmє, me njє trup tє derdhur prej statuje, me sy tє squar qє nxirte shkendija, ishte, pas dєshmimit tє njєzєshmє tє historiáneve tє vjetєr, njє єngjєll bukurie dhe madhєshtie mashkullore. Çdo vijє e fytyrєs, çdo lєvizje e dorєs, çdo fjalє, e çdo çap i ketí djali tregontє tє birin e mbretit dhe njerin' e véprave tє mєdhá. Kur lєftonte, si na thonє atá qє e kishin parє me sy, pєrvishte mєngєt pєr tє pєrdorur mé lirísht shpatєn, a jataganin. Krahє mé tє bukur prej burri, thotє Barleti, s' ishin parє gjєr ahєrє. Turqit provuan mé vonє ç' farє forcє tє tmerruar kishin krahєt e tij. Bukuria dhe madhєshtia trupєsore ishin njє trashєgím nє shtepinє princore tє Kastrióteve.

Sulltán Muradi kishte njє simpathi tє veçantє pєr Skєnderbenє dhe nukє linte rasje qє t' i trє-

---

2).—Sllavishten dhe Italishten Skєnderbeu do t' i kish mєsuar qє i vogєl nga kancellarєt qє mbante i atі pєr korispondencat nє ketó gjuhє.

Digitized by Google

gonte miredashjen. Te vellézerit e tjere vdiqne me nje menyre, e cila linte arallék per dyshimin qe vdekja e tyre nuk ishte e natýreshme. Nofta uhelmuan qe te mos mbetej nonjé trashegimtár i merzitur i Principates se Matit. Sulltán Muradi II munt te ishte aqe i drejte dhe aqe njerezór sa e pershkruan Laoniku, po mé pare se çdo gje tjater ishte Sulltán i Turqise. Interesi dhe qetesia e perandorise tij e deshnin çdukjen e príncerve shqiptare. Skenderbene e kurseu, se e genjente mendja qe ky, i çkulur nga Shqiperia qe ne vogelí, i rritur me kujdes e methude si princ muhamedán, i perkedhelur dhe i rrethuar me te gjitha te mirat e Sarajit, ishte turqesuar krejt dhe s' kishte asnjé rezík se mos e zinte mall' i atdheut dhe deshira e kthimit ne Mat.

Me trimerine qe tregój ne beteja te ndryshme u-bé oficér i larte kur ishte gjashtembedhjete vjetsh, dhe dy a tre vjet mé vone Sulltán Muradi e emerój Sanxhák Bej dhe i dhá kumanden e nje trupi kaloresie prej 5000 (1). Si Hannibali i Kar-

1).—"Sanazchi insignibus *primum* decoravit. Gradus autem is est dignitatis apud Turcas secundus post Bassas.... Scanderbegus igitur tunc quinque equitum millibus praepositus fuit. Caeteri quoque fratres iisdem ornati dignitatibus..... Caeterum is non multo post vix dum octavum et decimum egressus annum, in Asiam jussu Tyranni profectus...." Barleti, L. I, f. 4.

"Giunto poi questo Scanderbegh all' etá d' anni

Digitized by Google

thages, Skenderbeu ishte gjenerál kaloresie. Mori pjese ne disá fushata ne Así e n' Evrope, dhe kudó dolli i nderuar. Ne rethimin e nje fortese n' Anadóll, si Aleksandri i Math nje kohe ne Indí, ungjít ne mur, ku ngriti flámurin, dhe hyri i pari ne qytét. Sulltán Muradi ia rriti shkallen dhe e dergój si kumandár ne disá shpedita te renda. Skenderbeu kurdohere kthehej mundes dhe sillte ne Ederné rober e plaçka pa numer. Fama e tij po rritej dita me diten; ushteria e adhuronte; shoket e kishin zilí.

N' até kohe, dhe ca mé pak n' Anadóll, baruti s' kishte édhe ndryshuar mjeshterin' e luftes. Forca trupesore dhe trimeria personale losnin nje roll te math ne fitimin e betéjave, dhe dyelet, aqe ne kohe lufte midís leftónjesve te ushterive armike sa dhe ne kohe páqeje per sehír, ishin ne mode dhe ngjanin shpesh ne qytetet e medhénj. Çdo trim i kohes dilte ne patalók me nonjé panaír a festím dhe ftonte ne dyél mé trimin e vendit. Keshtú nje here nje Tatár vigán, ne mes te nje ce-

---

XIX fú fatto dal Gran Turco Sanzacco, che vuol dire Condottiere, dandogli condotta di cinque mila cavalli, e piú volte col títolo di capitano, che vuol dire in Turchesco Bassá fu mandato coutra suoi nemici."— Dimiter Frengu, K. I, f. 2.

Shkalla e Sanxhák Beut korespondón sot me shkallen e gjeneralit te brigades, pas Pisko's. Shih Pisko, Skanderbeg, f. 9.

Digitized by Google

remonie publike nε Ederné, dolli nε shesh dhé ftój nε dyél cilindó prej oficéreve qε rrethonin Sulltán Muradin. Asnjé Turk nukε levizi, ndonesé Sulltani u-zotua tε jipte njε çperblím tε math per até qε do t' i bente ballε Tatarit. Skenderbeu kerkój lejen e Sulltanit qε tε matej me Tatarin, i cili po kabardisej e mburrej, dyke parε qε askúsh nuk i dilte perpara. Pas shumε lutjesh Sulltani e la. Dyeli ishte me kamε dhe çveshur nε njε vent tε ngushtε. Vetem per múndesin kishte shpresε tε dilte i gjallε. Skenderbeu u-çvesh me vrap, dolli nε shesh dhe nε pak kohε e shtriu Tatarin perdhé tε vrarε. Skenderbeu ish ahere 25 vjetsh (1).

Njε herε tjater, nε Brusε, dy kalorεs persanε, tε qúajtur Jahja dhe Zampsa, ardhε per tε hyrε nε sherbím tε Sulltanit, dhe per tε provuar zotesin' e tyre dúallε nε shesh dhe ftuan atá mé tε miret kalorεs tε ushterisε turke nε dyél. Tε gjithε syte udrejtuan nga Skenderbeu. Ky s' priti shumε. I hipi kalit dhe dolli nε shesh qε t' u bente ballε tε dyve, njerit pas tjatrit. Kur e permbysi tε parin, shoku i tij, pa pritur radhen, u-sul qε t' a goditε Skenderbenε me tε pabesε. Po Skenderbeu

1).—"Sendo dipoi Scanderbeg di anni XXV et ritrovandosi in Adrianopoli apresso il prefatto principe turco et molti altri signori arrivó lí un fortissimo Tartaro...."—Anoním, k. 1, f. 3 verso, Venetí, 1545. Dimiter Frengu, f. 5.

Digitized by Google

s' flinte, dhe njε tε goditur e shtriu dhe tε dytin perdhé. Kετό dyele ia madhuan nderin ca mé teper nε sy tε ushterisε dhe tε Sulltanit.

Historianet e Skenderbeut na i tregojnε kετό dyele si njε prove tε fuqisε trupesore tε tij. Nga ana tjater, kετό tregojnε dhe karakterin e tij dhe kετύ munt tε gjejmε njε nga shkaket qε e bene tε shkonjε nε Shqiperí e tε kthehet kunder Turqve. Skenderbeu, si çdo Shqiptár prej race, s' e duronte dot mburravecin e kabardisur dhe e vinte jeten e tij nε rezík vetem e vetem per t' i thyer hunden. Turqit, me betejat qε fitonin nε Evropε e nε Así, nisnε tε kujtonin nε keté kohe qε ishin tε pamundur, dhe mbúrreshin e kapardíseshin me njε mενyre e me njε sjellje, sikúr thoshin: Eh kúsh munt tε na dalε neve perpara! Skenderbeu, munt t 'a marrim me ment, kur i shikonte, e kur i degjonte, ment pelciste qε s' muntte t' ua dermonte turinjtε e t' ua gjemonte kokes fjalen qε e shtrengonte me dhembε, dyke kafshuar gjuhen: " Unε, or unε!"

Si pamε mé siper nε keté kohe, mε 1435-1438, ngjau kryengritja e Arianitit. Kjo pa fjalε i tingelliu Skenderbeut nε zemer si kushtrím nga malet e Shqiperisε. Arianiti i rrefente udhen e detyres e tε nderit. Dhe qε ahere s' gjente mε gjumε nε shtrat dhe qetesí nε mendje. Oshetimi i betéjave nε grykat e Kurveleshit, rreth Gjirokastres e rreth Beratit, piramidat prej kokesh tε My-

Digitized by Google

zeqesɛ, dhe rɛnkimi i mbytur i tɛ pesɛ príncɛrve kryɛngritɛs tɛ dɛrmuar me çekán, e bɛnin tɛ çirej e tɛ grisej, si nonjé luán i ndɛrsyer qɛ ha me dhembɛ e me thonj hékurat e kafazit, e vjen rrotull me perçen pɛrpjetɛ, me sy tɛ gjakosur nga dɛshperimi, e bɛrtét e kɛlthet, e rreh veten me bisht si me kamçík; a si nonjé kalɛ luftetár, i lidhur nɛ grazht, qɛ dɛgjón klithmat e luftɛs dhe sulmat shurdhónjɛse tɛ kúajve, e mih dhenɛ, e hingɛllin i ndezur, i drithtɛruar, valɛ nga dirsa, e pɛrpiqet mɛ kot tɛ kɛputɛ tɛrkuzɛn e tɛ sulet nɛ mes tɛ zjarrit si rrufé.

Gɛgɛt, kur krisi kryengritja e Toskɛrisɛ, nisnɛ tɛ lɛvizin, tɛ kɛshillohen, po s' kishin krye. Gjon Kastrioti ishte mplakur dhe me njɛrɛn kembɛ nɛ varr. Vɛndosnɛ tɛ thɛrresin Skɛnderbenɛ. Njɛ komisión vajti dhe e gjeti nɛ Ederné. I Shpunɛ tɛ falat e prínderve, i treguan mjerimin e vɛndit nɛnɛ Turkun, i pɛrshkruan pɛrmbysjen e principatɛs atɛrore, dhe me lot nɛ sy e ftonin tɛ kthehej nɛ Mat, tɛ vihej nɛ krye tɛ tyre e t' a çlironte Shqipɛrinɛ. Pópulli e priste me krahɛ hapur. I sillnin pɛrpara syve shémbɛllen e Arianitit. Skɛnderbeu i dɛgjonte me vɛrejtje. Kjo s' ishte hera e parɛ. Komisione tɛ kɛtija i vinin nga koha nɛ kohɛ qɛ kur u-thye i ati prej Isák Pashɛs. S' kishte asnjé dyshim qɛ pɛrfaqɛsonin djenjat e pópullit, po ndruhej t' u hapte zɛmrɛn sɛ mos dilte fjala jashtɛ. I ktheu pra dhe kɛtá, si dhe tɛ méparesh-

Digitized by Google

mit me fjalë si këtó: Që një kryengritje kundër një fuqie të madhe si Turqia ishte plot me rezike dhe pa nonjé shpresë; që Turqia mbante garnizone të forta në Krujë e në Sfetigrád dhe që ish e pamundur për Shqiptarët t' i merrnin me forcë; që do të derdhej gjak më kot, e do mos fitonin gjë tjatër veç që do t' a egërsonin Sulltanin, i cili do t' a shtypte pópullin mé keq dhe do t' ia bënte zgjedhën mé të rëndë, kur gjer taní zoterimi i Turqisë ishte pak a shumë i butë.

Më 1442, i vdiq i ati. Skënderbeu ish ahere tridhjetë vjetsh. Sulltán Muradi, në vënt që të dërgonte në Mat Skënderbenë për të zënë fronin e stërgjýsherve të tij, urdherój me pabesí Hasán Bé Vërzhesdën t' a zaptonjë tërë principatën e Gjon Kastriotit në emrin e të bijve. Të gjitha kështjellat e Matit u-zaptuan pa kundërshtím dhe pritnë nga një garnizón turk të fortë dhe nga një grup kollonistësh turq, a renegatësh shqiptarë, për të shiguruar mbajtjen e tyre. Princesha Viosavë me të bijën Mamicë u-dërgua dikú në Mat, ku Sulltani i la një vënt të vogël sa për të rrojtur; vdiq ca kohë pastáj, para se të kthehej Skënderbeu (1). Që të shigurohej për besnikërín' e këtí, Sulltán Muradi e pyeti në dëshëronte të kthehej në Mat e të zinte vëndin e t' ëtt. Sikúr të kish thënë Skënderbeu até që ndjente në zëmër, do të kishte shkuar

1) Shih Barleti, L. I. f. 8.

Digitized by Google

atjé ku vanɛ tɛ vellezerit. Po ish mjaft i squar sa tɛ mos binte nɛ gracke dhe u-pergjéq qɛ e vétema deshir' e tij ishte tɛ mbetej nɛ sherbím tɛ Sulltanit e tɛ leftonte nenɛ úrdherin e tij.

Ketó thoshte me goje. Po me ment e kishte berɛ pllanin per tɛ ikur dhe s' priste veç rasjen. Kjo rasje i ardhi mɛ 1443. Krali i Serbisɛ Gjerq Brankoviç kerkój ndihmen e Papes Eugén IV (1431-1447) per tɛ fituar mbreterinɛ qɛ ia kish rembyer Sulltán Muradi II. Papa dergój Kardinál Julianin dhe e bindi mbretin Vladisláv tɛ Hungarisɛ e tɛ Pollonjes qɛ t' a ndihmonje kralin e Serbisɛ. Veç kesáj Eugeni IV prokllamój njɛ kryqesatɛ kunder Turqve dhe e ftoj terɛ Krishterimin tɛ ngrihen e t' i dbojnɛ nga Evropa. Midís príncerve tɛ tjerɛ, ftoj me letra e me bajlozɛ edhe Skenderbenɛ (1). Shqiptaret, tɛ shtyrɛ prej peshkopit tɛ Krujes, u-ngritnɛ prapɛ nenɛ kryesin' e Arianitit. Gjin Zenevizi, i bir' i Depes sɛ Gjirokastres, ngriti krahinat e Kolonjes e tɛ Devollit dhe bariti kunder Kosturit. Afer ketí qyteti u-perpóq me njɛ ushterí turke nenɛ Feríz Pashen e t' i vinte ndihma e zotuar prej Sulltanit. Kuman-Karaferjesɛ, u-munt e u-vrá nɛ njɛ beteje tɛ gjákeshme. Keté herɛ, jo vetem Shqiperia, e ngritur po dhe Evropa e terɛ me anen e Papes Eugén IV e therriste Skenderbenɛ nɛ Krujɛ ku e kishte vendin. Nɛ keté thirrje nukɛ vonój tɛ pergjigjet

1).—Shih Volaterranus, Lavardin, Préface.

Digitized by Google

Skenderbeu.

Ne vere te motit 1443 nje ushterí hungareze nene Janko Huniadin, Vojvoden e Transilvanise, hyri ne Serbí. Sulltán Muradi II dergój nje ushterí prej 20,000 nene Kará Bene, Pashán' e Rumelise, dhe nene Skenderbene qe t' i presin hovin gjer sa te arrinte aý vete me nje ushterí tjater. Te dy ushterite armike u-sheshuan pertéj e perketéj lumit Morava prane Nishit. Huniadi me 3 te Nentorit, 1443, me nje ushterí prej 10,000 kaperxeu lumin dhe e goditi ushterine turke, para se dari turk, i trembur nga sulma dhe kuximi i Hungarézeve, nisi te hiqet, po kur pá qe ushteria e Huniadit ish e vogel, dba urdher per te nisur betejen. Po Skenderbeu, ne vent qe te kthehej, vazhdój ritiraten, e cila dale nga dale po behej ikje e plotte, dhe e cila u-perháp ne tere ushterine turke. Ne trazire e siper, Skenderbeu kerkój dhe gjeti kancellarin e Sulltanit dhe me shpaten ne dore e shtrengój t' i jape nje fermán me myhyrin e Dovletit qe t' i dorezohej fortesa e Krujes. Pastáj e vrau kancellarin qe te mos dilte ne shesh pllani i tij dhe me 300 Matjane (1), midís te cíleve ishte dhe i nipi i tij Hamza, i bir' i Reposhit, u-nis per ne Shqipení.

---

1).—"Allora Scanderbegh con trecento giovani Albanesi molto fidati e valenti che erano stati al servitio suo..." Sansovino, 371v., dhe anoním, k. 2, 5v.

Digitized by Google

Barleti (1) nukë na shigurón po e lë të nenekuptohet që Skenderbeu ishte në marreveshje me Huniadin dhe perandáj ky kuxój të merrte ofensiven me një ushterí aqë të vogël. Nga ana tjatër, s' le asnjé dyshím që Skenderbeu gatiti me kujdés e me pllan dishfatën e ushtërisë turke, se në krye nisi ritiratën, pastáj e ktheu në ikje të plotë, dyke hequr ca pas, e dyke shtyrë të tjerë perpara, e dyke çkaterúar krahun që kumandonte. Dimiter Frengu dhe Anonimët na thonë që leftój dhe passí u-munt ushteria turke, në ikje e siper i ra në mendje ideja e kthimit në Krujë; kancellarin, pa e kerkuar, qellój t' a gjenjë mb' udhë e i mori fermanin me pahír.

Sidó që të jetë, në shtatë dit e siper, Skenderbeu arriu në Dibrë. Dhe para se të futet mé thellë, deshi të shikonte si do t' a pritnin Dibranët, të cilët ishin atá mé besniket e shtepisë princore të Kastrióteve. Dergój pra dhe thirri të parët e qytetit që t' u tregonjë pllanin e tij dhe t' u kerkonjë perkrahjen. Gëzimi i Dibráneve kur panë të birin e Princit të tyre ish e papershkruar. Ferkonin sytë që të binden që nukë shohin ënderr, ca hídheshin nga gazi, e ca qanin, e i puthnin duar e kembë e faqe, dhe i zotóheshin jeten, femijen dhe plengun e tyre per çeshtjen e shenjtë. Skender-

1.—Barleti, L. I, f. 13.—Anoním k. 2, f. 4-5.

Digitized by Google

beu, i mallengjyer nga kjo pritje, i porositi tε vεnε rúajtes nε tε gjitha grykat qε tε mos vente njerí tε lajmeronte kumandarin e Krujes. Pastáj u dha urdher tε mbledhin njε ushterí, e cila tε ishte gatí, posá tε jipte shenjen, t' a ndihmonte per tε zaptuar vendin. Dhe me qenε qε pllani i tij ishte t' a merrte Krujen me fermanin dhe jo me forcε, u kerkój vetem tre qint veta, qε dinin mirε udhet, tε cilet i dergój naten tε fshihen nε njε pyll afer qytetit.

Pastáj, qε até natε, para se tε dilte hena, i shoqeruar prej njε tokice tε zgjedhur, u-nís me shpejtesinε mé tε madhe per nε Kruje. Kur i u-afrua qytetit, dergój perpara tε nipin, Hamzε Kastriotin, gjoja si sekretár tε tij, qε tε lajmeronte kumandarin e keshtjelles qε arrinte per sε shpejti i urdheruar prej Sulltán Muradit tε marrε kumanden e saj. Hamza, i cili, i lindur dhe i rritur nε Ederné—i ati ish marrtuar atje me njε zonjε turke (1)—fliste turqishten si Turk, dhe ishte shum' i squar, e mbarój ploterísht keté misión. Hasán Bé Verzhesda e besój dhe, kur ardhi Skenderbeu e i tregój fermanin, e priti me nder, e kendój fermanin e Dovletit, passí e puthi, dhe ia leshój me njε herε fortesen. Oficerεt e garnizonit

1).—"Amesa nepos fuit egregial indolis adolescens, quem Reposius, postea Caragusius dictus, a Turcis ante insidias Ottomani uxore ducta susceperat." Barleti, L. I, f. 13.

Digitized by Google

dhe krerɛt e qytetit ardhɛ t' a pɛrshɛndoshnin e t' a pɛrgɛzojnɛ. Krujanɛt s' dinin qýsh t' a shpjegonin kɛté mɛngjɛs. Po Skɛnderbeu s' i la tɛ mejtóheshin shumɛ. I mori mɛ nj' anɛ krerɛt dhe ua shpjegój tɛrɛ punɛn. Krujanɛt i gjeti aqɛ bɛsnikɛ sa dhe Dibranɛt. Kur u-ngrýs, thirri brɛnda nɛ qytet njérɛzit e fshehur nɛ pyll, me tɛ cilɛt u-bashkua njɛ numur i math prej Krujanɛsh t' armatisur. Kɛtá, passí mbyllɛ portat, zunɛ tɛ gjitha pikat strategjikɛ tɛ qytetit, dhe prisnin shɛnjɛn. Njɛ klithmɛ e madhe oshɛtiu nɛ mɛs tɛ natɛs: "Lirí! Lirí!" Tɛ tjera zɛra i pɛrsɛdytin kɛtó fjalɛ (1), dhe tɛ gjithɛ u vɛrviten Turqve. Tɛ nésɛrmen s' kish mbɛtur nɛ qytét, as ushtár turk, as kollonist, as renegát, veç disá tɛ pákɛve qɛ u-kthyen tɛ krishterɛ. Flámuri i Turqisɛ dhe shɛnjat e zotɛrimit turk u-çdukɛ, dhe vɛndin e tyre e zuri flámuri i kuq i Skɛnderbeut me shkabɛn e zɛzɛ me dy krerɛ (2). Pópulli i tɛrɛ thɛrriste: "Rroftɛ Skɛnder-

1).—"Libertas in omnium erat ore. Libertatis dulce nomen undique resonabat." Barleti, L. I, f. 16.

2).—"Rubea vexilla nigris et bicipitibus distincta aquilis gerebat Scanderbegus." Barleti, L. II, f. 31.

"L' insegna di Scander begh era un' aquila negra distinta in due teste sopra campo rosso." Biemmi, L. I, f. 23, shenim 1.

"Dans ses estendards, qui estoient tous rouges, il portoit une aigle noire á deux tétes." Lavardin, L. II, k. I, f. 32 v.

Digitized by Google

beu!" (1).

Posá u-zaptua Kruja ploterísht, Skenderbeu u-kthye nε fenε aterore (2).

Me tε gedhirε e nésermja, Hamza Kastrioti shkoj nε Dibrε qε t' u shpinte lajmen e mirε Dibráneve dhe t' i porositte tε benin gjithashtú. Ajó qε ngjau nε Kruje u-persedýt nε Dibrε e kudó gjetkε nε principaten e Kastrióteve. Mbéteshin vetem katεr fortesa: Petrella, Petralba, Stellushi dhe Sfetigradi, tε cilat kishin garnizone tε forta. Per ketó duhej ushterí dhe Skenderbeu kerkój ndihmen e príncerve fqinj tε cilet i ftoj tε ndodhen nε Kruje dita qε do tε hipte nε fron tε stergjýsherve. Nε keté mes, dolli per tε vizituar Matin dhe per tε mbledhur ushtarε. U-prit kudó me enthusiazme si çlironjes dhe cilidó vihej me gezim nenε urdher tε tij. Zbriti gjer nε Dibrε ku u-póq per heren e parε me Moisinε, tε nipín' e Arianitit tε Kaninεs,

---

"Fece levar via la bandiera del Turco et vi fece mettere la sua con l' aquila nera con duoi capi in campo rosso." Sausovino, f. 371v.

"Fece levar via tutte le bandiere del Turco et vi fece mettere le sue con le aquile in mezzo di esse, *incoronate Imperiali*, in campo rosso." Dimiter Frengu, k. II, f. 13, Venetí 1679. Si duket nga pershkrimi i kεtíj shkaba e flámurit tonε kishte dhe kurorε.

1).—"Gribandosi per tutto viva Scanderbeg." Anoním, k. II, f. 5 v.

2).—"E Scanderbegh si fé subito Christiano." Hopf, Muzaka, f. 274.

Digitized by Google

i cili u-bé pastáj njɛ nga gjeneralet mé tɛ mirɛ (1).

Kur u-kthye nga ky udhetím, ishin mbledhur tɛ gjithe krerɛt e principatɛs sɛ Kastrióteve dhe príncerit fqinj, tɛ lidhur me shtepin' e tij, qɛ tɛ ndódheshin nɛ keté festím gazmór e tɛ papritur tɛ kurorɛzimit tij. Midís tɛ tjéreve, ishin i nipi i tij Muzaka i Angjelinɛs; Gjoka dhe Gjergji, tɛ bijt' e Pal Stres Balshɛs, dhe niper nga e motra Jella; dhe i kunati Gjin Muzaka, i shoqi i Vllajkɛs. Princi i Malit tɛ Zi, Stefán Çernoviçi, i shoqi i Marɛs, dergój ambasadorɛ me dhurata, pará dhe ushtarɛ; gjithashtú bɛnɛ dhe príncerit e tjerɛ qɛ s' kishin mundur tɛ vinin vetɛ. Keshtú u-mbloth njɛ ushterí e mjaftɛ prej dymbɛdhjetɛ mijɛ vetash. Kurorɛzimi u-bé mɛ 28 tɛ Nɛntorit (2), koincidencɛ e çudíteshme, se pikerísht até ditɛ u-ngrit

---

1).—Arianiti i Kaninɛs kish dy vellezɛr: Vlladanin, i cili u-marrtua me Angjelinɛn Kastrioti, dhe Muzakɛn. I bir' i Vlladanit ishte Muzakɛ Golém Komnén Arianít Thopia, osé shkurt Muzaka i Angjelinɛs; i bir' i Muzakɛs, tɛ vellájt tɛ dytɛ tɛ Arianitit tɛ Kaninɛs, ishte Moisí Golém Komnén Arianít Thopia, osé shkurt Moisiu i Dibrɛs. Si ky, si Muzaka i Angjelinɛs, fituan famɛ nɛ lufterat e Skɛnderbeut. Per fisin e tyre shih Barleti, L. VII, f. 208, Hopf, f. 535, dhe Hahn, Reise, Denkschriften, vell, 16, f. 109—114.

2.)—"Auguratus est autem Scanderbegus prima auspicia imperii sui*quarto Kalend. Decem. Anno Domini MCCCCXLIII* (28 Nɛntór, 1443)." Barleti, L. XIII, f. 272.

Digitized by Google

flámuri dhe u-prokllamua independenca e Shqiperisë në Vlorë 469 vjet pastáj, më 1912.

Skenderbeu, passí priti përgëzimet e zakóneshme u mbajti këté fjalë kréreve dhe pópullit të mbledhur (1):

"Kapedanë dhe ushtarë trima:— S' është as e re as e papritur pamja që kam sot përpara syve. Ashtú si ju kujtonja, ashtú ju gjeta, sternipër të fjeshtë të një race të vjetër e bujare, trima dhe besnikë të patronditur të vendit tuaj dhe të mbretit tuaj. Edhe jam i lumtur tani që munt t' ju hap zemrën time. Ju thom pa u-mburrur që, sa kam rrojtur, kam patur gjithënjé këté mall për atdhenë, dhe këté dëshirë për lirinë. Kur më ftuat për këté vepër nga shërbimi i Sulltanit, kisha në zemër até dëshirë që kishit edhe ju. Juve nofta ju shkoj nga mëndja që e kisha harruar edhe vendin, edhe nderin, edhe lirinë, kur ju kthenja prapë të helmuar pa ju dhënë asnjé shpresë e pa ju treguar asnjé ndjenjë bujare dhe shpirtmadhe. Po unë sillesha me até mënyrë, se ashtú e deshte shpëtimi

1).—Për këté fjalë shih Barletin, L. I, f. 19-20. Fjalët e Skenderbeut, që na jep Barleti, kanë dalë mé tepër nga penda e shkrimtarit se sa nga goja e kryetrimit, po kjó fjalë si dhe një pjesë e asáj që mban përpara Papës dhe kardinálëve kanë një tingëllím vërtetësie që s' munt të mohonet lehtë. Përkthimi që jap është përgjithërísht i lirë; dikú shkurtova, dikú ndrova úrdhërin e frázeve.

Digitized by Google

juaj edhe imi, se puna ish e tillë që duhet bërë e jo thënë, se shikonja që kishit mé teper nevoje per fré se sa per shtyrje. Jua fsheha pllanet e mia dhe s' jua çfaqa deshirën që kisha në zemer kaqë vjet, jo se s' ju kisha besim, jo se s' jua dinja shpirtin, posá ju ishit të paret që e hothtë zorin dhe ufutë në këté valle, po se puna duhej mejtuar thellë, se dúheshin gjetur mjetet, se duhej zgjedhur koha mirë. Ndryshe, do të derdhej gjak më kot dhe perfundimi do t' ish një roberí mé e keqe se e para; dhe ahere çdo shpresë per të nésermen fluturonte; se një punë si kjo niset një herë e mirë; dhe në mos vaftë mbarë, rasja dhe mjetet per t' a nisur ikin e s' kthehen kurrë prapë. Prandáj s' ia tregonja pllanin tim as vetes sime dhe rúhesha mos më shkiste gjuha e mos më degjonin murret. Kam per deshmór Hamzën tim-nip, që e kam pasur perkrahës, keshilltár dhe shok armesh, me ca të tjerë të pakë, me besnikerín' e të cíleve e vumë këté pllan në veperím. Tani, ndonesé rronim e hanim bashkë, dhe kishim një zemer e një shpirt, me gjithë këté as njé nga ketá s' më kish degjuar kurrë të zë në goje atdhenë, lirinë dhe krishterimin gjer sa ardhi rasja në beteje të Nishit.

"Lirinë munt t' a kishit fituar me trimerinë tuaj edhe me një tjater çlirimtár, se Shqiperisë nuk i mungojnë burrat, po ju pelqeu t' a prisni nga dora ime, ndonesé vonë, se keshtú nofta desh vetë i madhi Zot. Se është me të vertetë çudí që trima

Digitized by Google

kryelartë si ju, të rritur në lirí, duruat kaqë kohë roberin' e Barbárëve, dyke pritur të më shikoni një dítë në kryen tuaj. Po valle, á e meritonj këté titull të bukur të Çlirónjësit që kini miresinë të më jipni? Lirinë s' jua solla unë, po e gjeta këtú në mes tuaj. Posá shkela kemben këtú, posá më degjuat emrin, rentte të gjithë, më duallte perpara kush e kush mé shpejt, sikúr t' ishin ngritur nga varret atrit, vellezerit dhe bijtë tuaj, sikúr të kishte zbritur nga qielli vetë Perendia. Më pritte me aqë dashuri e gezím, më súallte aqë sherbime të çmúara e pa numer, sa më bëtë mé teper ju robin tuaj se sa unë të lirë ju. Këté mbreterí e këté qytét nukë jua dhashë unë, po m' a kini dhuruar ju; armet nukë jua dhashë unë, po ju gjeta t' armatisur, lirinë e kishit kudó, në krahërór, në ballë, në shpatë, e në ushtat; si gardianë besnikë, të emëruar prej tim-eti, ju m' a vutë mi krye këté kurorë, ju m' a dhatë në dorë këté shpatë, ju më bëtë zot të kesáj mbreterie, të cilen m' a rúajtit me aqë besë, me aqë kujdés, e me aqë mundime. Shpjermëni taní, me ndihmen e Perendisë, që t' a çlirojmë tërë Shqiperinë.

"Pjesën mé të madhe, pothua tërë punën e mbaruat; Kruja dhe tërë krahina e saj u-fitua; Dibra dhe malësitë u-bashkuan me né; armikut s' i mbeti as emri as shenja në fushat tona; qendrojnë vetem fortesat. Kam shpresë t' i marrim dhe këtó me hir a me pahír, me dhelperí a me trimerí,

Digitized by Google

ndonsé garnizonet turke janɛ tɛ forta, dhe kɛshtjellat janɛ vendosur nɛ shkembínj tɛ ashpɛr e tɛ paafrúarshmɛ. Armiku ɛshtɛ i rrethuar, i dɛshpɛruar dhe s' i kanɛ mbetur vɛç muret e fortésave. Po pɛr kɛtó do tɛ kɛshillohemi e do tɛ pɛrfundojmɛ mé mirɛ, kur tɛ vemi nɛ vent, e kur tɛ kemi armɛt nɛ dorɛ dhe armikun pɛrpara, sɛ sa taní pɛr sɛ largu dhe pa ditur ç' kemi pɛr ballɛ. Do tɛ nisim nga Petrella mé parɛ, jo sɛ kjo ɛshtɛ mé e lehtɛ pɛr tɛ fituar—pɛrkundɛr, ɛshtɛ njɛ fortɛsɛ prej natyre dhe ka njɛ garnizón tɛ fortɛ—po sɛ ndodhet mé afɛr kryeqytetit, dhe jam shigur qɛ lajma e mirɛ e ngjárjeve tɛ Krujɛs ka arrirɛ atjé dhe ua ka ngrirɛ gjakun armiqve. Tɛ tmerruar nga trimɛria juaj dhe nga çkatɛrimi i garnizonit tɛ Krujɛs, nofta do tɛ na lɛshojnɛ fortɛsɛn me tɛ mirɛ; nɛ mos, po do t' i shtrɛngojmɛ tɛ na e japin me tɛ kɛq. Njɛ gjɛ vetɛm duhet tɛ kini nɛr mɛnt: Nɛ mos e marrçim Petrellɛn, asnjé nga né s' duhet tɛ kthehet prapɛ i gjallɛ.

Ngréhni pra flámurin pɛrpara, dhe rrɛféhuni burra si nga hera. Pɛrɛndia, si gjɛr tani, ashtú dhe pasketáj do tɛ na ndihmonjɛ e do tɛ na nxiɛrɛ faqebardhɛ. O búrrani! "

Shqiptarɛt, tɛ ndɛzur nga kjo fjalɛ, u-nisnɛ kundɛr Petrellɛs. Ishte dimɛr, malet ishin mbuluar mɛ dɛborɛ dhe frynte njɛ vɛrí i tɛrbuar, po ushtarɛt e Skɛnderbeut s' dɛshnin t' a dinin, sɛ e kishin zɛmrɛn tɛ ngrohɛt. Petrella, Petralba,

Digitized by Google

Tonaçi, dhe Stellushi u-dhanë me kondítën që garnizonet të líheshin të shkonin në Turqí. Vetem garnizoni i Sfetigradit qendrój i patundur dhe Moisiu i Dibres u-ngarkua t' a bllokonjë me një ushterí prej 3000 e t' i shtrengonjë Turqit të jipen nga uria. Sfetigradi ra në duar të Shqiptáreve pas pak kohë.

Kështú, brenda në një muaj, Skenderbeu e zaptój tere principaten aterore me një shpejtesí prej furtune që perfshín çdo gjë që gjen perpara. Veç kesáj u-shtý pertéj Drinit dhe zaptój fushen e Mokrenes, midís Dibres dhe Gostivarit, ndénjesit e së ciles e njihnin flámurin e Kastrióteve që prej vjetesh (1). Barleti na thotë që në këté kohë Skenderbeu ishte gjithnjé në levizje e siper, sot këtú e neser atjé, dhe me-zí flinte dy orë naten, se mbarevajtja e kryengritjes varrej nga shpejtesia dhe çdo minutë vonimi munt t' a vinte tere punen në rezík (2). U-çloth vetem per Kershendella, të cilat i beri në Kruje, per heren e parë pas njëzét vjetsh me një shkelqím dhe pompë të veçantë, me lavderime per lirin' e fituar dhe lutje Perendisë per bekimin e ármeve shqiptare. Këté dite, pikerísht kur Huniadi kaperxente grykat e Ballkanit, u-pagezua dhe Hamza Kastrioti me disá shokë të tjerë, që ardhë nga fusha e Nishit.

---

1).—Barleti, L. II, f. 31.
2).—Barleti, L. I., f. 22

Digitized by Google

Me tє gjitha ketó s' ishte bєrє veç çapi i parє, dhe taní duhej shikuar á do tє muntnin Shqiptaret tє organizóheshin e t' u benin ballє Turqve. Skenderbeu e njihte mirє Sulltán Muradin H dhe rezikun e math qє kishte perpara. Nga ana tjatєr, dinte qє s' kishte mé teper kohє qє tє pregatitej veç gjer nє prendveren e motit 1444. Vendosi pra t' i therresє tє gjithє princerit e Shqiperisє nє njє mbledhje per tє lidhur njє aliancє dhe per tє organizuar njє ushterí tє perbashkme per mprojtjen e vendit. Po kú t' i therriste? S' kuxonte t' i ftonte nє Krujє se çe vallє vinin. Dhe kur s' ish e mundur tє mblidheshin nє kryeqytét tє Skenderbeut, s' duhej mendje e thellє per tє kuptuar qє do mos vinin nє kryeqytét tє nonjé princi shqiptár tjatєr. Per tє mos i mbetur hateri askújt, perfundój t' a mbledhє Kuvendin e Príncerve nє Lesh, tє cilin ahere e kish Venetia.

Nderin e njє Kuvendi s' deshnin t' ia jipnin Princerit shqiptarє asnjé shoku tє tyre nє kryeqytét tє tij, po ishin gatí t' ia jipnin tє húajit pa kundershtím. Po puna deshte nxitím dhe Skenderbeu nukє e meditój shumє kohє ketє karakteristikє deshperónjєse tє krєrєve shqiptarє. Nga ana tjatєr, dyke u-mbajtur Kuvendi nє Lesh, i bєhej qefi edhe Republikes Veneciane, perkrahja dhe bashkepunimi i sє cilєs ishin tє domosdoshme. Príncerit mé tє degjuar qє múarє pjesє ishin ketá:

Digitized by Google

Arianiti i Kanines (1); Andrea Thopia, sternip' i Karóll Thopise, princ i krahines midís Krujes dhe Dúresit, me dy te bijte dhe me te nipin Tanúsh Thopía (2); Theodor Korona Muzaka, princ' i Beratit, dhe disá princer te tjere te Myzeqese (3); Gjerq Stres Balsha, i nipi i Skenderbeut nga e motra Jella, princ i krahines midís Krujes dhe Leshit (4); Pal dhe Nikóll Dukagjini, principata e te cíleve zgjatej nga Drini ne Kosove gjer ne kufi te Serbise (5); Lek Zaharia Altisferi,

---

1).—Emeri i tij i plotte ishte: Gjerq Arianít Komnén Golém Thopia, princ i Kanines, i Çermenikes, i Mokres dhe i Shpatit. Fallmerayer-i e te tjere gabohen kur thone qe llagapin *Golém* (sllavísht *i math)* e mori nga vijtoret qe fitoj kunder Turqve, se keté llagáp e kane dhe te vellezrit dhe duket qe ishte i tere familjes nofta nga nonjé stergjýsh, i qúajtur Gulielm. Per gjeneallogjín e familjes se tij shih Hopf, f. 535, dhe Hahn, Reise Denkschriften, vell. 16, f. 109-114. Ka nje fshat *Aranít* ne Mallakastre dhe nje tjater Aranitas ne Myzeqé.

2).—Per deren e Thopíave shih Hopf, f. 532, dhe Hahn, f. 106-109.

3).—Shih Hopf, f. 270-340, dhe 532; Hahn, f. 96-105. Armet e Muzákeve qene shkaba dykrenore perandorake me nje yll persiper.

4).—Hopf, f. 534; Hahn, f. 126-131.

5).—Hopf, f. 533; Hahn, f. 121-123. Nje stergýsh i kesáj shtepie permendet me 1281. Armet e tyre qene shkaba te bardha.

Digitized by Google

princ i Danjes (1); Pieter Spani, princ i Malesive tє Shoshit e tє Shales, me tє kater tє bijtє, Lekє, Bozdá, Orosh dhe Marko (2); Lek Dushmani, princ' i Zadrines (3); Stefán Çernoviçi (4); princ' i Malit tє Zi, i kunati i Skenderbeut, me dy tє bijtє Gjergjin dhe Gjonin; dhe tє tjerє princer gegє dhe toskє (5). Veç kєtyre, u-ndodhє nє kєté Kuvént dhe perfaqєsonjes tє Republikes sє Venetisє per tє shikuar ç' bєhet.

Kuvendi u-mbajt nє kathedralen e Shen Kollit, nє Lesh, mє 1 tє Marsit, 1444. U-perfundua tє formohet njє Ligє e Príncerve Shqiptarє dhe Skenderbeu u-zgjoth me njє zє kryetár i saj dhe kryekumandár i ushterisє tє konfederates (6).

---

1).—Hopf, f. 534. Shtepia e tij permendet mє 1366.

2).—Hopf, f. 535. Spanet levdóheshin qє e kishin renjen nga perandori i Bizantit Theodosi i Math. Permenden qє mє 1386.

3).—Hopf, f. 535. Njє stergjýsh permendet mє 1340.

4).—Hopf, f. 534; Hahn, f. 123.

5).—Per shtepit' e tjera princore shikó, Hopf, f. 531-535, dhe Hahn, f. 96-131. Duhet mbajtur ment qє gjeneallogjít' e Hopf-it e tє Hahn-it kanє shumє gabime. Hopf-i ka maninє t' i nxierє mé tє shumet e príncerve tє kesáj kohe nga renjє serbe, i genjyer pergjitherísht nga emrat dhe llagapet sllave, tє cilat kanє tє bejnє me kombesin' e tyre aqє sa emrat greke dhe arabe tє Shqiptáreve tє sotmє.

6).—Pas kєtí vendimi Skenderbeu ishte kryeprinci

Digitized by Google

Tɛ gjithɛ príncerit u-zotuan t' a perkrahin me parά, me ushqime dhe me ushterí, si pas fuqisɛ cilidó, kunder Sulltán Muradit II. Vendimi nuk ishte njɛ frazɛ e zbrazɛt. Arianiti i Kaninɛs proponój qɛ çdo princ tɛ caktonte sumen e permóteshme qɛ do tɛ kontribuonte. Ay vetɛ dha shembɛllɛn, dyke caktuar sumen per veten e tij, dhe Príncerit e tjerɛ bɛnɛ gjith-ashtú. Kreret e vegjɛl, qɛ nukɛ jipnin dot pará u-ngarkuan tɛ japin mé teper ushtarɛ. Nɛ ketέ pikɛ Pal Dukagjini proponój tɛ caktohej edhe numri i ushtáreve qɛ do tɛ jipte çdo princ, po pas shumɛ bisedimesh kjo çeshtje mbeti nɛ pɛlqim tɛ çdo princi.

---

dhe *de facto* mbreti i Shqiperisɛ, ndonesé ketέ titull s' e ka nɛ dokumentat zyrtare. Perandáj Lavardin-i (L. II, k. II, f. 37) e pershkruan zgjedhjen e tij si kryetár i Ligɛs sɛ Príncerve keshtú: "Scanderbeg esleu roy d' Albanie." Shqiperia e Skenderbeut kishte ató kufire peraferísht qɛ u dhanɛ mé siper principátave tɛ Gjon Kastriotit dhe tɛ Arianitit, po tɛ nxierim jashtɛ Gjinokastren dhe tɛ shtojmɛ fushen e Mokrenɛs pertéj Drinit. Qɛ Skenderbeu nɛ ketέ kohɛ ishte shum' i ri, afró tridhjet' e dy vjetsh, provohet nga fjalet me tɛ cilat i drejtohen kreret nɛ Kuvént tɛ Leshit, pas Dimiter Frengut (k. III, f. 19), kur e emerojnɛ kryekumandár: Eccelentissimo Signore Giorgio, buon figlio e frattello nostro quanto alla etá, ma patre honorato quanto alla virtú e valore." Domethɛnɛ: *I shkelqyer Princ Gjerq, bir e vellάj ynɛ nga versa, po até i nderuar nga trimɛria dhe vlera.*

Digitized by Google

Tε árdhurat e Skenderbeut per mot ishin 200,000 dukate tε arta (1) nga pagesat e príncerve tε Liges, nga tε árdhurat e principates sε tij, dhe nga shellinat (minat e kripes) e Kampopeshkupit, afer Shen Kollit tε Grurit, nε verí tε Dúresit.

Ushteria e Liges ishte afró 18,000, gjysma kaloresí dhe gjysma kembesí. Nga ky numer tri tε kátertat ishin nga principata aterore e Skenderbeut, Krujan, Matjan, Mireditás dhe Dibranε.

Si u-mbarua Kuvendi, u-bεnε Tedeume tε veçanta dhe lutje per mbarevajtjen e Liges, dhe Skenderbeu i percjellur prej tε níperve dhe Pal Dukagjinit, u-kthye nε Krujε. Atjé e priste Moisiu i Dibres, i cili ishte kthyer, passí kish fituar Sfetigradin.

---

1).—Dyke marre nε sy qε dukati bente afró 12 franga tε arta dhe qε paraja ahere kishte tε paken dhjetε herε mé teper vlere se sot, munt tε thomi qε suma e 200,000 dukátave kishte vleren e pesε miliunε dollárεve tε sotme peraferísht.

Digitized by Google

KAPTINE II.

SKENDERBEU KUNDER SULLTAN MURADIT II.

1444-1451.

Ushteria e Skenderbeut.—Garda mbretërore. —Beteja e Torviollit kunder Ali Pashes, 29 Qershór, 1444.—Beteja e Varnes, 10 Nentór, 1444, —Marrtesa e Mamices me Muzake Thopine, 26 Jenár, 1445.—Beteja e Monkrenes kunder Firuz Pashes, 10 Tetór, 1445.—Beteja e Ottonetes kunder Mustafa Pashes, 27 Shtatór, 1446.— Vdekja e Pal Dukagjinit, 1446.—Vrasja e Lek Zaharia e Altisferit, 1447.—Lúftera kunder Venetise, beteja e Drinit kunder Daniel Juriçit, 23 Korrík, 1448.—Beteja e Oranikut kunder Mustafá Pashes, 14 Tetór, 1448.—Rrethimi i Sfetigradit, betejat e Rovikut dhe te Talmiranes, rénia e Sfetigradit, Maj-Korrík, 1449.—Rrethimi i Sfetigradit prej Skenderbeut, 25 Statór gjer 26 Tetór, 1449.—Humbja e Beratit, 1450.—Rrethimi i parë i Krujes 14 Maj-26 Tetór, 1450.—Vdekja e Sulltán Muradit II, Jenár, 1451.

Organizimi dhe stervitja e nje ushterie ishte vepra mé rendesore, se ciles i u-pervesh Skenderbeu qe kur u-kthye ne Kruje, veçanerísht posá dinte qe s' ish e larkme koha kur do te ndodhej

Digitized by Google

ballë për ballë me ushtërin' e perandorisë turke. Nga ushtarët dhe vullnetarët që u-mblodhë, mbajti vetëm 15,000, tetë mijë kalorës dhe shtatë mijë këmbës, të gjithë luftëtarë të çprovuar, të zgjedhur me kujdés; të tjerët i ndau nëpër fortesat, a i dërgój më shpi që t' i thërresë kur t' i dúheshin. Gjithë në këtë kohë, futi në principatën e tij kushkriptën, gjë për të cilën asnjerí s' ish mejtuar gjer ahere n' Evropë dhe e cila qé një reformë e padegjuar në Shqipërí, dhe bëri lista të plotta të méshkujve, që munt të mbanin armë, që t' i mblíthte kurdohërë që t' ish nevojë. Kësáj gjëje Skënderbeu i jipte aqë rëndësí sa u-vu në krye të komisionit dhe dolli vetë fshat më fshat për të shikuar njérëzit dhe për të bërë listat (1).

Vlerën e një ushtërie të régullshme, të gjithënjëshme dhe të gatíshme për luftë në çdo minutë Skënderbeu e kishte mësuar nga Turqia ku pá me sy shërbimet e výera të Jeniçéreve. Fitimet e tyre

---

1).—"Quare tollenda est omnis mora, P. C. abjiciendae jam nostrae istae consultationes, quas bellorum necessitates expectare non posunt, peragenda omnis provincia, edictum proponendum, percensenda capita, exercitus impigre scribendus, ne quum hostis in conspectu erit, et tubarum clangor ad milites evocandos auribus obstrepet, nos tum sera belli consilia quaeramus." Barleti, L. II, f. 39 dhe L. XIII, f. 366: "Nam quum universam provinciam ad recensenda capita obequitasset."

Digitized by Google

Turqit ia detyronin kєtí trupi ushtєriák tє zgjedhur, tє cilin e themeloj Sulltán Orhani. Skєnderbeu e solli kєté systém nє Shqipєrí dhe formój njє trup tє zgjedhur prej mé tepєr se dy mijє shqiptarєsh, tє cilєt nga disiplina, trimєria dhe besnikєria s' kishin shok nє botє. Emrat dhe trimєrít' e cilitdó prej kєtyre i dinte Skєnderbeu me gojє, hante shumє herє nє njє tryezє me tá, dhe pas fitimit tє nonjé bєteje i pinte shєndetin dhe i jipte tє pijє me kupєn e tij atí qє kishte rrєfyer mé tepєr trimєrí pa ndryshím shkalle dhe ofiqi. Kєté informatє me kaqє rєndєsí, e cila shpjegón sekretin e vitóreve tє Skєnderbeut na e jep Veneciani Melchior Michaeli (1). Barleti e pєrmént kєté gardє mbretєrore, tє cilєn e quan "*praetoria cohors*", nє bєtejєn e Troviollit, po nukє na jep asnjé çkoqitje pєr organizatєn e saj (2). Pjesa kalórєse e gardєs pєrbєhej prej gjashtє qint Krujanєsh tє zgjedhur (3). Skєnderbeu kujdesej ve-

1).—"Habuit in Comitatu, *cum prepetuas aleret copias,* lectissimorum hominum amplius duo millia. Horum nomina factaque memoriter tenere consueverat, summusque erat illi honor, cui ipse discumbrens de patera sua propinasset."—Melchior Michaeli, Codex Bavaricus No. 2624, f. 224.

2).—Barleti, L. II, f. 49.

3).—"*Sexcentos lectissimos equites* habuit semper .....Solebat Johannes Coccius, pater meus, qui Calabro bello sub Ruberto Ursino, viro fortissimo, aliquam-

Digitized by Google

çanerísht per ushqimin, veshjen dhe pagesen e ushtáreve te gardes dhe Anonimi na jep nje liste te gjate te provizióneve qe i sillnin Skenderbeut besniket e tij si dhurate per garden (1).

Pastáj beri fortifikata te ra rreth Krujes; vizitój te gjitha keshtjellat, te cilat i vuri ne shtet mprójtjeje; shtudiój hollesísht topografín' e Shqiperise, dyke mos lene as mal, as fushe, as pyll, as lume, as vije, as perrua, as gryke pa matur nga pikepamja strategjike. Dhe atyre qe kish pás u thoshte qe, per nje gjenerál te mire, eshte aqe nevoje te dije vendin qe ka per te mprojtur sa dhe númrin dhe cilesín' e ushterise armike (2).

---

diu militavit, adolescenti mihni (2) enarrare i vidisse se Epirotam hominem, qui *cum sexcentis equitibus* Ferdinandi nomine in Apuliam transiverat." Saballico, Decad. III, L. IX, f. 568, Basilea 1570.

"E nel centro erasi posto Scanderbegh con Aidino circondato da un battaglione di cavalleria ch' era tutto formato della gioventú di Croja, avendo voluto usare questa distinzione e quei cittadini di fargli servire per guardia alla sua persona in tanto cimento." Biemmi, L. I, f. 47.

"Utrinque Crojensis nominis miles, utrinque Crojensis eum juventus circumdabat." Barleti, L. II, f. 48.

1).—Biemmi, L. I, f. 28.

2).—"Intesa dalli Albanesi la venuta del suo Scanderbeg a salvamento con tanto triompho, li principali di quelli andorno tutti a fargli la debita reverentia, et visitare la celsitudine sua, con pretiosi doni, et presenti,

Digitized by Google

Ushterin' e re e mbante gjithnjé nє levizje dhe nє ushterím dhe, nє pak kohє, e beri gatí per ſuftє dhe aqє tє disiplinuar sa dukej sikur ishte e stervitur vjete me radhє, e ish pjekur e rrahur nє zjarrin e betéjave. Ushtáreve tє rinj s' u rrihej vendit nga mosdurimi qє tє perleshen me armikun. I kerkonin Skenderbeut me lutje e me klithma

---

di cose peró da mangiare come vitelli grassi, boui gioneni, capretti, agnelli, castati, fagiani, starne coturni pernici, tortore, quaglie, tordi, beccafigi, galine, picioni, caponi, lepori, conigli, cerui, caprioli, cingiari, anatre, oche, et altre sorte di ucelli, et animalli grossi, et menuti domestici, et siluatici, con ogni altra sorte di uettouaglia, et pesci nei tempi quadragesimali. Auenga che senza questi presenti, la corte di Scanderbeg staua sempre fornita, quando almeno *tre mila e cinque cento* boche di continuo mangiauano il pane suo. Siche á quel modo faceua ciera bona a tutti li sudditi suoi, et a qualunque vizitatori, con richi et honorevoli conviti, sedendo di grado in grado li suoi principali ordinatamente alla mensa sua, et *dando qualche uolta da bere á qualchuno di quelli col paese si stima di grandissima importantia,* quando che per tal atto si habbia ritrovato alcun soldato haver posta la vita per amore del suo signore, che si habbia dignato mostrarli segno di tal amore." Anonim, k. XXIV, f. 26 v., Venetí 1545. Pas Anonimit, garda mbreterore perbehej prej 3,500 ushtaresh, dhe jo prej mé teper se 2,000, si na thotє Melchior Michaeli. Nofta deshmimet e tyre munt tє pajtohen me ketє menyrє: Ushteria e gjithenjeshme e Skenderbeut ishte prej 3,500, nga tє cilet 2,000 perbenin garden.

Digitized by Google

t' i shpjerë kunder Turqve që t' i provojnë trimërinë dhe besnikërín' e tyre. Dígjeshin nga deshira e luftës. Cilidó ngrihej në mengjést gatí që të nisej, i fliste kalit, shpatës, krahut; ftonte shokët të bashkohen e të mos presin mé. Ishte frikë mos merrnin sytë e fúteshin në viset e Turqisë pa kumandë për të çprovuar armët e tyre e për të çdefryer kudó që t' i shpinte era (1). Skënderbeu mezi i përmbante dhe uronte me tërë zemër që ushtëria turke të vinte një or' e mé parë.

Rasja për të çprovuar ushtërin' e re dhe zotësin' e kumandarit të saj nukë vonoj shumë për të ardhur. Sulltán Muradi II, për të thyer kryengritjen shqiptare, dergój kunder Skënderbeut Alí Pashën, mé të zotín' e gjenerëlevë të tij, me një ushtërí prej 25,000, nga të cilët pesëmbëdhjetë i-shin kalorës dhe dhjetë mijë ishin këmbës. Kjo ushtërí hyri nga ana e Kosovës dhe zbriti në Dibrën e Poshtme.

---

1).—"Maximus ubique strepitus pugnam poscentium multus ardor erat. Ita socios, ita se ipsos exhortabantur viri, ita aequum quisque suum ensem, dexteram alloquebatur, et manus ad ictus aptabat, ac mille consumebat vulnera, ut victi jam hostis species ante oculos amnium observari videretur. Tanto undique tumultu miscebantur castra, ut pugnantium similia omnia magis, quam pugnam poscentium diceres vel eruptorum quamprimum crederes avidum sanguinis militem *sine duce, sine signis, nullo disciplinae militaris ordine, vel tenore servato.*" Barleti, L. II, f. 47.

Digitized by Google

Skenderbeu ish i informuar hollesísht per numrin dhe cilesín' e ushterise armike. Nje nga kujdesjet e tij kryesore, qe kur u-kthye ne Shqiperí, ishte te formonte nje zyre spiunesh ushteriake. Agjente te kesáj zyre kishte ne Ederné dhe ne te gjithe kyçet údheve qe shpinin s' andejmi ne Shqiperí. Posá pra qe mori lajmen qe Alí Pasha afrohéj, mblodhi me nje here ushterín' e tij dhe dhe dolli ne fushe. Prane Kasarit, nje fshati afer Tiranes se Vogel (1), beri viziten e ushterise tij, e cila ishte prej 15,000, domethene gjashte mije kembes dhe shtate mije kalores nga principata e tij, dhe dy mije kalores nga Princerit e Liges. Skenderbeu nuke deshi te marre nga aliatet e tij veç pak ndihme, vetem sa per prove te lidhjes, e para se reziku nga forcat turke nuke i u-dúk i math, dhe e dyta se, per shume aresye, nuke deshte t' u ngarkohej shume aliáteve. Dhe me gjithe qe kishte nje ushterí pothua dy here mé te vogel se ajó e armikut, dukej i qete, i çkujdesur dhe i gezuar sikur e kishte fituar betejen dhe i kish mundur Turqit krejt.

Pópulli nuke dukej aqe i qete; perkuńder i kishte zene frika qe te gjithe, dhe prisnin me tmerr aferimin e ushterise turke. Qe prej vjetsh,

---

1).—Tirana e Vogel ishte afer Krujes. Ne keté fshat lindi Justiniani, perandori román i Bizantinit, i cili ndertoj afró 20 kishe ne Shqiperí te Mesme.

Digitized by Google

vendi s' kishte parë luftë dhe shkelje ushtërie armike. Fusharakët iknin e fúteshin nëpër fortesat, a merrnin malet; atá që ishin në kështjellat punonin nat' e ditë për të ndrequr ledhishtat, për të mihur hendeket, e për të rúajtur portat, sikur ish armiku përpara prakut; pleqtë, gratë dhe fëmija rrinin tërë ditën në kishë i lúteshin Perëndisë t' a shpëtonte Shqipërinë nga potera që afrohej; thashethemet e shtonin numrin e ushtërisë turke nga dita në ditë aqë shumë sa dhe ushtarët nisnë të tregojnë shenjë frike (1). Skënderbeu vetëm qëndronte i patundur dhe rentte nat' e ditë nga njëra an' e ushtërisë tek tjatra dhe me fjalë përpiqej t' u jipte kurajë dhe besím në veten e tyre.

Gjer tani Shqiptarët ishin mësuar me dishfata dhe mjerime. Ishte rendë, pra, për tá të besonin që ish e mundur t' u nëneqeshte fati dhe nga beteja e parë varrej tërë puna e Skënderbeut. Shenjat nuk ishin shumë të mira. Si ushtarët, si oficerët, ishin të gjithë të rinj e të papjekur, që s' kishin parë betejë kampale të régulshme me sy në jetë të tyre, dhe taní venin të máteshin me ushtërinë, mé të fortë e mé të pjekur t' asáj kohe. Përveç Skënderbeut, kish vetëm dy oficerë veteranë, që e dinin mjeshtërín' e tyre mirë dhe këtá ishin Aidín Muzaka (2), i cili kishte shërbyer disá vjet

1).—Biemmi, L. I, f. 41-42.

2).—Princ Aidín Muzaka, i velláj i Gjin Muzakës, të shoqit të Vllajkës Kastrioti, së motrës së Skënder-

Digitized by Google

si oficér i ushtersε turke dhe i cili kish ikur s' andejmi qε tε bashkohej me Skenderbenε; dhe Vrana Konti (1), i cili kishte sherbyer disá vjet me

---

beut. "Sagittarios mox reliquum robur peditatus, et scutatorum ac hastatorum agmina cum Aidino Gnei (Musachii) fratre sequebantur." Barleti, L. II, f. 48. Biemmi (L. I, f. 46) e bεn tε vellan' e Stefán Darenit, tε cilin e ngaterón me Princin Stefán Çernoviç tε Malit tε Zi.

1).—Biemmi (L. III, f. 153, shením 1) shkruan: L' Antivarino non riferisce in alcun luogo che fosse il nome, o il cognome del Conte Urana; quí dice ch' era nipote del Simone Altisvero (o sia Altafoglia) che una volta era Principe dell' Albania: *Urana comes nobillissimi generis qui Simonis Altisveri quondam Albaniae domini nepos erat.*" Nga kjo merret vesh qε Vrana Konti ishte i nipi i Simón Altisferit, princit tε Shqiperisε dhe Zotit tε Danjes, njε kεshtjellε afer Drinit, po nukε çkoqet nε ish i nipi nga i vellάj apo nga e motra. Nga ana tjater dimε qε njε Alfóns, sterníp i Vrana Kontit, qε rronte nε Italí mε 1512-1544, mbante títullin "*Marchese di Tripalda*" dhe si pamε mé siper *Tripalda* ishte llagapi i Voisaves, s' emes sε Skenderbeut. Ahere Vrana Konti, kumandár i degjuar i Krujes ose ishte Altisfér nga i atí dhe Tripalda nga e ema, ose Tripalda nga i ati dhe Altisfér nga e ema, ose ish i marrtuar me njε princeshε Tripalda aý vetε. Barbarich-u e nxier sterníp tε Theodór Vranes, princit tε Edernesε nε kohe tε Perandorit Isaák Engjell Komnenit (Albania, f. 182). Per sherbimin e Vrana Kontit nenε Alfonsin e Napolit shih Biemmi, L. I, f. 47, dhe Sagredo, La Republica di Venezia, f. 93. Hopf-i e ngate-

Digitized by Google

radhe ne ushterín' e Alfonsit, mbretit te Nápolit, kish marre pjese ne disá fushata te tij, dhe keshtú pati rasjen t' a mesonte mjeshterine ushteriake t' asáj kohe ne fushe te betejes nene nje kumandár te degjuar e te zotin. Pothua te gjithe te tjeret do te merrnin "pagezimin e zjarrit" regullísht ne keté beteje per heren e pare, dhe Skenderbeu i shikonte me leftime zemre çapet e para te ketyre neofíteve shpreseplote, se mos u shkisnin kembet dhe e zvarnisnin ne greminen te dishfates.

Me keté ushterí Skenderbeu, passí u-bé nje meshe dhe u-bekuan flámuret, u-nis dhe dolli ne Dibre te Poshtme dhe e vendosi kampin e tij ne fushen e Torviollit, te cilen e kishte zgjedhur qe prej kohe per keté beteje. Fusha e Torviollit, e qúajtur keshtú nga nje fshat i vogel me keté emer, ishte, pas pershkrimit te Tivárasit, shtate mile e gjate dhe tre mile e gjere, e rrethuar prej malesh, brigjesh dhe pyjesh nga te gjitha anet. Pllani i Skenderbeut ishte te fshihte nje pjese te ushterise tij ne pyjet e ketyre máleve dhe t' i leshonte kunder armikut ne oren e duhur. Qe te mos kuptonte armiku qe ne keté fushe ia kish gatitur pusine, la ne Torvióll vetem nje pjese te kembesise, dhe aý vete me tere ushterine shkoj mé tutje per te pritur ushterine turke e per t' a hequr, gjoja me te ikur e siper, ne vendin e caktuar.

---

rrón me Hamze Kastriotin (f. 533), gje e cila historikerísht eshte krejt e gabuar.

Digitized by Google

Skenderbeu, me ca perpjekje te vogla dhe me manevra mjeshterake e hoqi armikun atje ku i duhej, dyke i dhene Alí Pashes pershtypjen qe aý e futi Skenderbene ne nje vrime, nga e cila s' kishte qysh te ikte. Ketó manevra ishin shume te renda per te bere, se Shqiptaret, te papjekur ne te ketilla hollesira, posá gjakóseshin, s' deshnin te híqeshin, dyke e kujtuar ritiraten si nje dishfate. Vrana Konti ish aý qe u-ngarkua te qendronte ne funt, te kundershtonte perparimin e ushterise turke e te hiqej dale nga dale ne Torviólĺ. Aidín Muzaka u-dergua perpara qe t' a radhite ne vendin e caktuar ushterine shqiptare, e cila do t' arrinte atjé grupe-grupe, dhe te mos e linte te shtyhej mé tutje. Skenderbeu ne mest, nga njera ane perkrahte dhe regullonte ritiraten e Vrana Kontit, dhe nga tjatra ia dergonte grupet e ndryshme Aidín Muzakes qe t' i regullonte dhe t' i kishte gati per beteje.

Kur arriu Skenderbeu ne Torvióll, Aidini e kishte radhitur tere ushterine si pas úrdherit te tij. Kumandár i krahut te djathte ishte Tanúsh Thopía me Láberit e Arianitit dhe malesoret e Dukagjinit; i krahut te mengjer Moisiu me Dibranet dhe Bullgaret e Mokrenes dhe Dibres se Síperme; dhe i qendres vete Skenderbeu me Aidín Muzaken dhe Gjerq Stres Balshen, i rrethuar prej gardes mbreterore te fámeshme. Nje nate mé pare 3,000 kalores nene kumanden e Hamze Kastriotit, Mu-

Digitized by Google

zakɛ Angjelinɛs, Pjetɛr Emanuelit, Gjin Muzakɛs dhe Zaharia Gropɛs (1), u-dɛrguan tɛ fshihen nɛ pyjet e máleve afɛr Torviollit me urdhɛr tɛ mos dalin s' andejmi, vɛç passí tɛ ndizej bɛteja e régullshmɛ mɛ tɛ gjitha anɛt. Njɛ ushtɛrí prej 3,000 pɛrbɛnte trupin e rɛzɛrvɛs; Vrana Konti kumandonte kaloresín' e kɛsáj dhe Marín Spani kɛmbesinɛ; i pari kish urdhɛr qɛ, posá tɛ dilte kaloresia e Hamzɛs nga pusia e tɛ mɛrrte krahun e' armikut, aý tɛ sulej e t' a goditte pɛr ballɛ e t' a vinte midís dy zjarresh; i dyti kishte urdhɛr tɛ mos tundej vɛndit vɛç kur tɛ nistɛ tɛ tronditej ushtɛria turke. Sa pɛr ushtɛrinɛ, pɛrgjitherísht, Skɛnderbeu e kishte vɛnɛ kaloresinɛ pɛrpara dhe kɛmbesinɛ prapa, dykɛ ditur qɛ pjesa m' e madhe e ushtɛrisɛ turke ishte kaloresí, dhe bɛteja doemós do tɛ nistɛ mɛ njɛ pɛrpjɛkje midís kúajvɛ; po eskadrat e tij ishin tɛ pɛrzíɛra mɛ kalorɛs e mɛ kɛmbɛs, tɛ regullúara e tɛ radhúara mɛ njɛ mɛnyrɛ tɛ tillɛ qɛ edhe kɛmbɛsia tɛ mɛrrte pjesɛ nɛ bɛtejɛ pa u-ndaluar prej kaloresisɛ.

Ishte mɛ tɛ ngrysur e siper, kur u-radhitnɛ tɛ dyja ushtɛritɛ, njɛra kundɛr tjatrɛs, dhe ushtarɛt e lodhur kishin nevojɛ pɛr prehje. As njɛra anɛ, pra, as tjatra nukɛ lɛvizi dhe puna mbeti pɛr tɛ nésɛrmen.

Kur u-gdhí dita e 29 Qɛrshorit, Shqiptarɛt

1.—Nga dera e Príncɛrvɛ tɛ Ohrisɛ.

Digitized by Google

patnɛ rasjen t' a shohin mirɛ armikun me tɛ cilin do tɛ máteshin. Fusha e tɛrɛ ish e mbuluar prej syresh dhe dukej sikúr Turqit s' kishin veç tɛ vervíteshin e me sulmen e parɛ t' a merrnin nɛpɛr kembɛ ushtɛrín' e vogel shqiptare. Malet oshetinin nga trumbetat, daullet dhe klithmat e tyre shurdhónjɛse. Skɛnderbeu kaluar po rentte nga njɛra anɛ e ushtɛrisɛ tek tjatra, i thɛrriste me emɛr oficerɛt dhe ushtarɛt, dhe i çortonte tɛ gjithɛ tɛ mbarojnɛ detyren e tyre si burra. Dyke ditur qɛ bɛteja do tɛ mbante shumɛ kohɛ, i vuri ushtarɛt tɛ hanɛ mɛngjezin, posá kish nisur tɛ zbardhɛllonte agimi, pastáj i vuri tɛ gjithɛ nɛ regull, e dha urdhɛr qɛ tɛ mos lɛvizin po t' i lenɛ Turqit tɛ sulen tɛ parɛt, nga frika se mos ushtarɛt e tij tɛ paduruar vervíteshin pa regull, shpɛrndáheshin edhe shtýpeshin nga numri i math i armiqve.

Turqit, tɛ bindur qɛ e kishin tɛ fituar bɛtejen, dyke shikuar Shqiptarɛt si tɛ mpirɛ, qɛ nukɛ jipnin shenjɛ jete, me njɛ bɛrtitje stentoriane tɛ çfryrɛ nga míjɛra gyrmaze, u-leshuan kunder Shqiptárɛve. Ahere trumbetat e gardes mbretɛrore dhanɛ shenjen e bɛtejɛs; Skɛnderbeu si na thotɛ Dimitɛr Frɛngu (1), bɛri kryqin e Perendisɛ, thirri me zɛ tɛ fortɛ: " Hani burra dhe shokɛ!"

1).—"Scanderbeg, fattosi il segno della santissima croce gridó forte, ah valorosi, et fedelissimi miei soldati, et fratelli, seguitemi; et cosí fu il primo ad entrare nella bataglia." K. IV, f. 24.

Digitized by Google

dhe u-sul i pari nε zjarr me Aidinin dhe Gjerq Balshεn pás. Tε dyja ushterite u-perleshnε dhe bεteja mbajti gjer mε tri orε pas dreke. Turqit e drejtuan tεrε forcεn e tyre kunder qendres shqiptare dhe sulmat e tyre tε perserítura qenε aqε tε terbúara sa do t' a kishin thyer, sikúr tε mos ndodheshin atjé Skenderbeu me Aidinin. Krahu i djathtε e kishte mé pisk; Antón Linjerosa, kapedán i Láberve dhe i Himarjóteve tε Arianitit, Marín Igraka, kapedán i malesóreve tε Dukagjinit, Pal Kuka, Pjeter Spani, Pjeter Strusimeri, Stefán Ersiçi, dhe disá kapedanε tε tjerε tε shenuar ishin vrarε; tre flámure kishin renε nε duar tε armikut; dhe Tanúsh Thopia me-zí po e mbante ushterín' e tij, e cila ishte nε tε thyer e siper. Nε keté çast, u-súl nga pusia kaloresia e Hamzε Kastriotit dhe goditi ushterinε turke nga krahet, kur nga ana tjatεr, Vrana Konti, si pas úrdherit qε kish marrei ra per ballε. Krahu i mengjer i ushtersε turke, i venε midís dy zjarresh, u-thye dhe u-çkaterrua nε pak kohε. Pas kesáj, Moisiu i Dibres, me njε sulmε tε perfuntme, e dermój krahun e djathtε tε armikut. Mbetéj qendra, ku ndodhej Alí Pasha vetε me lulen e ushterisε turke. Skenderbeu, dyke parε tε dy krahet e ushterisε tij tε fituar, beri njε sulmε tjatεr, u-vervít si shigjetε nε mes t' armiqve, dyke korur me shpaten e tij mε tε djathtε e mε tε mengjεr, dyke i çkateruar Turqit, e dyke humbur nε ren' e plúherit, tε ngritur prej kémbe-

Digitized by Google

ve tє kúajve. Garda mbretєrore, me Aidinin nє krye, dyke parє rezikun e Mbretit, u-súl e tєra si njє trup dhe e goditi qєndrєn turke me aqє tєrbím sa kjo nisi tє tronditet. Pas gardes ardhє Vrana Kontí dhe Marín Spani me rezervєn dhe me njє pєrpjekje tє pєrfuntme qєndra turke udєrmua dhe u-çkatєrua krejt. Luanєt kєté ditє kishin kumandarє luanє (1). Turqit, tє thyer ploterísht, múarє arratinє, po Shqiptarєt ishin aqє tє lodhur sa s' u kish mbetur forcє t' i ndiqnin.

Humbjet e Turqvє qenє 8,000 tє vrarє, 2,000 robєr, 24 flámúre dhe tєrє kampi i tyre me tendat, plaçkat, ushqimet dhe míjєra kuaj. S' єshtє aspák çudí qє, mé vonє, imagjinata popullore e rriti aqє numrin e ushtєrisє turke e cila nga 25,000 ubé 40,000, sa dhe numrin e tє vráreve, tє cilєt nga 8,000 kapєrxen 20,000, ashtú si na thotє Barleti. Nga ana e Shqiptárєve, mbetnє 1,600 tє vrarє, prej tє cíleve 120 ishin krerє tє shenuar, dhe 2,000 tє plagosur, nga tє cilєt 400 vdiqnє pastáj. Njє prej tє plagósurve rendє ish dhe Aidín Muzaka, i cili vdiq nє Dhjetór t' atí moti, dhe u-qá prej tєrє ushtєrisє dhe veçanєrísht prej Skєnderbeut, i cili e kishte si krah tє djathtє nє kєté bєtejє dhe kishte shpresa tє mєdhá nga sqojtєsia dhe trimєria e tij.

---

1).—"Leonum eo die leones ductores fuisse." Barleti, L. II, f. 50.

Digitized by Google

Kjo dite u provój Shqiptáreve qe Mbreti i tyre ishte nje kumandár i kllasit te pare. E pane me sy te sulet perpara kurdohere i pari; te marre pjese ne te gjitha perpjekjet si nje ushtár i zakóneshme; te jape kumande per çdo levizje pa e humbur gjakftohtesine ne mes te rrebeshit mé te tmerruar; te manovronje me shpejtesí e mjeshterí, dhe t' a trubullonje koken armikut, dyke e goditur nga fusha e betejes.

Pas Skenderbeut, Aidini i plagosur vinte i dyti ne nderet e betejes dhe meritój levdatat e pergjítheshme per trimerine dhe mjeshterín'. e tij. Vendin e trete te lavdise e múare Vrana Konti, Moisiu i Dibres dhe Tanúsh Thopia. Nga an e pópullit atá qe u-rekllamuan si kryefitonjes te vijtores ishin Hamza Kastrioti, Muzaka i Angjelines, Pjeter Emanueli, Gjin Muzaka, dhe Zaharia Gropa, se ketá me sulmen e tyre e kthyen rjedhjen e betejes, kur Tanúsh Thopia po tronditej dhe Skenderbeu me Aidinin me-zí e mbanin me dhembe qendren kunder váleve te qendres turke. Nga oficeret e tjere u-shquan ketá: Antón Misiaçi, Frano Koleti, Vellezerit Marín dhe Frano Spani, Pal Maneshi, Nikoll Vaseci, Luka Sani, Andrea Perllati, dhe Lazár Shqahu. Tre ushtaret te gardes rrefyen nje trimerí aqe te madhe sa u-nderuan prej ushterise dhe prej pópullit si pjesetare te lavdise per keté vijtore ne nje radhe me kumandaret dhe oficeret. Skenderbeu i ngarkój me dhurata

Digitized by Google

dhe nε darken kombetare t' asáj nate piu per shendetin e tyre e u dha tε pinε me kupen e tij nε mes tε brohorive dhe duartrokítjeve tε kohortes pretoriane.

Aqε tε kapitur ishin ushtaret nga kjo beteje qenerishte sa qendruan dy ditε nε fushe tε Torviollit qε tε mbledhin veten nga lodhja. Nε keté mes, Skenderbeu, i rrethuar prej kumandáreve tε tij, vizitój tε plagósurit, qε nga oficeret e larte gjer tek ushtaret e funtme. Hynte nε tendat, deshte t' ua shikonte plaget dhe tε ndodhej nε operatat dhe sherimin e tyre. Me keté sjellje fitój dashurín' e ushtáreve aqε sa kishte nderimin e tyre per fitimin e betejes; keshtú, qε tε gjithε qanin nga mallengjimi qε Perendia u dha njε mbret kaqε zemermirε, dhe prisnin pa durím oren e sherimit qε tε jipnin jeten e tyre nenε flámurin e tij, sikúr t' ish e mundur, njε mijε herε (1).

Tε treten ditε nε mengjést, e thirri terε ushterinε dhe u dha dhurata tε gjithε atyre qε treguan trimerí tε veçantε, me perkedhelje dhe njε embelsí qε i gezonte mé teper se çpagimi (2); pastáj u-kthye nε tε tjeret dhe u tha qε i vinte keq qε s' ishte mjaft i pasur sa t' ua çperblente mundimin tε gjítheve pas vleres. Perandáj, pra, u falte vendin e armikut, ku cilidó prej syresh munt tε

1).—Biemmi, L. f. 57-58.
2).—Biemmi, L. I, f. 58.

Digitized by Google

çpaguhej me plaçken qe i pelqente mé teper. Nje klithme gazmore mbulój fjalet e funtme te Skenderbeut dhe me nje here u-nís tere ushteria per te plaçkitur. Skenderbeu i mbajti pak kohe gjer sa u-kthye koshadhja, qe kish derguar perpara per te shikuar mos kishte nonjé ushterí armike atjé rrotull, dhe pastáj i leshój te gjithe, po dyke rúajtur gjithenjé grykat se mos u dilte armiku nga nonjé ane pa pritur. Mbrémane, Shqiptaret u-kthyen me lope, kuaj, dhen e roba pa numur. Me te kthyer, Shqiptaret, per te shkuar kohen qeshnin e benin shaká si ketó: "Sikúr te na shikonte Alí Pasha nga nonjé vrime taní, do te pelciste nga e keqja qe u-munt nga ca hajdute kecersh si né!" Te tjere, te hipur mi mushka te vjédhura, shtonin: "Turp per Zotin! Luftetare te Shqiperise jini ju, qe kthéheni nga Torviolli, apó barínj qe zbrisni me dhente nga verria?" Nje Lap i hipur mi nje ka dhe i mbytur ne mes te pláçkave qe kishte mbledhur po kendonte vjersha qe i bente vete:

Démave te Shqiperise
S' u shpetón lop' e Turqise.
Alí Pash, lope plake,
Po te duash, eja prape!

Dhe keshtú me te tállura e me kenge u-kthyen prape ne kamp (1).

1).—"Deridebant duces ignaviam suorum, quod ex

Digitized by Google

Pastáj Skenderbeu i radhiti dhe nє krye tє tyre u-nís pєr nє Kruję. Ngadó qє shkonte, pópulli i dilte pєrpara dhe e pєrgєzonte. Malet o-shetinin nga brohoria dhe klithmat gazmore. Ushtarєt labєr po pєrshkrúanin bєtejєn me elegjira trímєrore, tє bєra nє minutє, dhe vajtonin vdekjen e Linjoroses. Gjindja e rrethonin kalin e Skenderbeut; e qúanin Çlironjєs, mprojtєs tє Shqipєrisє, qє meritonte tє gjitha kuroret e botes; i puthnin duart, e shpatєn, e robat. Ay, buzeqeshur, u çfaqte falenderjet me dorє, me kokє, e me zє. I pєrcjellur kєshtú prej tєrє pópullit, Skenderbeu hyri nє Kruję dhe, passí i pagój ushtaret, i leshój nє shtepí tє tyre. Nє kryeqytét gjeti disá Princєr aliatє qє kishin ardhur t' a pєrgєzonin

---

fortissimis bellatoribus abactores pecorum, et ex Albaní nominis propugnatoribus, ovium custodes facti essent, accusabantque ultro nunc hos, nunc illos atternis cavillantes verbis. Quid si Alijbassa cum fracti exercitus reliquiis, vos tales munc ex aliquo loco aspiceret, tam trahentes impedimenta, et avari praemia militis? Nonne puderet magis, magisque cum tam pudendi victoris? et crebro suorum ignaviam increparet, quod ab hujus modi superati fuerint, et bellicam laudem cesserint vobis? Ita jugi laetitia, festivus miles *per multiplices jocos, cantusque* viae labores levabat, donec castrorum suorum custodias pro vallo prodeuntes, ingenti clamore salutarunt." Barleti, L. II, f. 51.—Vjersha e Labit єshtє bєrє prej auktorit mi bazєn e ketí dєshmimi tє Barletit.

Digitized by Google

me goje. Midís ketyre, ishin Pal Dukagjini, Theodór Korona Muzaka, Lek Zaharia Altisferi dhe Kostandini, i biri i Arianitit. Që të gjithë, ndonesé Skenderbeu refuzonte, deshnë, për të treguar besnikerinë dhe mirënjohjen, t' i puthnin dorën e fortë që theu armikun.

Prova e parë u-bé dhe vajti mbarë. Kryengritja patriotike u-shigurua me vijtorën e Torviollit dhe një besím i pakufishmë në kryemendjen e kumandarit mbreteronte në çdo zemër. Shqiperia tani e ndjeu forcën e saj dhe kishte shpresa të shëndosha që t' a mpronte vendin nga shkeljet armike. Ambasada të ndryshme me letra, të kurorëzúara me dafinë (1), flámure dhe dhurata, të plaçkítura nga Turqit në fushën e betejës, u-derguan në príncerit aliatë dhe në gjithë hoborret e Evropes për të lajmëruar këté vijtore të shkelqyer. Flámuret e tjerë u-varrë neper Kishet e Krujes. Në mes të besníkëve të Ev-

1).—"Et laureatae litterae ac signa quaedam militaria ad omnes Epiri regulos missa, alia affixa templis sunt." Barleti, L. II, f. 51 dhe L. IX, f. 275: "Urbs Roma fere sicut fama, ita ornamentis ejus victoriae repleta. Ita statueret pro virili Scanderbegus totum pene orbem eleganti ea liberalitate sibi devincire. Adjunxit praeterea his donis begatos, et ac preces sedulas, ut jam ex diutino somno expergiscerentur et libertatem tandem christionam e tot sordibus, ac imperio Turcarum emergere facerent."

Digitized by Google

ropes beteja e Torviollit zgjoj shpresa te medhá per te dbuar Turkun nga Evropa. Qarku dipllomatík i Perendimit u-shtua me nje hobór te ri, me hoborin e Krujes, i cili taní nemerohej ne nje radhe me hoboret e Romes, Venetise, Napolit, Budapestit dhe Burgonjes se Frances. Keshtú u-hapne marredhénie dipllomatike ne mes te Shqiperise dhe te fuqive evropiane t' asáj kohe.

Ne keté mes, Papa Eugen IV, i inkurajuar nga fitimet e Skenderbeut dhe te Huniadit, perpiqej te organizonte nje kryqesate te re kunder Turqve, ne te cilen do te hynin Hungaria, Venetia, Gjenova, Perandoria Bizantine dhe Princi i Karamanise. Ne keté kryqesate u-ftua te marre pjese edhe Skenderbeu. Sulltán Muradi H, i trembur nga ketó pregatitje, kerkoj paqe nga Hungarezet; dhe me gjithe perpjekjet e Kardinál Julianit, legatit te Papes, nje paqe prej dhjete vjetsh u-neneshkrua ne Szegedin, me 12 te Korrikut, 1444. Pas ketí trakteti, Sulltán Muradi, ia leshonte Serbine Gjerq Brankoviçit, te cilit i kthente dhe dy bijte qe ia kish marre si penk, dhe shtrengohej te mos i ngase viset e Shqiperise, mi te cilat zoteronte Skenderbeu, domethene e njihte zyrtarísht mbreterine shqiptare.

Passí u-bé paqja, Sulltán Muradi II abdikoj fronin, mi te cilin hipi Sulltán Mehmedi H, dhe shkoj ne Magnesí per te shkuar ne qetesí vjetet e tij te funtme. Po kjo paqe e dhjete vjetve me-zí

Digitized by Google

mbajti gjashtë javë. Kardinál Juliani e bindi Mbretin Vladislláv të Hungarisë dhe të Pollonjës t' a thýenjë këté traktet, të përfitonjë nga abdikata e Sulltán Muradit, t' u bjerë Turqve, i ndihmuar prej fuqive të lídhura në kryqësatë, t' i dbonjë nga Evropa dhe t' a çlironjë Stambollin nga reziku i humbjes. Mbreti Veladisláv, pra, e çori traktetin, i dekllarój luftë Turqisë dhe me një ushtërí prej 14,000 Hungarezësh, Pollakësh e Vllehësh hyri në Bullgarí dhe kampój në fushë të Varnës, ku duhej të venin t' a bashkonin aliatët kryqësorë.

Përpara se të niset, i kish kërkuar ndihmën Skënderbeut. Letra e Vladisllavit, e shkruar më 28 Qershór, 1444, u-shtrua përpara Këshillës së Ligës, dhe pas shumë bisedimesh e kundërshtimesh, Skënderbeu me përkrahjen e Pal Dukagjinit, i bindi krerët shqiptarë t' a ndihmojnë Vladisllavin me një ushtërí prej 15,000. Kjo ushtërí u-mbloth me një mijë mundime. Pal Dukagjini, i cili u-zotua 5,000 ushtarë, u-sëmur dhe i biri Lek Dukagjini refuzój të dërgonte ushtërí. Veç kësáj, Vrana Konti dhe Tanúsh Thopía ishin kunder kësáj shpedite se nuke besonin që perandoria turke munt të thyhej aqë lehtë dhe, nga ana tjatër kishin frikë se mos, në kohën e largimit të Skënderbeut, hynin Turqit në Shqipërí. Skënderbeu deshte të mbante fjalën që i dha Vladisllavit dhe e mblodhi ushtërinë që u-zotua, po vonoj disá muaj dhe ky voním e prishi tërë punën, se i dha

Digitized by Google

kohe Gjerq Brankoviçit te Serbise t' i zere grykat e kufireve dhe t' ia prese udhen. Skenderbeu u-nis me 15 te Tetorit, dyke lene Vrana Kontin si regjént, po e gjeti udhen permés Serbise te mbyllur, se Gjerq Brankoviçi, i zemeruar kunder Hungarézeve qe kishin rrembyer ca fortesa dhe i lidhur me Sulltán Muradin II, te cilit i kish dhene te bijen per grua, refuzój t' a lere te shkonje neper tokat e tij. Skenderbeu, passi u-perpóq me te mire t' ia kthente mendjen dhe pá qe ishte me kot, i dha urdher ushterise tij te shkojne me hir e me pahír. Kishte kaperxyer dy gryka e kishte hyre thelle ne Serbí, kur mesój nga Hungareze dhe Pollake te ikur qe Vladisllavi ishte mundur e vrare ne betejen e Varnes me 10 Nentór, 1444.

Ç' kishte ngjare? Sulltán Muradi II, me te degjuar qe Hungarezet e shkele traktetin, mblodhi me nxitím nje ushterí prej 40,000, kaperxeu Bosforin me anie Gjenovezesh, dyke paguar nje dukát per koke, dhe pa pritur arriu dhe kampój perpara ushterise Hungareze ne Varne. E vuri ushterine ne regull, me Turhanin, bejlerbej te Rumelise, ne krahun e djathte; me Karaxhane, bejlerbéj t' Anadollit ne krah te mengjer; ay vete me Jeniçeret e tmerruar ne mes, dhe gatitej t' u binte Hungarézeve. Huniadi nuke deshi t' ia linte keté nder dhe, dyke e marre me ment qe Skenderbeu ishte ndaluar nga pabesia e Sérbeve, goditi i pari. Te dy krahet e ushterise turke u-thy-

Digitized by Google

en, qendra po tronditej, Sulltán Muradi desh t' i hipte kalit per te ikur, Karaxháj ia ze kalin per freri dhe perpiqet t' a qendronje, kur nje marresí e Vlladisllavit ua dha vijtoren Turqve me pahír. I shtyre prej bujáreve pollake, te cilet i kishin zilí Huniadit, Vlladisllavi, kunder keshilles se ketí, posá pá qe Turqit ishin me te thyer e siper, per te fituar aý lavdin' e vijtores, sulet me garden pollake kunder qendres turke, rrethohet prej Jeniçéreve, plagoset e bie nga kali. Turqit ia presin koken, e vene maje nje ushte, dhe ia tregojne ushterise hungareze, e cila humbét tere kurajen dhe me nje sulme te Turqve thyhet e merr aratine. Afró 10,000 te vrare te krishtere mbuluan fushen. Midís tyre ugjét edhe Kardinál Juliani i shtrire dhe me shpaten ne dore. Huniadi vete me germadhat e ushterise se tij kaperxeu Tunen dhe atjé u-zu rop prej Gospodarit te Molldavise Vlladit III, te miemeruar prej Vllehve *Drakul Çepelpush* (Djalli Xhelát) dhe *Kaziklli Voda (Vojvoda i Hurit)* prej Turqve, me te cilet ish i lidhur keté here. Vojvoda i Hurit s' e leshój Huniadin veç passí mori nje çpagím te rende.

Skenderbeu, i zemeruar qe u-ndalua te merrte pjese ne keté beteje, e cila po te fitohej, munt t' a kishte shiluar fatin e Turqve n' Evrope per gjithenjé, i ra Serbise an' e mb' ane, e plaçkiti dhe e shkretój me zjarr e me hekur qe t' i jape nje mesím te mire kralit te pabese, dhe u-kthye ne funt te Nentorit ne Kruje i pangushelluar. Qindra Pollakesh

Digitized by Google

e Hungarezesh, te ikur nga beteja e Varnes, te uret, te çveshur, si mos mé keq, po vinin ne Shqiperí ne mes te dimrit. Skenderbeu beri ç' i ardhi doresh per ketá te mjere. I mblodhi, i veshi dhe i dergój ne viset e tyre me ane te Raguzes. Keshtú, ndalimet e kréreve shqiptare nga njera ane dhe tradhesia e Brankoviçit nga tjatra, e ndaluan Skenderbene te merrte pjese ne betejen e Varnes, fitimi i se ciles do t' a kishte ndryshuar krejt historín' e Shqiperise, dyke u dhene funt nje her' e mire lúftese kunder Turqve ne fushat e Bullgarise.

Moti 1445 nisi me nje dasme. Mamica, motra m' e vogel e Skenderbeut u-marrtua me Muzake Thopine (1). Dasma u-bé ne Muzakiane, midís Krujes dhe Dúresit, me 26 te Jenarit. U-ftuan dhe u-ndodhe te gjithe Princerit e kreret e Shqiperise. Dasma mbajti disá dite dhe vera rodhi si lume. Ne te pir' e siper, na u-zu Lek Dukagjini me Lek Zaharine, dhe nje beteje e tmerruar krisi ne mes te ketyre príncerve dhe trímave te tyre. Shkaku ishte i vjeter. Qe te dy kishin rene ne dashuri me Irenen, te vétemen bije dhe trashegimtare te Lek Dushmanit, pincit te Zadrimes, e cila ishte e pa-

1).—Muzake Thopia ishte i marrtuar me Princeshen Zanfina, te motren e Gjon Muzakes, te cilen e ndau nuke dime per ç' fare shkak. Zanfina e divorcuar u-marrtua pastáj me Moisín' e Dibres. Per marrtesen e Mamices shih Hopf, Muzaka, f. 296, 298; dhe Biemmi, L. II, f. 84.

Digitized by Google

josur prej natyre me një bukurí të pazakóneshme. Për fat të lik të dasmóreve, princesha Irena u-ndoth në këté dasmë dhe ua trubullój gjakne të dy Lékeve, të cilët i vinin rotull si kendesë. Cilin nga të dy do të zgjithte? Princin e Dukagjinit, që kish një principatë pothua aqë të gjerë sa të Skenderbeut, a Princin e Danjes së vogël? Zemra e Irenes e hodhi voten nga ana e këtí të funtmit, se vetem për këté kishte nëneqeshje. Po ku të le Lek Dukagjini të mbarohet puna me votë sa kohë kishte kordhen në dorë? Pas mendjes së tij, aý mé trimi duhej t' a merrte nusen dhe taní ishte koha të ndáheshin lakrat sa pa u-ftohur puna. Skenderbeu kishte shkuar, passí u-bé kurorëzimi, dhe fusha qé e hapur për të dy ashikët e ndezur. Shkaku që kërkonin u-gjént. Dy trima të tyre ishin zenë, pa dyshím dyke biseduar kapedani i kujt do t' a merrte Irenën, dhe kështú u-dha shenja e pritur prej të dy áneve.. Lek Dukagjini dhe Lek Zaharia ishin atjé me ushtërit' e tyre, dhe me një herë u-ndés një beteje e régullshme, e cila mbajti disá orë. Vrana Konti dhe Vlladán Givrici, që kuxuan të hynin meses për të pajtuar të dy palët múarë si çpagím të shërbímeve të tyre, i pari një çpojtje me ushtë në krahë dhe i dyti një çarje me shpatë në kokë. Kështú u ngjau dhe të tjéreve, që vanë t' i ndanin, dhe ahere u-përfundua që të lihen të dy ushtëritë t' a mbarojnë punën ashtú si e nisnë. Beteja pasój me terbím dhe vijtorja dukej që anon-

Digitized by Google

te nga ana e Dukagjinit. Ushtëria e Lek Zarisë po tronditej, po hiqej.—O búrrani, ô Dukagjín! Edhé një sulmë, dhe Irena është jotja!—Lek Dukagjini vervitet në krye, e ndjek armikun, e shtyn, e përmbýs, e dërmón. Po dhe Lek Zaharia s' mbetet prapa. Mé mirë do vdekjen se sa çnderimi përpara Irenës. Kujtimi i nëneqeshjes së saj ia përsërit forcën, kthehet e turet si rufé kundër rivalit të kabardisur nga vijtorja e shiguruar. Dyeli midís të dy príncërve malësorë s' mbajti shumë kohë, kur një goditje e deshpëruar e Lek Zarisë me ushtë e shtrín përdhé Lek Dukagjinin gjysmë të vdekur. Përmbysja e kapedanit nga njëra anë dhe dishfata e nisur nga ana tjatër ua ftohnë gjakun të dy páleve dhe kështú patnë rasjen të hyjnë prapë në mest të Vrana Kontit me krahun lidhur dhe Vlladán Givrici (1) me kokën lidhur e t' i japin funt ketí sherri në mes të dasmës. Në fushën e betejës kishin mbetur një qint e pesë të vrarë dhe afró dy-

1).—Vrana Konti dhe Vlladán Girvici ishin këshilltarët e besuar të Skënderbeut. Barleti (L. XI, f. 336) e quan Vlladán Givricin të áfërmë nga gjaku me Skënderbenë: "qui Scanderbego sanguine conjuctus erat." Lavardin-i (L. XI, k. IV. f. 338): "proche parent de Scanderbeg." Anonimi (k. XXII, f. 24, Venetí 1545) e bën kont dhe nip të Skënderbeut: "conte Giurizza suo nipote valor osissimo." Nip nga nonjé motër, a nonjé vëlla, nukë na thotë. Nofta ishte i biri i Gjin Muzakës dhe i Vllajkës.

Digitized by Google

qint tє plagosur. Para se tє pushonte bєteja, dasma kishte marrє funt. Mamica me dhénderin kishin ikur me nxitím nє Krujє. Irena me t' atin kishin marrє udhen e Zadrinєs. Princєt e tjerє shkuan me vrap nga frika se mos i pєrfshinte dhe atá zegla e luftєs. Gjemimi i kєmbánave, ulєrimat e grave e tє çiliminjve pєrhapnє tmerrin nє fushєn midís Krujєs dhe Dúrєsit. Njerєzia linin fushєn dhe mbýlleshin nє fortesat, sikúr kishte rєnє mizєria turke nє Shqipєrí. Ishte "ikє t' ikim" nga tє gjitha anєt.

Lek Dukagjini u-shєrua pas ca ditesh dhe ahere Skєnderbeu i thirri qє tє dy dhe me-zí i pajtój. Si do tє shohim mé vonє, pajtimi nga ana e Lek Dukagjinit ishte vetem pєr sy e faqe, se bєri si bєri, e mori gjakun me tє pabesє. Kjo dasmє duhet mbajtur mєnt, se prej kєsáj rúadhє lufta me Venetinє, dishfata e Beratit, dhe tradhesia e Moisiut, tri ngjarje qє mєnt e pєrmbysnє Skєnderbenє.

Nє krye tє Prillit, Skєnderbeu zbriti nє Dibrє, se kishte degjuar qє njє ushtєrí turke po aferohej nє kufiret. Po allarmi qé i pathemeltє. Sulltán Muradi, dyke mєsuar qє Huniadi gatitte njє ushtєrí tє re pєr tє marrє gjakun e Varnєs, desheronte t' a ndreqte punєn me Skєnderbenє. I dєrgój pra Hajredín Benє si ambasadór pєr tє negociuar paqen pothua me ató kondita qє kish akseptuar i atí mє 1421, domethenє Sulltani do t' a njihte Skєnderbenє si princ tє Krujєs e tє Matit, posá ky t' i

Digitized by Google

pagúante haráç, t' i leshonte keshtjellen e Sfetigradit, krahinat e Dibres dhe fushen e Mokrenes. Hajredín Beu shtonte qe, po te mos i akseptonte ketó kondita, Skenderbeu do te dermohej si Huniadi ne Varne. Skenderbeu s' deshi me asnjé menyre te bisedonte per marreveshje mi keté baze, dhe keshilla e tij e perkrahu ne keté qendrím me nje ze. Sa per frikesimet, e ftonte Sulltanin te urdheronte e t' i vente ne pune.

Sulltani u-terbua nga kjo pergjígje kryelarte, po me gjithe deshperimin e tij, s' muntte as te vente vete, as te dergonte nonjé ushterí te forte kunder tij, gjithenjé nga frika e Hungarézeve, me te cilet s' kishte bere paqe pas betejes se Varnes. Dergój pra Firuz Pashen me nje ushterí te vogel prej 9,000, te gjithe kalores te çprovuar me porosí qe t' a pergjonte e t' a shtinte Skenderbene me nonjé pusí, kur hynte ne Maqedoní i çkujdesur per te plaçkitur. Keté here ushteria turke nuke ardhi nga Kosova ne Dibre te Poshtme, po nga liqeni i Ohrise ne fushe te Mokrenes, afer Dibres se Síperme.

Lajma e ardhjes se Firuz Pashes i vajti me kohe Skenderbeut, po jo mjaft shpejt sa te mblithte ushterí tjater veç asáj qe kishte ne dore, e cila perbehej prej gardes mbreterore, afró 3,500, prej te cileve 1,500 kembes dhe 2,000 kalores (1). Fu-

1).—Ushteria e gatishme dhe e gjithenjeshme e

Digitized by Google

sha e hapur s' i jipte dorε Skenderbeut keté herε se ushtεria e tij e vogεl do tε merrej nεpεr kembε prej kaloresisε armike. E futi pra Firuz Pashen nε njε pyll tε Mokrenes, pertéj Dibres sε Síperme, dhe atjé i dha beteje mε 10 tε Tetorit, 1445. Kaloresia turke, e penguar mε çdo çap nga lisat dhe dushqet, e ndjekur dhe e pritur nga çdo anε prej Shqiptáreve, qε kishin zenε tε gjitha shtegjet, uçkaterrua dhe mori syte, dyke lenε 1,500 tε vrarε dhe 1,000 robεr.

Vijtorja e Mokrenes, ndonesé shumε m' e vogεl se ajó e Torviollit, bεri mé tepεr bujε n' Evropε, ku vajti si njε ngushellím i mirepritur pas katastrofes sε Varnes. Krishterimi i Evropes gezohej qε vendin e Huniadit tε mundur e zuri njε fushe-

---

Skenderbeut, veç garnizóneve tε fortésave, duket nga kjó beteje dhe ishte a tri mije a tri mije e pesε qint. Barleti (L. III, f. 68) i bεn 3,500: "Pedites, quorum *mille et quingentorum* erat numerus—jam et equitum *duo* amplius fuere—." Biemmi (L. II, f. 90) i zbret mε 3000: "Scanderbegh trovavasi personalmente ai confini di Dibra *colle sole guardie di mille fanti e due mila cavalli.*" Gjithashtú edhé Anonimi, i cili gjetkε i bεn 3500, ketú nε keté beteje i zbret mε 3000 (k. VII, f. 12): "Et Scanderbeg con li suoi duo mila soldati scelti a cavallo, et mille a piedi, andó a pigliare le stanze alli suoi confini." Pak mé siper Anonimi na thotε qε Skenderbeu i dergój ushtarεt e tjerε mε shpi, kur u-nís me 3000 tε zgjédhurit per nε kufí: Et ciascuno dipoi presa licentia, se ne ritornó a casa."

Digitized by Google

tár. Papa Eugen IX, i cili qante nat' e dite per mjerimin e Varnes, ku i u-permbysne te gjitha pllanet ne nje pellk prej gjaku, me te marre lajmen e vijtores se Mokrenes, hodhi me nj' ane çdo hidherím, falenderój Perendine me brohorí qe i dhá Krishterimit nje kryemprojtes tjater, i cili me fitimet kunder Turqve lavderonte pontifikaten e tij, i dergój ambasadore te veçante qe t' a pergezojne, e t' i japin bekimet apostolike, t' i blatojne ndihmen e Kishes Katholike, dhe t' a shigurojne qe do te bente ç' t' i vinte doresh per te bindur mbreterit e krishtere t' a ndihmojne kunder armikut te perbashkme. Veç Papes, edhe mbreti Alfóns i Nápolit, i Sicilise dhe i Argones se Spanjes, kumandar i deguar i kohes se tij, deshi te lidhe miqesi me kumandarin shqiptár dhe i dergój nje ambasadór te veçante, te qúajtur Pietro Dieri, qe t' i shpjere pergezimet dhe urimet e tij (1).

Ne krye te motit 1446, nje komisión, i perbere prej kryepeshkópeve te Tivarit e te Dúresit dhe disá prellatesh te tjere, vajti ne Dures per te pritur ambasadoret e Papes dhe te Alfonsit. S' andejmi, me nje eskorte kaloresie, bajlozet ardhe ne Kruje per te sallutuar yllin e ri te Krishterimit Evropján. Skenderbeu i priti me nderime te medhá, i ngar-

1).—Per ketó ambasada te Papes Eugen IV dhe te Alfonsit shih Biemmin, L. II, f. 92-93. Per ambasada pergezimtare nga ana e Venetise nuke behet fjale fare.

Digitized by Google

kój me dhurata dhe i percolli tɛ kɛnaqur e tɛ enthusiasur. Per tɛ kthyer komplimentin, Skenderbeu i dergój Papes Imzót Pjeter Perllatin, dhe At Pal Kuken, dhe Mbretit Alfóns Vrana Kontin dhe Zaharia Gropen. Ciladó prej ketyre dy ambasádave shpinte nga kater flámure turke per Papen dhe Alfonsin veç dhurátave tɛ ndryshme dhe pláçkave tɛ fitúara nɛ fushe tɛ betejes. Keshtú nisi nɛ mes tɛ Skenderbeut e tɛ Alfonsit njɛ miqesí e ngushte, e cila u-rrít me kohe aqɛ sa Alfonsi u-bé m' i madhi e m' i forti perkrahes dhe mprojtes i tij. Ardhja e ketyre ambasádave, fitimi i dy miqve kaqɛ tɛ larte, si Alfonsi i Napolit e i Spanjes dhe si Papa i Romes, kryembreti i Evropes, u-kremtuan prej Shqiptáreve si vijtorja e tyre m' e madhe.

Vendin e Firuz Pashes keté mot e zuri Mustafa Pasha me 15,000 kalores, me urdher qɛ tɛ mos i jipte betejɛ Skenderbeut, po vetem tɛ hynte nɛ viset e tij pa pritur, e tɛ plaçkitte, tɛ diqte, tɛ prishte e tɛ therte. Ushteria turke kampój nɛ njɛ vent tɛ forte, tɛ qúajtur Otonete, nɛ Dibrɛ tɛ Síperme. Pastáj Mustafá Pasha çoj njɛ pjesɛ tɛ ushterisɛ per tɛ plaçkitur mɛ tɛ djatht' e mɛ tɛ mengjer. Skenderbeu, dyke i parɛ Turqit, tɛ perndarɛ kesisoj, e goditi Mustafá Pashen pa pritur me njɛ ushterí prej 5,000, mɛ 27 Shtatór, 1446, dhe dyke e gjetur tɛ pagatitur, e dermój nɛ pak orɛ. Kampi i terɛ, me flámuret e me ushqimet

Digitized by Google

rane ne duar te Shqiptáreve. Afró 5,000 te vrare mbulonin fushen. Róberit ishin vetem 300, se Shqiptaret, te egersuar nga barbarite, qe kishin bere Turqit ne fushe te Dibres, nuke deshnin te zinin rober.

Pas kesáj dishfate, Sulltán Muradi i dha urdher Mustafá Pashes qe te rúanje vetem kufiret, dhe jo vetem te mos japen beteje, po as t' a leshonje ushterine per te plaçkitur.

Gezimi i vijtores se trete u-trubullua nga lajma e zeze qe Pal Dukagjini vdiq prej apopleksie, ne verse 61 vjetsh, passí mbreterój afró 40 vjet. Ishte nje princ i pajosur me te gjitha cilesite: bujár, besník, dorehapur, zemermire, i squar, i zoti, trim, qe meritonte nje mbreterí mé te madhe. Skenderbeu thoshte qe, sikúr te kishte dhe ca princer si Pal Dukagjini, Shqiperia do t' ish bere ne pak kohe shteti m' i lulezuar ne bote. Vulpiani, kryeqyteti i tij, kur hipi ne fron, s' qé veç nje keshtjelle e vogel dhe e varfer, qe s' kish mé teper se 1,500 ndenjes; kur vdiq, ish bere nje nga qytetet mé te pasur e mé te medhénj te Malesive, dhe kish mé teper se 15,000 ndenjes. Te gjithe ketá ishin mbledhur atjé me qeverimin e tij te urte dhe te drejte. Vdekja e tij, e cila ngjau ne funt te motit 1446, e hidherój shume Skenderbene, jo vetem se e kishte mik te ngushte, po se humbi nje aliát te forte, i cili me shembellen e tij dhe besnikerine e tij mbante bashkimin dhe lidhjen e konfederates.

Digitized by Google

Moti 1447 shkoj nε paqe dhe, natyrísht, Shqiptaret nisnε tε leftojnε nε mes tε tyre, si pas njε zakoni tε vjeter e tε paçrenjosur. Lek Dukagjini, i biri i Pal Dukagjinit, qε kishte zenε taní vendin e t' et, ia mori gjakun Lek Zaharisε dhe e lau borxhin qε i kish per até qε pesój nε dasmen e Mamicεs. I shkreti Lek Zaharia Altisferi kish vajtur nε kεshtjellen e Varoshit per tε neneshkruar kontratin e marrteses me Irenen, tε bijen e Gjerq Dushmanit, princit tε Zadrimes, per tε cilen u-bé nε Muzakianε bεteja e gjákεshme qε pershkruam mé siper. Andrea Thopia e kish lajmεruar Princin e Danjεs qε tε ruhej, po ky s' ia vuri veshin, se s' ia merrte mendja qε Lek Dukagjini tε sillej me aqε pabesí. Kεshtú, pra, kur kthehej nga Zadrima, permés pyllit Kavineni afer Drinit, njε çetε asasinesh, qε i kishin zenε pusinε, i ranε prapa kurizit dhe vranε até dhe shokεt e tij me Bozdarin, tε nipin e Stefán Çernoviçit, princit tε Malit tε Zi, i cili qellój tε jetε bashkε si vellamε.

Tε gjítheve u ardhi keq per Lek Zaharine, i cili ishte njε trim i urtε—aqε i urtε sa munt tε jetε njε Gegε Malesór—, i cili s' kishte dhenε asnjé shkák per njε gjε kaqε tε poshter. Tε gjithε e denuan sjelljen e pabúrrεshme tε Lek Dukagjinit, dhe asnjé s' ia vinte veshin kur çfajesohej, dyke thenε qε u-shtrengua t' a bente kεté vrasje per tε shpetuar njε her' e mirε nga pusitε qε i vinte Lek Zaharia. Terε Shqiperia e dinte qε shkaku ishte,

Digitized by Google

se deshte tɛ ç' gjakesohej per betejen e Muzakianes dhe per humbjen e Irenes, nga njera anɛ, dhe nga tjatra per tɛ rrembyer principaten e Danjes, si u-dúk mé pastáj.

Me vdekjen e Lek Zaharisɛ, i cili s' kishte femijɛ, principata e Danjes mbeti pa zot. Trashgimtár legjetím i saj ishte Skenderbeu jo vetem si kryezót i Shqiperisɛ dhe kryetár i Liges, po se Lek Zaharia ia kishte lenɛ Danjen edhé me njɛ traktét tɛ veçantɛ. Veç Skenderbeut i kerkonte Danjen edhe Lek Dukagjini, i cili dergój njɛ ushterí qɛ t' a zaptonte fortesen, po u-shtrengua tɛ ikɛ pa bere gjɛ. Nɛ keté mes, per tɛ ngateruar punen mé teper, hyri dhe Republika e Venetisɛ. Princesha Bosa, e ema e Lek Zaharisɛ dhe e motra e Vrana Kontit, s' dinte ngaha tɛ kthehej. Per tɛ leshuar fortesen nɛ duar tɛ Lek Dukagjinit, vrásesit tɛ Lek Zaharisɛ, as fjalɛ s' duhej bere. Mbetej pra Skenderbeu dhe Venetia. Skenderebeu dergój Vrana Kontin tɛ merret vesh me tɛ motren dhe ky e kishte mbaruar punen, kur pa pritur njɛ ushterí veneciane hyri nɛ Danjɛ, e zaptój fortesen me ndihmen e ca Danjáreve, dhe e shpuri Bosen nɛ Shkodrɛ. Atjé Venecianet dhe Shkodranet me njɛ mijɛ intriga dhe çpifje e bintnɛ Bosen t' ia

---

1).—Il Conte Urana ch' era fratello di Bosa." Biemmi, L. II, f. 103.

Digitized by Google

falte fortesen Republikes se Venetise. Nje nga çpifjet ishte qe Skenderbeu e vuri Lek Dukagjinin t' ia vriste birin qe t' i trashegonte principaten nje or' e mé pare.

Pabesia e Venetise e zemerój Skenderbene, i cili thirri Keshillen e Liges dhe proponój t' i dekllarojne lufte Venetise me nje here. Ne keté ukundershtua Vrana Konti dhe Vlladán Givrici, te cilet ishin te mendjes qe puna te ndreqej me te mire, se Shqiperia e vogel s' munt te kishte lufte ne dy balle, ne lindje kunder Turqve dhe ne perendím kunder Venetise. Te gjithe te tjeret ishin per lufte, se u dukej qe Venetia dhe Turqia kishin nje marreveshje te fshehte per te coptuar Shqiperine, si ne kohe te Bálsheve, dhe ne keté nuke gabóheshin. Keshtú u-perfundua lufta, me qe kjo ish i vétemi shpetím. Lek Dukagjini mbeti neutrál; Pjeter Spani, Princ i Shales dhe i Shoshit, dhe Gjerq Dushmani, Princ i Zadrimes múare anen e Venetise; dhe ky, duket ish qellimi i Republikes Veneciane, t' a perçante e t' a prishte Ligen e Príncerve Shqiptare dhe t' i vinte te zíheshin midís tyre.

Skenderbeu la Vrana Kontin me nje ushterí prej 4,000 kunder Mustafá Pashes, dhe aý vete nisi te mbledhe ushterine kunder Venetise. Arianiti i dergój 3,000; Theodór Korona 600; Stefán Çernoviçi 400; Andrea Thopia 300; dhe princerit

Digitized by Google

e tjerë, të gjithë bashkë, 500 (1). Ushtëria e Skënderbeut e tërë arriu 14,000, gjysma kaloresí dhe gjysma këmbesí. Pa humbur kohë, Skënderbeu botój një manifestë, ku dekllaronte shkaket e luftës, dyke shkruar veçanërísht mi piken që kjo ishte luftë për të shpëtuar Shqipërinë nga coptimi mé teper se sa për të marrë Danjen dhe në krye të motit 1448 u-nís kunder Shkodrës, ku Venecianët kishin mbledhur ushtërín' e tyre. Me t' arrirë përpara Danjës, e ftój kumandarin e saj t' a leshonje fortesën. Aý refuzój, dhe ahere Skënderbeu e bllokój Danjen me shpresën që t' a merrte me urí. Nga ana tjatër, bllokój edhe fortesën e Dúresit, e cila ishte në dorë të Veneciáneve.

Skënderbeu, i lajmëruar prej Vrana Kontit që Turqit kishin nisur të levizin në kufi, la një ushtërí prej 4,000 për të vazhduar bllokaden e Danjës, dhe aý vetë me restat e ushtërisë kapërxeu Drinin dhe me flámure të hapur bariste kunder Shkodrës. Një ushtërí veneciane, e përbërë prej 1,000 Italianësh, afró 3,000 Dalmatianësh, dhe 11,000 Shqiptarësh, po e priste nënë kumanden e Daniél Juriçit, kumandarit të Shkodrës, i cili ishte në krahun e djathtë me Dalmatianët; Bartholomé Umoja nga Shkodra ishte në krahun

1).—Këtó número qe na i jep Biemmi (L. II, f. 110) tregojnë sa pak e ndihmonin Skënderbenë Aliatët e tij në kohë të rezikut.

Digitized by Google

e mengjer me Italianet dhe Shkodranet; Simón Vullkatanja dhe Andrea Umoja ishin ne qendre me Malesoret. Skenderbeu, dyke mesuar nga informatoret keté regullím te ushterise armike, mori kumanden e krahut te mengjer me garden mbreterore kunder Daniél Juriçit; ne krahun e djathte vuri Moisine me Dibranet, dhe ne qendre Tanúsh Thopine me ushterite aliate. Pllani i betejes ishte qe, posá te tronditej krahu i djathte i ushterise veneciane, Tanúsh Thopia dhe Moisiu te goditnin qendren dhe krahun e mengjer.

Pak kohe si u-ndés beteja dhe nisi te epet krahu i djathte i Veneciáneve, Tanúsh Thopia dhe Moisiu e dermuan qendren dhe krahun e mengjer te armikut, dyke zene rober Simón Vullkatanjen dhe Andrea Umojen. Ahere Daniél Juriçit s' i mbetej veç te ikte a te rrethohej e te zihej rop. U ra kémbeve, pra, dyke lene afró 2,500 te vrare dhe 1,000 rober. Nga ana e Shqiptáreve mbetne afró 400 te vrare, mé te shumet nga krahu i djathte i Skenderbeut, ku u-bé beteja mé e rende. Skenderbeu e ndoqi ushterine veneciane kemba kembes gjer ne dyer te Shkodres. Atjé múndesit paraduan nene muret e forteses, dyke u-tallur me Shkodranet dhe dyke u treguar robrit qe kishin zene. Shkodranet benin sehir nga keshtjella, po s' guxonin t' i ngisnin tállesit nga frika se mos pesonin gje róberit e tyre. Pas kesáj shkene homerike, me qe afronte dhe nata, Skenderbeu ur-

Digitized by Google

dherój ritiraten dhe ushteria e tere u-kthye ne Danje.

Kjo beteje u-fitua me 23 te Korrikut, 1448, dhe e lartesój famen e Skenderbeut ne Evrope mé teper se te gjitha vijtoret qe kish fituar nga Turqit. Skenderbeu besonte qe pas kesáj beteje, Danjaret do te jípeshin, po u-genjye. Kumandari Danjes Nikóll Moneta nga Shkodra refuzój t' ia dorezonte fortesen. Pasój, pra, bllokada, se Skenderbeu, dyke mos patur artilerí per te rrahur keshtjellen, s' kishte asnjé shprese qe t' a merrte me force. Ne keté mes, Skenderbeu leshój te gjithe robrit veneciane dhe mbajti vetem te dy kumandaret, Simonin dhe Andrene, te cilet i dergój ne keshtjellen e Petralbes. Nga ana tjater nisi te rindertonje ne token veneciane, pertej Drinit, fortesen e Balshit, fshatit lindór te Bálsheve, i cili ishte prishur dhe shkretuar. Ky fshat ishte dymbedhjete mile nga Shkodra, pese mile nga Drishti, nje tjater fortese veneciane, dhe pesembedhjete mile nga Danja. Qellimi i Skenderbeut ishte t' a mbante keté keshtjelle si nje penk e nie çperblím per Danjen, te pasonte bllokaden e kesáj s' andejmi, dhe t' a kishte si baze operatash kunder Veneciáneve. Kur ushteria po ndertonte keté fortese te re, si nje vindikate historike te Bálsheve qe u-shtypne prej Veneciánee dhe Turqve, Skenderbeu shkoj te piqej me Dukagjinet, te cilet kerkonin te pajtoheshin me té, dyke lene ne Balsh e ne Danje Hamzen

Digitized by Google

dhe Marín Spanin. Nε keté mes, Hamza goditi fortesen e Drishit pas kokes sε tij dhe u-praps prej kumandarit tε saj Kont Andrea Engjellit, dyke lenε 43 tε vrarε. Qε tε çgjakesohet, Hamza i vuri zjarrin krahines sε Drishtit. Kur u-kthye, Skenderbeu e qertój rrepte Hamzen per keté veperím dhe sjellje, qε ishin kunder úrdherit tε tij.

Mi ketó e siper, Turqit, tε cilet ishin nε marrevesje me Venecianet nisnε ofensiven dhe Vrana Konti, i shtrenguar keq prej Mustafá Pashes, thirri me nxitím Skenderbenε, i cili shkoj me vrap nε Dibrε. Per bllokaden e Danjes dhe per garnizón tε Danjes la nje ushterí prej 5,000 nenε Hamzen dhe Marín Spanin.

Ushteria turke prej 15,000 nenε Mustafá Pashen kishte hyrε nga ana e Ohrisε nε Oraník tε Dibres sε Síperme, kur Skenderbeu, tε cilin aý e kujtonte nε Danjε, i dolli perpara me njε ushterí prej 6,000. Turqit paguan per mosmarrjen e Danjes. Beteja u-bé mε 14 tε Tetorit, 1448. Nisi me njε dyél homerík, nε tε cilin Pal Maneshi shtriu perdhé njε kabadaí anadollák dhe mbarój me dishfaten e plottε tε ushterisε turke. Mustafá Pasha humbi afró 5,000 tε vrarε, 15 flámure dhe tere kampin. Até vete me dymbedhjetε oficerε tε larte e zuri rop Moisiu tε nésermen nε fushen e Rethes, dy mile lark Oranikut. Nga oficeret rober, si dhe nga dokumentat e shtabit turk, qε i ranε nε dorε, Skenderbeu mori vesh qε Venetia i

Digitized by Google

kishte ftuar Turqit t' a goditnin, kur i kish duart tє zena nє Danjє.

Kur Skenderbeu leftonte nє Oraník, Venecianet me njє ushterí tє fortє u-nisnє kunder fortesєs sє Balshit, kumandár i sє ciles ishte Marín Spani. Ky, i lajmeruar prej tє vellajt Pjetєr Spanit, i cili ishte me anєn e Venetisє, dhe dykє parє qє ishte e pamundur t' a mpronte ketє fortesє, e cila s' ish édhe ndertuar mirє, e neveriti nє fatin e saj, passí e hoqi tєrє ushterinє perketej Drinit. Venecianet e rrєzuan dhe e sheshuan krejt fortesєn e Balshit.

Lajma e prishjes sє Balshit i arriu Skenderbeut naten pas betejes sє Oranikut. Me vrap ukthye pєrpara Danjes dhe aý, i cili e kish qertuar Hamzєn ca kohє mé parє, i vuri zjarrin krahinєs sє Shkodrєs pєr tє çgjakєsuar Balshin dhe pabesín' e Venetisє qє ftoj Turqit kunder tij. Nga ana tjatєr, nisi t' a rrahє Danjєn dhe Dúresin me artilerinє medievale qє kishte dhe pєr çudí, sikunder mєsojmє dhe nga arshivat e Venetisє, qє tє dyja ketó fortesa ishin mє tє rєnє e siper, kur Senati i Republikєs veneciane i trembur i kerkój paqє Skenderbeut. Delegatet veneciane Paulo Loredano dhe Andrea Venieri kishin patur urdhєr qє tє benin ç' t' u vinte doresh qє t' a thýenin Skenderben' e *tmerruar* (1); tє lajmeronin

1).—"Il formidabile".

Digitized by Google

Sulltán Muradin qe t' i binte prapa kurrizit e t' a vente midís dy zjarresh; po te vononte ardhja e ushterise turke, t' i zgjatnin negociatat e t' a vinin ne gjume Skenderbene, dyke i kujtuar miqesín' e vjeter te Kastrióteve me Venetine dhe perkrahjen morale qe i kish dhene Republika ne Kuvendin e Leshit; po te mos vinte ushteria turke, te benin paqe me çdo menyre (1). Ushteria turke ardhi e u-thye ploterísht, dhe s' kishte mé asnjé shprese, te paken até mot, qe te shtypej Skenderbeu i *tmerruar* midís mókrave turko- veneciane. Perkunder, po te vonohej paqja dhe ca kohe, Venetia do te humbiste Dúresin e Danjen dhe pas atyre nofta te gjitha keshtjellat qe kishte ne Shqiperí. Po as Skenderbeu s' muntte t' a zgjatte luften me Venetine gjer ne funt, se ató dite i ardhi lajma qe Huniadi u-dermua krejt prej Turqve ne fushen e Kosoves ne nje beteje te tridítesh-me me 17-19 Tetór, 1448, ku humbi tere ushterín' e tij, dhe Sulltán Muradi, i cili tani i kish duart te lira, po gatitte nje ushterí te madhe kunder tij. Keshtú, u-negociua dhe u-neneshkrua paqa ne Lesh, ne dimer te motit 1448, midís delegáteve veneciane, Paolo Loredano dhe Andrea Venieri, dhe delegáteve shqiptare, Andrea, peshkóp i Krujes, dhe Gjerq Pellini, abát i Shen Marise ne Ron-

1).—S. Romanin, Storia Documentata di Venezia, vell. IV, f. 243-244.

Digitized by Google

déc. Konditat e paqes ishin ketó: Venetia mbante Danjen, po si çperblím i leshonte Skenderbeut një copë vent mé të math anes Drinit, të qúajtur Buzegjárperi, dhe do t' i pagúante 1,400 dukate per mot; alianca dhe traktetet e vjetra tregetare perseríteshin (1). Republika veneciane u-kenáq aqë shumë nga kjo paqe e nderçime dhe e papritur pas një dishfate në fushë dhe pas rezikut, në të cilin ndódheshin Dúresi dhe Danja, sa votój me një zë që emri i Skenderbeut të shkruhet në libren e arte të bujáreve të Republikes. Andrea Venieri u-dergua si ambasadór i veçantë në Krujë që t' i dorezonte një kopje të kesáj rezollute dhe emerimin e tij si kryekumandár i nderit i ushterive veneciane në Shqipërí.

Lavdia e kesáj fushate në dy ballë ishte e pakufishme. Skenderbeu dolli mundes kunder dy fuqive mé të medhá të kohes ti, Turqisë, që ishte në steré si Gjermania perpara motit 1914, dhe Venetisë, që ishte në det si është Inglia sot. Nga ana tjater, Shqiptaret, të cilet ndódheshin nenehien e Venetisë, i mbajtin merí Skenderbeut vjete me radhë per demet që u kishte bere në kohë të kesáj lufte.

Dishfata e Oranikut e bindi Porten e Lartë që Skenderbeu nuke thyhej me ushterira të vogla dhe ishte nevojë të vente vetë Sulltani me tere

1).—Shih Romanin, vell. IV, f. 243-244.

Digitized by Google

ushterinë turke kunder tij. Pas betejes së Kosoves Sulltán Muradi II e ktheu tërë kujdesin e tij për të shtypur Ligen e Príncerve Shqiptarë. Skenderbeu mori të gjithë masat e nevójshime për të mprojtur vendin. Dergój Pal Kuken në Napoli që t' i kërkonte ndihmë Alfonsit t' Aragonës. Moisiu u-dergua në Dibrë; arkimandriti Pjetër Perllati në Sfetigrad; Hamza Kastrioti në Stellúsh. Tanúsh Thopía në Petralbë; Muzaka i Angjelinës në Tornáç (1); Vrana Konti me një garnizón prej 4,000 dhe me të ngrena të mjafta për 16 muaj mori kumanden e' Krujes; në çdo pikë strategjike u-dergua një gjenerál që të kujdesej për mprojtjen e saj; aý vetë, nat' e ditë kaluar, shkonte nga njëra fortesë në tjatrën, permiqyrte dhe drejtonte pregatitjet. Fusharaket múarë urdhër të mbyllen në keshtjellat.

Passí i forcój të gjitha fortesat me garnizone, Skenderbeu me 12,000 ushtarë u-nis për në Dibrë dhe Sfetigrád. Mb' udhë u-póq me Moisinë, i cili e lajmerój që Sulltán Muradi kishte në ment të goditte mé parë Sfetigradin dhe pastáj Krujën. Garnizoni i Sfetigradit përbehej prej afró 2,000 ushtaresh Dibranë dhe Sfetigradarë, nënë kumanden e Pjetër Perllatit. Skenderbeu vizitój fortifikatat e Sfetigradit dhe mbeti i kënaqur nga

---

1).—Biemmi e quan këtë fortesë *Tornacio*, L. III, f. 151; volaterrani *Ternacium*, Lavardin, Préface.

Digitized by Google

pregatitjet e Moisiut. U foli ushtáreve qe t' u jape kuraje per te mprojtur kyçin e Shqiperise dhe shkoj, passí i dhurój Pjeter Perllatit dy jatagane te punúara me mjeshterí, dhe nje shqyt kryetarit te Sfetigradáreve Martín Fersiçit.

Ne krye te Majit u-dúk kryerojtja e ushterise turke perpara múreve te Sfetigradit dhe me 14 t' atí múaji arriu Sulltán Muradi me nje ushterí prej 80,000, me dy topa te medhénj qe hithnin gjyle 200 oke te renda dhe me metál per te derdhur topa te tjere. Topi dhe dyfeku u-perdore per heren e pare ne Shqiperí ne rrethimin e Sfetigradit.

Sulltán Muradi e ftój Pjeter Perllatin qe te jipet, po ky refuzój, dhe me nje here nisi rrahja e forteses me top. Pas nje bombardimi prej tri ditsh u-çá nje pjese e ledhishtes dhe u-leshuan Jeniçeret ne nje sulme te pergjítheshme. Trimat dibrane i thyen ketó sulma, njeren pas tjatres, kur Skenderbeu se jashtmi s' e linte ushterine turke te qete as nate, as dite.

Me 10 te Majit kishte hequr ne pusí nje trup kaloresie turke prej 2,000 ne gryke te Rovikut dhe e kish coptuar. Ne funt te Majit nje ushterií turke vajti per te zaptuar keshtjellen e Stellushit, te cilen deshnin t' ia dorezonin 200 tradhetore turq, te kthyer te krishtere me 1443. Skenderbeu, i lajmeruar per keté kompllót, arriu me vrap ne fortese, i varri te gjithe kompllotistet dhe zuri pu-

Digitized by Google

sinɛ pɛr tɛ pritur ushtɛrinɛ turke qɛ afrohej nɛnɛ kumandɛn ɛ Ibrahím Beut, i goditi nɛ fushɛ tɛ Talmiranɛs dhe u dha arratinɛ mɛ humbje tɛ tmerrúara. Mɛ 22 tɛ Qɛrshorit goditi natɛn ushtɛrinɛ rrɛthónjɛsɛ, dykɛ shtrirɛ 3,000 Turq tɛ vrarɛ, dykɛ rrɛmbyɛr 6 flámurɛ ɛ disá qindra kuaj, ɛ dykɛ u kallur tmɛrrin armiqvɛ. I trɛmbur nga kɛtó goditjɛ tɛ paprítura, Sulltán Muradi dɛrgój Firuz Pashɛn mɛ 18,000 ushtarɛ pɛr tɛ ndaluar Skɛndɛrbɛnɛ t' i ngasɛ rrɛthónjɛsit kur t' i binin Sfɛtigradit. Skɛndɛrbɛu qɛ t' i kɛtɛ duart tɛ lira, i dolli pɛrpara Firuz Pashɛs qɛ t' a qɛrontɛ nga mɛzi. Bɛtɛja ishtɛ mɛ tɛ nisur, kur Firuz Pasha dolli nɛ shɛsh dhɛ ɛ provokój Skɛndɛrbɛnɛ nɛ dyɛ́l. Mɛ kot ofiɛrɛt ɛ tij pɛrpíqɛshin t' a mbanin. Skɛndɛrbɛu u-lɛshua mi tɛ́, dhɛ gjɛr sa tɛ mɛrrɛj vɛsh ç' ngjistɛ, ɛ shtriu Firuz Pashɛn tɛ vrarɛ pɛrdhɛ́. Ushtɛria turke, ɛ ngrirɛ nga humbja ɛ kumandarit, s' mundi t' u bɛntɛ ballɛ Shqiptárɛvɛ shumɛ kohɛ, dhɛ mɔri arratinɛ, dykɛ lɛnɛ 4,000 tɛ vrarɛ nɛ fushɛ.

Pikɛrísht atɛ́ ditɛ Sulltán Muradi, nɛ njɛ sulmɛ tɛ pɛrgjítheshmɛ kundɛr fɔrtɛsɛs, humbi, vɛç tɛ plagósurvɛ, 7,000 tɛ vrarɛ. Gjɛr nɛ funt tɛ Korrikut, humbjɛt turkɛ kishin kapɛrxyɛr 20,000, dhɛ u-dúk çkoqur qɛ Sfɛtigradi nukɛ mɛrrɛj dot. Sulltán Muradi gatitɛj t' a ngrɛntɛ rrɛthimin ɛ tɛ kthɛhɛj nɛ Ɛdɛrné, kur njɛ tradhɛtór ia dha fɔrtɛsɛn pa bɛtɛjɛ ɛ pa dɛrdhur asnjɛ́ pikɛ gjak. Nɛ

Digitized by Google

tɛ vétɛmin pus tɛ Sfetigradit, nga i cili pinin ujɛ ndénjɛsit dhe garnizoni, tradhɛtori, i paguar prej Turqve, hodhi natɛn njɛ qɛn tɛ ngordhur. Dibranɛt bullgarɛ dhe orthodoksɛ s' deshnin tɛ pinin ujɛ nga ky pus me asnjé mɛnyrɛ. Mɛ kot kumandari, passí e qɛrój pusin mirɛ, piu vetɛ ujɛ qɛ t' ua kthente mɛndjen; mɛ kot Sfetigradarɛt me radhɛ pinɛ ujɛ pas kumandarit. Dibranɛt bullgarɛ s' túndeshin dhe kɛshtú s' mbetej veç tɛ vdisnin nga etja, a t' a lɛshonin fortesɛn. Zgjodhɛ tɛ dytɛn. Dɛrguan parllamentarɛ dhe i proponuan Sulltán Muradit t' ia dorɛzojnɛ fortesɛn me konditɛn qɛ t' i linin tɛ shkonin jashtɛ me armɛt dhe me plaçkat e tyre. Sulltán Muradi akseptój konditat e tyre me gɛzím tɛ math dhe mɛ 31 tɛ Korrikut Dibranɛt me kumandarin e tyre dúallɛ jashtɛ dhe ushtɛria turke hyri nɛ Sfetigrád.

Kɛtá Dibranɛ nga Dibra e Síperme ishin Bullgarɛ nga raca dhe orthodoksɛ nga feja, sikundɛr na thotɛ Barleti (1), dhe jo katholikɛ, siç ishin pothua tɛ gjithɛ Shqiptarɛt qɛ nga koha e Bálshɛve. Po

1).—"Nec profecto mirum cuipiam esse videatur, si Dibrenses hac sua levissima superstitione adducti, in hanc delapsi dementiam, hujusmodi errorem commiserint, cum ii non tantummodo superstitiosi, verum etiam haeretici sint, fuerintque semper (hae nempe contagiones, sive morbi connexi sunt inter se, et affines). *Sermo enim hujus gentis Sclavomes est,* cujus

Digitized by Google

qenɛ gjysmɛ tɛ shqiptarɛzuar dhe tɛ lidhur me njɛ besnikerí tɛ patronditur me shtɛpín' e Kastrióteve. Per fat tɛ keq tɛ Skenderbeut, kishin supershtitɛn tɛ mos pinin ujɛ e tɛ mos hanin gjellɛ, qɛ kishte ardhur nɛ qasje me kufomɛ njeriu a bagetie, dyke besuar qɛ kalbesia e kufomɛs do t' u shkonte nga trupi nɛ shpirt.

Skenderbeu u-trondít aqɛ shumɛ, kur i vajti lajma e kapitulatɛs sɛ Sfetigradit, sa u-mbýll nɛ tenden e tij dhe vendosi t' u japɛ njɛ mesím tɛ tmerruar Dibráneve bullgarɛ qɛ ia leshuan for-

---

sermo et lingua (ut nobilissimi seriptorum tradidere) latissima, in varias, diversasque sectas diffusa, et sparsa est. Nam ex Sclavonibus alü Romanam sequuntur Ecclesiam, ut Dalmatae, Croatini, Carni, ac Poloni, alü Graecorum errores, et ineptias, *ut Tribali, qui et Bulgari dicuntur.*" Barleti, L. V, f. 141.

"La guarmigione era, come sopra ho detto, composta da *Dibresi* di *Dibra superiore,* il qual paese quantunque soggetto a Scander-begh non era peró abitato da gente albanese come la Dibra inferiore, ma da *Bulgari,* o sia Serviani. Professava bersi questo popolo la Religione Cristiana, ma corrotta dall' eresia, e non conforme ai dogmi della *Chiesa Romana ch' eramo creduti dagli Albanesi,* e seguia con una specie di fascino molte superstizioni. Una delle quali era di non osare giammai bere, ne mangiare di tutto ció che avesse toccato corpo morto di uomo, o di bestia, immaginandosi che quella cosa lor lasciasse una corrizione dentro il corpo che passasse insino all' anima." Biemni. L. III, f. 192.

Digitized by Google

tesen armikut per një qen të ngordhur. Po kur Pjeter Perllati, i thyer e i dermuar, i dolli perpara, në krye t' atí garnizoni prej trimash, që nuk i mundi forca po supershtita, dhe kur të gjithë me Sfetigradaret e perlotur i ranë në gjunjë, u-mallengjye dhe i shkoj tere zemerimi. I fali, dhe as e hapi gojen që t' i qertonte, po që ahere kurrë nukë vuri mé Dibranë bullgare per të mprojtur nonjé fortesë.

Kyçi dhe kryeporta e Shqiperisë ish taní në duar t' armikut dhe asnjerí nukë dyshonte që Sulltán Muradi, passí t' a forconte ushterín' e tij, do t' î binte Krujes. Po kjo nukë ngjau. I lodhur dhe i deshperuar nga humbjet e medhá, Sulltán Muradi, passí e ndreqi fortesen e dermuar dhe la një garnizón prej 2,000 Jeniçeresh me një grup të fortë prej kollonistesh turq, u-ngrit me tere ushterín' e tij në krye të Gushtit dhe u-kthye në Ederné per të gatitur shpediten e dytë dhe të funtme kunder Skenderbeut.

Kjo ikje u dha Shqiptáreve pershtypjen që Turqit nukë do të kthéheshin në Shqipería per shumë kohë, dhe hobori i Krujes deshte t' a festonte këté ngjarje, dykë marrtuar Skenderbenë me të bijen e Arianitit të Kaninës, i cili kishte derguar mblesë per të negociuar këté marrtesë. Po Skenderbeu ish i mendjes që s' ishte koha per marrtesë sa Sfetigradi ish në dorë t' armikut dhe sa ish frikë që Sulltán Muradi të kthehej veren

Digitized by Google

e pritme per te goditur Krujen. Mé ne funt, i shtrenguar prej miqve, u-zotua qe marrtesa do te behej posá te fitohej prape Sfetigradi. Nisi, pra, me nje here pregatitjet per keté shpedite. Ne syt' e Evropes, me gjithe humbjen e Sfetigradit, Skenderbeu quhej sikúr e fitój fushaten, posá Sulltán Muradi u-shtrengua te hiqej pa hyre mé thelle ne Shqiperí. Vullnetare frenq, gjermane, italiane dhe dalmatiane po vinin dite per dite dhe bashkoheshin me ushterín' e tij. Ketá súalle ca dyfegje dhe topa te vegjel. Arianiti i dergój 4,000 ushtare dhe 10,000 dukate; Alfonsi i Nápolit 1,200 ushtare me nje shumice te madhe ushqimesh nene kumanden e Giliberto Ortofano's. Zaharia Gropa, qe kish vajtur te kerkonte ndihmen e Papes Nikóll V (1447-1455), u-kthye, dyke sjelle vetem zotime, levdata dhe bekime apostolike. Me 25 te Shtatorit, 1449, me nje ushterí prej 18,000, midís te cíleve 50 artileriste frenq, Skenderbeu e rrethój Sfetigradin, po puna nuk i vajti mbare aspák. Dy sulma te pergjítheshme, ne te cilat vullnetaret gjermane treguan nje trimerí te madhe (1), u-prapsne me humbje te renda; nonjé tradhetór ne fortese nuk u-gjént; shirat e vjeshtes i benin operatat te pamúndeshme; lajmat nga te gjitha anet s' lenin asnjé dyshím qe Sulltán

1.)—"Nesciis cedere ac ruentibus in ferrum Germanis." Barleti, L. VI, f. 150.

Digitized by Google

Muradi do tɛ kthehej prapɛ nɛ Shqipɛrí; dhe kɛshtú mɛ 26 tɛ Tetorit, 1449, Skɛnderbeu u-shtrɛngua t' a ngrente rrethimin e Sfetigradit, passí humbi pɛrmí dy mijɛ tɛ vrarɛ dhe ca mé tepɛr tɛ plagosur.

Nɛ krye tɛ motit 1450 Skɛnderbeu humbi edhe Beratin. Puna ngjau kɛshtú. Theodór Korona Muzaka, dyke mos patur asnjé trashɛgimtár ia fali Beratin Skɛnderbeut me testamént, dhe kur ish mɛ tɛ vdekur e siper, e ftój qɛ tɛ dɛrgonte njɛ ushtɛrí qɛ t' ia dorɛzonte fortesɛn. Skɛnderbeu çoj Pal Maneshin me 800 ushtarɛ. Po Pasháj i Gjirokastrɛs, me tɛ degjuar kɛté gjɛ, mblodhi njɛ ushtɛrí tɛ madhe, hyri me tradhɛtí natɛn nɛ qytét, kur garnizoni dhe ndénjɛsit flinin qetɛsísht dhe e zaptój kɛshtjellɛn pothua pa dɛrdhur gjak. Pal Maneshi u-zu rop dhe u-lɛshua passi u-çpɛrblye prej Skɛnderbeut pɛr 500 dukate. Theodór Koronɛn e ngritnɛ Turqit nga shtrati i vdekjes dhe e varrɛ nɛ trek tɛ qytetit (1).

---

1).—Pɛr humbjen e Beratit shikó Biemmin, L. III, f. 225. Lehtɛsia, me tɛ cilen u-muar Berati, njɛ fortesɛ natyrale, e cila n' até kohɛ munt tɛ mprohej shumɛ lehtɛ, lɛ udhen tɛ hapur pɛr hipothezɛn qɛ princɛt e Myzeqesɛ dhe disá krerɛ tɛ Beratit kishin gisht nɛ tradhesí dhe ishin nɛ marreveshje me Turqit kunder Skɛnderbeut. Kɛté hipothezɛ e forcón fakti qɛ, pak kohɛ pastáj, Skɛnderbeu e aneksój tɛrɛ principatɛn e Myzeqesɛ. Berati, sikunder pamɛ mé siper ishte njɛ kɛshtjellɛ e

Digitized by Google

Humbja e Sfetigradit dhe e Beratit, njera pas tjatres, dhe lajmat e pregatítjeve te medhá te Sulltán Muradit, i trempne aqe shume Shqiptaret sa nisne te humbasin çfaredó shprese dhe ishin te shigurte qe edhé Kruja do te pesonte gjithaté mjerím dhe qe, me ardhjen e dyte te Sulltán Muradit, fati i Shqiperise ishte i shiluar.

Per te shtuar deshperimin, te gjithe aliatet e neveritne Skenderbene ne keté periude kritike. Arianiti, i zemeruar qe Skenderbeu e shtynte per mé tutje marrtesen me bijen, refuzój t' i dergonte ndihme. Skenderbeu u-perpóq t' a zbutte dhe t' ia mbushte koken qe s' muntte te bente dasme, si humbi Sfetigradin me Beratin, dhe kur gjithaý rezík i turej Krujes e tere Shqiperise; i zotohej qe marrtesa do te behej pa vonim, posá te shkonte furtuna qe aferohej, po Arianiti s' deshte te degjonte asnjé nga ketó aresye: A dhender thoshte, a s' ka ndihme. Ngulma e Skenderbeut per mos-marrtese, si do te shohim mé vone kishte dhe nje tjater shkak me rendesí kryesore: ishte frika se mos zemerohej, nipi i tij Hamza Kastrioti, i cili kishte shprese t' i zinte kemben sa kohe Skenderbeu s' kishte bij te tijte. Gjithaté shprese

---

Muzákeve, dhe ketá pa dyshím u-egersuan kur ushteria e Skenderbeut hyri dhe e zaptój. Per te marre gjakun, Muzaket ftuan Turqit dhe i ndihmuan per te rrembyer Beratin, nofta me shpresen qe do t' ua jipnin atyre. Turqit e múare dhe e mbajtin per Sulltanin.

Digitized by Google

e kishin pa fjalë dhe të níperit nga motrat, të cilët ishin nonjé dyzinë. Dyke u-marrtuar pra në këté rasje, e cila pa dyshím s' ishte për dasmë, Skenderbeu do të futte zjarrin në shtepí të tij. Keshtú pra marrtesa u-la më nj' anë dhe Arianiti mbeti i ftohur dhe i armiqësuar. Venetia dha për shkak paqen që kishte lidhur me Turqinë dhe nënë rogós shtynte krerët shqiptarë që t' a neveritin Skenderbenë a t' i bien e t' a dërmojnë me këté rasje; Arianiti i egërsuar u-emërua këté mot prej Senatit të Republikës kryekumandár i ushtërisë veneciane me títullin i *shkëlqýeri* (1) dhe u-vu në krye të príncërve shqiptarë të zëmëruar kundër Skenderbeut. Mbreti Alfóns i Nápolit, miku i tij m' i mirë, që i dërgój ushtarë dhe ushqime për të rizaptuar Sfetigradin, taní që ishte në rezík kryeqyteti dhe tërë mbretëria e tij, nukë mundi t' a ndihmonte me gjithë deshirën e tij. Kryepeshkopi i Tivarit, që kishte vajtur në Romë, nukë solli nga ana e Papës Nikóll V veç bekime apostolike dhe shigurime që Perëndia kurrë nukë do t' a neveritte Skenderbenë, të cilin e kishte mprojtur gjer ahere. Vetëm Dukagjinët dhe Thopíat e Dúresit i derguan ca ushtarë të pakë. Dyké qënë në nevojë të madhe për pará, mori një hua nga ca tregëtarë Raguzanë dhe Napolitanë, të cílëve u dha mi-

1).—"Magnificus." Shih Hahn, Reise, vëll. 16, f. 113.

Digitized by Google

nat e kripes qe t' i punonin per hesáp te tyre gjer sa t' u lahej borxhi.

Paniku mbreteronte ne tere Shqiperine. Tmerri i bente njerezine te shikonte kuçedra dhe fantazma me sy hapur. Makthi u kishte shkelur te gjitheve ne gryke e ne krahorór. Me sy te vrare e te perlotur, po pútheshin njeri me tjatrin, dyke qare e dyke vajtuar, sikúr píqeshin per heren e funtme. Afer Petrelles ishin pare dy ushterira fantastike, me arme te ndríçime prej ari, qe u-perpoqne ne ere me nje oshetím shurdhonjes prej trumbetásh; prane Krujes, disá net me radhe, ishin dukur me míjera lubira, qe nxirnin flage nga syte dhe nga goja, dhe qe i vinin rrotull forteses, dyke dashur t' a perpijne; ne Brantesh-koze, ne mes te dites, ishin pare tri hena, qe ndritnin aqe sa dhe díelli, kur nga ana e lindjes krisi nje furtune me bumbullima, me shkreptima e me rrufera, ndonesé ishte dimer; ne Muzakiane kishte rene shí me gure; Drini ne Rubre dhe Ishmi ne Gjate qénkeshin skuqur e po rrithnin gjak te mpiksur; ne Petralbe, flámuri i keshtjelles ishte djegur prej zjarri te rene nga qielli; ne Thornaç nje foshnje prej gjashte múajsh paske berrtitur me llahtarí: "Ardhi Turku!"

Skenderbeu, i trembur mé teper nga frika dhe deshperimi i njéresve te tij se sa nga reziku turk qe i varrej mi koke, si u-keshillua me pesh-

Digitized by Google

kopin e Drishtit (1), beri keté maryfét qe t' ia sillte pópullit shpirtin ne vent: Passí perhapi me te gjithe anet qe kishte nje lajme gazmore, i mblodhi te gjithe oficeret, tere ushterine dhe pópullin ne nje fushe te hapur, hipi ne nje brek dhe u tregój keté enderr: "Naten e shkuar, kur flinja, pashe Shen Gjergjin, te veshur me arme qe shkelqenin mé teper se rezet e díellit, hipur mi nje kale, qe dukej sikúr ishte zjarr i teri, me nje shpate te arte çveshur ne dore, i cili me tha te jem burre, se do t' a munt Sulltán Muradin dhe ushterín' e tij te tmerruar ashtú si kam dermuar dhe gjeneralet e tij; me tha qe krahu i Perendise do te me mpronje mua dhe pópullin tim, sa mé teper te na shtohen reziket; qe eshte e shkruar ne qiell te rronj e te vdes mbret i Shqiperise, dhe qe mizerít' e Anadollit perpiqen me kot te me tundin nga froni i stergjýsherve; pastáj Shen Gjergji zgjati doren e m' a dha shpaten e ndríçime me ketó fjale: Merr-e keté shpate, arme qe t' a dergón vete dora e Perendise, dhe me keté shtrih-i ne kembet e tua te gjithe armiqte, qe leftojne Shqiperine dhe Krishterimin"

Peshkopi i Drishtit dhe prellatet e tjere e mbuluan me doretrokitje dhe brohorí énderren e çudíteshme te Skenderbeut dhe po pergezonin

1).—Pal Engjelli, i cili pastáj u-bé kryepeshkóp i Dúresit.

Digitized by Google

njeri-jatrin qe Perendia e kujtój Shqiperín' e mjere dhe e mori nene mprojtje kunder barbáreve t' Asise. Pastáj u-ngrít nje Peshkóp dhe tregój qe kishte pare ca net mé pare ne enderr vete Sulltán Muradin me nje tufe Pashallaresh, te lidhur me vargónj, qe i lúteshin Skenderbeut me gjunje t' u falte jeten. Nje tjater prellát tregój qe kishte pare fushat afer Krujes te mbulúara me kufoma prej Turqsh. Dy prellate te tjere treguan qe kishin pare, tri dit mé pare, jo ne enderr, po me sy hapur, nga mezi i nates nje tokice engjejsh, te radhitur dy nga dy, me qirinj te ndezur ne dore, qe kendonin litanira dhe i lúteshin Perendise qe t' a marre nene mprojtje Shqiperín' e neveritur. Ketó éndera jo vetem ua nxúare friken Shqiptáreve, po dhe i shiguruan ploterísht qe e kishin luften te fituar, dhe qe e kishin kaperxyer rezikun (1).

---

1).—Panikun e pópullit, énderren e Skenderbeut dhe vizionet e prelláteve na i tregón si me te tallur Biemmi (L. III, f. 227-230), te cilit here-here i mungón hollesia. Mé te shumat e ketyre, qe i kish kenduar ne histor-n' e Tivárasit, i mban per vete, dyké shtuar qe ató qe na transmetój jane te mjaftta: " *e molti altri casi simili in favola, ed in ispavento sono raccontati dall' Antivarino, i quali is tralascio, sembrandoni d' averne riferiti a sufficienza.*" Merret vesh lehte qe ketó informata jane te paçmúara, se hedhin drite mi shtetin e mendjes se Shqiptáreve dhe lene udhen te hapur per hipothezen qe Skenderbeu shikonte vizione dhe degjonte zera prej qielli si kryetri-

Digitized by Google

Si u-mbýll kjo plagɛ, Skenderbeu beri pregatitjet e nevójshime dhe priste qetɛsísht ardhjen e Sulltán Muradit. Kur mɛsój qɛ ushteria turke ishte nisur nga Ederneja, dolli jashtɛ Krujɛs pɛr tɛ zgjedhur viset qɛ duhej tɛ zaptonte pɛr tɛ ndihmuar sɛ jashtmi kryeqytetin e rrethuar. Ushteria e tij e tɛrɛ ishte prej 8,000, nga tɛ cilɛt dy mijɛ

---

mja frɛnge Jana e Arkɛs, e cila u-dóq nɛ Rouen njɛzét vjet mé parɛ, dhe me tɛ cilɛn ishte vellá nga shpirti, nga flaga patriotike dhe nga nxehtɛsia fetare. Ɛshtɛ fare e mundur qɛ éndɛra e tij tɛ ketɛ qɛnɛ imagjinare dhe njɛ *pia fraus*, po asnjé historián kritik, qɛ meritón keté emɛr, s' munt tɛ nɛnɛqeshɛ pɛr besimin qɛ Skenderbeu e kishte parɛ me tɛ vertetɛ keté ender. Tɛ gjithɛ historianɛt na thonɛ qɛ ishte fetár. Kjó, duket, ishte karakteristika e familjɛs sɛ tij; i áti u fal fshatra manastíreve; i vellάj lá principaten dhe shkoj e vdiq si murk nɛ manastír tɛ Malit Siná. Mɛ 1450, Skenderbeu u-neverít prej Papɛs, prej fuqive evropiane, prej shókɛve tɛ tij, me njɛ ushterí tɛ demoralizuar nga paniku, dhe s' i mbetej tjatɛr shprɛsɛ veç Perendisɛ. Nga ana e ketí i vjen Shen Gjergji, mprójtesi i Shqipɛrisɛ, dhe i thotɛ nɛ ɛnderr: "Merr-e keté shpatɛ dhe dermój-i armiqtɛ!" Sidó qɛ tɛ jetɛ, já njɛ shkenɛ qɛ meritón tɛ pavdekesohet nga dora e nonjé piktori prej race: Skenderbeu, i veshur me çelík, fle i qetɛ me shpaten nɛ duart e kryqɛsúara mi krahɛrór, i shigurtɛ qɛ Perɛndia s' munt t'a neveritɛ nɛ luften e shenjtɛ pɛr shpɛtimin e atdheut; Shen Gjergji kaluar i zgjat shpaten e ndríçime dhe i siell lajmɛrimin dhe bekimin e qiellit.

Digitized by Google

kembes dhe gjashte mije kalores, te gjithe te zgjedhur, qofte se nuke mundi te mbledhe mé teper, qofte se e qúajti te mjafte keté numur per pllanin per te ngacemuar ushterine rrethónjese. Ne Kruje lá nje garnizón prej 4,000, nene kumanden e Vrana Kontit, me ushqime te mjafta per tridhjete muaj, me 30 topa te vegjel nene drejtimin e disá artilerísteve frenq (1), dhe me dyfegje per nje pjese te madhe te garnizonit. Ne armet e zjarrit ishin te stervitur mé mire vullnetaret gjermane, italiane dhe dalmatiane, kur Shqiptaret perdornin édhe shigjetat. Femija, grate dhe pleqte uderguan ne qytetet e Venetise anes detit; burrat múare urdher t' i zbrazin fushat dhe te marrin malet a te futen ne keshtjellat. Pas keshilles se Vrana Kontit dhe Vlladán Givricit, Skenderbeu dha urdher qe te shkretohen te gjitha fushat (2) e Shqiperise Mesme qe te mos gjente armiku asnjé gje qe t' i hynte ne pune (3).

---

1).—Barleti (L. VI, f. 156) na thote qe Skenderbeu e pagúante cilindó artilerist frenk, si ne kohe páqeje dhe lufte, me nje roge prej pese dukatesh ne muaj.

2).—Taktike qe perdore Ruset kunder Napoleonit te Math, afró kater shekuj mé vone.

3).—"Appigliossi secondo la consueta sua franchezza, e confidenza al partito suggeritoli dal Conte Urana, e Uladenio Giurizza suoi intimi amici: e fu di disertare, e spogliare tutto il paese colla stessa forma che avea tenuto al tempo dell' invasioni d' Amurate,

Digitized by Google

Posá arriu kryerojtja e ushterisε turke perpara Krujεs nε krye tε Majit, 1450, Skenderbeu me ushterín' e tij tε vogel u-hoq nenε malin Tumenísht, kater mile lark kryeqytetit, dhe atjé vendosi kampin e tij.

Mε 14 tε Majit, arriu Sulltán Muradi me tε birin Mehmet me njε ushterí prej mé teper se 100,000 (1), me topa per tε rrahur keshtjellen dhe me metál per tε derdhur topa tε rendε. Ushteria, si nga numri, si nga artileria, nuk ish m' e vogel se ajó qε rrethój dhe mori Stambollin tre vjet mé vonε. Tεrε trupi i zgjedhur i Jeniçéreve ish atjé. Ishte ushteria m' e fortε dhe m' e tmerruar qε ish parε gjer m' até kohε. Perpara se tε niste goditja, u-ftua Vrana Konti qε t' a dorezonte fortesen me tε mirε. Ky refuzój me zemerím dhe shtoj qε qenat e ngordhur nukε shkojnε nε Krujε, si nε Sfetigrád.

Sulltani, me tε marrε keté pergjigje urdherój tε derdhen topat e rendε, posá arriu metali i revojshim. Kjo punε mbajti nja dy javε; dhe u-fabrikuan dhjetε topa prej kalibri tε tmerruar, qε

---

commandando ai villici di ritirarsi coi víveri bestiami, e ogní lor effetto dentro le Cittá, e Fortezze, senza lasciar alla campagna cosa che potesse servir di nutrimento al nimico." Briemmi, L, V, f. 356.

1).—Pas Laonikut (L, V, f. 350) Sulltán Muradi kishte mbledhur tεrε ushterín' e Evropεs dhe t' Asisε: "Amurathes convocans *Asiae Europaeque exercitus universos.*"

Digitized by Google

nukɛ pɛrdoren sot mé, katɛr prej tɛ cílave hithnin gjyle tɛ gurta prej 600 litrash, dhe tɛ tjerɛt prej 200. Kurrɛ gjer ahere, Turqit s' kishin pɛrdorur artilerí aqɛ tɛ shumɛ e aqɛ tɛ fortɛ kundɛr nonjé fortese. Veçanɛrísht, njɛ prej kɛtyre tópave, si na thotɛ Tivárasi, ishte aqɛ i tmerruar sa, kur hiqte, dridhej dheu disá mile rrotull. Ky me katɛr tɛ tjerɛ u-vendós kundréjt kryeportɛs sɛ forteses; tɛ tjerɛt kundrejt ledhíshtave nga ana e Tiranɛs (1). Kɛtó ishin tɛ vétɛmat anɛ tɛ qytetit,

---

1).—"Longuem id opus fuit, quindecim amplius dierum spacio, *decem* confertae dispari aliquantulum magnitudine, *quatuor* aequales, quae *sexcentarum amplius librarum* pondo saxa jaciebant, *reliquae ducentarum*, harum quatuor cum duabus majoribus locatae, qua moenia Tyrannam versus Orientem spectant." Barleti, L. VI, f. 161-162.

"Giammai i Turchi avean avuto per l' addietro in alcun attacco di Piazza tanta quantitá di cannoni di batteria, e d' una tale grossezza; uno de quali specialmente era si tremendo, che al suo · tiro tremava sempre la terra molte miglia all' intorno. La moltitudine concorrea a vedere l' effetto di quelli terribili, e non piú veduti istrumenti; e tutti stupianse in vedere con sí orribile tuono, ed empito incredibile volare per aria palle d' una grossezza, e pesso si enorme, (a quei tempi usavansi di pietra, non di ferro) e dove andavano a percoutere. in quel punto rompere, fracassare, ruínare, nanaltrimenti che saette cadute dal Cielo." Biemmi, L. IV. f. 239.

Digitized by Google

nga tє cilat ish e mundur tє béheshin sulma, se anєt e tjera ishin shkєmp i prerє si thikє.

Katєr ditє me radhe u-bombardua keshtjella gjer sa u-dermuan murret e saj dhe u-çá njє udhє pєr ushterinє rrethónjєse. Sulltán Muradi ahere urdherój njє sulmє tє pergjítheshme, dykє kujtuar qє e kishte fortesєn nє dorє. Po Vrana Konti me mprójtesit e forteses i prapsnє me humbje tє tmerrúara. Sulltán Muradi, passí u-perpóq mє kot t' a blente kumandarin trim me 200,000 aspra, urdherój sulma tє tjera, tє cilat múarє funt si e para. Kruja, e mprojtur prej shkembit nga tє tria anєt, mprohej lehtє nga pika qє goditéj, dhe asnjé forcє njerєzore nukє munt t' a thýente. Njє llagєm qє nisnє tє hapin Turqit nєnє muret u-perbýs e u-dermua me gjithє míhesit prej njє gjýleje turke.

Skєnderbeu passój até taktikє qє mbajti motin e kaluar nє Sfetigrád. Me 8,000 veteranєt e tij, nga mali i Tumenishtit, s' i jipte armikut asnjé çast qetєsie; kur aferohej, kur largohej; sot e goditte ushterinє nga njєra anє, nєsєr nga tjatra, gjithenjé atjé ku s' e pritnin Turqit fare; kur ditєn, kur natєn; kur vetєm, kur bashkє me tє rrethúarit, tє cíleve u bente shenja me zjarr nga maja e malit tє Kranjєs; pergjonte dhe perfshinte konvojat e ushqímeve; copetonte trupe ushteriake, qє i hiqte nє pusí, a qє dergóheshin qє t' a

Digitized by Google

ndiqnin; ndodhej kudó qe t' a deshte nevoja; vinte e fluturonte si rufé (1).

Sjellja e veneciáneve ne kohe te ketí rrethimi ishte aqe e túrpshime sa dhe e pabese. Tregetaret e Venetise gjetne rasje per te bere pará, dy-

---

1).—"Castra quotidie infestabat, nec illum sinebat aliquo momento quiscere, sed ita assidue adoriebatur, invadebat, infestabat, et instar torrentis, qui ex magnis, et inundantibus pluviis ex montibus descendeus, omnia secum rapit, prosternit, atque evertit; sic Scanderbeg quoque in Turcica, et hostilia castra alio semper, et alio irrumpens latere, ea undique vexabat, hosti caedem, cladem, damna, et jacturas maximas inferebat." Barleti, L. XII, f. 354.

Habens autem secum exercitum quem de sua regione conscripserat, iter per montes faciebat; uxores et liberos in loca munistissima deponens, ipse hinc inde cum exercitu vagabatur, ut defenderet regionem; *semperque presens erat, ubicunque ejus opera desiderabatur.*" Laonicus, L. VIII, f. 433; dhe L. VII, f. 335: "Cum regii quidam ascenderent montem, Scenderes eos aggressus est, *praeliabarturque, opera memorabilia edens.*" Ne L. VIII, f. 432 shton: *Quamvis eum debellare occepisset, vincere nequivit.*"

Levdatat e pahirta te Laonikut orthodóks e turkofíl jane te paçmúara: "*Ndodhej gjithenjé kudó qe e deshte puna; leftoj dhe beri trimerira per te mbajtur ment; ndonsé Sulltán Muradi u-perpóq shpesh, prape s' qé i zoti t'a thýente.*" Nje armík shtrengohet nga faktet te njohe trimerine dhe shpejtesine rrufesore te Skenderbeut.

Digitized by Google

ke provizionuar ushterinë turke dhe puna durohej sa kohë Turqit venin e blenin në qytetet veneciane anës detit. Po me qënë këtó ushqime binin përgjithërísht në duar të Skënderbeut, Turqit vunë si kondite që tregëtarët veneciane t' ua sillnin të ngrënat dhe provizionet në kamp të tyre përmés ushterive të Skënderbeut, se ndryshe do t' i dekllaronin luftë edhe Venetisë. Shqiptarët i parëlajmëruan tregëtarët, midís të cílëve ishin dhe disá Shkodranë, që venin veten e tyre në rezík dyke bërë një gjë të tillë, po këtá s' ua vunë veshin, dyke qënë shigúr që Skënderbeu do të mos kuxonte t' i ngiste nga frika se mos ndiste edhe me Republikën, e kështú vihej në mes dy zjarresh, si dy vjet mé parë. Dhe vertét, Skënderbeu dha urdhër që të líheshin të lirë, po Shqiptarët, të egërsuar, kudó që i gjenin këtá tregëtarë, ua konfiskonin plaçkat, dhe në një rasje vranë dy tregëtarë shkodranë, të qúajtur Thomá Begani dhe Nikóll Gradilaska. Kjo ment shkaketój një luftë të dytë me Venetinë, po punën e ndreqi guvernori venecián i Dúrësit, që ishte mik i fortë i Skënderbeut, që i ndihu me sa i ardhi dorësh dhe që s' la kurrë tregëtarë të shpien të ngrëna në

Gjith ashtú Laoniku (L. VII, f. 335) levdón trimërín' e dëshpëruar të garnizonit të Krujës: "Nec tamen (Turcae) superare potuerunt oppidanos, qui praeter spem fortissime pagnabant."

Digitized by Google

kampin turk (1).

Asnjé nga sulmat e ushtrisë turke nukë vajti mbarë; në një nga mé të tmerrúarat, që u-bé më 25 të Qershorit, Sulltán Muradi humbi 8,000 të vrarë. Nga koha në kohë bënin sulma edhe të rrethúarit. Barleti levdón prapë vullnetarët gjermanë të cilët, të përzier me Shqiptarët, bënë një dalje nga kështjella, e shtynë armikun me humbje të medhá, dhe e shijuan aqë shumë këté operatë sa s' u rrihej mé brenda në kështjellë dhe kërkonin me lutje të dalin jashtë nga herë (2). Kjo gjakderdhje e tmerruar mbajti mé tepër se pesë muaj pa nonjé shpresë fitimi. Sulltán Muradi uperpóq prapë t' a fitonte Varna Kontin me pará, pastáj hapi negociata me Skënderbenë që t' a njohë si mbret të Shqipërisë me një haráç të vogël dhe, kur pa që ishin më kot që të gjitha, dhe që kishin nisur shirat e Vjeshtës, e ngriti më 26 të Tetorit rrethimin e Krujës ku la permí 20,000 të vrarë; humbi disá míjera të tjera, nga që Skënderbeu e ndoqi këmba këmbës gjer pertéj kufireve

1).—Shih Biemmi, L. IV, f. 255-260.

2).—"Germani hi omnes, Epirotis mixti fuere, qui vix exorata a praefecto exeundi faclutate, cum singulis tantis scloppis processere non longe a moenibus, aeditaque satis magna caede, ut pro numero pagnantium extemplo recepere se in urbem, rursus infestiores erupturi, sed nullis precibus, ut id rursus facerent, obtinere potuerunt ab Uranaconte." Barleti, L. VI, f. 168.

Digitized by Google

dhe Shqiptaret i kishin zenë pusinë kudó; dhe me germadhet e ushterisë tij shkoj i turperuar dhe i vrarë në Ederné, ku i ra pika dhe vdiq në Jenár, 1451, në versë 49 vjetsh (1).

Në krye të Nëntorit, 1450, Skënderbeu u-kthye me triúmf në fortesën e Krujës. Garnizoni dhe pópulli i tërë dúallë t' a presin dhe me-zí besonin syt' e tyre kur shikonin që Turqit kishin ikur. Kur arriu, tërë keshtjella oshetiu nga gjëmimi i tópave, i trumbétave, i kembánave dhe nga brohoria e pópullit. Skënderbeu e puthi në ballë Vrana Kontin, trimin kumandár të Krujës, dhe pastáj pershendoshi me radhë oficerët dhe ushtarët e garnizonit. I levdój per trimerín' e tyre, u dekllarój që u detyronte shpetimin e kryeqytetit

---

1).—Barleti (L. VI, f. 189) na thotë që vdiq nenë muret e Krujës dhe shton që trupi i tij u-ballsamós e u-shpu per varrím në Brusë. Këtë legjendë e kopión nga Barleti dhe Spandoni (shih Sansovino, Historia Universale, f. 195, Venetí 1564) me ndryshimin që e dergón kufomen e Sulltán Muradit në Ederné: "Il qual ritrovandosi all' assedio ammaló, e morto ch' egli fu il corpo suo fú condotto in Adrianopoli; la dove fu seppelito dal suo figliuolo honoratamente." Të gjithë historianët e tjerë thonë që vdiq në Ederné tre muaj passí ngriti rrethimin e Krujës. Fakti që Turqit, në kohë shpeditash, e fshihnin vdekjen e Sulltáneve per të mos trembur ushterinë i beri shumë të besojnë që kjó gjë ngjau dhe me vdekjen e Sulltán Muradit, e cila gjoja u-fsheh në Krujë dhe u-çfáq në Ederné.

Digitized by Google

e tɛ mbretɛrisɛ, dhe i ngarkój me dhurata si pas shkalles dhe shɛrbimit tɛ tyre. Vrana Kontin e bɛri Dukɛ tɛ Matit, i fali njɛ vent tɛ gjerɛ tɛ qúajtur Fullgaria, i dhurój pará, roba tɛ púrpɛrta, tɛ éndura me ar, dhe armɛ tɛ ralla, tɛ punúara me mjeshtɛrí; pas Vrana Kontit, múarɛ dhurata tɛ veçanta katɛr oficerɛ shqiptarɛ, dy Frenq dhe njɛ Gjermán, tɛ cilet treguan trimerí tɛ madhe nɛ mprojtjen e fortesɛs (1). Disá ditɛ me radhɛ Kruja festój çlirimin e saj me dárkɛra, valle, tostongale, dhe turresa. Lodra theatrale pɛrjetɛsonin vijtoren dhe lartɛsonin ndjenjɛn kombɛtare si qɛmoti nɛ Athinɛ e nɛ Olimpí pas lúfteve persiane (2).

---

1).—"Al Conte Urana con tutta la sua discendenza fu data l' investitura di un largo tratto di paese chiamato Fulgaria. Quanto alla guarnigione, quei che la componeano ricevettero dei considerabili doni, in cui specialmento furone distinti *un Alemano, due Francesi, e quattro Albanesi.*" Biemmi, L .IV, f. 281.

"Postremoque non expectatis fascibus decoratus est, ac totius *Dux Aemathiae disignatus.*" Barleti, L. VII, f. 190.

2).—"Castriotus instructis ludis omnis generis, ea pulchritudine spectaculi famam ipsam victoriae mirum in modum auxit, alter jam exercitus sub Croja videbatur, tanta undique multitudo confluxerat, non spectatorum tantum, sed lectissimae juventutis ad proposita sibi praemia expetenda, non videbatur usque adeo mirabile hominibus fractas ab Albanis fuisse vires A-

Digitized by Google

Lajma e rrethimit te papémeshme te Krujes dhe e ritirates se ushterise turke nene kumanden e Sulltán Muradi II u-perháp si vetetime ne tere Evropen. Múndesi i Varnes dhe i Kosoves me Jeniçeret e tmerruar iku perpara Skenderbeut. Krishterimi nisi prape te marre fryme e te shpresonje. Emri i Skenderbeut ishte ne gojen e tere botes evropjane. Qe te gjithe me nje ze e qúanin si gjeneralin mé te math te shékullit. Papa Nikolla V, Mbreti i Hungarise dhe Duka i Burgonjes i derguan ambasadore qe t' a pergezonin, me ndihma te medhá financiale per te ndrequr demet qe kish pesuar ne keté lufte te gjate. Mbreti Alfóns i Nápolit i kaperxeu te gjithe ne dorehapesí. Jo vetem mori persiper te lante borxhin qe u kishte Skenderbeu tregetáreve Raguzane dhe Napolitane, po i dergój edhe disá míjera dukatesh si dhurate, 300,000 shinike grure, 300,000 shinike theker, edhe disá mjeshter dhe ingjinere per te ndrequr muret dhe fortifikatat e príshura te Krujes pa nonjé pagese nga ana e Skenderbeut. Gjithashtú Arianiti, qe kishte refuzuar ndihmen ne kohe te rezikut, i dergój tre zoterimj te hoborit tij

---

murathis, intuentibus eam militarem aetatem, et virorum robur circa Scanderbegum aspicientibus. Redierat vere tunc vetusta nobilitas Macedoniae, et secula illa Alexandri, Pyrrhique jam obsoleta, in integrum restituta videbantur." Barleti, L. VII, f. 191.

Digitized by Google

me një dhuratë prej 10,000 dukatesh, të cilët, pasí e përgëzuan i hapnë prapë fjalë për marrtesën dyke blatuar një paje mé të madhe se mé parë.

Kruja u-bé haxhilleku i tërë Krishterimit. Me qíndera të huaj nga anët mé të larkme të Evropës vinin për të vizituar fortesën e lavderuar dhe për të parë me sy Mbretin e Shqipërisë dhe luanët e tij. Me qíndera vullnetarë vinin të hynin në shërbím të tij.

Skënderbeu taní qëndronte në kulmin e fames, madhërisë dhe fatmirësisë; Shqipëria ndodhej në një ngazëllím dhe lumerí qiellore—ngushëllím dhe çpagím për vojtjet, që hoqi përpara e kishte për të hequr pas kësáj periude të shkëlqyer.

Me ikjen e Sulltán Muradit nga Kruja, si thotë Fallmerayer-i, u-mbarua akti i parë i tragjedisë së madhe shqiptare (1).

---

1).—Fallmerayer, vëll. 9, f. 53.

Digitized by Google

KAPTINC III

SKCNDERBEU KUNDCR SULLTAN MEHMEDIT II.

Hipja e Sulltán Mehmedit II nc fron, 5 Shkurt, 1451.—Marrtesa e Skenderbeut, 26 Prill, 1451.—Ndertimi i kcshtjellcs sc Modrises, 1451.—Kompllót kunder Skenderbeut, 1452.—Beteja e Modrises kunder Hamza Pashes dhe e Meçadit kunder Talíp Pashes, 21 Korrík 1452.—Pajtimi i Skenderbeut me Lek Dukagjinin, 25 Shtatór, 1452.—Beteja e Pollagut kunder Ibrahím Beut, 22 Prill, 1453.—Renia e Stambollit, 29 Maj, 1453.—Rrethimi i Beratit, 13-25 Qershór, 1455.—Tradhesia e Moisiut dhe dishfata e tij nc Dibrc, 20 Maj, 1456.—Shitja e kcshtjelles sc Modrises prej Gjerq Stres Balshes, 18 Tetór, 1456.—Lindja e Gjon II Kastriotit, 1456.—Tradhesia e Hamzc Kastriotit dhe beteja e Albulenes kunder Isa-Daút Pashes, 2 Shtatór, 1457.—Vdekja e Alfonsit tc Nápolit, 27 Korrík, 1458, dhe e Vrana Kontit pak mé pastáj.—Ikja e dytc dhe vdekja e Hamzc Kastriotit nc Stambóll, 1458.—Beteja e Mokrenes kunder Sinán Pashes dhe Hasán Beut, 27 Gusht, 1459.—Beteja e Shkupit kunder Jusúf Beut, Shtatór, 1459.—Beteja e Livadit kunder Karaxhá Beut, 1460.—Pajtimi i dytc i Skender-

Digitized by Google

beut me Dukagjinet, 1460.—Paqe me Sulltán Mehmedin II, 27 Prill, 1461.

Kemben e Sulltán Muradit II, i cili ishte pak a shume njerezór, e zuri Mehmedi II, Sulltani m' i pabese, m' i tmerruar, mé shpir-lík, mé gjakpires dhe mé dinák qe ka nxiere Turqia. Me hyrjen e tij ne shkene, lufta ne mes te Shqiperise dhe te Turqise mori nje karaktér mé te rrepte dhe mé te terbuar, per jete dhe per vdekje. Midís Skenderbeut dhe Sulltán Muradit nje pajtím ishte i mundur. Po s' kishte asnjé shprese per nje pajtím me Sulltán Mehmedin II, i cili enderonte te zaptonte Stambollin, nga njera ane, dhe nga tjatra Romen, sa kohe udhen e kesáj ia mbyllte Skenderbeu. Njeri nga te dy duhej te thyhej.

Qe te dy pra pregatíteshin per matjen titanike, dhe t' armatisur, prisnin rasjen qe t' i hídheshin njerjatrit per gryke. Sulltán Mehmedi, qe t' i vere ne gjume viktimat e tij, perseriti me fqinjet traktetet e paqes qe kish bere i atí. Skenderbeut, te cilin e urrente mé teper se te gjithe, i proponój nje armepushím, po ky i u pergjéq qe munt te hapte negociata vetem kur t' i dorezóheshin fortesat e Beratit e te Sfetigradit. Dyke mos marre pergjígjie nga Sulltani, e leshój ushterine per te plaçkitur viset turke. Sultán Mehmedi, i terbuar nga zemerimi desheronte te hidhej me nje here kunder tij, po ngaterime te ra me Princin e Karamanise nuk e

Digitized by Google

lanɛ t' a vɛrɛ pllanin e tij nɛ vɛpɛrím dhe moti 1451 shkoj nɛ qɛtesí.

Shqiptarɛt ishin tɛ bindur qɛ do tɛ mos ngíteshin prej Turqve disá vjet dhe kɛshtú nisnɛ prapɛ lutjet e krérɛvɛ qɛ tɛ marrtohej Skɛnderbeu pɛr tɛ lɛnɛ njɛ trashɛgimtár tɛ fronit. Arianiti i kujtój pɛrsɛrí zotimin, dhe Skɛnderbeu s' kishte qýsh tɛ shpɛtonte kɛté hɛrɛ. Marrtesa ishte e nevójshime, se me kɛté shigurohej alianca me Princin mé tɛ fortɛ tɛ Toskɛrisɛ, ndihma ushtɛriake dhe financiale e tɛ cilit ish e domosdoshme pɛr pasimin e luftes, pa marrɛ nɛ sy pajɛn e madhe qɛ blatonte kɛté hɛrɛ Arianiti, qɛ kishte rɛndesí edhe ajó nɛ shtrɛngicɛn e kohɛs. Dɛrgój, pra, tɛ kunatin Muzakɛ Thopía (1) nɛ Kaninɛ qɛ tɛ merrej vesh me Arianitin pɛr hollɛsít' e marrtesɛs.

---

1).—Biemmi, (L. IV, f. 284) dhe Barleti (L.VII, f. 195) na thonɛ qɛ Muzakɛ Thopia u-dɛrgua nga ana e Skɛnderbeut pɛr negociatat e marrtesɛs. Gjon Muzaka (Hopf, 275) na thotɛ qɛ, nga ana e Arianitit, u-dɛrgua i ati Gjin Muzaka, i vɛlláj i sɛ shoqes sɛ Arianitit Maria Muzaka: "Et il detto Scanderbegh adomandó per moglie la figlia del Signor Arayniti Comnino, lo quale Signor lo mandó a consultar con lo Signor Ginno mio padre, che il detto Signor Arayniti era cognato a mio padre, perché hebbe per moglie la Signora Maria Mosachi sorella de mio padre." Marrtesa e Arianitit me njɛ princeshɛ nga dera e Myzeqesɛ munt tɛ shpjegonjɛ gjer mɛ njɛ pikɛ pɛrsé Arianiti kish tɛ drejta nɛ Kaninɛ.

Digitized by Google

Dasma u-bé me 26 te Prillit, 1451, kur Skenderbeu ish 39 vjetsh dhe nusja Marina Andronika 23 (1). Príncerit aliate dhe kreret fqinje osé ardhe vete, osé derguan bajloze per te pergezuar te martúarit e rinj me dhurata te pásura. Nuke múare pjese ne keté gezim Princet e Dukagjinit, te cilet qene ftohur prape (2), dhe te

---

1).—Biemmi (L. IV, f. 285) e quan *Marina;* Barleti (L. VII, f. 195) *Donica;* Muzaka (Hopf, 275, 284) *Andronica. Donica dhe Andronica* jane nje emer, po *Marina* ndryshón. Nofta kish dy emra dhe quhej Marina Andronika. Ish e para bije e Gjerq Arianit Komnén Golém Thopise dhe e princeshes Maria Muzaka. Arianiti (Arajniti, osé Araniti) i Kanines kish tre bij dhe nente bija; nje nga te bijat, Voisava, u-marrtua me Gjon Çernoviçin e Malit te Zí, dhe i bir' i saj, i kthyer muhamedán dhe i emeruar *Skenderbé* Çernoviç, zaptój Malin e Zí me ndihmen e Sulltanit; nje tjater e bija, Helena, u-marrtua me Gjerq Dukagjinin, dhe bijt' e saj te gjithe u-kthyen muhamedane, nje prej te cíleve quhej *Skenderbé* Dukagjini. Shih Hopf, f. 284-285, dhe 535. Pas Barletit, Marina Andronika ishte shum' e híeshme: *"Non indigna eo parte puella, forma elegantissima."* Pas Anonimit *"bellissima."*

2).—Shkakun e kesáj ftohtesie s' na e thote Tivárasi, te cilit i detyrojme disá hollesira te shemtúara qe hedhin drite mi historín' e Skenderbeut, dhe Barleti as e perménd keté ftohtesí, se e quan per detyre patriotike t' i fshehe te gjitha gjerat e papelqýera. Dyké ditur qe Dukagjinet u-pajtuan me Skenderbene pas betejes se Drinit dhe ishin pothua te vétemit qe e ndihmuan ca muaj mé pare ne kohen kritike te rrethimit te

Digitized by Google

vellézerit e nuses, te cilet qene zemeruar qe i ati i dha motres se tyre nje paje teper te madhe (1).

Si u-mbarua dasma, Skenderbeu shetiti tere mbreterine me te shoqen, me qene qe populli deshte te shikonte kryezonjen e Shqiperise. ngadó qe shkuan, qytetet dhe keshtjellat i pritne me gezím, dhe njerezia hanin seder me njerjatrin kush e kush t' u jipte dhurata mé te mira. Te gjithe hoboret e Evropes i derguan urime. Republika e Venetise dhe Mbreti Alfóns i Nápolit i çuan kenaqesí te výera. Skenderbeu ua çperbleu, dyke u çuar arme, kuaj, flámure, sklleve (2) dhe plaçka te ndryshme te fitúara nga Turqit.

Krujes, munt t'a marrim me ment qe s' u pelqeu kjó marrtese, nofta nga shkaku qe kishin édhe atá ne dere te tyre nje nuse per té. Mos u kish dhene shprese Skenderbeu per nje gje te tille ne kohe te rezikut? Nuk dihet. E verteta eshte qe ftohtesia u-bé armiqesí e rrepte dhe ment krisi lufta civile pak kohe mé vone.

1).—Per pajen Biemmi (L. IV f. 299) thote qe ishte me te vertete shum' e madhe. Barleti (L. VII, f. 196): "Dos ad arbitrium soceri relata, et eo statuente accepta, digna quam et il darét, et hic acceperet."

2).—Sulltanet s' kujdeseshin t' i çperblenin róberit e luftes, veç po t' ishin oficere te larte me vlere. Te tjeret ia falnin Skenderbeut, dhe ky i dergonte si dhurate neper hoborret e fuqive mike t' Evropes. Barleti (L. IX, f. 275) na thote: "Caeteri quoque soluti vinculis, quidam novos, et christianos homines induentes,

Digitized by Google

Si mbarój udhetimin me nusen, Skenderbeu pasój pregatitjet për të pritur furtunen e ushterive të Sulltán Mehmedit. Ndreqi fortifikatat e Krujes, rindertój ledhishtat që ishin prishur, me një menyrë që të muntnin të qendronin kunder tópave të ra. Pastáj zbriti në Dibrë të Poëhtme, ngaha hynin ushteritë turke përgjitherísht. Për të mbyllur deren, e cila ish hapur me humbjen e Sfetigradit, ndertój fortesen e Modrises në një majë të malit Shar, që zoteronte fushen e Maqedonisë. Në fortesen e re Skenderbeu la një garnizón prej 400 ushtaresh me disá topa nenë kumanden e Gjerq Stres Balshes. Detyra e tij ish të permiqyrte levizjet e ushterisë armike në kufi dhe të lajmeronte me top aferimin e tyre.

Kur u-kthye në Krujë, gjeti Barthollomé Eperanin dhe Dimiter Basilikun, të cilet kishin vajtur të falenderonin Papen për ndihmat që i dergój Skenderbeut pas ikjes së Sulltán Muradit, dhe ishin kthyer nga Roma me një sumë të re ndihmash, me zotime për mé shumë në të pritmen, dhe me bekime apostolike.

Turqit nukë dúkeshin gjekúnt dhe Skenderbeut nuk i rrihej pa punë. Mblodhi pra keshi-

---

domicilium fixere in Epiro. Caeteri ad varios, et omnes fere passim Christianorum reges destinati, tum Hispaniae, tum regi Gallorum praeter captivorum sat magnum numerum, equi et spolia omnis generis missa, atque ad alios identidem alia."

Digitized by Google

llen dhe proponój qe te perfitonin nga lufta e Karamanise, ku i kishte duart te zena Sulltán Mehmedi, t' i binin Sfetigradit e Beratit, e t' a shpinin luften ne toke t' armikut ne vent qe t' a prisnin gjithenjé ne toke te tyre, posá ushteria shqiptare ish m' e forte se mé pare, posá kishte qíndera vullnetare te huaj, dhe posá, per heren e pare, arka e Shqiperise ishte plot me ar e argjént te Papes, te Alfonsit e te príncerve te tjere evropjane. Shqiptaret, te djegur nga rrethimi i palumur i Sfetigradit, s' deshnin mé te degjonin per rrethime dhe s' kishin aspák deshire per shpedita sistematike ne toke te huaj veç per te plaçkitur. Nga ana tjater, kujtonin qe Sulltani do t' i linte te qete, po te rrinin urte e te mos i binin me qafe, kur kish andralla te tjera, dhe plaçkitjet e régullshme te víseve turke i qúanin gjera fare te urta, per te cilat Sulltani s' kishte persé te zemerohej. Kishin urrejtjen e fushátave te jashtme, si e pame ne rasjen e betejes se Varnes, dhe s' merrnin vesh qe menyra m' e mire per te mprojtur veten e tyre ish ofensiva dhe e vena e armikut ne mes dy zjarresh. M' i miri, m' i sqúari, m' i zoti gjenerál i tij Vrana Konti ishte kunder dhe çdo bisedim qé me kot. Skenderbeu ish i denuar te rrinte duar-kryq e te priste radhen e tij gjer sa te mbaronte Sulltán Mehmedi punet qe kishte gjetke, e t' i vinte me ngé, me duar te çlirúara, dhe me ushterí te çlodhur.

Digitized by Google

Per tє mos humbur kohєn, Skєnderbeu, i shtrєnguar tє mbetet nє defensivє, nisi tє ndertonjє njє tjatєr fortesє nє kap tє Rodonit, atjé ku derdhet Drini nє det, qє tє kishte ku tє hiqej nє kohєn e shkéljeve turke. Vente pothua ditє pєr ditє pєr tє shikuar mjéshtєrit qє po ngrenin muret dhe fortifikatat. Njє ditє, kur dilte nga porta e Krujєs, njє njєri i panjohur i u-afrua dhe e kєshillój tє ruhet, sє nє pyllin e Krabєs, ngaha shkonte, i kishin vєnє pusinє qє t' a vrisnin. Me njє herє dєrgój kapedán Balshєn e gardєs mbretєrore me njє koshadhє, i cili i ra an' e mb' anє pyllit dhe gjeti tetє veta t' armatisur brenda nє njє shpellє; u-perpóq me sa i ardhi doresh qє t' i shtinte nє dorє tє gjallє, po me qє u-kundershtuan dhe u-pєrpoqnє tє çajnє udhen e tє ikin, vrau pesє dhe vetєm tre prej syresh i zuri robєr. Ketá i solli nє Krujє, dhe si u-vunє nє tortyrє, rrєfyen qє ishin Turq, tє dєrguar pastafát prej Sulltanit vetє pєr tє vrarє Skєnderbenє; n' até pyll kishin vajtur tє udhєhequr prej dy Shqiptaresh, tє cilєt u-vranє bashkє me tre shokєt e tyre; ketá udhheqєs ua kishin dhenє Turqve ca princєr shqiptarє, po emrat e tyre s' ua dinin se s' ua kishin çfaqur shokєt. Ketó ishin tє vétєmat çkoqitje qє muntnє t' u çkєputnin Turqve para se tє japin shpirt nє mes tє torménteve.

Armiqєsia e Dukagjíneve, e cila ndizej mé keq dita me diten kundєr Skєnderbeut, dhe fama

Digitized by Google

e ligë e Lek Dukagjinit, i cili gjykohej prej të gjí-thëve si fare i zoti për të këtija vrasje të pabesa, ishin shkaku që këtá u-qúajtin prej të gjíthëve si auktorët e këtí kompllóti të dështuar; që të mbé-teshin të larë, súallë për këté punë dhe disá Turq, në marrëveshje me Sulltanin, që t' i bjerë këtí ba-rra e kësáj paburrërie. Skënderbeu, i ndezur prej një zëmërimi aqë të math sa ish reziku nga i cili shpëtój për qime, mblodhi me vrap ushtërinë që t' u bjerë Dukagjínëve dhe t' i bënjë t' a pagu-ajnë shtrënjtë poshtërsín' e tyre. Kryepeshkopi i Tivarit, Peshkopi i Drishtit dhe i vjehri Arianiti përpíqeshin më kot t' a qetësonin e të ndalonin luftën civile, kur si më porosí gjemój topi i Mod-risës, dyke lajmëruar që dy ushtërira turke të for-ta po i afróheshin kufirit. Skënderbeu rendi si vetëtimë në kufí dhe kështú hesapi i kompllotit mbeti që të zgjidhet mé vonë (1).

---

1) Për këté kompllót shih Biemmin, L. IV, f. 289-290 dhe 298-299. Barleti as e përmént fare. Për-kúndrazi na thotë që Skënderbeu, kur e thirri topi i Modrisës në kufi, po shijonte një prehje të ëmbël me mbrëtëreshën në kështjellën e bukur të Petralbës. Dhe me këté rasje na përshkruan bukurítë idilike të kësáj kështjelle, ngritur majë malit, si folé shqipo-nje, rrëzë lumit të Matit, me brigje të veshur rrotull, dhe tatëpjetë fusha të mbulúara me pemë, dhe bilbilat që këndonin kënge dasmore. I mjeri Skënderbé! Kú e linin zuzarët, prej të cíleve rrëthohej dhe për të cilët vritej, të shikonte një dítë të bardhë!.

Digitized by Google

Pllani i kumandarit turk, Talíp Pashes, (1), ishte t' a vinte Skenderbene ne mes dy zjarresh. Dergój, pra, Hamze Pashen me nje ushtetrí prej 10,000 perpara dhe aý vete me 15,000 te tjere ardhi nga nje tjater udhe. Skenderbeu, i lajmeruar me kohe, me nje ushterí prej 14,000 goditi Hamza Pashen afer Modrises me 21 Korrík, 1452, e mundi ne pak ore, dyke patur ushterí mé te madhe, e zuri rop Hamza Pashen yete me tere shtabin e tij, dhe dy ore pastáj bariti kunder Talíp Pashes, te cilin e shtrengój te japé beteje ne fushe te Meçadit, dyke i marre krahet aý vete me garden mbreterore, kur ushteria tjater nene Moisine po e godite per balle. Para se te ndizej beteja, Shqiptaret u treguan Turqve Hamza Pashen me oficeret rober te lidhur dhe flámuret turke qe kishin fituar afer Modrises. Turqit, ndonesé te deshperuar nga kjo pamje, leftuan trimerísht, dhe fati i betejes mbeti ne ballance disá kohe, gjer sa Moisiu dyke e njohur Talíp Pashen nga uniforma dhe kumandat qe jipte me te djatht' e me te mengjer, u-sul kunder tij, çau udhen midís Turqve, dhe me nje te goditur te shpates e shtriu perdhé te vrare. Pas kesáj, ushteria turke, e mbetur pa kumandár, u-çkaterua dhe mori arratine, po Shqiptaret, te lodhur nga te dy betejat,

1).—Biemmi e quan *Tilufo*, emer i panjohur ne turqishten. Barleti perménd vetem Hamza Pashen.

Digitized by Google

s' kishin forcë t' a ndiqnin e t' a shúanin fare. U-vranë këtë ditë në të dyja betejat afró 7,000 Turq, veç róberve dhe të plagósurve. Mbetnë në duar të múndësve të dy kampet me plaçkat e tyre, míjëra kuaj dhe pothua të gjithë flámuret e ushtërisë turke. Shqiptarët patnë, veç të plagósurve, afró një mijë të vrarë, midís të cíleve Andrea Erizi, një oficer trim dhe i zoti. Si çperblim të Hamza Pashës dhe të oficéreve robër Skënderbeu mori 13,000 dukate nga Sulltani.

Këtó dy vijtore, me roberimin e një kumandari dhe vrasjen e kryekumandarit, e gëzuan pópullin shqiptár dhe e shigurúan që fati i luftës e favoronte Skënderbenë aqë kundër Sulltán Mehmedit II sa dhe kundër Sulltán Muradit II. Skënderbeu vetë, pas këtyre vijtórëve u-bë një njëri fare i ndryshmë. U-rrethua me madhështitë dhe shkëlqimet e një mbreti. Që këtú e tutje, Barleti oficerët e shtabit të tij i quan *Purpuratë*, domethënë zyrtarë të veshur me purpër.

Gëzimi u-shtua ca më teper me pajtimin e Dukagjíneve. Skënderbeu, i qetësuar nga triumfi i parë kundër ushtërive të Sulltán Mehmedit II, u-bínt që t' a ndreqë punën me të mirë, dhe veçanërísht posá Dukagjinët ishin gatí të provonin që s' kishin gjísht në kompllotin e Krabës. Papa Nikóll V, i cili dëshëronte me çfardó mënyrë të ndalonte luftën civile në Shqipërí, me një letër të shkruar më 22 Gusht, 1452, e ngarkój Pal En-

Digitized by Google

gjellin, peshkopin e Drishtit, prellát me influencë të madhe, i cili pastáj u-bé kardinál-kryepeshkóp i Dúresit, legát apostolík i Papës në Shqipërí, dhe, në mos me emër, po në fakt minister i púnëve të jashtme i Skenderbeut, të hynjë në mes dhe t' i pajtonjë të dy kreret Shqiptarë (1). Më 25 të Shtatorit, 1452, Skenderbeu shkoj në Durës dhe atjé përpara kryepeshkopit të Tivarit, Peshkopit të Drishtit, Arianitit, dhe kumandarit venecián të Dúresit, Princet Dukagjinë dhanë shpjegime; Skenderbeu dekllarój që i gjente të kenáqeshme; disá mosmarrëveshje të vjetra u-regulluan dhe u-përsërít miqësia e vjetër. Si dualle Dukagjinët të larë, dyshimet për kompllotin u-drejtuan mi të bijt' e Arianitit, të cilët qenë zëmëruar për pajen e pazakónëshme të motres së tyre dhe e kallëzonin Skenderbenë që ua plaçkiti principatën (2). Ngjarjet e pastajme e ndryshuan këté mejtím dhe faji u ra me radhë Moisiut të Dibrës, Gjerq Stres Balshës, dhe Hamzë Kastriotit, të cilët, sikundër do të shohim mé vonë, dúallë tradhëtorë dhe rebelë, njëri pas tjatrit. Po puna mbeti në t' errët, dhe bota kurrë nukë mundi të mësonte me shigurí cilët qenë atá princër shqiptarë që kurdisnë

1).—Për letrën e Papës shih Pinaldi, Aunales Ecclesiastici, mot 1452, dhe Biemmi, L. IV, f. 298.

2).—Të bijt' e Arianitit të Kanines qúheshin Thoma, Kostandín dhe Arianít. I treti u-kthye muhamedán më 1461. Shih Hopf, f. 535.

Digitized by Google

pusinɛ nɛ pyll tɛ Krabɛs; as u-muar vesh cili qé njeriu qɛ e lajmerój Skɛnderbenɛ dhe i shpetój jeten; as ngaha kish ardhur; as kúsh e dergój; as qysh e zbulój kompllotin. Disá thoshin qɛ ishte gjahtár dhe nga njɛ shtek, ku ishte fshehur per tɛ vrarɛ njɛ derr tɛ egɛr, kishte marrɛ vesh pllanin e kompllotísteve, kur bisedonin midís tyre tɛ çkujdesur. Pas disá vjetsh dolli fjala qɛ Skɛnderbeu i zbulój mé nɛ funt fajtorɛt, po qɛ nuk i çfaqte dot per disá arɛsye rendɛsore, dhe dyshimet u-kthyen prapɛ mi tɛ bijt' e Arianitit.

Ibrahím Beu (1), njɛ shok i vjeter i Skɛnderbeut, me njɛ ushterí prej 14,000 u-dergua prej Sulltán Mehmedit qɛ tɛ hynte nɛ Shqiperí nga ana e Kosovɛs e t' u mɛrrte gjakun Talipit dhe Hamɛzɛs. Skɛnderbeu priste nɛ kufí se kish mɛsuar qɛ Turqit gatitnin njɛ ushterí tɛ madhe, e cila nukɛ dihej per kú do tɛ nisej. Si u-dúk mé vonɛ, ushteria e madhe u-drejtua kunder Stambollit. Me tɛ mɛsuar kɛté lajme, Skɛnderbeu, pa humbur kohɛ, kaperxeu kufirin, e goditi pa pritur ushterinɛ turke nɛ fushɛ tɛ Pollogut, afer Shkupit, ku ishte kampuar, mɛ 22 tɛ Prillit, 1453, dhe e çkaterój, passí vrau me doren e tij

1.—Barleti e quan *Debreas* dhe Biemmi *Debrea*, emer krejt i panjohur nɛ Turqishten. Anonimi e quan Debreambeg, qɛ ɛshtɛ padyshím Ibrahím Bé (k. XVI., f. 18v., Venetí 1545).

Digitized by Google

kumandarin e saj, dyke zbatuar régullen e tij te dashur: "Kur pritet koka, trupi bie prej vetiu." Afró 3,000 te vrare mbuluan fushen. Shqiptaret, te ngarkuar me plaçka, u-kthyen ne Dibre.

Nje muaj pastáj, me 29 Maj, 1453, ra Stambolli, dhe Sulltán Mehmedi II, i fryre nga suksés i math, u dekllarój lufte te gjithe fqinjve te tij. Kur po leftonte ne Serbí, ne Moré, ne Det te Bardhe, kunder Grékeve, Shqehve dhe Fránkeve, Skenderbeu mblodhi keshillen dhe u-perpóq t' a binde qe ishte koha te perfitonin keté rasje per te rizaptuar Sfetigradin dhe Beratin. Keshilla ishte kunder nga shkaku qe ushteria shqiptare s' kishte topa te rende per te rrahur fortesat. Pas shume bisedimesh u-vendós qe t' i kerkojne ca topa Mbretit te Nápolit dhe u-derguan per keté qellím si ambasadore Pal Kuka, Nikóll Erizi dhe Gjon Perllati. Ne leter qe i çoj Alfonsit, Skenderbeu i thoshte: "Ushtaret e mi, ô mbret fort katholík, dine te leftojne kunder búrrave, po jo kunder múreve."

Alfonsi i dergój 5 topa te medhénj e 13 te vegjel me artileriste, nje ushterí prej 1,500 me dyfegje, dhe nje sume te madhe te hollash. Shtabi vendosi t' i bjere Beratit, me qene qe kjo keshtjelle s' ish e fortifikuar aqe mire sa Sfetigradi. Ishte shprese te fitohej pa derdhur nje pike gjak, nga shkaku qe tere bota besonin qe Skenderbeu do t' i binte Sfetigradit, dhe garnizoni i Beratit

Digitized by Google

nuk ish aspák i gatitur per furtunen qe i turej. Puna do te kish vajtur mbare, po nje tradhetór shqiptár ua lajmerój Turqve pllanet e Skenderbeut dhe kur arriu ushteria shqiptare perpara Beratit, Turqit ishin gatí se gjithash. Tradhetori ishte Moisiu, m' i zoti gjenerál i Skenderbeut.

Moisiu ish nga shtepia e Komnén Thopíave, i nip' i Arianitit te Kanines dhe i Vlladán Arianitit te Çermenikes, te kunatit te Skenderbeut, i bir' i te cilit u-miemerua Muzaka i Angjelines qe te çquhej nga Muzaket e panúmerte. Ish i marrtuar me princeshen Zanfina Muzaka, te motren e Gjon Muzakes, e cila u-divorcua prej Muzake Thopise. Nga trimeria, zotesia dhe vlera e tij nderohej prej Shqiptáreve aqe sa dhe Skenderbeu vete, i cili e kaperxente vetem ne emer. Skenderbeu ia çperbleu sherbimet, dyke i falur te dy Dibrat, te cilat i qeveriste si princ, dhe keshtú umiemerua *Moisiu i Dibres*. Po lavdia, qe fitój ne betejat e ndryshme, e beri aqe kryelarte sa s' deshte te shikonte tjater mé te math, dhe sillej gjithenjé me nje menyre despotike dhe madheshtore. Ky ishte shkaku qe rrinte gjithenjé ne Dibre, lark hoborit te Krujes, si kumandár i ushterive te kufirit, se atjé s' kish njeri mi koke. Moisiu nuke haronte qe stergjyshet e tij ishin princer te Krujes dhe te paret e Shqiperise dhe menyra m' e mire per te rifituar kuroren e saj i u-dúk tradhesia ne kohen mé kritike te Shqiperise. Ne keté u-

Digitized by Google

shty prej Venetisë, e cila e shikonte me frikë lidhjen e ngushtë midís Skënderbeut e Alfonsit të Napolit, prej së cilës, e cila deshte t' i merrte gjakun Skënderbeut dhe Mamicës Kastrioti për divorcimin e saj nga Muzakë Thopía, prej Sulltán Mehmedit, i cili i u-zotua fronin e Shqipërisë, dhe prej politikës qëndrallësore dhe anti-feodale që kish nisur Skënderbeu, dyke aneksuar principatat e vogla dhe dyke i bashkuar nënë hien e tij.

Sulltán Mehmedi, pas betejës së Shkupit, dyke parë që s' e thýente dot Skënderbenë me forcë, nisi të përdorë të tjera mjete dhe shpesh thoshte që Skënderbeu do të mundej prej shókëve, të cilët e bënin të pamundur. U-përpóq, pra, të fitonte me anën e tij Moisinë, i cili quhej prej Shqiptárëve dhe prej Turqve si Skënderbé i dytë, dhe nofta m' i tmerruar dhe m' i zoti. I blatój pra me anën e kumandarit të Sfetigradit kuroren e Shqipërisë, po të hidhej nga ana e tij. Moisiu e mirëpriti këté proponim dhe përgjonte rasjen. Kur e ftój Skënderbeu të merrte pjesë në rrethimin e Beratit, Moisiu gjeti një mënyrë që mos vente, gjoja nga shkaku që ndodhja e tij në kufí ishte m' e nevójshime. Nga ana tjatër, për të provuar sa besník i ishte kryezotit të ri, lajmërój Sulltanin dhe kumandarin e Beratit për pllanet e Skënderbeut dhe për rezikun në të cilin ndodhej kjo fortesë.

Skënderbeu pá me një herë që u-tradhëtua.

Digitized by Google

Rrethimi i Berati ishte perfunduar pak dite mé pare prej shtabit, vendimi u-mbajt i fshehte dhe, pervéç oficéreve te larte, te gjithe te tjeret kujtonin qe ushteria shqiptare do te bariste kunder Sfetigradit. Skenderbeu, dyke mos ditur cili e tradhetój, nisi te dyshonje per te gjithe oficeret e shtabit a *purpuratet* qe e rrethonin dhe nuke dinte mé kujt t' i jipte besím.

Me 13 Qershór 1455 (1), me nje ushterí prej 14,000 e rrethój Beratin, passí la 4,000 per te rúajtur kufirin e Dibres. Te nésermen dha urdher per te nisur bombardimin e keshtjelles. Ne dit' e siper, nje pjese e murit u-rrezua nga gjylet, nje hyrje u-háp per ushterine rrethónjese, dhe Skenderbeu dha urdher per nje sulme te pergjithesh-me. Kumandari turk per te fituar kohe, kerkój te negocionte dorezimin e forteses dhe proponój ketó konditá: Te behej nje armepushím prej nje múaji dhe, ne qofte se ne keté mes nuk i vinte nonjé ndihme se jashtmi, t' i hapte dyert e forte-ses per rrethónjesit, passí te shkonte garnizoni me armet dhe plaçkat. Skenderbeu s' deshte me as-njé menyre te binte ne keté gracke. Po *purpu-ráteve* u-pelqeu ky proponím si shume i aresysh-me. Pas nje bisedimi te gjate, Skenderbeu u-

1.—Barleti e ve rrethimin e Beratit me 1453, Bi-emmi me 1454, po nga arshivat e Nápolit e te Milla-nit duket qe s' munt te kete ngjare perpara motit 1455.

Digitized by Google

shtrengua prej shtabit tɛ tĩj t' i japɛ kumandarit turk njɛmbɛdhjetɛ dit kohɛ. Ushtarɛt shqiptarɛ u-gɛzuan pɛr kɛté vendím, se rrethimin e fortésave nuk e shijonin aspák.

Njɛ gabím i dytɛ ishte qɛ Skɛnderbeu, tɛ cilit s' i rrihej njɛmbɛdhjetɛ dit pa punɛ pɛr tɛ bɛrɛ sehír Beratin, u-ngrit me gardɛn mbrɛtɛrore dhe shkoj pɛr tɛ marrɛ njɛ tjatɛr fortesɛ disá mile mé tutje. Tivárasi, qɛ na e jep kɛté lajme, s' na e tregón emrin e kɛshtjellɛs tjatɛr, dhe Barleti thotɛ vetɛm qɛ u-hóq disá mile mé tutje pa dhɛnɛ nonjé shkak (1). Njɛ gabím i trɛtɛ dhe fatál: Kumandɛn e ushtɛrisɛ rrethónjɛsɛ, Skɛnderbeu ia dha kunatit, Muzakɛ Thopisɛ, njɛ djaloshi tɛ papjekur nɛ lufte dhe mɛndje-fjetur, nga shkaku qɛ s' u jipte besím *purpuráteve*. Mi kɛtó duhet shkuar dhe njɛ mjerím: Spiunɛt ushtɛriakɛ tɛ Skɛnderbeut flenin kɛté hɛrɛ dhe s' e lajmɛruan qɛ njɛ ushtɛrí armike e fortɛ nɛnɛ kumandɛn e Isá Bé Evrenozit (2) po vinte me vrap pɛr tɛ shpɛtuar Beratin nga rrethimi.

Muzaka Thopía u-shtrua sikúr ishte nɛ shtepí tɛ tij dhe e lɛshój ushtɛrinɛ tɛ bɛntɛ qɛf gjer sa tɛ shkonin tɛ njɛmbɛdhjetɛ ditɛt. Ushtarɛt, ca flenin, ca losnin, ca pinin, ca kɛndonin, ca dúallɛ

1.—Biemmi, L. V. f. 317 dhe Barleti, L. VII. f. 223.

2).—Barleti e quan *Sabelia* dhe Biemmi *Vrenese*. Laoniku (L. VIII, f. 432) i jep emrin e plottɛ: *Isa Bé Evrenozi*.

Digitized by Google

per gjah, ca çepelitnin anes lumit. Rreth múreve te Beratit ishte nje paterdí, nje dasme, nje panaír prej nje turme te dehur e te çkujdesur qe defrenin. Tanúsh Thopía dhe disá gjenerale veterane e shikonin rezikun, po s' flisnin, as múare nonjé mase, se ishin zemeruar qe Skenderbeu i vuri nene úrdherin e nje çilimiu. Kalóresit, qe ishin vene te rúanin grykat dhe brigjet e te shikonin mos vinte nonjé ushterí armike, dyke pare tavaturin, qe po behej rreth Beratit, e dyke mos patur zot mi koke, ca u-kthyen te marrin pjese ne deferimin e pergjítheshme, ca zbritne nga kúajte dhe u-shtrine nene hien e lísave qe te mpróheshin nga vapa e tmerruar, dhe ca u-hodhe nga ana e armikut, i cili ua çperbleu mundimin me te teper.

I lajmeruar prej ketyre, Isa Bé Evrenozi (1), me 25 Qershór, 1455, ra pa pritur si rufé, e mori neper kembe dhe e copetój turmen ushteriake te çkaterruar qe defrente rreth Beratit. I vétemi shpetím ishte ikja, dhe aý qe mundi iku. Atá qe u-zune ne gracke u-there pa meshire. Midís

1).—"Misit (Mehmed II) igitur partem exercitus contra scenderem Iuanis filium, quem pater, quam vis saepius eum debellare occepisset, vincere nequivit. Josuen filium Brenezis ad id bellum ducem constituit, cui tradidit exercitum qui Pherris erat, et eum qui erat apud axium flumen, necnon Thesaliae exercitum." Laonicus, L. VIII, f. 432.

Digitized by Google

5,000 tє vráreve, qє mbuluan fushєn, ishte dhe Muzaka Thopía, i cili e çpagój shpejt e shtrenjtє çkujdesjen e tij fatale. Napolitanєt e Alfonsit, tє cilєt qєlluan tє ndodhen andéj nga ardhє Turqit, pothua u-shuan krejt, mє oficerє e me ushtarє, si nє kasapanє. Topat, kampi, dhe flámuret ranє nє duar tє Turqve.

Kur merrte fund kjo tragjedí, Skєnderbeu, passí ish munduar mє kot tє merrte até kєshtjellen tjatєr qє s' ia dimє emrin, po kthehej nє Berát, me qєnє qє tє njєmbєdhjetє ditєt ishin mє tє mbaruar e siper (1). Mb' udhє gjeti Shqiptarєt, qє po iknin, dhe mori vesh mjerimin qє kish pєsuar ushtєria e tij. E vétema gjє, qє i mbetej pєr tє bєrє, ish tє qєndronte sulmєn e Turqve dhe tє mbulonte ritiratєn nga fusha e Beratit. Kjo gjє ish aq' e rendє sa dhe e rezíkєshme, sє paniku ish pєrhapur nє tє gjithє Shqiptarєt, dhe garda mbretєrore ment u-pєrfshí nє ikjen e pєrgjítheshme. Pєr fat tє mirє, ardhi nata dhe i shpetój nga njє katastrofє tєrєsore. Nga Shqiptarєt, qє múarє pjesє nє kєté rrethím tє palumur, pothua asnjé nukє shpetój pa plagє. Midís tє plagósurve rendє ishin Gjerq Thopía, i velláj i Tanushit, dhe Muza-

1.—Qє Skєnderbeu s' ndodhej nє Berat kur ngjau kjo dishfatє, na e vertetón dhe Laoniku (L. VIII, f. 433), i cili çfaq hidhєrimin qє aý papistán i urryer s' ish atjé e s' pєsój gjє tє kєqe. "Scenderes vero, ut qui abfuisset, mali nihil passus est."

Digitized by Google

ka i Angjelinës. Vetë Skënderbeu u-ndóth në rezík, kur, në dëshpërím e siper, u-sul në mes t' armiqve, u-rrethua prej syresh nga të gjitha anët, dhe mezí çau udhën me shpatën e tij të tmerruar. Nga zemërimi, na thotë Barleti, i ishte çarë buza e poshtme, dhe gjaku po i rridhte si rrëké (1). Kur u-érr, Skënderbeu u-përpóq të riorganizonte 'ushtërín' e tij, po që të gjithë kishin marrë sytë dhe iknin si të xhindosur.

Pothua katër shekuj mé vonë, më 1830, tragjedia e Beratit u-përsedýt përpara Manastirit. Shqiptarët kryengritës kishin rrethuar Manastirin dhe do t' a kishin marrë, kur Valiu u-proponój t' a ndreqin punën me të mirë. Kreret e kryengrítësve ranë në gracke, pikërísht si stërgjyshët e tyre në Berát. Negociatat u-zgjatnë gjer sa u ardhi Turqve një ndihmë së jashtmi. Ahere Valiu i ftoj kreret shqiptarë për darkë dhe i theri si shqera, pastáj u ra kryengrítësve jashtë dhe i coptój krejt.

Aqë Barleti sa dhe Tivárasi na shigurojnë që, pas kësáj dishfate, Shqipëria do t' ish e humbur, sikúr Isá Bé Evrenozi të kish baritur kunder Krujës, udha e së cilës qé e hapur. Po vijtorja përpara Beratit ish aq' e papritur dhe tmerri nga emr' i Skënderbeut ish aq' i math, sa Evrenozi i urtë, nga frika se mos binte në nonjé pusí, nuk u-

1.—L. VIII, f. 229.

Digitized by Google

túnt vendit, po ndreqi muret e Beratit, vuri topat e Alfonsit nε keshtjellε, forcój garnizonin dhe shkoj nga Shqiperia me nxitím pas pak ditesh. Si i pari gjenerál turk qε mundi njε ushterí tε Skenderbeut, u-prít nε Stambóll me triúmf dhe u-festua si luani i dites. Po Sulltani nukε mbeti i kenaqur, posá Skenderbeu qendronte édhe i gjallε.

Kur u-kthye Skenderbeu nε Kruje, mesój qε Moisiu kishte ikur nga Dibra dhe ish hedhur nga ana e Sulltanit. Kjo lajme e hidherój mé teper se mjerimi i Beratit. "Dhentε Zoti, tha, kjo tε jetε e funtmja trathesí." Nε krye, kujtój qε terε ushteria e kufirit me tε gjithε ndénjesit e krahínave tε Dibres ishin bashkuar me armikun. Po, kur vajti nε Dibrε, i gjeti Dibranet shqiptarε dhe bullgarε aqe tε patundur nε besnikerí sa dhe mé parε. Moisiu kish ikur vetem me pesembedhjetε shokε. Ushteria e kufirit ishte nε vent nenε kumanden e vellézerve Dimiter dhe Nikóll Berisha. I bindur, qε Skenderbeu do tε mos ngrente dot krye pas deshyllit tε Beratit, Moisiu kishte arrirε perpara Isa Bé Evrenozit nε Stambóll, dhe i ishte zotuar Sulltanit t' a shtronte Shqiperinε nenε urdher tε tij me njε ushterí prej 15,000. Me qenε qε ish vjeshtε, puna mbeti per veren e motit t' áfermε. Sulltán Mehmedi i ishte zotuar Moisiut me tε shkruar njε qint mijε dukate dhe kuroren e Shqiperisε pa haráç, "po t' i shpinte ko-

Digitized by Google

kєn e Skєnderbeut nє Stambóll." Natyrísht, po tє vente puna mbarє, Sulltán Mehmedi, si pas zakonit tє tij, do t' a hithte kєté marrєveshje nє shportє.

Pas ikjes sє Isá Bé Evrenozit, Tanúsh Thopía me njє ushtерí prej 7,000 u-dєrgua nє Berát qє tє kujdeséj pєr varrimin e tє vrárєve. Me míjєra gra e burra vanє pás qє t' i kєrkonin tє vdékurit e tyre dhe t' i vajtonin pas zakonit. Kufoma e Muzák Thopisє nuk u-gjént, se Turqit e kishin prerє copє-copє dhe e kishin hedhur mє tє katєr anєt. As u-gjetnє kufomat e kalóresve, qє ishin ngarkuar tє rúanin grykat, se njє pjesє prej syresh kishte zbritur nє fushє tє Beratit dhe tjatra ishte bashkuar me armikun. Sa pєr kufomat e tjera, asnjé nukє njihej nga shkaku qє kishin shkuar mé tepєr se dyzét ditє. Tanúsh Thopía i mblodhi kufomat dhe i varrosi tє gjitha bashkє nє disá gropa tє mєdhá. Mi ketá varre tє pєrbashkmє u-mblodhє graria dhe nisnє njє vajtím tє mallєngjyer pєr até ushtерí tє palumur prej trimash veteranє tє disá bєtéjave tє shkєlqýera. Fusha e Beratit oshєtiu disá dit' e disá net nga ulєrimat, lebetitє dhe elegjitє heroike. Varret e trímave u-vaditnє me lotet dhe gjakun e grave tє pangushєllúara qє shkulnin floket, qє çirnin faqet qє rrihnin krahєrorin, e bєrtisnin me duar pєrpjetє qє, nє ka burra Shqipєria, duhej t' u merrej gjaku tє vrárєve tє Beratit. Tanúsh Thopía, i

Digitized by Google

perlotur aý vetє si dhe ushtaret e tij, me njє mijє mundime, me-zí i çkeputi nga varret, dyke i shiguruar qє Skenderbeu do t' ua merrte gjakun qє tє gjítheve me tє teper.

Mamica mbajti zi per tє shoqin terє jeten e saj dhe, ndonesé shumє princer e kerkonin per grua, refuzój tє marrtohej per sє dyti. Si trashgimtare e tє shoqt dhe nє emrin e tє bijve tє saj tє vegjel, e qeverisi principaten e Thopíave me njє urtesí dhe zotesí tє çudíteshme gjer sa vdiq. Ishte m' e zonja nga tє gjitha princeshat e deres sє Kastrióteve dhe Skenderbeu i kerkonte gjithenjé keshillen per çfardó punє me rendesí (1).

Si pá Skenderbeu qє nuk ardhi nonjé ushterí turke gjer nє funt tє vjeshtes, shkoj nga Dibra nє krye tє Dhjetorit nє Pulát, ku e kish thirrur Pal Engjelli peshkopi i Drishtit. Pjeter Spani, princ i Shales e i shoshit, kishte vdekur, tє bijtє ishin zenє midís tyre, dhe pushka po jepte e merrte nє malesitє. Skenderbeu i pajtój dhe e qetesój vendin ca me tє urtє, ca me forcє. Vellán' e vogel Mark Spani, i cili nukє bindej me asnjé menyrє dhe i cili ishte shkaku i trazirєs, e lidhi me hékura dhe e hodhi nє burk.

Nє dimer Skenderbeu pati kohє t' a riorganizonte ushterinє dhe t' a ngrente moralin e un-

1).—"In rebus agendis sociam consiliorum a Scanderbego adhibitam." Barleti, L. VIII, f. 238.

Digitized by Google

jur tє Shqiptárєve. Ishte periuda m' e rezíkєshme. Shqiptarєt nisnє tє dyshonin pєr zotesín' e Skєnderbeut; nga ana tjatєr agjentєt e Venetisє dhe tє Sulltán Mehmedit futnin spica dhe pєrndanin mє tє djatht' e mє tє mєngjєr ryshfete pa kursím pєr tє blєrє krєrє dhe gjєnєralє, aqє sa njerí s' i kishte besím tjatrit. Pєr fat tє mirє, pópulli i tєrє qєndrój besník dhe shumica e kréréve vanє nє Krujє qє t' i blatonin Skєnderbeut tєrє pєrkrahjen e tyre. Gjithashtú Alfonsi i Napolit, Papa i Romєs, dhe príncєrit e tjєrє evropjanє i dєrguan ambasada me ndihma dhe me fjalє tє mira qє tє mos e humbiste kurajon nga mjerimi i Beratit dhe tradhєsia e Moisiut.

Prєndvera e motit 1456 pritej pa durím prej tє dy páléve: prej Turqve, tє cilєt kishin shprésє kєté hєrє t' a dєrmonin Skєnderbєnє, dhe prej Shqiptárєve, tє cilєt dєshnin tє mєrrnin gjakun e Beratit. Moisiu u-nís nga Stambolli nє funt tє Prillit mє njє ushtєrí prej 15,000 qє t' i ngultє atdheut tє tij thikєn nє zєmєr. Skєnderbeu e pristє nє Dibrєn e Poshtmє mє njє ushtєrí prej 12,000. Mє 19 tє Majit tє dy ushtєritє ishin tє radhítura pєr bєtejє, kur njє kalorєs turk, i qúajtur Ahmed, dolli nє fushє dhe provokój nє dyél até mé trimin prej Shqiptárєve. Zaharia Gropa kєrkój dhe mori lejєn nga Skєnderbeu qє tє matej mє trimin anadollák. Dyeli qé i gjatє. Kalóresit u-turє kundєr njєrjatrit, po ushtat e tyre u-dєrmuan mi

Digitized by Google

shqytet e hékurta dhe kúajt e tyre u-perpoqne me aqe hov sa u-permbysne me gjithe kalóresit perdhé. Zaharia dhe Ahmedi u-ngritne dhe me shpatat çveshur e nisne dyelin me kembe, po fati e deshte qe te mos merrte funt puna as me keté menyre, se ne nje perpjekje te terbuar u fluturuan shpatat nga dúarte qe te dyve. Ahere, Zaharia e kapi armikun prej trupit, i nguli kamen ne gryke dhe e shtriu te vrare perdhé. Vitorja e Zaharia Gropes ishte nje shenje e lige per ushterine turke dhe Moisiu, per te prishur keté pershtypje, dolli ne shesh dhe ftoj per dyél vete Skenderbene. Ky nuke vonój t' ia mbaronte deshiren, ndonesé zyrtaret e tij perpíqeshin t' a ndalonin. Po qofte nga turpi, qofte nga frika, Moisiu, me te pare Skenderbene perpara, iku me vrap midís brohorive dhe tálljeve te ushterise shqiptare.

Nje shi i tmerruar e ndalój betejen, e cila u-bé te nésermen, 20 Maj, jo shume lark Oronikut, ku u-thye Mustafá Pasha me 1448. Moisiu leftój me aqe trimerí sa Skenderbeu tha: "Tradhesia e ka bere mé trim se sa besnikeria." Me gjithe keté, ushteria turke u-dermua, dyke humbur afró 10,000 te vrare, te plagosur e rober. Shqiptaret s' u fale jeten e as te plagósurve, as róberve, po i shkuan te gjithe ne shpate per te lare gjakun e Beratit. Nga ana e tyre humpne afró nje mije ushtare dhe dyzét e dy oficere te vrare, midís te cíleve Dimiter Erizin dhe Marín Spanin, dy

Digitized by Google

trima veteranë, dhe afró dy mijë të plagosur. Zaharia Gropa dhe Pal Maneshi treguan trimërí të madhe në këté beteje dhe u-ngarkuan me dhurata prej Skenderbeut.

Kjo vijtore i bëri Shqiptarët të harrojnë krejt dishfaten e Beratit. Vetë Moisiu, i mundur prej Skenderbeut, i kontemnuar prej Turqve, dhe i rrahur prej vetedijes iku nga Stambolli, ardhi në Shqipërí, i ra nër kembë Skenderbeut me një bres të lidhur në qafë, dhe me lot në sy i kërkój ndjesë për fajin e tmerruar që kish bërë. Skenderbeu e ngriti, e puthi në ballë, si birin prodík i ati në Ungjíll, i dha shkallen e vjetër që kishte në ushtrinë kombëtare dhe nxori një urdhër që asnjerí të mos i flasë për tradhesín' e shkuar.

Në këshillën mbretërore u-bé një bisedím i gjatë për çështjen e plengut të Moisiut, të cilën e kish konfiksuar Skenderbeu motin e shkuar dhe ua kishte ndarë si dhuratë Nikóll Erizit, Andrea Gropës, Gjon Perllatit, Gjerq Thopisë dhe Gjerq Stres Balshës. Këtá, dhe veçanërísht i funtmi, kundërshtonin dhe protestonin që nuk ish e drejtë t' u rrembehej gjëja, që e kishin fituar me besnikërín' e tyre, e t' i dorëzohej prapë një tradhëtori. Po Skenderbeu, pas këshillës së Vrana Kontit dhe Vlladán Givricit, pesëmbëdhjetë dit passí u-kthye Moisiu, dha urdhër që t' ia kthenin prapë tërë plengun. Të gjithë u-bintnë, përveç Gjerq

Digitized by Google

Stres Balshes, i cili me proteste dhe kanosje mbajti nje krahine afer Elbasanit (1).

Gjon Muzaka na thote qe Moisiu u-hóth nga ana e Sulltanit, passí i rrembeu Skenderbeu *principaten*, te cilen nuk ia dha prape mé; Barleeti dhe Biemmi na thone qe Skenderbeu i konfiskój *plengun* e tij, domethene proprietetin personál, passí iku, dhe keté ia dorezój, kur u-pendua dhe u-kthye prape. Ketó deshmime nuke kundershtohen, po plotesohen njera prej tjatres. Skenderbeu, i merzitur prej príncerve feodale te vegjel, te cilet i kishte si gjyle ne kembe, ne mos krejt armíq a tradhetore, i vuri kazmen sistemit feodal dhe atá prej príncerve qe mundi i *mediatizój*, do-

1.—Biemmi, L. V, f. 346.—Gjon Muzaka (Hopf, f. 300) e tregón punen ndryshe: "Skenderbeu i rembeu Moisiut *shtetin e tij*, qe ish ne Dibre; pas kesáj, Moisiu i zemeruar u-hóth nga ana e Sulltanit, i cili e dergón me nje ushterí kunder tij, ahere Skenderbeu i dergój fjale qe te kthehej se do t' a kishte si vellá; dhe Moisiu, dyke ditur qe s' kishte nonjé shigurí prane Sulltanit dhe dyke mos dashur t' i rrite forcen Turkut me gjakun e te Krishtéreve, u-kthye prape." Duhet vene re qe Gjon Muzaka flet per rembimin e *principates*, dhe Biemmi per dorezimin e *plengut*, "*suoi beni*" *a* "*suo avere*" pas kthimit te Moisiut. Si Biemmi, dhe Barleti flet per dorezimin e plengut, jo te principates (L. VIII,f. 250): "Neque multos post dies, quae ablata Moisi, aut fisco adjudicata, aut divisa inter privatos fuerant, reddi omnia curavit."

Digitized by Google

methenε ua hoqi tε drejten e mbretεrimit dhe i aneksój principatat e tyre nenε hien e tij, po u la, nga ana tjatεr, proprietet personale, tε cilat nuk ua ngau, edhe títujtε ashtú si i kishin. Kεté masε e gjykonte si tε vétemin shpetím tε Shqiperisε, e cila duhej tε ish e lidhur e bashkuar ngushtε dhe me njε guvernε tε qendralεsuar nε kεté periudε kritike. Si kryekumandár i ushtεrisε, deshte tε ishte aý vetε zot dhe jo tε varrej nga miredashja dhe qefi i príncεrve aliatε, tε cilet nε orεn e rezikut, si nε rethím tε Krujεs, e neveritnε nε meshirε tε fatit, pa kuptuar qε humbja e tij ishte dhe humbja e Shqiperisε. Kεshtú Skenderbeu del i pari princ evropján, qε i dekllarój lufte feodalizmεs dhe bεri nε Shqipεrí tε Mesme até qε u-bé tre shekuj pastáj nε Francε ploterísht dhe katεr shekuj pastáj nε Gjermaní vetem pjeserísht. Kjo politikε e Skenderbeut, e cila kishte pεr qellím kryesór bashkimin e kombit nenε njε flamur e *njε* krye, ishte njε nga shkaket e tradhesive tε kréreve tε ndryshme si Moisiu e tε tjerεt, qε do tε shohim mé vonε. Nga ana tjatεr, shpjegón adhurimin dhe besnikerín' e pakufishme tε pópullit, tε cilin Skenderbeu e çlirój jo vetem nga Tirani i huaj po dhe nga tiranεt e vegjel tε vendit, qε i thethinin gjakun dhe e venin tε vritej vella me vella pεr interesat e tyre vetiake. Prishja e sistemit feodal ishte n' até kohε njε masε aqε radikale, sa Gjon Muzaka e kallεzón Skenderbenε si rrembé-

Digitized by Google

njes dhe uzurbatór, Tivárasi hesht dhe as e perménd gjekúnt keté riforme te tmerruar, dhe Barleti e paspallós dhe na e tregón vetem ne dy rasje terthori (1), po aqe çkoqur sa qíelli i kthjellet.

Keté mot Sulltán Mehmedi nisi nje fushate kunder Hungarézeve me nje ushterí te forte dhe

---

1.—Príncerit e Myzeqese, na thote Barleti (L. II, f. 34) ishin te bashkuar me Skenderbene *nga zemra* aqe ngushte, sa principatat e tyre s' kishin kufire te veçanta qe te ndáheshin nga e tija: " His (Musaciis) sicut idem voluntatis, idem etiam Labitus animorum erat cum Scanderbego, ita neque imperium ab illo ulla ex parte separatum, distinctumve habebant." Me fjale te tjera Skenderbeu e kish aneksuar principaten e Myzeqese, dhe Gjon Muzaka na e thote me sepate, qe ua rrembeu me force. Hamza Kastrioti qahet qe Skenderbeu jo vetem s' i dha pjesen qe i binte nga principata aterore, po dhe até cope vent qe i kish falur, nga turpi i botes, do t' ia kish marre prape, posá te gjente nonjé shkak, sikunder kish bere me Balshet: "Recuperavit, auxi imperium Scanderbegus non sine multo labore, et opera nostra. Expectavimus diu, *si non aviti, et paterni juris, portionem saltem, ut mercedem* aliquam sudoris, et periculorum tantorum nobis daret. Ducta est non multo post uxor illi, quaesitus et susceptus novus haeres, imperii successor. Nobis prae pudore quodam hominum, ne privati omnino degeremus, assignatus vilis quidam Epiri angulus, ubi (illo caetera obtinente) infamem traheremus vitam. Vix poteram animo imperare, neque unquam satis eam concoquere ignominiam. Coëgit tamen temporis ratio, et insolens ingenium viri caelare omnia, dissi-

Digitized by Google

Skenderbeu, si u-kthye Moisiu, mblodhi prapë keshillen që t' a bindë të marrin ofensiven, osé të paken të përpíqeshin për të rifituar Beratin dhe Sfetigradin. Ishte rasja m' e mirë, se Sulltán Mehmedi u-dërmua prej Huniadit përpara Belgradit më 6 Gusht, 1456, dyke humbur tërë artilerín' e tij dhe 24,000 të vrarë, po keshilla s' deshte të degjonte gjë as për njërin as për tjatrin pllan. Shqiptarët u-gëzuan për dishfaten turke aqë sa ishin helmuar për humbjen e Stambollit dhe Skenderbeu i dërgój Huniadit një ambasadë me letra përgëzimi. Për fat të keq, gjashtë dit pas

---

mulareque, ne suspicionem aliquam causatus me circumvenieret, ut nuper Georgio Stresio, sororis suae filio fecit, quem confictis criminationibus insimulatum *omni ferme imperio nudavit.*" Barleti, L. IX, f. 253.

Paja që mori Skenderbeu nga Arianiti përmbliht-të, si pas zakonit t' ahéreshmë, dhe disá krahina, dhe përandáj qáheshin të vellézërit e së shoqes që ua plaçkiti principaten. Pas vdekjes së Arianitit më 1461, si duket, Skenderbeu ia aneksój tërë principaten dhe i mediatizój të bijtë, se një prej syresh nga inati u-bé muhamedán pikërísht pas ketí moti. Sidomós, dimë me shigurí që Himarën e trashëgój Gjon Kastrioti, i bir' i Skenderbeut, dhe jo të bijt' e Arianitit. Nofta kjo politikë ishte shkaku i shérreve periodike me Dukagjinët, se Skenderbeu, si pamë pak mé siper, kaperxeu Drinin dhe i *shtroj* malesít' e Shoshit e të Shalës, të cilat munt t' a marrim me mënt që i aneksój një her' e mirë.

Digitized by Google

vijtores sɛ shkelqyer tɛ Belgradit (11 Gusht, 1456), kryetrimi Hungarés i lavderuar u-semur edhe vdiq nga ethet.

Mɛ 18 tɛ Tetorit, 1456, Turqit zaptuan me tradhesí keshtjellen e Modrises. Kumandari i saj ish Gjerq Stres Balsha, i bir' i Jelles, sɛ motres sɛ Skenderbeut, njerí pas parasɛ, i cili s' e kishte per gjɛ tɛ bente até turpin mé tɛ math, posá tɛ kish nonjé fitím personál. Sulltán Mehmedit, pra, s' i vajti mɛ kot mundimi, kur u-perpóq t' a blerɛ me anɛn e agjénteve tɛ tij. U-múarɛ vesh, si u-perháp fjala, per 30,000 dukate t' argjentta. Po qɛ tɛ dukej se keshtjella ra nga moskujdesja, jo nga pabesia, dhe keshtú tɛ vogelohej faji i tij, kumandari i Modrises dolli per gjah me terɛ garnizonin diten e caktuar, dyke lenɛ porten e forteses hapur, dhe Turqit, pas marreveshjes, hynɛ dhe e zaptuan pa derdhur asnjé pikɛ gjak. Nɛ krye u-besua pergjitherísht qɛ Modrisa humbi nga mos perkujdesja, dhe ahere oficeret dhe ushteria nisnɛ tɛ qahen kunder Skenderbeut, i cili nukɛ vuri ment nga deshylli i Beratit dhe po u jipte kumanda me aqɛ rendesí disá oficéreve tɛ rinj e tɛ papjekur, qɛ s' kishin tjater vlerɛ veç qɛ ishin gjirínjɛ tɛ tij. Po ketó qarje pushuan shpejt. Gjerq Stres Balsha u-arrestua me urdher tɛ Skenderbeut, u-hóth nɛ burk si tradhetór, dhe me tɛ parɛ veglat e tortures e rrefeu fajin me gojɛn e tij. Principatɛn e tij Skenderbeu e aneksój;

Digitized by Google

plengun e tij ia dhurój te vellájt Gjon Stres Balshes; Moisiu mori prape krahinen prane Elbasanit qe s' ia kthente; dhe Skenderbeu konfiksój dukatet e fitúara me tradhesí dhe i perdori per te ndertuar fortesen e Rodonit. Tradhetori udenua ne burk per jete bashke me te vellane Gjoke Stres Balshen dhe u-derguan ne Napoli qe t' i rúante Alfonsi. Pastáj me lutjet e papushúara te Jelles u-çliruan, po kurre mé nuk u-qasne ne ushterí a me nonjé tjater sherbím te shtetit. I velláj i tyre Gjon Stres Balsha sherbeu nene Skenderbene besnikerísht gjer ne funt (1).

1.—Barleti s' na thote gjekúnt asgjé per humbjen e Modrises, hollesít' e se ciles i mesojme nga Biemmi (L. V, f. 346-348). Ky na tregón vetem Gjerq Stres Balshen si fajtór, po nga Muzaka mesojme terthori qe ne keté tradhesí kishte gjisht edhe i velláj Gjoke Stres Balsha, se qe te dy bashke u-derguan ne Nápoli: "e fé prigione il Signor Giovani (kendó *Giorgio)* e il Signor Coico Balsa fratelli e li mandó al Ré Ferrante vecchio (kendó *Alfonso*) in Napoli, che li tenesse prigioni, e li tolse il stato loro ch' era tra Croia et Alessio, dico il paese della Misia." Hopf, f. 300.—Barleti, (L. IX, f. 253) e vertetón aneksaten e principates se Bálsheve, qe zgjatej nga Kruja gjer ne Lesh, prej Skenderbeut pa dhene asnjé hollesí tjater. Gjoke Stres Balsha duket qe u-fal ploterísht prej Skenderbeut, se ne betejen e Oranikut, 1465, Barleti (L. XI, f. 339) e perménd si kumandár te nje krahu te ushterise shqiptare.

Digitized by Google

Keté mot i lindi Skenderbeut një djalë, i cili u-emerua Gjon pas gjyshit të tij. Pópulli e festój keté ngjarje se taní kishte një trashegimtár per fronin e Shqiperisë. Po ky gezím nukë mbajti shumë kohë, se pak ditë pastáj, Hamza Kastrioti, me gjithë të shoqen e femijen shkoj në Stambóll dhe u-vú në sherbím të Sulltanit kunder atdheut të tij. Kjo tradhetí e tronditi tere Shqiperinë, se keté here tradhetori ishte princ i shtepisë mbreterore. Kur e mesój Skenderbeu tha: "Kjo vetem më mbetej, të leftónj kunder gjakut tim!" dhe qau mé teper per fatkeqesín' e vetë se sa per pabesín' e të nipit (1).

Barleti nukë na i shpjegón drejt per drejt shkaket që e shtynë Hamzën në dezertím, se i pelqén mé mirë të heshtë per gjerat e papelqýera (2). Po Tivárasi (3) na e thotë çkoqur: Hamza kishte shprese të hipte në fron të Shqiperisë pas vdekjes së Skenderbeut; kur u-marrtua me të bijën e Arianitit, Hamza nukë mundi t' a fshehë zemerimin as në mes të dasmes; edhe një here

---

1.—"Pianse, accusando piú la propria disavventura nei suoi piú cari, che la perfidia del nipote." Biemmi, L. V, f. 352.

2.—"Multa scribentem hoc loco deterrent, et ad silentium quasi me invitant, quod ea domestica scelera ac ingratitudinem mortalium sicut meminisse, ita referre horret animus." Barleti, L. IX, f. 251.

3.—Biemmi, L. V, f. 350-353.

Digitized by Google

kishte dekllaruar boterísht perpara një shumice që Skenderbeu, dyke u-marrtuar, ia pagúante sherbimet me mosmirënjohje; kur lindi Gjoni i vogël dhe s' i mbeti mé asnjé shprese per trashëgimin e Skenderbeut, ahere çfaqi një zemerím të terbuar, sikúr ia kishin rrembyer nga koka kuroren e Shqiperisë.

Sulltán Mehmedi, i cili tjater s' mejtonte veç t' a demoralizonje e t' a shtypë Skenderbenë me anë tradhetirash, passí nuk i vajti mbarë goditja e Moisiut, i vuri synë Hamzes. Per marreveshje i dergój t' emen, e cila ishte turkë, dhe i proponój t' a bente Vezír të Shqiperisë, po të kthehej kunder Skenderbeut. E ema e Hamzes arriu në një çast psikollogjík, pikerísht kur lindi Gjoni i vogël, dhe nuk u-mundua shumë që t' a mbaronte misionin e saj, se i biri ishte gatí. Dyke patur një krahinë pertej Dibres, afer kufirit, që ia i kish falur Skenderbeu, s' kishte veç të bente një çap që të hidhej nga ana e Sulltanit, i cili e ftonte me një kurorë në dorë. Po të mos i vente mbarë s' kishte frikë mos pesonte gjë, se Skenderbeu do t' a falte me até lehtesí që fali dhe Moisinë (1).

1.—Fallmerayer-i (vell. 9 f. 66) shton me ironí që tradhesia falet leht' e shpejt prej Shqiptáreve si një mekát krejt i natýreshmë dhe pa rendesí: "Verrath wird beiden Schkyptaren als eine der natuerlichsten und am wenigsten gravirenden Suenden leicht und schnell verziehen."

Digitized by Google

Hamza u-prit prej Sulltanit me nderime tɛ medhá, se ky s' munt tɛ ikte si Moisiu, posá solli nɛ Stambóll tɛ shoqen e bijte si penk tɛ besnikerisɛ tij. Dhe kɛtú Barleti, ató qɛ s' na i thotɛ vetɛ drejt per drejt, ia vɛ me mjeshtreí dhe hollesí nɛ gojɛ Hamzes, kur ky i flet Sulltanit per shkaket e ikjes sɛ tij dhe i qahet kunder Skenderbeut, qɛ e genjeu me shpresa, e shpuri nɛ udhɛ tɛ ligɛ, dhe pastáj i dolli i pabesɛ: E para, Skenderbeu nuk i dha Hamzes pjesen e principates sɛ Matit qɛ i binte jo vetem si trashegím nga i atí, po dhe si çperblím tɛ ndihmes, tɛ mundímeve dhe tɛ lúfteve pranɛ tij; e dyta, shpresa qɛ t' i trashegonte tɛ gjitha sa fitój Skenderbeu humbi posá ky umarrtua dhe beri njɛ djalɛ; e treta, kishte frikɛ qɛ Skenderbeu, dyke zbatuar politiken e tij qendralesore, do tɛ gjente njɛ shkak qɛ t' i rrembente dhe até krahinɛ tɛ vockel, qɛ i kish falur nɛ njɛ çip tɛ Shqiperisɛ, nga turpi i botes, qɛ tɛ mos e lente tɛ ngordhɛ per bukɛ (1).

1.—Barleti, L. IX, f. 253.—Kɛshtú ben Barleti per çdo gjɛ tɛ papelqyer: a hesht fare, a e thotɛ terthori, si pa tɛ keqe, a e shpjegón bukur, po ahere e fut mɛ nonjé vrimɛ ku duhet t' a kɛrkósh me qirí qɛ t' a gjesh. Me gjithɛ kɛté nukɛ duhet t' ia hamɛ haken, se nɛ ca pika me rendesí kryesore e kaperxen Tivárasin, si historián: me kater a pesɛ fraze elegánte, tɛ vena nɛ gojɛ tɛ Hamzes, na i tregón tɛ gjitha shkaket e ikjes sɛ tij dhe na ndriçón mé teper se kater faqet e

Digitized by Google

Nε vere tε motit 1457 Hamza Kastrioti hyri nε Shqipεrí me njε ushtεrí prej 50,000 nenε kryekumandεn e Isák Daút Pashes (1). Ushtεria e Skenderbeut ishte vetem 12,000. Kerkój pra ndihmεn e Papes (2), tε Alfonsit, dhe tε Príncerve aliatε. Papa Kalisti III (1455-1458) i dergój 200 ushtarε me njε shumicε tε madhe ushqimesh e municionesh. Aliatet i derguan 5,000 ushtarε dhe tε holla. Alfonsi nukε mundi t' a ndihmonte se ndodhej nε lufte me Gjenovezet.

Keté here, Skenderbeu ishte i shtrenguar tε perdorte njε taktikε tε re, se Hamza ia dinte tε

Biemmit mi keté çeshtje; terthorí, po fare çkoqur, na informón per politiken qendralesore dhe anti-feodale tε Skenderbeut, tε cilen as e perménd Biemmi fare dhe tε cilen e verteton Gjon Muzaka ploterísht.

1).—Barleti e quan Isak Pashε dhe Tivárasi Daút Pashε. I japim qε tε dyja emrat.

2).—Si ambasadór pranε Papes, Skenderbeu dergój priftin e pallatit, tε qúajtur Gjerq Kuka: "*Georgium Cuccam suum sacerdotem.*" Shih Biemmi L. V, f. 359, shením latinísht i hequr nga teksti i Tivárasit. Veç ketí dergój At Dimiter Frengun, arketarin e tij qε tε kerkonte ndihmen e fillotes papale, e cila ndodhej nε Det tε Bardhε nenε kumandεn e Kardinalit d' Aquileja: "Spacció parimenti per la via del mare Demetrio Franco suo Tesoriere verso Levante alla flotta Pontifizia ch' era commandata dal Cardinale d' Aquileja, a fragli istanza di rivorlgersi in suo ajuto." Biemmi, L. V, f. 359.

Digitized by Google

gjitha tє fshehtat strategjike dhe kishte marrє masa. Bєri pra sikúr u-trémp dhe u-hoq me tєrє ushtєrinє nє kufirin venecián afєr Leshit. Hamza nє krye kujtój qє kjo ritiratє ishte njє nga manevrat e zakóneshme tє Skenderbeut, po dykє parє qє ushtєria shqiptare s' bente asnjé lєvizje, ndonєsé kishin shkuar disá javє qє kur hyri nє Shqipєrí, u-bínt qє Skenderbeu iku me tє vertetє nga frika nє Lesh. Ushtєria turke u-çkujdés, disiplina u-lavєrua, dhe ushtaret nisnє tє perndáheshin mє tє djatht' e mє tє mengjєr pєr tє plaçkitur. Kampi i ushtrisє turke ishte vendosur nє fushєn e Albulenєs, pranє lumit Mati, nє perєndím tє malit Tumenísht. Skenderbeu zaptój ketє mal, e ndau ushtєrín' e tij mє tri pjesa, tє parєn nєnє veten e tij, tє dytєn nєnє Moisin' e Dibrєs, tє tretєn nєnє Gjon Stres Balshєn dhe Pjetєr Emanuelin, dhe i goditi Turqit pa pritur nga disá anє tє ndryshme, mє 2 Shtatór, 1457, nє mes tє ditєs, kur bente njє vapє e tmerruar. Luftєthirrjet e Shqiptárєvє, oshєtimet e trumbétavє, dhe kєrcєllimat e dyfégjevє lajmєruan qє Skenderbeu ish atjé, kur Turqit ia kishin humbur farє tragєn. Kúajt' e tyre kullosnin pa shalє, ushtaret çlódheshin, rúajtєsit flenin tє shtrirє nєnє hien e lísavє, dhe kumandaret po bisedonin nє duhej tє prisnin pa punє nє Albulenє apo t' i binin Krujєs. Ketє ditє u-lá ploterísht dishfata e Beratit. Turqit kundєrshtuan sa muntnє, po

Digitized by Google

beteja ish e humbur qe ne krye, dhe atá qe s' u vrane múare aratine. Afró 20,000 Turq te vrare mbuluan fushen, 1,500 u-zune rober, míjera te tjere u-copetuan prej Malesóreve kur iknin, dhe tere kampi mbeti ne duar te múndesve. Midís róberve ishte nje Sanxhák Bej, i qúajtur Mesíd dhe Hamza vete, te cilin e zuri te gjalle Zaharia Gropa me dy ushtare, te qúajtur Stefán Ubini dhe Vincént Raleni, te cilet i lidhe me hékura dhe ia shpune t' ungjit. Si Davidi per Abesallomin, Skenderbeu kishte dhene urdher qe te mos vritej tradhetori i shtepise, i fese dhe i atdheut te tij, po te zihej i gjalle.

Plaçkat qene te panúmerta. Pothua cilidó ushtár mori nga nje kale te ngarkuar me plaçka te ndryshme. Skenderbeu gjeti ne tenden e kryekumandarit nje qint mije dukate. Gjysmat e ketyre ia dha Moisiut perpara tere ushterise me nje fjale, ne te cilen i tha qe nderi i vijtores i binte atí mé teper se cilitdó tjater. Moisiu, nga ana e tij, ua perndau Dibráneve dhe u-kenáq me nderin qe i beri Skenderbeu. Si legjionet e Jul Qesarit ne Farsalle, ushtaret e Skenderbeut i gjetne sofrat te shtrúara ne tendat armike, dhe kryetenda e kumandarit ishte ngritur e stolisur me aqe luse sa s' kishin pare Shqiptaret as ne ender.

Skenderbeu, si varrosi te vraret, u-kthye ne Kruje me triumf. Dhe keté here, Shqiptaret i hoqne robat e zise qe mbanin per te vraret e Be-

Digitized by Google

ratit, per tє kremtuar kєtє vijtore tє shkelqyer. Bєteja e Albulenєs u-kєndua me vjersha an' e mb' anє Shqipєrisє dhe ambasadoret e Skєnderbeut, me plaçka turke dhe letra tє kurorєzúara me dafinє e shpunє lajmєn e mirє nє hoborret e Romєs, Napolit, Budapestit, Venetisє dhe Francєs.

Stambolli u-trondit nga kjo dishfatє e papritur. Sulltani pagój 15,000 dukate pєr Mesíd Benє dhe 40,000 pєr oficєret e tjєrє. Hamza Kastrioti, pєr tє cilin Sulltani s' u pєrkujdés aspák, u-dєrgua prej Skєnderbeut nє Nápoli pranє Alfonsit si rop bashkє me 12 kuaj, 4 flámure tє Turqisє dhe tendєn madhєshtore tє Isák Daút Pashєs.

Ambasadoret e Sulltanit qє súallє çpєrblimin e oficєréve robєr, i proponuan Skєnderbeut paqє osé armєpushím me konditєn *uti possi detis*, domethєnє ciladó anє tє mbante ató qє kish nє dorє. Kєshilla shkelte kєmbє qє tє akseptohej ky proponím, kur Skєnderbeu s' deshte tє bєnte paqє veç me konditєn qє t' i kthєhєshin fortesat e Beratit e tє Sfetigradit. Mi bisedím e siпєr ardhi njє ambasadór i Papєs, Imzot Giovanni Navarro, i cili i solli Skєnderbeut njє sumє tє hollash, qє ishte mbledhur me pєrpjekjet e Vatikanit nє Raguzє dhe nє Dalmatí. Ky u-paraqít pєrpara kєshillєs dhe, passí i pєrgєzój Shqiptaret pєr vijtorєn e Albulenєs u bєri tє njohur zyrtarísht qє Papa Kalisti III po organizontє njє kryqєsatє prej mbrétєrve tє Krishtєrє tє Evropєs kundєr Turq-

Digitized by Google

ve dhe qe shpresen mé te madhe per mbarevajtjen e saj e kishte nga Shqiptaret dhe veçanerísht nga Skenderbeu i cili, pas vdekjes se Huniadit, ish i vétemi gjenerál i zoti qe te vihej si kryekumandár i Kryqetáreve (1). Kjo i bindi Shqiptaret t' i hedhin poshte proponimet e paqes dhe t' a vazhdojne luften.

Ne keté mes, Sulltán Mehmedi dergój nje ushterí nene Sinán Pashen dhe Omer Pashen me úrdherin qe te rúajne vetem kufirin, po te mos e goditin Skenderbene, as t' i japin beteje po t' i provoktonte.

Me 1458, Skenderbeu, si u-përpóq me kot t' i hiqte ushterite turke ne beteje dhe pá qe ish e pamundur, lá dhe aý nje ushterí per te rúajtur kufirin dhe u-kthye ne Kruje. Atjé i ardhi lajma e vdekjes se Alfonsit te Nápolit dhe pak kohe pastáj i la shendét edhe Vrana Konti. I pari ishte miku i tij m' i ngushte dhe mprójtesi i tij mé besník, i cili e kishte ndihmuar me dore te hapur ne disá rasje kritike; i dyti ishte nje nga gjeneralet e tij mé te zotet, kumandari i degjuar qe mprojti Krujen me aqe trimerí dhe nder kunder Sulltán Muradit II, veterani i disá betéjave te lavderúara kunder Turqve, stratigjisti qe i dha bashke me Vlladán Givricin pllanin, me te cilin e mun-

1.—Biemmi, L. V, f. 378-379, dhe Rinaldi, Annales Ecclesiastici, mot 1457, no. 15, ku eshte teksti i letres se Papes per Skenderbene.

Digitized by Google

di Hamzen, dhe burri i patronditur ne besnikerí. Vdekja e Alfonsit, e cila ngjau ne 27 Qershór, 1458, ishte nje mjerím i math edhé nga nje shkak tjater: si do te shohim mé vone, pas vdekjes se tij, krisi lufta civile ne mbreterí te Nápolit dhe kongresi i Mantoves, i cili u-mbloth prej Papes per te organizuar kryqesaten kunder Turqve, ne vent qe te dergonte ushterite kryqetare t' Evropes ne Shqiperí, e thirri Skenderbene si ndihmes per te shtruar Italine Jugore.

Pas vdekjes se Alfonsit, kemben e tij e zuri i biri Ferdinandi dhe Skenderbeu i dergój nje ambasade, te perbere prej Tanúsh Thopise, Vlladán Givricit dhe Muzakes s' Angjelines, qe t' a ngushellonin per vdekjen e t' ett dhe t' a pergezonin per hipjen e tij mi fronin e Nápolit. Kjo ambasade kishte porosí te sillte ne Kruje edhé Hamzen, pas shume lutjesh nga ana e tij dhe e miqve.

Hamza Kastrioti, si u-kthye ne Kruje, vuri tere forcen qe t' i ndjehej faji dhe flitej lart e poshte qe Skenderbeu do t' a falte si Moisine, a te paken do t' a çlironte si Gjerq Stres Balshen. Ne keté mes, Hamza iku prape ne Stambóll, ca thone me lejen e Skenderbeut qe te merrte s' andejmi te shoqen me te bijte, ca persrí fshehtazi e me tradhesí. Ne Stambóll, Hamza u-prít shume ftohte dhe pak kohe pastáj vdiq i helmuar prej Sulltanit, duke lene pas te shoqen e te bijte, te

Digitized by Google

cilet ishin kthyer muhamedanë. Hamza, sikúr të mos kishte dalë tradhetór, s' është çudí që të zinte kemben e Skënderbeut, passí Gjon Kastrioti ish teper i vogel që të hipte mi fron të Shqiperisë pas vdekjes tij. Në Shqipërí vinte i dyti pas Skënderbeut në shkallë të nderit, jo vetem si i nipi i tij nga i vëllaj m' i math, po dhe si mé trimi nga gjeneralet e tij, dhe pas Moisiut quhej aý m' i sqúari dhe m' i zoti në punët e luftës. Nga rritja, nga dituria, nga fjala s' kishte shok. Ishte i ëmbël, popullór, dorëhapur dhe të gjitha sa kishte, a fitonte në beteje, ua përndantë ushtárëve. Në një cilësí e kapërxente edhe Skënderbenë: në të fituar zemrat. Ushtarët dhe oficerët e deshnin aqë shumë sa, kur ish i burgosur, qáheshin fáqeza kunder Skënderbeut që s' e falte, ashtú si kish bërë për Moisinë dhe Gjerq Stres Balshën. Këtó qarje dhe frika e kryengritjes ishin shkaku që e dërgój të mbahet i burgosur në Nápoli. Hamza kishte gjithatë dashuri për luften dhe urrejtje për paqen, si Skënderbeu, të cilit i shëmbëllente në të gjitha veç në madheshti morale dhe bukurí trupësore. Ishte i shkurtër nga shtati, i thatë nga trupi, dhe jo i híjeshmë a madheshtór nga pamja, si princët e tjerë të derës së Kastrióteve, po ish plot me energjí dhe i lindur për kumandár. Me tradhesín' e tij, Shqiperia humbi një Skënderbé të dytë potenciál, i cili munt t' a kishte ndryshuar krejt historín' e saj të pastajme.

Digitized by Google

Mε 1459 Sulltani adoptój njε tjatεr pllan pεr tε dermuar Skεnderbenε: tε dergonte kundεr tij ushtεrí pas ushtεrie, pa pushím, pa prεhje, gjer sa t' a lothte e t' a shúante. Sinán Pasha e hapi kεté fushatε me 20,000. Skεnderbeu e priti nε grykat e máleve tε Mokrenεs, afεr Ohrit, dhe e dermój krejt mε 27 tε Gushtit, 1459. Gjithaté ditε goditi Husein Benε, i cili vinte tε bashkohej me Sinán Pashεn, e çkaterrój ushtεrín' e tij prej 30,000 dhe e zuri kumandarin e saj tε gjallε. Pakε ditε pastáj, Skεnderbeu, i lajmeruar qε njε tjatεr ushtεrí turke prej 18,000 nenε Jusuf Benε po zbriste nga Kosova nε Dibrε, s' i dha kohε t' afrohet as nε kufí po e goditi dhe e shtypi afεr Shkupit, nε fushε tε Pollogut.

Gjithashtú e pesój edhé Karaxhá Beu me njε ushtεrí prej 40,000 nε Livád, afεr Ohrisε, nε verε tε motit 1460. Karaxhá Beu ishte shok i vjetεr i Skεnderbeut dhe gjenerál i çprovuar, po plak nga versa. Ky í ish levduar Sulltán Mehmedit qε munt t' a thyente Skεnderbenε me 30,000. Sulltani e besój, po qε t' a shiguronte punen mé mirε, i dha 10,000 mé tepεr se sa kerkój. Dishfata e tij ish e plottε, po njε shi i tmerruar i ndalój Shqiptarεt t' a ndiqnin armikun e tε mblithnin pemεt e vijtores. Kεshtú Karaxhá Beu u-kthye nε Stambóll me humbje tε paka dhe thuhet qε Sulltán Mehmedi e pergezój qε shpetój aqε lehtε nga thonjt' e Skεnderbeut.

Digitized by Google

Sulltán Mehmedi, dyke humbur shpresen i dergój perserí ambasadorε Skenderbeut per tε negociuar paqe a armεpushím. Skenderbeu, si gjithenjé, s' deshte tε degjonte as fjalε per negociata pa marrε prapε Beratin me Sfetigradin, dhe lufta do tε kishte vazhduar, kur ardhi nε Krujε njε ambasadór nga ana e Ferdinandit tε Nápolit, i qúajtur Marco Caravasio, qε t' i kerkonte ndihmε kunder Dukes Jean nga dega Anjou e shtepisε mbreterore Bourbon tε Frances, i cili perpiqej t' i rrembente fronjn. Ferdinandi ish thyer mε 7 tε Korrikut, 1460, nε Sarno, njezet ditε mé vonε nε Puglie, dhe ndodhej aqε liksht sa e shoqja, mbreteresha Isabella, dolli nε ruget e Nápolit qε tε mblithte ndihma per tε paguar ushtaret. Pothua tε gjithε príncerit e Italisε u-trazuan nε keté lufte: Duka i Milanit Francesco Sforza dhe Papa Pius II (1458-1464) múarε anen e Ferdinandit; shumica e tε tjérεve dhe tε gjithε bujaret e Italisε Jugore anuan nga Duka Jean d' Anjou. Nε shtrengicε, Ferdinandi kerkój ndihmen e Skenderbeut, dhe Papa i u-lút veçanerísht qε tε hidhej nε Italí. Skenderbeu iu pergjéq Papes keshtú: "Edhe sikúr tε mos mε shtynte zemra per tε ndihmuar tε birin e mikut tim, deshira e Papes do t' ish per mua njε urdher, qε do tε mε bente tε shkonja nε Italí."

Po per keté fushatε kishte dy ndalime: lufta kunder Sulltán Mehmedit dhe reziku i njε luf-

Digitized by Google

te civile me Dukagjinet. Dergój pra ne Italí Gjen Stres Balshen me 500 kalores si kryerojtje dhe aý vete iu-vú punes per te regulluar punet me Dukagjinet dhe me Sulltán Mehmedin. Batleti s' ben fare fjale per zihjen me Dukagjinet dhe Tivárasi e perménte pa dhene asnjé çkoqitje. Po nga nje letre qarketore e Papes Pius II (1), drejtuar ne kryepeshkopet e Dúresit e te Tivarit, me date 10 Shkurt, 1461, merren vesh ketó: qe Lek Dukagjini, i ndihmuar prej Spáneve te Pulatit, e kishte zaptuar Danjen me pabesí dyke vrare kumandarin e saj venecián, dhe kish kerkuar ndihmen e Skenderbeut kunder Venetise (2); passí ky refuzój, Lek Dukagjni dhe Spanet lidhe nje aliance me Sulltán Mehmedin aqe kunder Venetise nga njera ane dhe Skenderbeut nga tjatra; lufta civile ishte me te krisur e siper, se Skenderbeu gatitej t' i shtronte Dukagjinet dhe Spanet me force; po para se t' u dekllaronte luften, i ulút Papes te perdorte influencen e tij prane Malesóreve qe te ndreqej puna me te mire; Papa u dergój kryepeshkópeve dhe peshkópeve shqiptare letren qarketore, qe permentme mé siper, me anen e se ciles u bente te njohur qe Dukagjinet, Spanet dhe pasaniket e tyre jane te çkisheruar,

1.—Rinaldi Ann. Eccl., 1460, no. 104.

2.—Danja ra ne duar te Dukagjíneve me 1456, pas arshívave te Venetise.

Digitized by Google

nε qoftε se brenda nε 15 ditε nukε presin çdo lidhje qε kishin me Turqit. Kryepeshkopi i Dúresit, Pal Engjelli, me keté letrε nε dorε, i solli nε udhε Dukagjinet, Spanet dhe Malesoret, tε cilet e prishnε aliancen me Turqit dhe u-kthyen prapε nε Ligen e Príncerve shqiptarε.

Tani mbetej armepushimi a paqja me Sulltanin, delegatet e tε cilit ishin nε Kruje, gatí tε neneshkrúanin njε paqe tε nderçime per tε dyja anet, posá qε Skenderbeu tε hiqte konditen e dorezimit tε fortésave tε Sfetigradit e tε Beratit. Sadó qε njε marreveshje e tillε s' i pelqente, Skenderbeu, i shtrenguar ca nga qarjet e pópullit tε lodhur qε kerkonte paqe me çfaredó çmim, ca i shtyrε nga deshira per tε marrε pjesε nε fushaten e Italisε pa rezík, neneshkrój njε paqe, a mé mirε armepushím per dhjetε vjet me Sulltanin, mε 27 Prill, 1461, me konditen *uti possidetis*, domethenε qε cilidó prej paqebéresve tε mbante ató vise qε kishte nε dorε, qε tregeria nε mes tε dy mbreterive tε ishte e lirε, dhe Sulltán Mehmedi II t' a njihte Skenderbenε si mbret tε Shqiperisε. Konditen qε tε zbrázeshin fortesat e Beratit e tε Sfetigradit prej Turqve nuk e akseptój Sulltani, po as Skenderbeu nuk akseptój konditen qε t' i jipte Sulltanit tε birin si penk, edhe t' i linte ushteritε turke kunder fortésave veneciane anes detit. Tanúsh Thopia u-dergua pranε Papes, i cili s' e pelqente keté paqe me asnjé mε-

Digitized by Google

nyrɛ, qɛ t' i tregonte shkaket, pɛr tɛ cilat u-bé dhe duhej bɛrɛ me doemós. Sidó qɛ tɛ jetɛ, Skɛnderbeu arriu sa t' a shtrɛngonte Sulltán Mehmedin II, ngadhɛnorin mé tɛ tmerruar dhe mé kryelartɛ t' atí shékulli tɛ negocionte njɛ paqe me té, *si njɛ me njé.*

Me nɛnɛshkrimin e paqes sɛ dhjetɛ vjéteve mori funt akti i dytɛ i tragjedisɛ madhe shqiptare.

Digitized by Google

KAPTINE IV

SKENDERBEU DHE VENETIA KUNDER SULLTAN MEHMEDIT II. 1461—1502

Fushata e Italise, beteja e Ursares, 18 Gusht, 1462.—Kryqesata e Papes Pius II, Nentór, 1463. — Dekllarata e luftes, 27 Nentór, 1463.—Beteja e Ohrise kunder Sheremet Beut, vdekja e Papes Pius II, 14 Gusht, 1464.—Fushata e Ballabán Pashes kunder Skenderbeut Prill-Shtatór, 1465. —Rrethimi i dyte i Krujes, udhetimi i Skenderbeut ne Rome, çlirimi i Krujes, Korrík-Tetór. 1466.—Rrethimi i trete i Krujes, 1467.—Vdekja e Skenderbeut ne Lesh, 17 Jenár, 1468.—Rrethimi i katerte dhe rénia e Krujes, Prill 1477-15 Qershór, 1474.—Rénia e Shkodres, 25 Jenár, 1479 .—Rénia e Dúresit, 1499.— Paqja e Venetise me Turqine, 14 Dhjetór, 1502.

Paqja u-prít nga te dy anet me gezím dhe brohorí. Njerezia nisne prape te lerojne arat, te rindertojne fshatrat dhe qytetet e prishur, te merren me tregetí, te hyjne e te dalin nga njeri vent ne tjatrin pa ndalime. Pas nje lufte te paprere prej 18 vjetsh, po merrnin fryme per heren e pare.

Digitized by Google

Vetem Skenderbeu, i rritur ne fushe te betejes, ne mes te shamates se luftes, e shijonte jeten e qete aqe pake sa dhe kundershtari i tij Sulltán Mehmedi II. Vetem ne kamp e ne armorine e çelnikte e ndjente veten mire. Ftimin e Papes e te Ferdinandit, pra, e priti me gezím jo vetem per aresye qe treguam mé siper, po dhe per shkakun qe s' i rrihej pa lufte. Gatiti pra me nxitím nje ushterí te zgjedhur prej afró 5,000 dhe ne krye te vjeshtes 1461, u-nis nga Shqiperia per ne Italí me Moisine, Vlladán Girvicin, dhe Zaharia Gropen. Regjencen ia la Mbretereshes, se ciles i dha si keshilltare Anastás Rumicin per punet ushteriake dhe Pjeter Engjellin, te vellán' e kryepeshkopit te Dúresit, per punet civile. Ushteria u-imbarkua ne Dures, Vlore dhe Lesh dhe fllota qendrój ne Raguze, ku Skenderbeu u-prit me nderime te medhá prej pópullit dhe Senatit te Republikes, u-festua, u-lavderua me fjale panegjirike, u-percuall me brohorí si gjenerali m' i shkelqyer i shékullit te tij (1). Nga Raguza Skender-

1.—Barleti, L. X, f. 285-289 dhe Luccari, f. 106.—Barleti na thote qe, kur u-prít Skenderbeu zyrtarísht prej Senatit te Raguzes, e pershendoshi me nje fjale kancellari David nga ana e Republikes dhe u-pergjéq Pal Engjelli, kryepeshkopi i Dúresit, nga ana e Skenderbeut. Biemmi s' e perménd fare viziten e Skenderbeut ne Raguze dhe ky fakt e dobesón hipothezen e Fallmerayer-it qe *Tivárasi* ishte Pal Engjelli.

Digitized by Google

beu u-hoth nε Italí (1), ku arriu nε kohen mé kritike pεr birin e mikut qε vente tε shpetonte nga humbja. Pas deshmimit tε kronikáneve italianε (2), Ferdinandi ishte i rrethuar nε Bari prej ushterive franko-italiane tε Dukes Jean d' Anjou dhe Kontit Giacomo Picininos dhe s' i mbetej veç njera nga tε tria: a t' a linte fortesεn dhe tε ikte nga ana e detit pεr tε shpetuar jeten; a tε sulej kundεr ushterive armike dhe tε vdiste me armet nε dorε pa nonjé shpresε fitimi; a tε jipej i gjallε nε duar tε armiqve tε tij.

Ardhja e ushterisε shqiptare nené kumanden e njε luftetari tε degjuar nε terε boten e tmerrój ushterinε rrethónjese aqε shumε sa Konti Picinino e ngriti rrethimin me vrap dhe u-hóq tridhjetε mile mé tutje. Ferdinandi, i çliruar me njε herε prej njε reziku aqε tε math, hapi dyert e fortesεs dhe plot me gεzím dolli t' a presε çlirónjesin e tij. E pεrqafój Skenderbenε, i bεri njε mijε falenderje, i tha qε kurrε s' kish pεr tε harruar shpirtmadhesinε, me tε cilεn la shtetin e tij dhe ardhi nε njε vent tε huaj pεr tε ndihmuar njε mik, dhe çfaqi shpresεn e shigurtε qε me ndihmεn

1).—Kur nisi tε duket toka e Italisε, Skenderbeu pyeti si quhej mali qε shikonte dhe u-gεzua, dhe e mori pεr shenjε tε mirε, kur mesój qε ish mali i Shen Mehillit, se keté engjell luftetár e adhuronte shumε. Barleti, L. X, f. 291.

2).—Biemmi, L. VI, f. 398.

Digitized by Google

e tij do t' i dermonte armiqte, te cilet múare aratine posá e pane. Skenderbeu i u-pergjéq qe me ardhjen e tij pagúante nje pjese te vogel te borxhit qe i kishte t' ett, Alfonsit, dhe çfaredó qe te bente kurre do mos arrinte t' a lante ploterísht.

Si u-mbaruan pershendoshjet, u-mbajt nje keshille lufte, ku u-vendós qe Ferdinandi te shkonte ne Abruzzi qe te bashkohej me fuqite aliate te Papes e te Dukes se Milanit, dhe Skenderbeu te qendronte per te mprojtur fortesen e Barit dhe pjacat e tjera te Apulise. Per te nisur, Skenderbeu leshój nje pjese te ushterise tij per te rrahur viset e krérreve italiane kundershtare, te cíleve ne ca dite u-beri aqe deme sa s' u ishin bere me tere kohen e luftes..

Me hyrjen e Skenderbeut ne shkene, fati i luftes u-kthye krejt dhe ushteria italo-frenge e Kontit Picinino dhe e Dukes Anjou nga ofensiva u-hóth ne defensive te deshperuar. Beteja decizive, e cila i dha funt luftes, ngjau ne Ursar me 18 Gushte, 1462. Ne kete beteje Skenderbeu me Moisine dhe Vlladán Givricin kishte kumanden e krahut te djathte te ushterive se Ferdinandit. Qe te dyja anet luftuan qenerísht, po mé ne funt ushteria italo-frenge u-dermua krejt prej Shqiptáreve te Skenderbeut dhe Italiáneve te Ferdinandit dyke lene 4,000 te vrare ne fushe, 1,000 rober dhe njezét e pese flámure ne duar te múndesve. Duka Jean d' Anjou iku ne France pas kesáj beteje;

Digitized by Google

Konti Picinino, disá kohe pastáj, u-pajtua me Ferdinandin dhe vdiq i vrare me te pabese.

Ferdinandi hyri me triúmf ne Nápoli dhe per pak kohe e shtroj tere mbreterine aterore nene úrdherin e tij. Skenderbeu u-festua me shkelqím ne Nápoli dhe i ngarkuar me dhurata nga Papa, Ferdinandi dhe Duka i Milanit, u-kthye ne Shqiperí ne vjeshte te motit 1462, se mbreteresha e lajmerój qe Turqit, dyke perfituar nga largimi i tij, kishin nisur te shkelnin e te plaçkitnin toka shqiptare, dhe ishte frike mos kerciste lufta prape. Ferdinandi, veç dhurátave te pásura, .e emerój Skenderbene gjenerál te deres se Aragones si shenje nderimi me nje pensión prej 1,200 dukatesh ne mot dhe i fali tre qytete, te qúajtur Trani, Gargano dhe San Giovanni il Rondo, te cilat t' i kishte aý dhe trashegimtaret e tij, po te zaptohej Shqiperia prej Turqve. Papa, veç bekímeve, i u-zotua qe do te organizonte nje kryqesate kunder Turqve, do t' a emeronte kryekumandár te ushterive te krishtera dhe do te vinte vete ne Shqiperí qe t' a kurorezonte zyrtarísht mbret te Shqiperise, Maqedonise dhe Rumelise.

Me fushaten e tij italiane, Skenderbeu ngjalli kohet e Aleksandrit te Mollosise dhe te Piros, me ndryshimin qe dolli m' i lumur, se u-kthye i ngarkuar me lavdí dhe passí e mbarój ploterísht punen per te cilen u-nís.

Per fushaten e Italise historíanet jane ne

Digitized by Google

kundershtím mi disá pika: mi daten e vajtjes sε tij nε Italí; mi númerin e ushterisε tij; mi ndodhjen e tij nε beteje tε Ursares.

Barleti e pershkruán gjer' e gjatε fushaten e Skenderbeut nε Italí, po s' na jep motin e vajtjes sε tij dhe nuk eshtε as aý vetε i shigurtε per númerin e ushterisε tij, i cili, na thotε, ish 5,500 pas cave, 7,200 pas disá tε tjéreve (1). Na shigurón vetem qε vajti me njε herε pas vdekjes sε Alfonsit, domethenε dy vjet perpara paqes me Sulltanin, passí beri njε armepushím prej njε moti dhe qε ndenji nε Italí·njε mot.

Tivárasi na thotε qε vajti nε funt tε Korrikut, 1461, me 5,000, po fushaten e pershkruán shkurter dhe çfajesohet per keté gjε, nga qε i velláj, i cili ishte oficér nε shtab tε Skenderbeut dhe i cili i jipte gjithenjé hollesít' e fushátave, keté herε ish i semurε dhe s' vajti dot nε Italí. Edhe ky e ben Skenderbenε tε shkonjε nε Italí pas njε armepushimi prej njε moti, si Barleti, po paqen me Sulltán Mehmedin e heth dy vjet mé vonε, 1463 (2).

Moti i vajtjes sε Skenderbeut nε Italí munt

1.—Barleti, L. X, f. 290.

2).—Biemmi, L. VI, f. 391-406. Nε parethénie tε historisε tij, Biemmi na jep fjalet me tε cilat çfajesohet Tivárasi per fushaten e Italisε: "Venia mihi detur si in hac transmarina Scanderbegi expeditione aliquid aut veri omiserim, aut falsi immiscuerimi cum frater meus qui in ipsis Domni stationariis ordines ducebat,

Digitized by Google

tє vihet me shigurí nє vjeshtє tє motit 1461, pas dokuméntave nє arshivat e Nápolit dhe Milanit (1). Qє vajti, passí u-bé armєpushimi i dhjetє vjéteve me Sulltán Mehmedin, na e mєsón Luccari, kroniku i Raguzєs (2), dhe ky armєpushím u-bé mє 1461, pas historianit tє Turqisє Hammer-Purgstall (3).

Ca kronikanє italianє e zbresin ushtєrín' e Skєnderbeut gjer nє 600, kur tє tjerє e ngjitin gjer mє 8,000. Ambasadori i Milanit nє Venetí, Antonius Guidobonus lajmєrón guvernєn e tij mє 12 tє Gushtit, 1461, qє Skєnderbeu gatitej tє hi-

---

cujas traditiones ego potissimum sequebar, eo tempore morbo implicitus domi manere coatus est."

1).—Pisko, Skanderbeg, Appendix.

2).—"Giorgio Castrioto, *conchiusa la tregua con li Turchi,* domandato da Papa Pio secondo, s' indusse a dare ainto Ferdinando Re di Napoli contra Renato Duca di Angio, e fece scala in Rausa, et mentre vi dimoró fu spesato dal publico, secondo l' antico costume della cittá." Luccari, f. 106.

Nє formєn qє e vє Luccari, Skєnderbeu shkoj pas armєpushimit tє dhjetє vjéteve, tє njohur prej tє gjítheve: *la tregua.* Mentimi i Pisko's qє Skєnderbeu shkoj, pas njє armєpushimi prej njє moti, pa u-kuptuar prej Turqve, s' munt tє merret seriozísht, se Shqipєria dhe Raguza ishin plot me spiunє tє Sulltanit.

3).—Hammer-Purgstall, Geschichte des Osmanischen Reiches, vєll. I, f. 461, Pesth, 1840. Nє kєté mєndje єshtє dhe Fallmerayer-i.

Digitized by Google

dhej nε Italí me 2,000 kεmbεs dhe 1,000 kalorεs (1). Dεshmimi i kεtí e forcón besimin qε ushtεria e Skεnderbeut ishte 5,000, si na thotε Tivárasi, se munt t' a marrim lehtε me mεnt qε Skεnderbeu i fshihte pregatitjet e tij ushtεriake qε tε mos i merrnin vesh armiqtε, dhe tε jashtmit kujtonin se ushtεria e tij ish m' e vogεl se sa ishte me tε vεrtetε. Dεshmimi i ca kronikáneve italianε qε Skεnderbeu zbriti nε Italí me 600 kalorεs εshtε njε moskuptím, i cili shpjegohet lehtε nga fakti qε garda mbretεrore kalórese e Skεnderbeut ishte e pεrbεrε prej 600 Krujanεsh. Gjεja m' e interesme pεr sypámεsit ishte Skεnderbeu nε krye tε gardεs kalórese dhe tε gjithε flisnin pεr Skεnderbenε me 600 kalóresit me famε, qε ishte, pamja m' e bukur dhe m' e çudíçime e atí shékulli. "Im-atε, na thotε njε kronikán italián (2),

---

1).—Pisko, Scanderbeg, f. 86.

2).—"Solebat Johannes Cocius, pater meus, qui Calabro bello sub Ruberto Ursino, viro fortissimo, aliquamdiu militavit, adolescenti mihi enarrare: vidisse se Epirotam hominem, qui cum sexcentis equitibus Ferdinandi nomine in Apuliam transiverat." Sabelico, f. 568.

Pεrqás me tε sípεrmen ató qε thotε Biemmi (L. VI, f. 484) pεr pamjen e Skεnderbeut nε krye tε ushtεrisε tij: "Era un' egregio spettaccolo a vederlo quando uscia armato alla testa della sue truppe."

Ishte fare ε natýrεshme qε Skεnderbeu me gardεn kalórese u la Italiáneve njε pεrshtypje tε paharrúarsh-

Digitized by Google

kishte zakón tє mє tregonte, kur isha i ri, qє e pá me sy trimin shqiptár me gjashtє qint kalóresit." Nga mєnyra, me tє cilєn na e thotє, merret vesh qє ky njerí s' e harronte dot pamjen e Skenderbeut me 600 Krujanєt dhe *kishte zakón* t' i tregonte tє birit qє i pá me sy atá trima tє degjuar. Ushtєria tjatєr e Skenderbeut s' e interesonte, s' u-mundua t' a numєronte, a dhe nє e dinte númєrin e saj s' e pєrmєntte, se s' ishte fjala pєr statistikє ushtєriake, po pєr madhєshtinє dhe shkєlqimin e kryetrimit legjendár me kalóresit e tij tє zgjedhur. Pєr ketá flisnin e çudíteshin qє tє gjithє. Tє tjerєt shkuan pa u-vєnє rє. Sidó qє tє jetє s' duhet harruar qє sa m' e vogєl tє ishte ushtєria e Skenderbeut aqє m' e madhe єshtє lavdia e tij pєr fushatєn italiane, se єshtє çudí qýsh me njє grusht trimásh e theu rrethimin e Barit, e ktheu fatin e luftєs dhe vuri Ferdinandin prapє nє fron tє Nápolit. Llogjika e dó qє Skenderbeu s' munt t' i bєnte ketó çudira me ca tє paka qindra kalorєs kundєr luftєtárєve frenq tє çprovuar dhe Konti Picinino, qє ishte gjenerali

---

me, kur tє marrim nє sy qє Italianєt e jugєs janє tє shkurtєr e tє shєmtuar dhe Gegєt tє gjatє e tє híjeshmє. Barleti na tregón qє Konti Picinino ish aqє i shkurtєr sa, nє njє bashkєfjalim, kur Skenderbeu vigán deshte t' a pєrshєndoshte, e mori si foshnje, e ngriti, e puthi nє ballє dhe pastáj e leshój me ngadale pєrdhé qє tє mos pєsonte gjє.

Digitized by Google

italián m' i zoti i kohes se tij. Eshte, pra, mé lehte te besojme Tivárasin qe Skenderbeu u-hóth ne Italí me 5,000 ushtare, veç pese qint kalóresve qe kish derguar ca mé pare nene Gjon Sres Balshen.

Kronikanet napolitane nuke na thone ne u-ndóth Skenderbeu ne betejen e Ursares, si na tregón Barleti, Dimiter Frengu dhe Anonimet. Po ndodhjen e tij ne keté beteje na e vertetón Mariana, historian spanjóll i asáj kohe, njekombás i Alfonsit dhe i Ferdinandit te Nápolit, te cilet i-shin princer spanjolle nga dera mbreterore e Aragones (1). Historiane te pastajme, si Lavardin, Duponcet, dhe Fallmerayer, jane te mendjes qe u-ndóth, dhe qe Skenderbeut i bie nje pjese e madhe e nderit per vijtoren e Ursares, e cila i dha funt luftes me fitím te plotte te Ferdinandit. Po ne nje pike kryesore jane me nje mendje te gjithe historianet, te vjeter e te rinj: qe Ferdinandi ish i humbur krejt dhe Skenderbeu me ushterín' e tij, te vogel a te madhe, e ngriti me kembe, i dha krahe qe t' i thýente kundershtaret, dhe te rizaptonte mbreterín' e tij. Te tjerat jane gjera te dores se dyte, qe interesojne kerkónjesit e hollesive per qime.

Kur u-kthye Skenderbeu ne Shqiperí, u-

1.—Mariana, Historia e Spanjes, L. 23, kap. 2 Shih dhe Duponcet, Histoire de Scanderbeg, parethénie.

Digitized by Google

háp shkena per aktin e trete, te funtme dhe mé te hidhur te tragjedise shqiptare.

Midís Republikes Veneciane dhe Sulltán Mehmedit II mbreteronte nje paqe e paprere qe me 18 Prill, 1454. Me Skenderbene dhe Ligen Shqiptare kishte nje armepushím prej dhjete vjetsh qe me 1461 gjer me 1471. Sulltani, pra, pati kohe te mjafte per te thyer dhe per te shtruar nene urdher te tij ploterísht mbreterine bizantine te Trapezundes, principaten e Karamanise, Rumanise, Bosnjen dhe Morene. Qe te mbaronte ketó shpedita te ndryshme, Sulltani kishte nevoje per paqe me fuqite evropjane dhe me Skenderbene. Ideja per te shpetuar te Krishteret e Lindjes dhe per te dbuar Turqit nga Evropa kishte vdekur ne príncerit e perendimit, po rronte ne Rome, dhe veçanerísht ne zemer te Papes Pius II me nje gjallesí medievale. Me qetesimin e Italise jugore hobori i Papes, me nje force te re, nisi perpjekjet per te lidhur príncerit e Perendimit ne nje kryqesate kunder Turqve. Venetia, e para fuqi e detit, dhe Shqiperia, e vétema fuqí e sterese e lire dhe e forte ne Ballkán, do te losnin rollet e pare ne keté drame madheshtore dhe titanike. Po qe te dyja kishin lidhur paqe me Sulltanin. Papa u-perpóq qe t' i binde qe te dyja t' i çierin traktetet e tyre dhe ne Nentór, 1463 (1), i dekllarój lufte Sulltanit zyrtarísht. Repu-

—"Nense Novembri, 1463, Pius II in curia be-

Digitized by Google

blika Veneciane i dekllarój edhe ajó luftë dhe dergój në Krujë si ambasadór Gabriél Trevisano'n që të shiguronte ndihmën e Skënderbeut. Ky hezitonte në krye, dhe kështilla e tij ishte me një zë kunder perseritjes së luftës. Gjon Stres Balsha i kujtoj këshillës si u-suall Venetia në kohen e rrethimit të Krujës dhe ahere që të gjithë i thanë Skënderbeut me zemërim t' a priste shkurtë bisedimin me Trevisano'n. Po bajlozi venecián s' u deshpërua nga kjo pritje armiqësore dhe ngarkój Pal Engjëllin, kryepeshkopin e Dúresit, që t' a përkrahte në misionin e tij. Pal Engjëlli u shpjegój kréreve shqiptarë që Sulltán Mehmedi do t' a hithte në shportë traktetin e dhjetë vjéteve, posá t' a mbaronte punën që kështe gjetkë, dhe do të sulej për të dërmuar Shqipërín' e vogël me ngé dhe me duar të lirúara; që Shqiptarët s' kishin sí të shpëtonin nga një luftë e përfuntme me Turqit; që rasja m' e mirë për të shpëtuar Shqipërinë nga reziku turk ishte tani që do të kishin ndihmën e tërë Evrópës dhe jo të prisnin t' u binte Sulltani kur të ndodheshin të vetëm, pa nonjé aliát; që Papa po gatitej të hidhej në Shqipërí në krye të Kryqëtárëve evropjanë, t' a emëronte Skënderbenë kryekumandár të ushtërive të krishtera, dhe t' a kurorëzon-

---

lum decrevit in Turcos." Spondanus, Annales Ecclesiastici, Tom II, f. 93, mot 1463, Edicje Lyon, 1678.

Digitized by Google

te zyrtarísht mbret tε Shqipεrisε, tε Maqedonisε e tε Rumelisε; qε Shqiperia me keté rasje hynte nε radhen e parε tε mbretεrive evropjane; qε kjo lufte ish e nevójshime aqε per nderin sa dhe per shpetimin e Shqiperisε. Keshilla u-bínt; lufa u-dekllarua mε 27 Nentór, 1463; krypeshkopi i Dúresit, per çpagim tε mundímeve tε tij, u-emerua prej Papes kardinál.

Sulltani, i cili, kunder zakonit tε tij, e kish nderuar besnikerísht traktetin e armepushimit, dhe pagój per demet qε kishte bere njε ushterí turke plaçkítese,—natyrísht, per interesin e tij—u-perpóq t' a ndalonte Skenderbenε nga shkelja e traktetit, po ish teper vonε. Skenderbeu ish i patundur dhe, nε pergjígjie tε tij, e ftonte Sulltán Mehmedin tε kthehej i krishterε (1). Per tε prerε çdo shpresε per marreveshje, kaperxeu kufirin, u vuri zjarrin víseve turke dhe u-kthye nε Shqiperí me kopera tε plaçkítura prej 60,000 lopesh e qesh, 80,000 dhensh e dhish, e 3,000 kuajsh. Pas kesáj, çdo pajtím me Sulltán Mehmedin ishte jashtε bisedimit, po Skenderbeu dhe Shqiptaret e prisnin me qetesí furtunen qε afrohej, se ishin tε shigurte qε ushterite kryqesore nenε kumanden e Papes po vinin dhe i prisnin dita me diten.

1.—"Si perfidia ista et Muhamedanae sectae erroribus depositis ad christi fidem et veritatem te convertere volueris." Barleti, L. XI, f. 325.

Digitized by Google

Per tє mpruar kufiret, Sulltán Mehmedi dergój Sheremét Benє me njє ushterí prej 14,000, po Skenderbeu e futi nє njє pusí afєr Ohrisє dhe e dermój krejt mє 14 Gusht, 1464. Gjysma e ushterisє turke mbeti e vrarє nє fushє. Midís róberve ishin i bir' i Sheremét Beut, tefterdari i ushterisє dhe dymbєdhjetє oficerє tє larte. Kєtá u-çperblenє per 40,000 dukate (1), dhe tefterdari e çlirój veten, dyke i dhenє ushterisє mjaft peshk per tє ngrenє até ditє, me qenє qє ishin kreshmet e Shen Marisє, se ushteria e Skenderbeut i mbante régullat e fesє dhe nє kohє tє fushátave (2).

1.—Kєtó pará Skenderbeu i shtroj nє njє qellim dhe ua perndau ushtáreve me doren e tij: "Allora Scanderbeg fece scaricare sopra li tapeti ogni cosa, et con bocco da ridere dispensava con lemani sue proprie quelli denari a tutto l' esercito." Anonim, k. 31, f. 34v.-35.

2.—Pishqit e Ohrisє ishin me famє qє nє kohen e Skenderbeut, se Anonimi (k. 31, f. 33v.) nukє harrón tє lepinjє gjishtrinjtє kur i kujtohen: "Ochrida, overo Aelcria, non é lontana dal paese di Scanderbeg et é appresso un lago dal quale nasce il fiume Drino, nel quale lago ogni giorno si pigliava assai carpioni, trutє, et piú altri *delicati et nobili pesci* in abundantia."

Me kєtó duhen perqasur ató qє thotє Muzaka (Hopf, f. 282) pothua me gjitható fjalє: "Questa cittá d' Ocrida é appresso ad un lago, dal quale nasce il fiume Drino, nel quale lago se piglia assai carpioni, trotte e piú nobili pesci."

Digitized by Google

Skenderbeu u-kthye ne Kruje dhe gatitej te shkonte ne Dures per te pritur Papen me ushterite kryqesore. Kishte arrire taní ne kulmin e lavdise qe munt te te enderonte nje generál i atyre kóheve. Pas meshes pontifikale, qe do te behej ne kathedralen e Dúresit, Papa do t' i jipte me doren e tij kryepeshkopit te Dúresit dhe kardinalit te emeruar kapen e kuqe, pastáj do t' a kurorezonte Skenderbene mbret te Shqiperise dhe do t' i dorezonte stapin e kryekumandarit permí ushterite kryqesore per te dbuar Turqit nga Evropa. Ne vent te fllotes dhe ushterive kryqesore, ardhi lajma e zeze qe Papa Pius II kishte vdekur ne Ankone kur gatitej te hipte ne anie, me 14 te Gushtit, pikerísht diten kur Skenderbeu dermój Sheremét Bene afer Ohrise. Pas vdekjes se tij, ushterite kryqesore ishin perndare dhe taní Skenderbeu dhe Venetia mbéteshin te vetem qe t' i benin balle terbimit te Sulltán Mehmedit. Natyrísht, rrebeshi m' i math do te pelciste mi Shqiperine.

Dishfata e Sheremét Beut e bindi Sulltán Mehmedin edhe nje here qe me gjenerale turq s' munt te bente asgjé kunder Skenderbeut dhe qe Shqiptaret munt te thýheshin vetem prej nje Shqiptarí. Kété here, pra, dergój Ballabán Pashe Baderen, nje renegát shqiptár me nje ushterí prej 18,000. Ballabani ishte aqe trim dhe i zoti ne lufte sa Skenderbeu, te cilin e urrente me

Digitized by Google

perpoqnε mε kot tε çanin udhεn, ranε tε plagosur tε Gjon Kastriotit. Ishte nga Badera, njε fshat i Matit nε lindje tε Krujεs. E kishin marrε Turqit nε njε nga shpeditat e tyre nε Shqipεrí, kur ish djal' i vogεl, dhe me trimεrín' e tij kish arrirε shkallen mé tε larte nε ushterinε turke. Ishte njε nga ushtarεt e parε qε hynε nε Stambóll mε 1453.

Qε nε bεtejεn e parε, u-dúk qε Skenderbeu gjeti shokun e tij. Nε fushε tε Valkalisε, afεr Olrisε, Ballabán Pasha u-munt nε Prill, 1465, po manovrój aqε mirε sa zuri tetε oficerε tε dεgjuar tε Skenderbeut. Ketá, dykε parε qε Turqit u-çkaterυan, nukε qendruan atjé ku i kish porositur Skenderbeu, po u-shtynε brenda nε njε gryke, ku u kish vεnε pusinε Ballabani, dhe passí u-tεrε zεmrεn, si renegát dhe si bir' i njε bariu nε duar t' armikut. Ishin Moisiu i Dibrεs, Vlladán Givrici, Muzaka i Angjelinεs, Gjin Muzaka, Gjon Perllati, Nikóll Berisha, Gjerq Kuka, dhe Gjin Maneshi me njε qint ushtarε tε tjerε. Skenderbeu dergój me njε herε pallamentarε qε t' i çperblente, gatí tε pagúanjε çfaredó sumε, a t' i çkembenjε me çfaredó numεr robersh turq. Po Ballabani ia dergój Sulltán Mehmedit nε Stambóll, i cili passí i mundój 15 ditε qε tε ndronin fenε e tε kthéheshin kunder Skenderbeut i ropi tε gjallε, i preu copε-copε dhe ua hodhi qénave

Digitized by Google

t' i hanɛ (1). Asnjé nga tɛ tetɛ nuk u-túnt, asnjé nukɛ lypi mɛshirɛ, asnjé nukɛ dɛshi tɛ mohontɛ fenɛ dhe atdhenɛ: kishin lɛftuar si trima, dhe taní vdiqnɛ si dɛshmorɛ. Tɛrɛ Shqipɛria mbajti zi

---

1.—Omnes excoriari suo more jussit." Barleti, L. XI, f. 337.

"Con una crudeltá delle piú detestabili comandó che tutti si scortificassero vivi ed a liste, affine di render piú durabile il tormento; e non saziato della pena dei vivi, fece gitta i lor cadaveri divizi in pezzi ad esser divorati dai cani." Biemmi, L. VI, f. 433.

Gjon Muzaka dhe Anonimi e tregojnɛ robɛrimin dhe mundimet e tyre prej pesɛmbɛdhjetɛ ditsh pothua me gjitható fjalɛ dhe duket çkoqur qɛ i pari kaptoj tɛ dytin, gjɛ e cila provón qɛ njɛ pɛrkthím italísht i historisɛ prej Dimitɛr Frɛngut u- botua pɛrpara motit 1510:

"E lá stava un' i mboscata dei Turchi, che allora se mossero tutti contra questi Signori e cavalieri, li quali combattendo virilmente passaro per mezo de quella valata e montarno sopra un certo calle, e nella cima di quello stavano li fanti Turcheschi, e da detti cavalieri non consociuti, credendo fossero christiani, furno presi e menati avanti a Balaban Bendera loro capitano, e subito li mandó al Gran Turco; et il Signor Scanderbego mandó al Gran Turco che le restituisse quelli prigioni, che le daria il cambio d' altri Turchi et anco l' offerea denari; ma avisato dal detto Balaban del valor loro, non volse restituirli, anzi per piú crudeltá li fece scorticare vivi a poco a poco, talché per quindici dí continui con simile afflittione e dollore pasarno da questa vita." Muzaka Hopf, f. 297.

Digitized by Google

per tá; kembanat e kíshcve gjemuan kudó; qytete, kcshtjella, male dhe fusha vajtuan; ushteria e tcrc la mjekren dhe floket; tc gjithc, oficerc dhe ushtarc u-betuan t' ua merrnin gjakun me njc mcnyrc tc tmerruar. Skenderbeu ish aq' i egersuar, kur e mcsój kctć lajme, sa urdhcrój ushtcrinc tc derdhet mi token armike, dhe vuri zjarrin kudó qc shkój: kctć hcrc, s' kishte mć plaçkitje, po prishje, shúajtje, dhe shkretím pa mcshirc.

Sulltán Mehmedi, i kcnaqur me oficcrct shqiptarc qc u-ropnc tc gjallc, e ngarkój Ballabán

---

"Allora la squadra nimica, che stava dentro nascosta, corse insieme tutta adosso quelli otto fortissimi cavalieri, liquali dapo molta aspra et crudel battaglia fatta per difendersi, passorno per forza per mezo di quella vallata, et montorno certo monte sopra la cima del qual stavano li fanti turcheschi, da essi cavalieri non conosciuti perche si ingannorno credendo, che fossero christiani di suoi, et furono presi da detti Turchi, et menati nelle mani empie di Ballaban, il quale subito li mandó al Gran Turco che era in Constantinopoli. Inteso tal flebile et daloroso caso, Scanderbeg mandó subito un imbasciatore a esso Gran Turco, pregando assai quello che li restituisse quelli prigioni sani, che li daria altri all' incontro o pur tanto argento, quanto pesavano. Ma lui pieno di furia et crudelta, avisato giá da Balaban de valore loro, non volse compiacergli per alcun modo, anzi per singulare dispetto fece scorticarquelli a poco, a poco per quindici giorni continui. Si che con simile afflittione et dolore passorno da questa vita." Anoním, k. 32, f. 36.

Digitized by Google

Pashen me dhurata, i dha një ushtërí të re prej 18,000, dhe e urdhërój t' a pasonte fushaten e tij pa pushím. Ballabán Pasha hyri nga ana e Ohrisë në Qershór, 1465, dhe pas zakonit t' ahéreshmë, i dergój dhurata të pásura Skenderbeut. Ky, ndonesé heren e parë nuk i qasi dhuratat e një renegati dhe tradhëtori, këté herë i mori dhe i dergój, nga ana e tij, një krabë, një çapë dhe një pluar që t' i tregonte që do të kish patur mé teper nder, sikúr të kish mbetur barí dhe bujk në Mat, se sa të bëhej gjenerál dhe të leftonte kunder atdheut të tij. Ballabani, i terbuar nga këtó dhurata që e doqnë mun në zemër, u-betua të çgjakesohet. Dyke blerë me tradhesí rúajtesit e kampit, arriu pa pritur, një orë perpara mengjezit që t' a goditte ushterín' e Skenderbeut, e cila ndodhej në Meçád të Dibres së Síperme, afer Oranikut. Po Skenderbeu, dyke ditur me ç' farë armík kish të bënte, nukë flente, dhe tek shëtitte naten per të permiqyrur kampin, e vuri re aferimin e armikut, u-kthye me vrap, regullój ushterín' e tij dhe priste gatí per beteje. Ballabán Pasha, i cili shpresonte t' i gjente Shqiptaret në gjumë, qendrój pa ditur në duhej të hiqej a t' a goditte ushterinë shqiptare. Në këté mes, Skenderbeu me një trup kaloresie shqiptare dhe vullnetaresh italianë, u merr krahun Turqve, i vë në mes dy zjarresh, e shtrengón Ballabanin të japë beteje dhe e dermón krejt. Kampi turk me të gji-

Digitized by Google

the flámuret mbeti ne duar te múndesve. Ballabani vete me-zí shpetój me germadhat e ushterise tij, po kthehet per se treti ne Korrík me nje ushterí prej 20,000 dhe kampón afer Sfetigradit. Skenderbeu e rrethój, e goditi nga te gjithe anet dhe nga tere ushteria turke me-zí shpetój e gjalle nje e káterta; te tjeret a u-vrane ne beteje e siper, a u-zune rober dhe u-therre pa meshire per te marre gjakun e tete oficéreve te rjepur. Nga ana e Shqiptáreve kishte mé teper te vrare dhe te plagosur se me çdo tjater beteje qe me 1443. Per te paren here, Shqiptaret e blenin vijtoren rende dhe shtrenjte. Pas deshmimit te Barletit e te Tivárasit, asnjé beteje s' u leftua nga te dyja anet me aqe terbím sa kjo. Vete Skenderbeu ment humbi jeten ne fushe te Sfetigradit ne dy rasje. Heren e pare, u-rrethua prej Turqve, nje prej te cileve e rrembeu per qafe dhe perpiqej t' a zvarniste nga kali perdhé; e shpetój nje ushtár, i qúajtur Liveta, i cili e vrau perqafesonjesin turk. Heren e dyte, kal' i tij, ne sulm' e siper, u-perpóq pas nje lisi, dhe u-permbýs bashke me Skenderbene, i cili goditi shpatullen e djathte dhe koken aqe rende sa mbeti disá kohe i shtrire, gjysm' i vdekur. Turqit i u-derdhe persiper qe t' i prisnin koken, u-perháp lajma qe Skenderbeu u-vrá, Shqiptaret ngrine dhe nisne te trondíteshin. Po garda mbreterore e rrethój mbretin e shtrire, qe besohej i vrare, per te shpetuar kufomen e tij te

Digitized by Google

paken, dhe rreth tij u-bé një përpjekje qenerishte, e terbuar, e deshpëruar. Skenderbeu u-ngrít me pahír, qendrój pak kohe si i zalisur, u-shkúnt si i squar nga një ender, mori veten, hipi mi një kalë tjatër, kapi shpatën nga dora e mengjer dhe u-vervít kunder armiqve me një sulmë dhe terbím mé të math. Kjo i dha funt betejes dhe Turqit múarë arratinë. Ketú rrefyen trimerí të pashémbëllte Gjokë Stres Balsha, Tanúsh Dukagjini, një Muzakë, Pal Maneshi, Dimiter Bersha dhe Raján Kuka.

Po në këtó tri vijtore Shqiptarët humpnë aqë të vrarë dhe të plagosur sa Sulltán Mehmedi mbeti i kenaqur nga Ballabani dhe e nderój për të káterten herë me një ushterí prej 24,000 nga ana e Ohrisë, kur një ushterí tjatër prej 16,000 po hynte në Shqipërí nga ana e Beratit nënë Jakúp Arnautin, një tjatër renegánt shqiptár. Ballabani vinte nga lindja, Jakupi nga juga, dhe që të dy barisnin kunder Krujës. Pllani ishte bërë shumë bukur. Të dyja ushtëritë do t' a vinin Skenderbenë midís dy zjarresh dhe, dyke bashkupunuar ngushtë, do t' a shtypnin Shqiperinë. Ishte manovra që u-përdór prej ushtërive austroruse kunder kryengrítësve hungarezë në veren e motit 1849. Në Stambóll asnjé s' kishte dyshím që këté herë pun' e Skenderbeut kish marrë funt, se veç ushtërive të forta, kumandarët shqiptarë të Sulltanit sillnin suma të panúmërta për të blerë

Digitized by Google

oficerε dhe ushtarε tradhetorε. Pozita e Skenderbeut ishte mé kritike se kurdoherε tjatεr. Tanúsh Thopia, Zaharia Gropa dhe Pjetεr Emanueli e keshillonin tε mbahej nε defensivε. Po Skenderbeu, mé tepεr i ndezur se sa i trembur nga reziket e shtuar rendi nε Dibrε me njε ushtarí prej 12,000 qε t' a spastronte Ballabanin para se t' arrinte Jakupi. Para se t' a goditte, dergój tre veta qε tε shikonin dhe t' a lajmeronin pεr levizjet e armikut. Po ketá u-blenε prej Turqve, uhodhε nga ana e Ballabanit, dhe i treguan pllanet e Skenderbeut. Nga kjo tradhesí, Skenderbeu ment humbi jetεn, dyke renε nε njε pusí armike. Ballabani dinte qε Skenderbeu do tε vinte vetε pεr tε shikuar pozitat dhe levizjet armike, posá s' u kthyen tε tre ushtaret. I vuri pusinε, pra, dhe e rúante. Nuke dolli i genjyer. Skenderbeu, dyke mos ditur cilin tε besonte, vijti vetε dhe do tε kish renε nε pusí, sikúr tε mos e kish shpetuar njε ushtár besník, i cili me tε parε Turqit e fshehur, i bertiti me zε tε fortε qε tε largohej me vrap. Si u-kthye nε kamp, Skenderbeu e regullój ushterín' e tij, e rrethój Ballabanin nε Gusht, 1465, e shtrengój tε japε beteje pa dashur nε fushεn e Valkalisε, pikerísht atjé ku u-zunε rober tetε oficeret e palumur dhe fitój njε nga vijtoret mé tε medhá e mé tε gjákeshme. Dishfata e Ballabanit ishte e plottε dhe dermónjese.

Shqiptaret po mblithnin pemet e betejes,

Digitized by Google

kur i ardhi Skenderbeut lajma nga ana e Mamicës që Jakupi po i afrohej Tiranës së Vogël. Skenderbeu rendi me ushtërín' e tij, i dermój Turqit në fushë të Kasarit dhe e vrau Jakupin me doren e tij. Në këtó dy beteja Turqit humpnë mé teper se 20,000 të vrarë dhe afró 6,000 robër. Atá që shpetuan u-farosnë më të ikur prej Shqiptárëve të egërsuar që i prisnin më çdo gryke ngaha shkonin. Disá nga oficerët e këshilluan Skenderbenë t' a ndiqte e t' a shúante Ballabán Pashen, që po kthehej në Stambóll me germadhat e ushtërisë tij, po Skenderbeu, i lodhur për heren e parë nga kjo fushatë prej gjashtë muajsh, u-përgjéq: "Léreni të shkojnë; dikúsh duhet të arrinje në Stambóll i gjallë që t' a lajmëronje Sulltanin për vijtoret tona."

Në Kruje, lajma e këtyre dy vijtóreve ish aq' e papritur sa askúsh nukë deshte t' a besonte. Njerëzia dridheshin nga frika dhe s' muntnin të besonin në një lumerí aqë të madhe. Kishet i-shin plot me gra dhe pleq, që fáleshin nat' e ditë. Vetem, kur ardhi Tanúsh Thopía, ahere besuan dhe me një herë, pas úrdherit të mbretëreshës, oshëtitnë këmbanat e kísheve (1), gjëmuan topat e kështjéllave, dhe pópulli dolli i stolisur për të

1) Degrand-i në libren e tij mi Shqipërinë Veriore (Souvenirs de la Haute-Albanie, f. 219, Paris 1901) na përshkruán një këmbanë të derdhur në motin MCCCCLXII (1462, domethënë gjashtë vjet përpara

Digitized by Google

kremtuar disá dit me radhe vijtoret e shkelqýera te Valkalise dhe te Kasarit. Ambasadore te veçante, me dhurata te pásura dhe me letra te dafinúara u-derguan qe t' a shpinin lajmen e mire ne hoborret e Evropes.

Me gjithe ketó triumfe, Shqiptaret e ndjenin veten te lodhur. Njerezia deshnin te gezonin ne paqe pemet e kaqe vijtóreve, e kaqe mundímeve, dhe te sheronin plaget e hápura te nje lufte prej mé teper se 20 vjetsh. Barren kryesore te luftes e hiqte gjithenjé principata trashegimtare e Skenderbeut dhe pópulli i kesáj ishte rrahur aqe shume sa s' kishte mbetur veç nje pakice e vogel burrash qe munt te sherbenin ne ushterí. Dhe me gjithe keté, taní po vinte kunder Shqiperise me tere ushterín' e tij Sulltán Mehmedi II vete, i cili kishte mbaruar ngadhenimet e tij ne Karamaní, Trapezunde, Rumaní, Serbí, Bosnje dhe Moré. Mé pare u-perpóq t' a spastronte Skenderbene me pabesí. Po te dy asasinet, qe u-ngarkuan me keté pune, u-zune dhe u-varre.

---

vdekjes se Skenderbeut), te cilen e gjeti te hedhur mi patomen gjysme te kalbur te keshtjelles se vjeter te Krujes, dhe çfaq hidherimin qe kjo kemban' e neveritur e Skenderbeut s' munt te qendronje atjé shume kohe pa fundosur ne katua, ku do te behet copra-copra. Eshte çudí qysh nuk e vurí re njerí e t' a shpetonte, keté kembane historike, qe lajmerój me brohorí vijtoret e funtme te Skenderbeut dhe vajtój vdekjen e tij me ze te mbytur nga shkembi i Krujes.

Digitized by Google

Shqiptaret ishin tє trembur kєtє herє mé tєpєr se nє rrethimin e parє tє Krujєs, se nukє shikonin me ç' farє mjete do t' u benin ballє mizerive turke. Po Skєnderbeu, me buzєqeshjen dhe vetebesimin e tij tє zakóneshmє, ua solli shpirtin nє vent dhe nisi pregatitjet kunder rrethimit qє po afrohej. Nє Krujє la njє garnizón prej 4,400 ushtaresh gegє, toskє dhe veneciane nenє kryekumanden e Tanúsh Thopisє (1), i cili ishte gjenerali i tij m' i zoti, qє i kish mbetur, dhe tє cilit i

1)"In Croja pose di guarnigione quattro mila e quattro cento soldati; e ne diede il guverno a Tanusio Topia, ch' era il piú accreditato Uffiziale delle sue truppe ed in cui maggiormente coufidava." Biemmi, L. VI., f. 448.

Barleti (L. XII, f. 353) na thotє qє kumanden e Krujєs e kishte njє Venecián, i qúajtur Balthasar Perducci: "Scanderbegus omnia loca praemunuit, praesertim urbem Crojae, in qua firmissium praesidium tum Albanorum, et Epirotarum, tum Italorum posuerat, quibus Baldesarem Perducem Italum, virum aeque strenuum, atque fidum praefecerat." Kєtó dєshmime munt tє pajtohen lehtє: Kryekumandár ish Tanúsh Thopía; Baltasár Perduçi ish kumandár i artilerísteve veneciane, nga zotesia e tє cilit varrej mprojtja e Krujєs. Nє kєtє mendje єshtє dhe Pisko-ja (f. 101).

Dergand-i (f. 225) na jep perkthimin frengjísht tє njє vjershe popullore, nє tє cilen lavderohet Tanúsh Thopía, qє refuzój t' i jipte Sulltanit fortesєn e Krujєs, tє cilen e mproj dy vjet me radhe.

Digitized by Google

kishte besím tє plottє. Passí vuri garnizone, ushqime dhe municione tє mjafta nє tє gjitha fortesat, mblodhi restat e ushtërisє qє t' a mbante nє fushє, ashtú si kish bєrє kunder Sulltán Muradit II. Po forcat e tij ishin aqє tє paka, nga qє shumica e oficéreve dhe ushtáreve tє tij ishin vrarє nє bєtjat e mepáreshme, sa i dergój Papes Pal III (1464-1473) Zaharia Gropєn dhe Venetisє Pjetєr Engjєllin, tє vellan' e kryepeshkopit tє Dúresit, qє t' u kєrkonte ndihmє nє rezikun e math qє pєrballte. Papa dhe príncerit e tjerє italianє, veç Republikes sє Venetisє, i derguan urime dhe bekime tє thata. Evropa s' u-túnt, se ishte e shigurtє qє Skenderbeu ishte mjaft i fortє sa t' a prapste ngadhenorin e Stambollit.

Nє mes tє Qershorit, 1466, Sulltán Mehmedi vetє e rrethój Krujєn me njє ushtерí prej 15,000. Blatój ar e ndere, e rrahu kєshtjellєn me topa, çpoj llageme nєnє muret, bєri sulma tє dєshpєrúara, po tє gjitha i vanє mє kot, si Sulltán Muradi 15 vjet mé parє. Forca natyrale e kєshtjellєs edhe trimєria e mprójtesve saj e bєnin Krujєn tє pangadhenúarshme. Skenderbeu passój taktikєn e tij tє vjetєr, derdhej pa pritur, e pєrfshinte, e tmerronte, e çkaterонte, e lothte ushtєrinє rrethónjєse nga mali i Tumenishtit, pa i dhєnє prehje as ditє, as natє, aqє sa Sulltán Mehmedi, i mєrzitur dhe i dєshpєruar shkoj nga Kruja mє 1 tє Gushtit, 1466, dyke lenє Ba-

Digitized by Google

llabán Pashen me 70,000 per te vazhduar rrethimin e bllokaden e Krujes. Po Sulltán Mehmedit i vinte turp te kthehej ne kryeqytét pa bere gje. Bariti, pra, kunder Kidnes, nje fortese natyrale afer Struges, e rrethój, e mori me tradhesín' e dy Shqiptáreve renegate me zotimin qe t' a linte garnizonin dhe ndenjesit te dilnin jashte lirísht me armet dhe plaçkat e tyre. Posá e shtiu ne dore Kidnen, therri pa meshire 8,000 burra, dhe afró 20,000 pleq, gra dhe çilimínj, qe ishin mbledhur atjé nga fushat rrotull (1), e shkretój tere Shqiperin'e Mesme me zjarr e me hekur, dhe i ngopur me gjak, u-kthye ne Stamból (2).

Ballabán Pasha e mbylli Krujen, si Títua nje here Jerusalemin, me nje vargua keshtjellash, dhe pasój bllokaden me shpresen qe t' a merrte qytetin nga uria. Kruja duhej shpetuar me çfaredó çmim dhe Skenderbeu, i veshur si kalores simpel, shkoj vete ne Italí qe te kerkonte ndihmen e Papes. Dhe ahere u-pá ky mprojtes i degjuar

---

1) Biemmi, L. VI, f. 454: "Presso a trenta mila furono tra huomini, e donne, e fanciulli che restarono in quest' occasione sagrificati alla rabia di Meemetto, e ammazati inumanamente, tra cui computavansi dintorno otto mila ch' erano abili all' armi."

2) Laoniku turkofil na shigurón qe Sulltán Mehmedi iku nga Shqiperia, passí e shkretój aqe sa mundi, pa bere asnjé vepre per te mbajtur ment (L. VIII, f. 433): "Tandem cum satis evastata esset regio, exercitum abduxit, cum nihil sane memorabile designasset."

Digitized by Google

i Krishterimit, ky mbret i math i një vendi të vogël, ky luftetár i patrembur që mbushi boten me lavdín' e tij, i cili kish kaperxyer detin ca vjet mé parë me një ushterí të lulëzuar për të shtruar Italinë, të shtrengohet në pleqerí të neverítë atdhén' e mbytur prej armiqve për të lypur mjetet e mprojtjes nga Evropa, për të cilën leftonte, nga Roma, e cila e shtyri me pahír në këté luftë të deshpëruar. Në qytét t' ameshuar u-prít si shpëtimtár i Krishterimit, u-sallutua kudó që shkonte me enthusiazmë dhe brohorí. Gjindje pa numër kishte rjedhur në Romë që t' a shikonin me sy e t' a përshëndoshnin, si në kohët e vjetra gjeneralët Romanë që kthéheshin mundës me triúmf. Papa Pal III u-çudít me pamjen e tij madhështore, e priti me nderime të mëdhá dhe e shpuri përpara mbledhjes së Kardinálëve (1), të cílëve

1) Farlati (Pisko, f. 103) e përshkruán kështú pritjen e Skënderbeut në Romë: "Urbem itaque ingressus, quam sui nominis suaeque virtutis celebritate repleverat, statim in Pontificis praesentiam venit; quod, ut a Romanis cognitum, *incredibilis hominum motus concursusque ad eum* conspiciendum suspiciendumque facti undique fuerunt; Paullus autem, cum Georgium vidisset, *miratus est tanti viri adspectum et maximo honore excepit;* quem etiam in Patrum collegium adduci voluit, et coram de Epiri statu dicere, ac de Turcarum rebus et imperio, quippe qui verius certiusque haec nosset, atque de his copiosius, quam ceteri, sciret disserere."

Digitized by Google

Skenderbeu u tregój perparimet e Turqve dhe rezikun, i cili dita me diten po i afrohej Italisë, sherbimet që i kishte sjellë botes evropjane me lúfterat e tij dhe nevojen e perkrahjes së Shqiperisë, e cila ishte gardhi i Evropes në Ballkán. Fjala e tij u-doretrokít po pemet e udhetimit s' qenë të shuma. Papa i dhurój Skenderbeut një shpatë dhe një helmé të bekúara me doren e tij, i dha Dimiter Frengut, arketarit të Skenderbeut dhe kusheririt të kryepeshkopit të Dúresit, tri mije dukate, dhe shkroj letra në të gjithe mbreterít' e Evropes që t' a ndihmojnë me pará dhe me ushtarë. Nga Roma Skenderbeu deshi të shkonte në Venetí, po koha s' priste dhe u-kthye në Shqipërí me vrap. Në këté mes, kumandari venecián i Shkodres Josafát Barbaro kishte mbledhur një ushterí vullnetaresh, mercenaresh dhe kryqesoresh italianë, dalmatianë, dukagjinás, shkodranë, tivarás, drishtanë, leshjanë dhe dursakë nenë Lek Dukagjinin dhe Nikóll Moneten nga Shkodra, të cilet, të bashkuar me ushterín' e Skenderbeut, kaperxenin të trembedhjetë mijet. Në krye të kesáj ushterie të perzjer dhe të papjekur Skenderbeu bariti kunder Ballabanit. Kur i afrohej Krujes mesój që Jonuzi, i velláj i Ballabán Pashes po vinte me një ushterí per të forcuar ushterinë rrethónjese. E goditi naten, e dermój dhe e zuri rop me gjithë të birin Hajdár. Në mengjést beri një sulmë kunder kryekeshtjelles së

Digitized by Google

rrethimit mi malin Kranjɛ, e zaptój dhe e theu vargun e kɛshtjéllave rrethónjɛse. Nga mája e atí mali i tregój Ballabán Pashɛs tɛ vellanɛ Jonúz dhe tɛ nipin Hajdár, tɛ lidhur me hékura. Ballabán Pasha, i dɛshpɛruar, bɛri njɛ sulmɛ tɛ funtme kundɛr Krujɛs dhe u-vrá prej njɛ Krujani, tɛ qúajtur Gjɛrq Aleksi. Ushtɛria turke, e vɛnɛ midís dy zjarresh dhe e mbetur pa kumandár ushtrɛngua t' a ngrente rrethimin me nxitím, dyke neveritur tɛrɛ kampin, tɛ hiqet nɛ fushɛn ɛ Tiranɛs, tetɛ mile lark Krujɛs dhe nga rrethónjɛse ubé e rrethuar, se Skɛnderbeu ia kishte prerɛ udhɛn e ritiratɛs. Turqit i proponuan Skɛnderbeut t' i jipnin armɛt, municionet, dhe kúajt me konditɛn t' i linte tɛ shkonin tɛ lirɛ nga Shqipɛria. Skɛnderbeu s' deshte mé mirɛ dhe ishte gatí t' a akseptonte kɛté proponím (1), po tɛrɛ kɛshilla dhe krɛrɛt aliatɛ ishin kundɛr. Kɛtá s' ishnin tɛ kɛnaqur veç po t' u merrnin Turqve edhe shpirtin. Lek Dukagjini, kur u-pyét tɛ jipte mendimin ɛ tij, u-pɛrgjéq me dy fjalɛ: "Mi tá!" (2) Tɛ gji-

---

1) Biemmi (L. VI. f. 466) ɛ vɛ nɛ kɛté formɛ: "Mon dispiacque questa offerta a Scander Begh, cui comminciavano i continui pericoli a far piacere i partiti sicuri." Barleti (L. XII, f. 363) thotɛ qɛ Skɛnderbeu nga luftɛtár i rrɛptɛ u-bé i ngadáleshmɛ: "De acerrimo bellatore cunctator factus."

2) "Dipoi parló l' inclito Lech Ducagino, et disse con audatia: *Embetha*, che in Albenesco uol dir ados-

Digitized by Google

thε ishin tε mendjes, veçanerísht mercenarεt dhe vullnetarεt, qε t' i binin armikut e tε mos linin kembε tε gjallε, pa bεrε hesáp qε ushtεria turke, me gjithε humbjet e saj ishte mé tepεr se dy herε m' e madhe, kur ushtεria shqiptare s' ishte mé ajó e para, po njε turmε e paorganizuar, tε cilεn Skenderbeu e çprovój, s' gjeti tamám, dhe s' kuxonte t' i binte njε armiku tε trimεruar nga deshperimi (1) me njε armε aqε tε pashigurtε.

Pas shumε bisediméṣh u-vendós qε as t' i goditin Turqit, as t' akseptojnε konditat e tyre, po tε zenε tε gjitha grykat dhe t' i shtrengojnε Turqit tε jipen nga uria. Kjo edhe u-bé. Po Turqit, kur Skenderbeu ndreqte fortesεn e Krujes dhe sillte ushqime dhe municione, me njε sulmε tε deshpεruar dhe me humbje tε tmerrúara çanε udhen dhe kapεrxyen kufirin, tε ndjekur kemba-kembes prej Shqiptárεve. Pas kesáj, garnizonet turke, tε lena nε disá pika tε Shqiperisε

---

so, perche non gli pareva douerso usare misericordia uerso l' infideli nemici, ma quelli in pezzi tagliare." Anoním, k. 37, f. 42.

Lech Ducagin parla plus librement, selon qu' il était brusc, et promp de la main et de la cervelle, et dit en un mot, *Embeta*, qui signifie en Albanais, A doz." Lavardin, L. XII, k. 2, f. 357.

1) Me keté rasje Barleti i vε nε gojε Skenderbeut njε epigramε tε bukur pεr trimerín' e deshperimit: *"Omnia timentes nihil timent"* domethenε, atá qε kanε frikε nga tε gjitha s' kanε frikε nga asgjé.

Digitized by Google

Mesme, si nε Kidnε e gjetkε, u-zunε dhe u-therrε pa meshirε.

Pεr tε larε trupin e ritiratεs sε tij dhe pεr tε çgjakosur dishfatεn e Ballabán Pashes, Sulltán Mehmedi u-hóth pεrsεrí nε Shqipεrí nε prendverε tε motit 1467. Methuda e tij keté herε ish e ndryshme: Nε vent qε tε bariste drejt pεr drejt kundεr Krujεs, mori anεn e lumit Shkumbín, dyke lenε garnizone nε disá vise tε forta rindertój nε fushεn e Shεn Savrεs qytetin Valm (Elbasanin e sotmε), ku ngriti njε fortesε, qε t' a kishte si bazε operatash (1), dhe arriu nε

1) Rrethimi i tretε i Krujεs mε 1467, i kontestuar prej disá historiáneve, tε genjyer nga besimi i gabuar qε Skenderbeu vdiq mε 1466, a 1467, provohet nga kronikanet turq dhe nga Franza:

"Mohammed, da er fuer jetz Croja nicht erobern konnte baute und befestigte, um Albanien im Zaume zu behalten, die alte Stadt der Walinier, welche, heute Ilbessan genannt, der Sitz eines Sandchakbeg's ist." Hammer-Purgstall, vell. I, L, XIV, f. 492, shenim 9.

"*Quo autem tempore nos Romae morabamur* (9 Qershór—16 Korrík, 1467), impiorum princeps et ameras adversus Albanitas expeditione suscepta, horum ducem Scanterinum clade afflixit, omnia cepit, ac vastavit, et, *condito oppido* prope urbem eorum principem, quae Crua appellatur, *ad euminde lacessendum,* Constantinopolim reversus est." Franza, L. IV, k. 22, f. 425.—Franza, si na thotε aý vete shkoj nga Morea mε 18 Prill tε motit bizantín 6975, domethenε mε 1467 pas Krishtit, arriu nε Ankonε mε 17 Maj, nε Viterbo

Digitized by Google

Adriatík me qellimin tє zaptonte fortesat e anєdetit, Dúrєsin, Çivrilin dhe Leshin, nga tє cilat hynin ushqimet dhe municionet pєr Krujєn, tє cilєn u-bínt qє s' e merrte dot veç me urí, dyke e bllokuar nga deti e nga stereja. Dúrєsin (1) e rrethój dhe e rrahu me top nja dy muaj, po s' bєri dot gjє me gjithє sulmat e tєrbúara tє Jeniçéreve. Çivrilin, fortesєn e Skenderbeut gjysmє tє ndєrtuar dhe tє pamprojtur, e zaptój pa kundershtím dhe e sheshój me top. Pastáj i ra Krujєs dhe bєri disá sulma tє gjákєshme, po u-shtrєngua

---

mє 1 Qershór, nє Romє mє 9 Qershór, shkoj s' andejmi mє 16 Korrík dhe arriu mє 18 Korrík nє Ankonє dhe s' andejmi nє Korfús mє 5 Shtatór, 1467. Shih dhe Fallmerayer, vєll. 9, f. 93-94.

1.—Me kєté rasje Barleti (L. XIII, f. 364) na pєrshkruan Dúrєsin, ashtú si ish ahere, me tempuj, monumente, statuja, amfitheater, dhe kollosin e perandorit Arián qє nga koha e Romєs: "In ea sunt aedes sacrae, templa augusta, atque magnifica. Ibique conspiciuntur imagines Regum, et Imperatorum. Ibi visuntur antiquissima Principum monumenta. Ibi statu Adriani Caesaris, seu potius Colossus ingens ex metallo conflatus, in aeditum locum erectus est ad portam. Caballinam eptentrionєm versus. Arena praeterea, sive Amphitheatrum, mira artє ingenioque constructum. Muri urbis munitissimi, turribus, aliisque insignibus operibus ornati, decoratique. Spectanda quoque ea civitas est maxime in maritimarum specie, salinarum, ac mercium commoditate. Quae demum qualis quantaque fuerit, ipsa ruina docet."

Digitized by Google

prapë të shkonje si heren e parë pa bërë gjë dhe i ndjekur kemba-kembës prej Skenderbeut gjer pertej kufirit. Pranë Ohrisë, Sulltán Mehmedi la një ushtërí për të rúajtur kufiret dhe shkoj i turperuar në Stambóll.

Skenderbeu i spastrój prapë garnizonet turke, të lena në disá pika të Shqiperisë, po kunder forteses së Valmit s' kishte as topa, as ushtërí të mjaftë. Vendi ish i djegur, i shkretuar prej armikut; pópulli ish therrur e shuar; dhe në fortesat turke të Sfetigradit, Modrisës dhe Beratit ushtua tani dhe Valmi. Hallka e hékurtë rreth Krujës forcohej dhe ngushtohej. Armiku, nga dale po qenerísht, pa bërë hesáp therorite, po futej thell' e më thellë në zemer të Shqiperisë. Skenderbeu deshte t' a thýente këté hallkë. Si pas çdo fushate, dolli në krye të komisionit të rekrutimit, bëri lista të ra të njéresve të zotet per armë, dhe mblodhi një ushtërí të re që t' i binte forteses së Valmit (1). Pastáj thirri Kuvendin e Príncerve në Lesh që t' u shtronte aliáteve dhe Venetisë pllanin e tij dhe t' u kerkonte ndihmen ushteriake dhe financiale. Atjé u-semúr nga ethet dhe u-shtí në shtrat nga i cili s' ungrít mé. "Si Ajaksi i Sofokliut (2), Skenderbeu u-hóq nga shkena, para se të mbarohej akti i tretë dhe i funtmë i tragjedisë shqiptare."

1.—Barleti, LXIII, f. 366.

2.—Fallmerayer-i, vëll. 9, f. 94.

Digitized by Google

Katastrofa po afrohej. Zemerimi i Sulltanit kunder Shqiptáreve dhe Veneciáneve ishte aqe i math, sa ne mes te dimrit, nje turme prej 15,000 Turqsh, permés máleve te mbuluar me debore, u-dúk perpara Shkodres. Kur ardhi lajma ne Lesh, kryetrimi, i semure ne shtrat te vdekjes, u-perpóq te ngrihej e te kapte armet, dhe dha urdher qe t' i gatitnin kalin. Po trupi i tij, i tretur nga ethet, nuke leviste nga vendi, dhe garda mbreterore shkoj keté here te leftonte pa mbretin ne krye te saj. Po tmerri i emrit te tij ish aqe i math sa Turqit, me te pare *kohorten pretoriane*, kujtuan qe vinte edhe *aý*, múare aratine dhe u-shuane krejt prej Malesóreve neper grykat dhe pusirat. Skenderbeu me-zí merrte fryme, kur i súalle lajmen e mire te vijtores se funtme. Kur i thane mjeket qe s' kishte mé asnjé shprese per sherím, thirri princerit shqiptare dhe bajlozet e Venetise, te cíleve u la shendét dhe i keshllój t' a vazhdojne luften e perbashkme kunder Turqve. Mbreterín' e tij ia la te birit, Gjon Kastriotit, me mbretereshen si regjente, dhe i porositi qe, po te ndódheshin ne rezík, te shkonin ne qytetet qe i kishte falur Ferdinandi i Nápolit. Munt t' a marrim me ment hidherimin qe ndjeu Skenderbeu, kur hodhi rreth tij syrin e mjegulluar nga hija e vdekjes dhe s' pá asnjé princ shqiptár, te zotin per te pasuar vepren, te cilen vdekja s' e la t' a mbaronte. Pastáj u-pershen-

Digitized by Google

dósh me tɛ gjithɛ, kungój, e dha shpirt mɛ 17 tɛ Jenarit, 1468 (1), nɛ vɛrsɛ prej 56 vjetsh, pas njɛ mbretɛrimi prej 24 vjetsh e dy muajsh, tɛ shkuar nɛ lufɛ kundɛr Turqve pɛr lirín' e Shqipɛrisɛ dhe pɛr mprojtjen e Evropɛs.

---

1) Datɛn *17 Jenár* na e japin Barleti dhe Dimitɛr Frɛngu me Anonimet, motin 1468 Franza, L. IV, k. 22, f. 430: *"Mense Ianuario ejusdem anni* (6976 tɛmotit bizantín, domethɛnɛ 1468 pas Krishtit) *Albanitarum princeps Scantares morbo obii."* Ky mot i vdekjes sɛ Skɛnderbeut vɛrtetohet nga arshivat e Millanit e tɛ Venetisɛ:

Bajlozi i Millanit nɛ Romɛ, Augustinus de Rupeis, nɛ njɛ rapórt zyrtár qɛ i bɛn guvernɛs sɛ tij *mɛ* 3 *Gusht,* 1467, e lajmɛrón guvernɛn e tij pɛr rrethimin e Krujɛs e tɛ Dúrɛsit dhe çfaq bɛsimin qɛ, pas lútjeve tɛ bajlózɛve venɛcianɛ, Papa do t' i dɛrgonjɛ nonjɛ́ ndihmɛ financiale Skɛnderbeut (Pisko, Appendix): "De le cose del Turcho se la adviso, che le molto grosso in Albania et fa contra Croya et anche Durazzo grandissima et et crudelissima guerra. Questi ambasadori Venetiani ancora a questa parte solicitano molto el papa di provisione. Credo se manderá de qua qualche soccorso de denari a Scanderbegho." Me fjalɛ tɛ tjera, Skɛnderbeu s' kish vdekur gjer mɛ 3 Gusht, 1467.

Nga ana tjatɛr lajma e vdekjes sɛ tij arriu nɛ Venɛtí mɛ *13 Shkurt 1468,* se ketɛ́ ditɛ mblidhet Senati i Venetisɛ dhe dɛrgón kryepeshkopin e Dúrɛsit me porosí qɛ tɛ bɛnjɛ ç' tɛ jetɛ e mundur qɛ tɛ mbetej Kruja dhe principata e Skɛnderbeut nɛ dorɛ tɛ Gjon Kastriotit, dhe *po tɛ ndódhɛshin nɛ rezík,* t' i mɛrrte nɛ-

Digitized by Google

Kur vdiq Skenderbeu, asnjé sy nuke mbeti i paperlotur. Mbreteresha dhe i biri dymbdhjetevjeçar, te gjunjezuar perpara kufomes se tij po lebetiteshin. Príncerit, rreth e rrotull, po qanin si foshnja, dhe e vajtonin pas menyres shqiptare

---

ne mprojtjen e Republikes *me zotimin e shkruar qe do t' ia kthenin prape* (S. Romanian, Storia Documentata di Venezia, vell.IV, f. 333): "Fino dal 13 febbraio 1468, era giunta a Venezia la notizia della morte di Scanderbeg in Alessio, e testo partí a quella volta l' arcivescovo di Durazzo con commissione di fare il possibile per conservare Croja e gli altri luoghi nel possesso dei figli di lui, e quando fossero in periculo accettassa tutti quei luoghi sotto la protezione della Republica, promettendo questa anche con carta di restituirli (Secr. XXIII, p. 94); andasse Francesco Cappello, che giá trovavasi in quelle parti, a tutelare il paese, al quale scopo gli si mandavano truppe e Munizioni."

Nga te sípermet provohet qe Skenderbeu vdiq ne Jenár 1468; qe si trashegimtár la te birin; qe Krujen dhe mbreterín' e tij nuk ia dha Venetise as me traktét perpara vdekjes, as me testamént pastáj, ndryshe nuke do t' ish nevoje per Senatin e Republikes te bente kártera me te birin qe t' a merrte Krujen nene mprojtje dhe pastáj t' ia kthente prape; qe Kruja *nuke ndodhej ne rezík*, kur vdiq Skenderbeu, se Kryepeshkopi i Dúresit shkon me porosí te perpiqet qe Kruja t' i mbetet te birit te Skenderbeut, dhe po te kthéheshin prape Turqit e te ndodhej ne rezík, ahere t' a merrte Krujen nene mprojtje te Republikes.

Digitized by Google

me kenge (1): "O trim Gjerq, Zot e Mbret, ô ate i shenjte dhe mprójtesi yne, qýsh na lé jetime dhe te shkrete si dhente pa barí? Kú te vemi taní te kerkojme ndihme ne shtrengimet? E kúsh do te na mpronje taní nga armiqte dhe nga terbimi i Turqve? Mjere ti, ô Shqiperí, mjere né derezeste, mjer' i math, e mjer' i vogel, mjere tere Krishterimi qe humbi nje te ketille kryemprojtes!" Lek Dukagjini, si i marrosur nga hidherimi rendi ne shesh te qytetit e, dyke çjerur kraharorin, e dyke çkulur mjekren dhe floket, bertiti (1): Ejani, ô Shqiptare! Sot rá kryekeshtjella e Shqiperise; fortesat tona u-permbysne; fuqia jone humbi; qytetet tona rane perdhé; tere shpresa jone u-shua me vdekjen e nje burri!" Klithmat zemer-çjérese dhe te mallengjýera te pópullit e mbuluan keté lajmerím te Dukagjinit, te cilin e vertetonin tingellimet vajtimtare te kembánave.

Atjé tej degjohej hingellimi i deshperuar, i mallengjyer, i ngjirur, i keputur i nje kali. Ishte kali luftetár i Skenderbeut, qe vajtonte te zotin. Mihte dhene me terbím, renkonte si i plagosur per vdekje, dritherohej e ngjethej si nga e ftohta e étheve, çfrynte avull e leshonte lote si njerí. Qe kur u-shtrí Skenderbeu ne shtrat, u-semúr edhe aý; dhe kur vdiq, u-egersua, s' qaste njerí tjater qe t' i hipte, s' deshte mé te hante,

1) Dimiter Frengu, k. 40, f. 216.

Digitized by Google

s' deshte mé tɛ rronte, e u-shtrí e vdiq pakɛ ditɛ pas tɛ zotit (1).

Skenderbeu u-varrós nɛ kathedralin e Shen Kollit nɛ Lesh. Tɛ gjithɛ príncerit, oficerɛt dhe ushtarɛt e tij me garden mbretɛrore e percúallɛ nɛ banoren e funtme. Gjemimi i tópave dhe kercellimi i púshkave lajmeruan qɛ kufoma e tij zbriti nɛ varr dhe, bashkɛ me té, edhe Shqiperia e lirɛ.

Shqiperia e qau dhe e vajtój vjete me radhɛ. Evropa derdhi lotɛ tɛ hídhura. Tɛ gjithɛ hoboret, an' e mb' anɛ Evropɛs mbajtin zi, se ish e perhapur aqɛ shumɛ nɛ botɛ sa dhe armiqve u vinte keq per vdekjen e tij.

Kur e degjój Sulltán Mehmedi tha: " Njɛ Iuán tɛ tillɛ do mos lindɛ mé dheu kurrɛ!" dhe pastáj shtój: "Taní Evropa dhe Asia janɛ tɛ miat! Mjerɛ Krishterimi, se i humbi shpata dhe mburonja!"

Per tɛ hapur udhen e Romɛs, qɛ ia kish vɛnɛ syrin taní, Sulltán Mehmedi vazhdój fushaten e tij kunder Shqiperisɛ. Lufta mbajti 11 vjet pas vdekjes sɛ Skenderbeut dhe s' munt tɛ mbaronte veç me shojtjen e plottɛ tɛ njeres palɛ. Taní s' mbetej mé asnjé dyshím cila anɛ ish e denuar prej fatit. Arɛsyet, per tɛ cilat Shqiptarɛt u-thyen nukɛ janɛ tɛ renda per tɛ gjetur: 1) Tur-

1) Anoním, k. 41, f. 45 v.

Digitized by Google

qia ishte një pus ushtériák i pasosur, kur kapitali njerezór i Shqipërisë nisi të pakësohej dhe ishte më të shuar e sipër. 2) Turqia, që kur nisnë lúfterat shqiptaro-turke më 1362, pati një serí Sulltanësh të medhénj, si Muradi I, Bajazidi I Jillderemi, Mehmedi I, Muradi II, dhe Mehmedi II, kur fati doreshtrenguar nuk i dha Shqipërisë veç *një* Skenderbé. 3) Turqit ishin një komp i bashkuar si një shkëmp rreth Sulltanit, aqë nga fanatizma sa dhe nga disiplina ushtériake, kur Shqiptarët kanë qenë ahere, si dhe sot, një elemént qender-ikës, të pabindur e të pabashkuar, të cilët më-zí i mbante pak a shumë të lidhur kryemendja sipërnjerezore e Skenderbeut. Çudia është vetëm qýsh, pas vdekjes së tij, Shqipëria e kapitur, jetime, e neveritur krejt prej Evropës, mundi me Venetinë bashkë të qendronte kunder kollosit turk njëmbedhjetë vjet më kembë.

Fryma heroike, që kish përhapur Skenderbeu, si gjysmë-perendi, e vjetërisë, rronte e gjallë në zemrat e Shqiptárëve vjete passí fluturój në qiell shpirti i ndriçim i kryetrimit. Valle vajzash shqiptare, si Vallkyrat e legjéndave gjermanike, mblídheshin regullísht çdo tetë ditë mi kështjellat ku kishte mbreteruar dhe, midís buçitjes dhe oshetimës së betéjave, kendonin hymne levdatore për kryetrimin e vdekur të kombit dhe i lúteshin, si një shenjti, që t' i shpetonte nga armiku i terbuar dhe t' u falte vijtoren flámurit dhe ármëve kombë-

Digitized by Google

tare (1). Shqiptarɛt, tɛ ndezur nga ketó kengɛ trimɛrore, e shikonin me sy hien e Skɛnderbeut kaluar nɛ krye tɛ tyre dhe leftonin si luanɛ me forcɛ tɛ pɛrsɛritur.

Lidhja e krérɛve shqiptarɛ ishte laverуar, posá u-çdúk aý qɛ i kish dhenɛ shpirt e forcɛ bashkimit. I biri, Princ Gjon Kastrioti, i cili ish dymbɛdhjetɛ vjetsh kur i vdiq i ati, kishte emrin dhe tɛ drejtat dinastike, po ish tepɛr i vogɛl qɛ tɛ vihej nɛ krye tɛ Ligɛs dhe duket qɛ s' kish trasheguar cilesít' e pazakóneshme t' ett. Mɛ 1474 ia dorɛzój Republikɛs sɛ Venetisɛ Krujɛn dhe principaten atɛrore dhe shkoj me mbretɛreshen nɛ Trani tɛ Italisɛ. Pjesat e Shqipɛrisɛ, tɛ zaptúara prej Turqve, u-vunɛ nenɛ qeverimin e njɛ tɛ nipi prej motre tɛ Skɛnderbeut, i cili ishte kthyer Muhamedán e rronte pranɛ Sulltanit (2).

---

1)"Quod factum esse ajunt, ut post ejus mortem eximia viri admiratione populi imbati, quasi in illo aliquid vidisseut quod humanum excederet fastigium, grati principis memoriam solemnibus consecrabant carminibus. Reluterant mihi digni vivi, vel medio ardore belli, et tum quum Barbarorum armis omnia strepebant, puellarum coetus in his rubibus, quibus ille imperavit, octavo quoque die mediis triviis coire solitos, ac defuncti principis (ut veteres magnorum heroum in conviviis solebant) laudes decantare." Sabtlico Decad. III, f. 568, Basilea 1570.

2.—"Cujus (Scanderbegi) regions et dominii partem res publica Venetorum, partem sororis ipsius fi-

Digitized by Google

Arianiti kishte vdekur mε 1461 dhe tε vétemit princer luftetarε, qε pεrmenden pas Skenderbeut janε Lek Dukagjini dhe Gjon Muzaka. Shqiptaret nukε pushuan sε lεftúari, po pushuan sε shkrúari. Asnjé kronikán s' na ndriçón mi lufton e ketyre vjéteve tε funtme dhe s' dimε hollesísht veç rrethimet e Krujεs e tε Shkodrεs, tε cilat na i pεrshkruan Barleti (1), dhe me tε cilat mbyllet akti i tretε dhe i funtmε i tragjedisε shqiptare. Dy herε nε mot, mε tε korrε e mε tε vjelε, nε verε e nε vjeshtε, vinin ushterite turke regullísht pεrpara Krujεs, Dúresit, Leshit e Shkodrεs, tε cilat mpróheshin prej garnizonesh tε pεrzíera veneto-shqiptare (2). Nε çdo rasje e shkretonin vendin me zjarr e me hekur qε t' i shtrengonin fortesat tε jípeshin nga uria. Mun pεrpara kryeportεs sε Krujεs, Turqit kishin ngritur njε keshtjellε me njε garnizón tε fortε pεr tε vazhduar bllokaden e kesáj fortese tε urryer dimεr e verε.

---

lius Turca, qui apud Ameram vivebat, missus ab eodem occuparit." Franza, L. IV, k. 22, f. 430.—Cili ishte ky nip i mbarε dhe nga cila motεr nukε dimε.

1) Marini Barletii, De Expugnatione Scodrensi, Venetí 1504.

2.—"In Epiro, ab initio suscepti belli, quasi statis diebus bis quotannis circa Scodram, hissum, crojam et alia oppida, quae in ea ora Venetí tenebant, sub messium et vindemiarum dies Barbarorum equitum alae erumpebant." Sabellico, Decad.III, f. 568.

Digitized by Google

Mε 1476, Sanxhák Beu i Bosnjεs Omár i mundi ushterite veneciane nene Geronimo Novello'n afer Gradiskes, zaptój provincen e Friulit qe nga lumi Isonzo gjer ne Tagliamento, dhe baristε kunder Venetisε. Qendrój perpara forteses se Udine's dhe, qε tε çgjakesohej per mosmarrjen e saj, e plaçkiti dhe shkretój me zjarr e me hekur krahinen e Friulit.

Ne prendvere te motit 1477, Ahmed Beu me nje ushterí prej 8,000 e rrethój Krujen nga te gjitha anet. Atjé kish arrire puna sa Turqit, me nje ushterí kaqe te vogel, kishin shprese t' a merrnin Krujen, perpara se ciles u-práps me turp tere ushteria turke nene Sulltán Murad II e Mehmed II. Kumandár i Krujes ishte veneciani Pietro Vettori. Ahméd Beu, mé i mençur se Sulltanet, nuke humbi as kohe as gjak ne sulma te papémeta, se pesimet e tyre e kishin bindur qe Kruja s' munt te merrej me force. E bllokój pra dhe e la urine t' ia mbaronte punen. Sa humbi Shqiperia me vdekjen e Skenderbeut duket ne keté rasje. Nje ushterí veneto-shqiptare prej 13,000 nene kumandarin e Shkodres Francesco Contarini dhe Lek Dukagjinin ardhi me 6 te Statorit, 1477, per te shpetuar Krujen, e goditi dhe e mundi Ahméd Bene ne fushe te Tiranes se Vogel, kater mile lark Krujes, dyke zaptuar kampin e ushterise turke. Ne vent qe t' a ndiqnin e t' a farosnin Ahméd Bene krejt, Contarini dhe Dukagjini i lane

Digitized by Google

ushtaret e tyre tε plaçkitin kampin e tε perndahen mε tε djatht' e mε tε mengjεr. Ahméd Beu, si i pá kεshtú tε perndarε e tε çkujdesur, i goditi natεn, me dritεn e henεs, dhe i copetój krejt. Midís tε vrárεve, ishte dhe vetε kumandari venecián Contarini. Pas kesáj dishfate Venetia, e goditur prej Turqve nga tε gjitha anet, nε Shkodrε, nε Dalmatí, nε Isonzo e nε Tagliamento, e shtrydhur dhe e dobesuar nga financat e nga ushtεria, e shtyrε vetε nε buzε tε gremines, e neveriti Krujεn nε fatin e saj. Me tε ngrenat e plaçkítura nga Turqit nε bεtejεn e Tiranes sε Vogεl, garnizoni u-mbájt tεrε dimrin dhe pasój kundershtimin. Vetem prej njε bllokade prej mé teper se trembεdhjetε muajsh, si u-mbaruan ushqimet dhe s' kishte mé asnjé shpresε ndihme sε jashtmi, garnizoni dhe Krujanet nisnε tε mendohen per kapitullatε. Kur u ardhi lajma qε vetε Sulltán Mehmedi kish rrethuar Shkodren, derguan mε 15 Qershór, 1478, parllamentarε nε kryeqendren turke dhe proponuan t' a dorεzonin fortesεn me konditεn qε tε líheshin tε shkonin lirísht me armet dhe plaçkat e tyre. Sulltani e akseptój me gεzím kεté kondite dhe shkeli pastáj me pabesín' e tij tε zakónεshme. I la Krujanet dhe garnizonin tε dalin nga fortesa, tε cilεn e shtiu nε dorε, dhe pastáj dha urdhεr t' i therrnin burrat pa meshirε, t' i skllaverονin gratε dhe femijεn, dhe tε mbanin vetem kumandarin venecián dhe kreret e

Digitized by Google

pasur, tє cilєt munt tє çpєrbléhєshin me pará. Kєshtú u-çgjakєsua Sulltán Mehmedi II pєr dishfatat e tija, tє t' ett e tє gjenerálєve tє tij pєrpara Krujєs. Veç ndénjєsve, Turqit deshnin t' i shúanin Krujєs edhe emrin, dhe e pagєzuan Ak-Hisár, domethєnє Kєshtjella e Bardhє.

Gjithє kєté verє ranє fortesat e Leshit, tє Drishtit e tє Xhabjakut. Mє 25 Jenár, 1479, pas njє rrethimi tє dytє prej 15 muajsh dhe pas njє mprojtjeje heroike, Shkodra kapitullój nga uria me konditєn qє garnizoni dhe ndénjєsit tє delnin lirísht me armєt dhe plaçkat e tyre. Sulltán Mehmedi, kєté herє, s' munt t' a shkelte fjalєn e tij, se kumandari venecián Antonio de Lezze kєrkój dhe mori nga Sulltani disá veta, si penk tє besnikєrisє sє tij. Shkodranєt refugjiatє u-vєndosnє nє Venetí me pєrkrahjen e Republikєs. Njє ditє para se tє binte Shkodra, Venetia kishte bєrє paqe me Turqinє, sє cilєs i lєshonte tєrє Shqipєrinє, veç Dúrєsit.

Tє gjithє príncєrit shqiptarє qє kishin lєftuar kundєr Sulltanit, si aliatє tє Venetisє u-neveritnє nє fatin e tyre. Njє nga kєtá ishte Gjon Muzaka, auktori i Gjeneallogjisє. Ndonєsé Sulltani i blatonte pasurira dhe nder, i kish refuzuar tє gjitha dhe vazhdój luftєn trimєrísht gjer sa ra Shkodra. Ahere e gjeti veten nє mєshirє tє Sulltanit dhe, i lajmєruar prej disá miqsh iku natєn me tє birin, me tє bijєn dhe me tє shoqen, prin-

Digitized by Google

ceshen Maria nga dera e Dukagjinit, nε Durεs. Atjé e shoqja, e cila qé me barrε, lindi njε foshnjε, qε u-pagεzua fshéhtazi pa ditur e kujt ishte. Komisarε turq ardhε nε Durεs dhe kerkonin Gjon Muzakεn, i cili ishte hedhur me njε varkε nε Italí. E shoqja u-fsheh nenε njε shtrat dhe shpetój per qime, kur bastisnε komisarεt turq shtepinε ku ishte fshehur. Keshtú e pesuan dhe qε tε gjithε príncerit e tjerε, tε cilεt u-shtrenguan a tε iknin, a tε kthéheshin muhamedanε (1).

Me míjera shqiptarε, qε s' duronin dot zgjedhen turke iknε nε Evropε, veçanerísht nε Italí, ku ndodhen gjer mε sot afró 200,000 prej syresh qε flasin shqip e kanε mbajtur zakonet dhe traditat kombεtare. Kur Shqiptarεt e Shqiperisε,

1.—Muzaka, Hopf, f. 276-277. Muhamedanizma nε Shqiperi u-perháp mé parε neper kreret, ca prej tε cíleve u-kthyen nga interesi dhe pa shtrengicε qε nga koha e Bálsheve, dhe tε tjerεt nga e keqja pas vdekjes sε Skenderbeut. Nε popull u-perháp dale nga dale nε shekujt e pastajme. Çermenika u-kthye nε kohen e kryengritjes frenge mε 1793, dhe pjesa m' e madhe e Laberisε nε kohen e Ali Pashes, nε krye tε shékullit tε nentembεdhjetε. Atá prej tε Krishtéreve qε s' u kthyen muhamedanε, qε tε shpetonin nga vdekjet, u-hodhe nga katholikizma nε kishen orthodoksε tε Patrikanes sε Stambollit. Mbetnε katholikε vetem Malesorεt e veriut mε armet nε dorε. Himariotεt qendruan besnikε tε Papes gjer nε mes tε shékullit tε tetembεdhjettε, dhe u-kthyen orthodoksε nε kohen e Katerinεs sε Madhe.

Digitized by Google

qindra vjete pastáj, i kishin harruar Skenderbeut edhe emrin, Shqiptaret e Italisë e mbanin kujtimin e kryetrimit të kombit me kenge dhe legjenda tradicionale. Papa Pal II në një letrë i përshkruan Filipit, Dukes së Burgonjes, mjerimin e këtyre refugjiáteve: "Nuke munt t' i shohë njeriu pa derdhur lote këtá refugjiatë neper limanet e Italisë, të uret e të çveshur, të çkulur nga vatrat e tyre, që rrinë anes detit, e ngrenë dúarte në qiell, e qajn' e vajtojnë në një gjuhë që s' ua marrim dot vesh."

Më 1481, i bir' i Skenderbeut, Gjon Kastriotì, i thirrur prej Shqiptáreve shkoj nga Italia në Shqipërí, zaptój një pjesë të madhe të mbretërisë atërore me ndihmen e Himarjóteve dhe theu një ushtërí turke prej 2,000 që u-dergua kunder tij (1). Kryengritja u-përháp në verí e në jugë dhe me-zí u-thye pas disá vjetsh. Dhe ahere nisi një tjatër ikje krerësh dhe Shqiptaresh në Italí. Po këté here, mbreti Ferrante i Nápolit nukë e qasi Gjon Kastriotin me Shqiptaret e tij dhe s' e lá të zbresë as në Palermo as në Napoli, nga frika se mos i dekllaronte lufte Sulltani. Shkoj pra dhe i ra ner kembë Papes, i cili e ndreqi punen dhe kështú Shqiptaret u-vendosnë në Sicilí e në Kallabrí po të përndarë, jo më një vent, dhe s' kishin

---

(1)—Annali di Domenico Malipiero, Shih Pisko, Skanderbeg, f. 160.

Digitized by Google

tє drejtє tє ndertonin qytét a kєshtjellє (1). Mє 1488, Gjon Kastrioti bєri njє pєrpjekje tє dytє pєr tє rifituar mbretєrinє atєrore dhe mє 1500 e gjejmє nє Venetí, ku Senati me njє dekrét mє 9 Prill, 1500, vendós t' a ndihmonje me ushtєrí dhe pará e t' a dergonjє nє Shqipєrí (2).

Mє 1499, Turqit zaptuan me pabesí Dúrєsin dhe Venecianєt, pєr çgjakєsím, u rrembyen Leshin. Mé nє funt, Turqia dhe Venetia bєnє paqe mє 14 Dhjetór, 1502, pas sє cilєs Shqipєria e tєrє i mbetej Sulltanit, veç Tivarit dhe Ulqinit, tє cilat i zaptój mє 1571.

Kєshtú nє kohєn, kur Evropa dilte nga koha e Mesme dhe hynte nє Rilindjen e Qytetєsisє, Shqipєria shuhej nga lista e shtéteve tє lirє dhe hynte nєnє zgjedhen e urryer tє njє fuqie barbare, nєnє tє cilєn vúajti mé tepєr se katєr shekuj.

1.—Historín' e Gjon Kastriotit, tє birit tє Skєnderbeut, e tregón, pas tradites pópullore, njє doreshkrim i shkruar prej Agostino Tocci-t mє 1650. Pas ketí doreshkrimi, Gjon Kastrioti nukє vajti nє Nápoli, pas vdekjes sє Skєnderbeut, po vazhdój luften pєr dymbєdhjetє vjet gjer sa u-kthye dhe u-shtrєngua tє ikє nga Tivari me ca anie veneciane pєr nє Sicilí. Doreshkrimi i Agostino Tocci-t u-botua prej Girolamo de Rades nє gazeten e tij La Bandiera d' Albania (Flámuri i Shqipєrisє). Pєr fat tє keq, s' munda t' i gjenja númєrat e kesáj gazete, ku u-botua ky doreshkrím i interesmє, qє t' a pєrdornja nє ketє historí.

2.—Shih Pisko, Skєnderbeg, f. III.

Digitized by Google

Vendi u-shkretua krejt; tregeria u-venít; qyteteria u-shua; çdo lidhje me Evropen u-pré. Keshtjella dhe qytete, te lulezúara ne kohe te Skenderbeut, me pallate dhe monumente, si Patrella, Petralba, Stellushi, Tornaçi, Sarda, Drishti, Danja, Vulpiani dhe Sfetigradi humpne fare nga faqia e dheut; te tjera si Kruja, Dúresi, Shkodra, Leshi, Vlora, Kanina, Berati dhe Gjinokastra u-venitne dale nga dale dhe mbetne si híera te bukurise dhe shkelqimit te tyre te vjeter.

Sa rendesí jetesore kishin per Evropen fushatat e Skenderbeut u-dúk passí ra Kruja dhe Shkodra. Me 1480, Sulltán Mehmedi, posá zaptój Shqiperine, u-dérth kunder Italise. Amirali Ahméd Gjedík Pasha, Shqiptár nga raca, me nje flote dhe me nje ushterí te forte, u-hóth nga Vlora ne Otranto. E zaptój keté qytét dhe gatitej te hidhej kunder Romes. Italia e tere dridhej, Papa mendohej te ikte nga Roma, kur me 3 te Majit, 1481, Sulltán Mehmedi, midís pregatítjeve qe bente per te zaptuar tere Evropen, vdiq para se te realizonte énderen e tij, gje qe do t' a kishte bere, sikúr te mos ia kishte mbyllur udhen mé pare Shqiperia nene Skenderbene.

Kjo eshte mjaft qe t' i japë Skenderbeut, ne historín' e Evropes, nje vent te nderuar midís mprójtesve mé te medhénj te saj kunder barbarise asiatike. Sikúr t' a kishin ndihmuar fuqite evropjane, ashtú si duhej, Skenderbeu do te loste

Digitized by Google

një roll shumë mé të math e munt t' a dërmonte fuqinë turke para se të rritej. Po Evropa ndenji e ftohtë, dhe fati e desh që Papa Pius II, një nga të vétemit burra të kohes së tij, që e çmonte Skenderbenë pas vleres dhe deshte t' i jipte punen që meritonte, të vdesë pikerísht kur gatitej të hidhej në Shqipërí në krye të kryqetáreve evropjanë.

Nga forca e rásjeve Skenderbeu u-mbajt në defensivë dhe çudia eshtë si mundi të qendronte më kembë aqë vjet. Me një ushterí të vogël, pa topa, pa pará, me niper dhe shokë, që e tradhetonin osé e pengonin më çdo çap, mbeti i pamundur, i patundur, i padeshperuar, mproj lirín' e Shqiperisë dhe mbajti fatin e sinisisë ballkanike njezét e kater vjet në ballancë, leftój gjithenjé i pari në sulmë, i funtmi në ritirate, dhe fitój beteja të shkelqýera që e vënë në radhen e gjeneráleve të parë të botes.

Turqit, të mundur gjithenjé, kur e kishin kunder, arrinë të besonin që ishte gjysmë-perendí dhe e nderonin jo mé pak se Shqiptaret. Kur e múarë Leshin, e hapnë varrin e tij, jo që t' a desekronin, po që t' ia ndanin midís tyre koskat, të cilat i peshtillnin me ar e argjént dhe i varrnin më qafë si hajmalira të shenjta dhe çudibérese që t' u shtohej trimeria e të mos i zinte plumbi.

Bukuria e pamjes së tij dhe madheshtia e shtatit bashkóheshin me një forcë trupesore të perminjerishme. Shpata e tij bënte çudira. Me

Digitized by Google

një të goditur të saj ia preu koken një demi të eger që shkretonte arat e së motres Mamicë. Në rrethmin e Krujes, për të çgjakesuar rjepjen e pashpirtme të Moisiut dhe të shtatë oficéreve, me një goditjé të shpatës i coptój më dysh të vëllán' e Ballabán Pashes, Jonúz me të birin Hajdár. Në bëtejë, e kishin parë të çante me shpatën e tij burra t' armatisur nga koka në kémbet. Turqit kujtonin që shpata e tij ish e magjepsur dhe, pas paqes së motit 1461, Sulltán Mehmedi ia kerkój si dhuratë. Skenderbeu ia dorezój me një herë, po Sulltani ia ktheu prapë, dyke thënë që s' ishte shpata që kerkój, posá nukë ndryshonte nga të tjerat më të prerë. Skenderbeu, dyké neneqeshur, i tha ambasadorit turk: "I dergova shpatën e mirë, po s' munt t' i dergonja dhe krahun bashkë!"

Energjia morale dhe kuraja e tij janë ca mé të çudíçime, dhe me ketó Skenderbeu fitój një vent në radhën e parë të kryetáreve të pavdekur. Keshtú, në kohën, kur fuqia turke ishte më t' arrirë kulmin e saj, niset me treqint veta për të shpëtuar Shqipërinë nga zgjedha. Qýsh ndodhej Shqipëria, kur vajti t' a shpëtonte? Kishin mbetur vetëm pleqtë, na thotë Gjon Muzaka (1), se të rinjtë pothua ishin vrarë që të gjithë në lúfterat e paprera kunder Turqve. Në një lufte për vdekje prej njezét e katër vjetsh, më ç' ushterí u bënte

1.—Muzaka, Hopf, f. 274.

Digitized by Google

ballε mizerive turke? Me njε grusht trimash, qε i frymezonte me heroizmen e tij. Sa mé teper rríteshin reziket, aqε mé teper i çelej fytyra; nε syrin e tij shkrepetinte vijtorja.

Shumε herε Turqia, tmerri i Evropes i blatoj paqe. Skenderbeu hiţte poshtε kryelartesísht çdo proponím qε nukε pajtohej me dignitetin dhe independencen e Shqiperisε; dhe ketέ gjε e bente nε kóhera kritike, kur humbja e tij dukej fare e shigurte. Jo vetem s' kerkój paqe kurrε, po e theu dhe até tε vétemen qε beri, posá ubínt qε ashtú e deshte e mira e Shqiperisε dhe e Evropes, pa u-trembur nga bara e njε pergjígjesie aqε tε madhe.

Ish i palodhur nga shpirti dhe nga trupi: gjithenjé nε levizje, kurrε nε prehje, hante me ushtaret, flinte i armatisur nε kamp, me gunen, e nε rrogós. Pesε orε gjumi i shin mjaft nε kohε qetesie, dy a tri orε vetem nε kohε shtrengice. Hante dhe pinte shumε, po duronte ditε me radhε pa ngrenε. Si Hannibali dhe Napoloni, vishej vetε pa lluse e pa madheshtí, po ushtaret i deshte tε stolisur me ar e mendáfsh, tε ushqyer mirε dhè tε paguar pasurísht.

Nε betejat, kursente mé teper ushtaret se sa veten e tij. Edhe leftonte edhe e drejtonte betejen. Nga shpejtesia e çudíçime dhe rreptesia dermónjese e godítjeve tε tij munt tε barabitet vetem me Jul Qesarin, nε mos me shkreptimen e rrufesε.

Digitized by Google

Me ushterira tɛ vogla thýente gjithnjé ushterira dy a tri herɛ mé tɛ mɛdhá, dhe çdo herɛ e ndronte methuden. E shijonte bɛtejɛn nɛ tɛ gjjitha format: nɛ fushɛ tɛ hapur, nɛ pyll, mɛ nonjé vent tɛ fortɛ, kur i binte nɛ kamp tɛ fortifikuar; kúr e shtynte, kúr e zvarniste gjer nɛ pusín' e zgjedhur; nɛ tɛ thyer ushtɛritɛ rrethónjɛse, nofta s' ka shok nɛ historí tɛ botɛs. Armiku e gjente gjithenjé t' armatisur dhe gatí. Me tɛ mbaruar njɛrɛn bɛtejɛ, gatitej pɛr tjatrɛn. Pjesɛn e rendɛ e merrte vetɛ, tɛ lehtɛn ua jepte gjenerálɛve tɛ tij. Plaçkat dhe paratɛ qɛ fitonte nga armiku ua pɛrndante qɛ até ditɛ oficérɛve dhe ushtárɛve.

I ɛgɛr dhe i rrɛptɛ nɛ bɛtejɛ e sipɛr, ishte zakonerísht aqɛ zɛmɛrmirɛ sa jo vetɛm vullnetarɛ nga anɛt e funtme t' Evropɛs po edhé Turq nga Turqia vinin e kthéhɛshin tɛ krishtɛrɛ qɛ tɛ shɛrbenin nɛnɛ kumandɛn e tij. Ndonɛsé rronte nɛ njɛ kohɛ, kur zakonɛt ishin tɛ égɛra dhe lufta pa mɛshirɛ, prapɛ ishte njɛrɛzór dhe kurrɛ s' i kishte lɛnɛ ushtarɛt, nɛ plaçkitjet e víseve armike, tɛ ngisnin grua, plakɛ, a çilimí.

Nga moralí, ndonɛsé i rritur nɛ njɛ hobór tɛ korruptuar, mbeti puritán malɛsór. Si Gustáv Adolfi i Suedisɛ s' linte gra, tɛ mira a tɛ liga, t' i afróhɛshin kampit tɛ tij, dhe ndiqte mɛ ashpersí prej fanatiku çdo farɛ immoraliteti. Si Skipión Afrikani, s' u qasej grave, dhe u-shtrɛngua tɛ

Digitized by Google

marrtohet vetem per shkake politike, pas shtyrjes dhe lútjeve te keshilltáreve te tij.

Luftetár i math ishte edhe dipllomát nga mé te hollet se mundi jo vetem te fitonte simpathín 'e fuqive evropjane, te cilat pak e shume e ndihmuan moralísht dhe materialísht per te pasuar luften e lirise, po qé dhe i zoti—i vétemi ne tere historín' e kombit—t' i lidhe kreret e palidhur, t' i bashkonje e t' i organizonje Shqiptaret e pabashkúarshme e te pabíndurshme ne nje ushterí te régullshme dhe te disiplinuar. Per te bere keté s' i arrinte zotesia ushteriake, po i duhej nje durím dhe nje hollesí dipllomatike nga mé te rallat. Nje anekdote, qe e kendojme ne historín' e Anonimit (1), na tregón me ç' fare elemente organizój Skenderbeu nje ushterí: Nje dite, tek u jipte ushtáreve kumanda, nje prej syresh, ne vent qe te mbaronte úrdherin qe mori, i u-pergjéq aqe paturpesísht, sa Skenderbeu i zemeruar nxori shpaten dhe i u-derth persiper. Ushtari, i trembur, i ra kalit dhe iku me vrap qe te shpetonte. Skenderbeu e ndoqi gjer sa arrine me nje lume. Atjé ushtari e ktheu kalín, nxori shpaten dhe i tha Skenderbeut te qendronte, se kish t' i thoshte ca fjale. Skenderbeu qendrój dhe ahere ushtari i çfaqi pendimin e tij qe i shkau gjuha dhe i lutej t' ia falte fajin, se do mos e bente tjater here; po

1.—Anoním, k. 41, f. 47 v.

Digitized by Google

tɛ mos ia falte, ahere do tɛ leftonte si burrɛ me burrin pɛr tɛ mprojtur jetɛn e tij nga e keqja, se s' kishte qysh t' a kapɛrxente lumin. "Nukɛ do tɛ tɛ ngas, i tha Skenderbeu, tɛ cilit i iku zemrimi nga fjalɛt e paprítura tɛ ushtarit, po eja me mua, se qenke trim!"

Fallmerayer-i, me gjithɛ ftohɛtsín' e tij kritike, e karakterizón Skenderbenɛ keshtú: "Gjerq Kastrioti ɛshtɛ njɛ nga kryeluftɛtaret mé tɛ mbaruar, mé faqebardhɛ dhe mé tɛ medhénj tɛ botes (1). Sa qé i gjallɛ, e rúajti lirín' e kombit; ketɛ nukɛ mundi t' ua lerɛ si trashegím sterníperve tɛ tij, ashtú si nukɛ muntnɛ dhe as tɛ dy bashkatdhetaret e tij tɛ degjuar, Pirua dhe Alí Pasha; po kɛtá i kapɛrxeu jo vetem nɛ madheshtí morale, po dhe nɛ fatmiresinɛ qɛ u-hóq nga fusha e veperímeve, midís shkelqimit e fames, mundes i kurorɛzuar me dafina, dhe u-thye vetem prej vdekjes.

Papa Kalisti III, pɛr tɛ cilin historianɛt thonɛ qɛ ish i matur nɛ fjalɛt sa kurrɛ s' e kishin degjuar tɛ flasɛ me lajka, a pɛr tɛ bɛrɛ qefin e nonjéjt (2), i shkruante Skenderbeut mɛ 11 tɛ Shta-

1.—"Georg Castrioto gilt, wie jedermann weiss fuer einem der vollendetsten, gluecklichsten und groessten Kriegsmeistern aller Zeiten." Fallmerayer vell. 8, f. 732.

2.—"In dicendis sententiis ita gravis, ut nihil unquam per adulationem et gratiam locutus sit." Spondanus, Annales Ecclesiastici, dhe Duponcet, Histoire de Scanderbeg, préface.

Digitized by Google

Digitized by Google

Digitized by Google

Digitized by Google

Digitized by Google

UNIVERSITY OF CHICAGO
59 517 134

Digitized by Google